



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 111

Tiranë – E martë, 30 korrik 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 46/2019, datë 18.7.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar..... 8227
Dekret i Presidentit nr. 11238, datë 26.7.2019	Për shpallje ligji..... 8231
Ligj nr. 49/2019 datë 18.7.2019	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e Zbatimit të Projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV..... 8231
Dekret i Presidentit nr. 11239, datë 26.7.2019	Për shpallje ligji..... 8249
Ligj nr. 56/2019 datë 18.7.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar... 8249
Dekret i Presidentit nr. 11240, datë 26.7.2019	Për shpallje ligji..... 8252
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 25.7.2019	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Federatës së Shën Kristoferit (St. Kitts) dhe Nevisit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të zakonshme..... 8253
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 25.7.2019	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e Zbatimit të Projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për grantin WBIF, për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV..... 8256

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 25.7.2019	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e Zbatimit të Projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për masat shoqëruese në kuadër të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale IV.....	8266
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 25.7.2019	Për miratimin e udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023, i rishikuar.....	8274
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 25.7.2019	Për miratimin e rregullores “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI)”	8345
Vendim qarkullues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 23, datë 12.7.2019	Për përjashtimin nga skema dhe revokimin e certifikatës së sigurimit të depozitave të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a., të përthithur nga Banka Union sh.a.....	8370
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Edison Çera.....	8371



LIGJ
Nr. 46/2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 10 006, DATË 23.10.2008,
“PËR MBROJTJEN E FAUNËS SË
EGËR”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Emërtimi i ligjit ndryshohet dhe bëhet: “Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”.

Neni 2

1. Kudo në ligj, emërtimet: “Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve”, “Policia Pyjore” dhe “Drejtoria e Shërbimit Pyjor” zëvendësohen, përkatësisht, me: “agjencia përgjegjëse për monitorimin e mjedisit”, “struktura inspektuese, që mbulon fushën e pyjeve” dhe “struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki”.

2. Kudo në ligj, fjalët: “ligji nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për substancat dhe preparatet kimike”” zëvendësohen me fjalët: “legjislacionin në fuqi për menaxhimin e kimikateve”; fjalët: “ligji nr. 9537,

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 maj 1992, “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër”, e ndryshuar. Numri CELEX 31992L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 206, datë 22.7.1992, faqe 7-50.

Direktivën 2009/147/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 30 nëntor 2009, “Për konservimin e shpendëve të egër”, e ndryshuar. Numri CELEX 32009L0147, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 20, datë 26.1.2010, faqe 7-25.

datë 18.5.2006, “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”” zëvendësohen me fjalët: “legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; fjalët: “ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar”, zëvendësohen me fjalët: “legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura”; fjalët: “ligji nr. 7908, datë 5.4.1995, “Për peshkimin dhe akuakulturën”, i ndryshuar”, zëvendësohen me fjalët: “legjislacionin në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën”.

Neni 3

Në nenin 1, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Ky ligj ka për qëllim konservimin e faunës së egër, mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e saj, me synimin për të siguruar llojet, popullatat, habitatet, ku kjo faunë e egër jeton, si dhe për të plotësuar kërkesat e saj për ushqim, strehim e shumim, duke siguruar, në të njëjtën kohë, edhe rrugët e saj të shtegtit.”.

2. Pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Nëpërmjet këtij ligji, synohet:

a) ruajtja ose rivendosja në gjendje të favorshme e habitateve natyrore dhe llojeve të faunës së egër, me interes për Komunitetin Evropian;

b) sigurimi i vlerësimit të gjendjes së biodiversitetit në Shqipëri dhe i mekanizmave për monitorimin e kësaj gjendjeje;

c) krijimi i një sistemi, me qëllim mbrojtjen dhe konservimin afatgjatë të karakteristikave që do të shërbejnë si bazë për përcaktimin e zonave potenciale për t’u shpallur zona të mbrojtura;

ç) sigurimi i një kuadri ligjor dhe institucional për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për të mirën e brezave të sotëm e të ardhshëm, duke minimizuar degradimin e habitateve dhe shqetësimet ndaj llojeve, i cili të ndikojë në arritjen e statusit të tyre të favorshëm të ruajtjes;

d) kontributi në konservimin e gjendjes natyrore të tokës, konservimin e cilësisë, sasisë dhe disponueshmërisë së ujit, mirëmbajtjen e atmosferës, prodhimin e oksigjenit dhe mirëmbajtjen e klimës.”.



Neni 4

Në nenin 2, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. ‘Konservim’ është tërësia e masave të ndërmarra për të mirëmbajtur ose rivendosur për një afat të gjatë kohor, në një status të favorshëm ruajtjeje, habitatet natyrore dhe popullatat e llojeve të florës dhe faunës së egër.”.

2. Pas pikës 2, shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/1. ‘Zonë’ është një hapësirë e përcaktuar gjeografike, shtrirja e së cilës përshkruhet me hollësi në aktin e shpalljes së saj si e tillë.

2/2. ‘Statusi i ruajtjes së një lloji, ekosistemi, habitatit natyror apo peizazhi’ është gjendja e popullatave të llojit, ekosistemit, habitatit natyror ose peizazhit, që vjen nga tërësia e faktorëve që veprojnë mbi to.”.

3. Pas pikës 9, shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. ‘Status i favorshëm ruajtjeje për një lloj’ është kur:

a) të dhënat dinamike të popullatës për një lloj me interes tregojnë që ai ngelet për një periudhë afatgjatë një përbërës i vlefshëm dhe i aftë i habitateve të tij natyrore;

b) përhapja natyrore e llojeve nuk është pakësuar dhe nuk ka gjasa të pakësohet në të ardhmen e afërt;

c) gjendet dhe, me shumë gjasa, do të vazhdojë të jetë një habitat i përshtatshëm, nga ana e përmasave, për të mbajtur popullatën për një kohë të gjatë.”.

4. Pas pikës 12, shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

“12/1. ‘Monitorimi’ është mbikëqyrja e përcaktuar mirë dhe në mënyrë sistematike e gjendjes së natyrës ose përbërësve të diversitetit biologjik dhe të peizazhit.”.

5. Pas pikës 17, shtohet pika 18, me këtë përmbajtje:

“18. ‘Komisioni’ është Komisioni Evropian.”.

Neni 5

Në nenin 5, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) mirëmbajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje të habitateve natyrore dhe të llojeve të faunës së egër, me interes për Komunitetin Evropian.”.

Neni 6

Në nenin 6, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Sigurimi i rivendosjes e mirëmbajtjes së statusit të favorshëm të ruajtjes për faunën e egër dhe i mbrojtjes së veçantë për llojet e saj, në përputhje me gjendjen konkrete të llojeve e të habitateve ku jetojnë, duke u dhënë status të veçantë mbrojtjeje llojeve:

a) të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje;

b) që kërkojnë vëmendje të veçantë, për arsye të natyrës specifike të habitatit të tyre.”.

Neni 7

Pas nenit 6, shtohet neni 6/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Masat e mbrojtjes për zonat me interes për Komunitetin Evropian

1. Masat specifike të ruajtjes zbatohen në përputhje me planet e menaxhimit, planet zhvillimore dhe detyrimet ligjore ose kontraktuale, që korrespondojnë me kërkesat ekologjike të tipave të habitatit natyror, pas shpalljes së një zone si zonë me interes për Komunitetin Evropian.

2. Çdo plan ose projekt që nuk lidhet drejtpërdrejt, por mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në zonën me interes për Komunitetin Evropian, i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Autoritetet kompetente, sipas përcaktimit në legjislacionin për zonat e mbrojtura, miratojnë planin ose projektin, në kuadër të programit qeverisës, vetëm pasi të konstatohet në raportin e vlerësimit të ndikimit për zonën dhe llojet, se ai nuk do të ndikojë negativisht në integritetin e zonës në fjalë dhe vetëm pas marrjes së mendimit të publikut.

3. Në rastet kur një plan apo projekt duhet të realizohet për arsye të interesit publik, pavarësisht ndikimit negativ në zonën e llojet dhe në mungesë të zgjidhjeve alternative, miratohen masa kompensuese, sipas përcaktimeve në këtë ligj. Këto



masa përcaktohen me urdhër të ministrit, me qëllim sigurimin e koherencës së përgjithshme të rrjetit të zonave me interes për Komunitetin Evropian.”.

Neni 8

Në nenin 7, pas pikës 2, shtohet pikat 3, me këtë përmbajtje:

“3. Ministria, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe/ose agjencitë ligjzbatuese dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, institute të specializuara, organizata jofitimprurëse dhe me persona fizikë e juridikë, harton planet e veprimit për ruajtjen e llojeve të kërcënuara dhe endemike. Planet miratohen me urdhër të ministrit.”.

Neni 9

Në nenin 8, pas pikës 3, shtohen pikat 4 e 5, me këtë përmbajtje:

“4. Për ekosistemet, habitatet, si dhe për llojet e faunës së egër me status mbrojtjeje, që ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, në zona të caktuara mjedisore, sipas hartës së përhapjes së llojit dhe në pyjet e kullotat në administrim të njësisë së qeverisjes vendore, hartohen plane menaxhimi, që miratohen me urdhër të ministrit.”.

5. Kriteret për hartimin e planeve të menaxhimit, si dhe përcaktimin e ekosistemeve, të habitateve dhe llojeve të faunës së egër me status mbrojtjeje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mbrojtjen e faunës.”.

Neni 10

Në nenin 10, titulli dhe pika 1, ndryshohen si më poshtë:

“Neni 10

Mbrojtja nga lëndët, mbetjet e rrezikshme dhe shërbimet

1. Për të shmangur efektet e rënda negative mbi faunën e egër dhe tërësinë gjenetike të saj, mbi habitatet, rrugët e shtegtimin dhe kushtet e shumimit, përdorimi dhe administrimi i lëndëve dhe i mbetjeve të rrezikshme, i kimikateve

bujqësore, veterinarë dhe shërbimeve bëhen në përputhje me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi, që lidhet me substancat dhe preparatet kimike, administrimin e mbetjeve të rrezikshme, shërbimin e mbrojtjes së bimëve, shërbimin veterinar, si dhe duke marrë në konsideratë edhe çështjet specifike, që lidhen me parandalimin e helmimit të shpendëve shtegtarë, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në marrëveshjet në të cilat vendi ynë është palë.”.

Neni 11

Në nenin 13, pas pikës 3, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Masat e marra për të siguruar mbrojtjen e llojeve në vendet e ruajtjes, duke përfshirë mirëmbajtjen e popullatave të llojeve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, në një nivel të përputhshëm me kërkesat ekologjike e shkencore, realizohen duke mbajtur parasysh edhe kërkesat ekonomike, sociale e kulturore, si dhe veçoritë rajonale e lokale.”.

Neni 12

Në nenin 14, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Për shpendët e egër, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për shpendët shtegtarë, ndërmerren masa me qëllim ruajtjen, mirëmbajtjen ose rivendosjen e një diversiteti dhe habitati të mjaftueshëm, nëpërmjet:

a) krijimit të zonave të mbrojtura mjedisore, sipas dispozitave të kuadrit ligjor për zonat e mbrojtura, dhe kuadrit nënligjor, që lidhet me miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes;

b) sigurimit dhe menaxhimit të habitateve, brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura mjedisore, në bazë të nevojave ekologjike;

c) krijimit të biotopeve dhe rivendosjes së biotopeve të shkatërruara.”.

Neni 13

Në nenin 19, pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Përdorimi i karremeve helmuese për asgjësimin e llojeve të faunës së egër.”.



Neni 14

Në nenin 33, pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Procesi i inventarizimit koordinohet dhe mbikëqyret nga ministria, me pjesëmarrjen e AKZM-së, strukturave përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, instituteve kërkimore-shkencore, OJF-ve dhe të shoqatave që mbulojnë fushën e biodiversitetit.”.

Neni 15

Në nenin 35, pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Ministria koordinon dhe mbikëqyr monitorimin e llojeve të faunës së egër dhe të habitateve të tyre, përfshirë monitorimin e kapjeve apo vrasjeve aksidentale të llojeve të faunës me interes për Komunitetin Evropian, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e listave të tipave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Komunitetin Evropian.”.

Neni 16

Pas nenit 35, shtohet neni 35/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 35/1

Këshilli Kombëtar i Faunës së Egër

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen e faunës, ngrihet Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër, si një organ konsultativ, për të kontribuar në lehtësimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.

2. Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër drejtohet nga zëvendësministri i ministrisë përgjegjëse për faunën e egër dhe në përbërje të tij ka përfaqësues nga:

- a) ministria përgjegjëse për mbrojtjen e faunës;
- b) ministritë e linjës, fusha e përgjegjësisë së të cilave lidhet me mbrojtjen e faunës;
- c) organizatat jofitimprurëse mjedisore të fushës së faunës së egër dhe biodiversitetit;
- ç) federatat dhe shoqatat e gjuetarëve;
- d) universitetet dhe institucionet kërkimore-shkencore.

3. Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër këshillon dhe kontribuon në hartimin e:

- a) programit të inventarizimit të faunës së egër;
- b) programeve për zhvillimin e faunës së egër;
- c) planeve vjetore të mbarështimit të faunës së egër;
- ç) projekteve për zhvillimin e faunës së egër;
- d) kalendarit të gjuetisë;
- dh) listës së specieve objekt gjuetie, për çdo sezon gjuetie;
- e) përcaktimin e kuotave vjetore për speciet objekt gjuetie.

4. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për Faunën e Egër përcaktohet në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit.”.

Neni 17

Në nenin 37, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Metodot, kriteret dhe procedurat për grumbullimin, regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave për faunën e egër miratohen me udhëzim të ministrit. Të dhënat duhet të përfshijnë edhe informacionin për aspektet sociale, ekonomike dhe mjedisore të kafshëve të egra dhe ndikimin mbi banorët lokalë. Personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, paraqesin të dhënat brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së kërkesës, të cilat shoqërohen edhe me shpjegime për interpretimin e tyre, si dhe me rekomandime për zgjidhjen e problemeve.”.

Neni 18

Në nenin 39, pika 1, pas fjalëve: “e faunës së egër”, shtohen fjalët: “dhe për statusin e saj të ruajtjes”.

Neni 19

Në nenin 43, pika 12, ndryshohet si më poshtë:

“12. Shfaroja e llojeve të faunës së egër dhe e popullatave të tyre, në kundërshtim me dispozitat e pikave 7 dhe 10, të nenit 19, të këtij ligji, me gjobë, në masën 100 000 deri në 200 000 lekë.”.

Neni 20

Në nenin 44, pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:



“3. Individët e konfiskuar apo të sekuestruar dorëzohen në qendrat e shpëtimit.”.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.7.2019

Shpallur me dekreten nr.11238, datë 26.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11238, datë 26.7.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 46/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 49/2019

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCave DHE
EKONOMISË (HUAMARRËSI), FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (AGJENCIA
E ZBATIMIT TË PROJEKTIT), DHE KfW
FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR
PROGRAMIN E FURNIZIMIT ME UJË
TË ZONAVE RURALE IV**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja e Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV, me një hua në shumën 40 000 000 (dyzet milionë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.7.2019.

Shpallur me dekreten nr.11239, datë 26.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE HUAJE
E DATËS 3.6.2019

NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCave DHE EKONOMISË (“HUAMARRËSI”) DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR SHUMËN 40.000.000,00 EURO

- Furnizimi me ujë i zonave rurale IV -

BMZ-ID: 2014 67 448
Huaja nr. 29089

PËRMBAJTJA

Preambulë

1.Huaja

2.Kanalizimi i Huas

3.Disbursimi

4.Tarifa



5. Interesi
 6. Shlyerja dhe parapagimi
 7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi
 8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë
 9. Paligjshmëria
 10. Kostot dhe detyrimet publike
 11. Detyrime të veçanta
 12. Përfundimi i Marrëveshjes
 13. Përfaqësimi dhe deklaratimet
 14. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me projektin
 15. Dispozitat e përgjithshme
- Shtojca 1: Grafiku i Disbursimit
- Shtojca 2: Formulari i Opinionit Ligjor të Këshilltarit Ligjor për Huamarrësin
- Shtojca 3a: Zotimet e pajtueshmërisë së Huamarrësit
- Shtojca 3b: Zotimet e Pajtueshmërisë Agjencia e Zbatimit të Projektit

Preambulë

Baza për këtë Marrëveshje Huaje ndërmjet KfW-së, Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit (“Marrëveshja” ose “Marrëveshja e Huas”) është marrëveshja që do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (BF) 2018 për programin e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale IV (“Marrëveshja Qeveritare”).

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ka vënë në dispozicion edhe fonde për masat që shoqërojnë projektin. Për këtë qëllim, KfW-ja, Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit synojnë të lidhin një marrëveshje të veçantë financimi.

Projekti do të bashkëfinancohet nga Fondi i Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor (FPEBP) nën Kuadrin e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (KIBP). Për këtë qëllim, KfW-ja, Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit synojnë të lidhin një marrëveshje të veçantë financimi (Marrëveshja e Financimit të KIBP-së).

KfW-ja do të rifinancojë Huan e dhënë në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, me subvencione interesi nga fonde buxheti me interes të ulët të dhëna nga Republika Federale e Gjermanisë për projekte që përmbushin kriteret e

pranimit të politikave të zhvillimit. Termat dhe kushtet e Huas pajtohen me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes për njohjen si Asistencë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

Mbi këtë bazë dhe me kushtin që Republika Federale e Gjermanisë ofron një garanci për Huan, KfW-ja do të japë një Hua në pajtim me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje.

1. Huaja

1.1 Shuma. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një Hua që nuk kalon një shumë totale prej **40.000.000,00 euro (“Huaja”)** (me fjalë: **dyzet milionë euro**)

1.2 Qëllimi. Huamarrësi do të kanalizojë Huan plotësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit do të përdorë Huan ekskluzivisht për rehabilitimin dhe shtrirjen e sistemeve të ujësjellësve dhe kanalizimeve, duke përfshirë trajtimin e ujërave të zeza, si dhe për shërbime të konsulentit zbatues (“Projekti”). Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë e Projektit, si dhe furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga Huaja me anë të një marrëveshje e veçantë (“Marrëveshja e Veçantë”) që do të kundërfirmoset nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.3 Taksat, detyrimet, tatimet doganore. Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të shlyhen nga Huamarrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, si dhe tatimet doganore nuk do të financohen nga Huaja.

2. Kanalizimi i Huas

2.1 Marrëveshja kanalizuese. Huamarrësi e kanalizon Huan tek Agjencia e Zbatimit të Projektit si grant të pashlyeshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Përkthimi i vërtetuar. Para disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të vërtetuar të marrëveshjes së financimit të specifikuar në nenin 2.1

2.3 Detyrimi i Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Kanalizimi i Huas nuk përbën detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Disbursimi

3.1 Kërkesat për disbursim. Sapo të përmbushen të gjitha kushtet paraprake për disbursimin sipas nenit



(*Kushtet paraprake të disbursimit*), KfW-ja do të disbursojë Huan në pajtim me progresin e Projektit dhe me kërkesën e Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Disbursimet do të bëhen në përputhje me grafikun e disbursimit të parashikuar në shtojcën 1 (*Grafiku i Disbursimit*) të kësaj Marrëveshjeje Huaje. KfW-ja do të kryejë disburse vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo gjashtë muaj. Në masën që Agjencia e Zbatimit të Projektit kërkon disburse për shuma më të vogla brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, shumat e padisbursuara mund të kërkojnë në ndonjë prej periudhave gjashtëmujore pasuese. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disburse në një shumë më të ulët se 200.000,00 euro.

3.2 *Afati për kërkimin e disburseve.* KfW-ja ka të drejtë të refuzojë kryerjen e disburseve pas datës 30.3.2024.

3.3 *Kushtet paraprake të disbursimit.* KfW-ja është e detyruar të kryejë disburse sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm me përmbushjen e kushteve të mëposhtme paraprake në formë dhe përmbajtje të pranueshme për KfW-në:

a) Huamarrësi do të ketë provuar në një formë të pranueshme për KfW-në, me anë të paraqitjes së një opinionit ligjor, përmbajtja e të cilit është kryesisht në përputhje me modelin në shtojcën 2 (*Modeli i Opinionit Ligjor të Këshilltarit Ligjor për Huamarrësin*), si dhe paraqitjes së kopjeve të vërtetuara (secila me një përkthim zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet ky opinion ligjor, se Marrëveshja e Huas dhe e Projektit është ligjrisht efektive dhe e zbatueshme dhe në veçanti se:

i) Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas të drejtës së tij kushtetuese dhe dispozitave ligjore të tjera të zbatueshme për përmbushjen e vlefshme të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

ii) KfW-ja është e përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesi dhe të gjitha detyrimet, komisionet dhe kostot e ngjashme në Republikën e Shqipërisë për dhënien e Huas;

b) KfW-ja zotëron një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje, të nënshkruar me fuqi ligjrisht detyruese;

c) modelet e nënshkrimeve të përmendura në nenin 0 (*Përfaqësimi i Huamarrësit dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit*) janë marrë nga KfW-ja;

d) garancia nga Republika Federale e Gjermanisë e përmendur në nenin 0 (*Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë*) është në fuqi dhe efekt pa kufizim;

e) Huamarrësi ka paguar Tarifën e Menaxhimit të përcaktuar në nenin 0 (Tarifat e Menaxhimit);

f) nuk ka ndodhur asnjë arsye për zgjidhjen e Marrëveshjes, as ndonjë incident që do të përbënte shkak për zgjidhjen e Marrëveshjes me anë të njoftimit ose skadimit ose konstatimit apo plotësimit të një kushti (arsye e mundshme për zgjidhjen e Marrëveshjes); dhe

g) nuk kanë lindur rrethana të jashtëzakonshme që parandalojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

Para disbursimit nga Huaja, KfW-ja ka të drejtën të kërkojë dokumente dhe prova të tjera që i çmon të nevojshme sipas diskrecionit të saj për të konstatuar kushtet paraprake për disbursimin, të përcaktuara në këtë seksion.

3.4 Detaje të procedurës së disbursimit. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e procedurës së disbursimit në Marrëveshjen e Veçantë që do të kundërfirmoset nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe në veçanti të dhëna që duhet të jepen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, të cilat dokumentojnë se shumt e Huas së kërkuar përdoren për qëllimin e rënë dakord.

3.5 E drejta për anulimin e disbursimit. Në bazë të përmbushjes së detyrimeve të tij sipas nenit 0, (Detyrime të veçanta), Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të Huas me miratimin paraprak të KfW-së kundrejt pagesës së Kompensimit të mospranimit në pajtim me dhe siç përcaktohet në nenin 0 (Kompensimi i mospranimit).

3.6 Kompensimi i mospranimit. Nëse Huamarrësi anulon disbursimin e një shume të Huas për të cilën një normë interesi është përcaktuar tashmë sipas nenit 0 (E drejta për anulimin e disbursimit) ose nëse shuma e kësaj Huaje nuk disbursohet ose nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në nenin 0 (Afati për kërkimin e disburseve), Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, sipas kërkesës së saj, shumën që është e nevojshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar



nga KfW-ja si rezultat i mosdisbursimit të shumës së Huas (“Kompensimi i mospranimit”), me përjashtim të rasteve kur mosdisbursimi përbën shkelje të kësaj Marrëveshje nga KfW-ja. KfW-ja do të llogarisë shumën e Kompensimit të Mospranimit dhe do t’ia komunikojë Huamarrësit.

4. Tarifa

4.1 Tarifa e Angazhimit. Huamarrësi do të paguajë një tarifë të pakthyeshme angazhimi prej 0.25% në vit (“Tarifa e Angazhimit”) për shumat e padisbursuara të Huas.

Tarifa e Angazhimit është e kërkueshme për pagesë në bazë gjashtëmujore në datat 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, për herë të parë në datën 15 maj 2020, por jo më parë se në datën përkatëse pas datës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt në bazë të nenit 0 (*Hyrja në fuqi dhe efekt*).

Tarifa e Angazhimit do të përlogaritet, nëse është rasti, edhe me efekt prapaveprues, për periudhën që fillon dymbëdhjetë muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të zgjasë deri në datën e disbursimit të plotë të Huas ose nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit të plotë të disbursimeve nga Huaja.

4.2 Tarifa e menaxhimit. Huamarrësi do t’i paguajë KfW-së një tarifë të përgjithshme, të njehershme dhe të pakthyeshme menaxhimi të barabartë me 1% të shumës së Huas të përcaktuar në nenin 0 (*Shuma*) (“Tarifa e Menaxhimit”).

Tarifa e Menaxhimit është e pagueshme në rastin më të hershëm të të dyja datave të mëposhtme: i) para disbursimit të parë ose ii) pas kalimit të tre muajve që prej nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja ose me kalimin e një periudhe njëmujore pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi dhe efekt (cilado nga datat e përcaktuara sipas pikës “ii” është më e vonshme). Tarifa e Menaxhimit është e kërkueshme për pagesë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nëse Huaja është disbursuar plotësisht ose vetëm pjesërisht ose nëse nuk është disbursuar.

5. Interesi

5.1 Interesi Huamarrësi do t’i paguajë KfW-së interes si më poshtë:

Normë fikse e interesit e caktuar me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huas. Huamarrësi do të paguajë normë interesi mbi Huan në një normë (“Normë Fikse Interesi”) e përcaktuar nga KfW-ja në ditën e dytë të punës pas datës së marrjes së njoftimit të parashtruar në nenin 15.10 (*Hyrja në*

fuqi dhe efekt) të kësaj Marrëveshjeje deri kur kryhet shlyerja e kështit të fundit në përputhje me grafikun e shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1 (Grafiku i shlyerjes). KfW-ja do t’i njoftojë Huamarrësit, Normën Fikse të Interesit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përcaktimi i saj.

5.2 Llogaritja e interesit. Interesi për një shumë të disbursuar të Huas do të faturohet nga data (duke e përjashtuar) në të cilën shuma përkatëse e Huas disbursohet nga llogaria e Huas që mbahet te KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (përfshirë) në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së të përcaktuar këtu në nenin 0 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit). Interesi do të llogaritet në pajtim me nenin 0 (Llogaritja).

5.3 Datat e pagesës. Interesi do të jetë i kërkueshëm në shuma të prapambetura për pagesë në datat e përcaktuara më poshtë (secila e referuar si “Datë pagese”):

a) para datës së kërkueshme të kështit të shlyerjes së parë, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, por jo më parë se në Datën e Pagesës pas datës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt në bazë të nenit 0 (*Hyrja në fuqi dhe në efekt*);

b) në datën e kërkueshme të kështit të shlyerjes së parë sipas nenit 0 (Grafiku i shlyerjes) së bashku me këtë kësht;

c) më pas, në datat e kërkueshme të kështeve të shlyerjes sipas nenit 0 (Grafiku i shlyerjes).

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 Grafiku i shlyerjes

Huamarrësi do të shlyejë Huan si më poshtë:

Data e kërkueshme	Kësti i shlyerjes
15.11.2022	1.600.000,00
15.05.2023	1.600.000,00
15.11.2023	1.600.000,00
15.05.2024	1.600.000,00
15.11.2024	1.600.000,00
15.05.2025	1.600.000,00
15.11.2025	1.600.000,00
15.05.2026	1.600.000,00
15.11.2026	1.600.000,00
15.05.2027	1.600.000,00
15.11.2027	1.600.000,00
15.05.2028	1.600.000,00
15.11.2028	1.600.000,00
15.05.2029	1.600.000,00
15.11.2029	1.600.000,00
15.05.2030	1.600.000,00



15.11.2030	1.600.000,00
15.05.2031	1.600.000,00
15.11.2031	1.600.000,00
15.05.2032	1.600.000,00
15.11.2032	1.600.000,00
15.05.2033	1.600.000,00
15.11.2033	1.600.000,00
15.05.2034	1.600.000,00
15.11.2034	1.600.000,00

6.2 Shumat e padisbursuara të Huas. Shumat e padisbursuara të Huas do të kompensohen kundrejt kështit përkatës të fundit të shlyerjes, në pajtim me grafikun e shlyerjes të përcaktuar në nenin 0 (Grafiku i shlyerjes) përveç kur KfW-ja, sipas diskrecionit të saj, zgjedh një alternativë tjetër kompensimi në raste të veçanta.

6.3 Shlyerjet në rast të disbursimit të plotë. Nëse një kësht shlyerjeje është i kërkueshëm para disbursimit të plotë të Huas, kjo nuk do të cenojë grafikun e shlyerjes, në bazë të nenit 0 (Grafiku i shlyerjes) për sa kohë që kështi i shlyerjes i kërkueshëm në pajtim me grafikun e shlyerjes është më i vogël se shuma e Huas e disbursuar dhe ende e pashlyer (“Shuma e papaguar e Huas”). Nëse kështi i shlyerjes i kërkueshëm në pajtim me nenin 0 (Grafiku i shlyerjes) tejkalon Shumën e Papaguar të Huas, ky kësht shlyerjeje do të ulet në nivelin e Shumës së Papaguar të Huas dhe diferenca do të shpërndahet në mënyrë të barabartë për kështet e shlyerjes ende të papaguara. Në llogaritjen e Shumës së Papaguar të Huas, KfW-ja rezervon të drejtën për të konsideruar disbursimet nga Huaja që kryhen brenda një periudhe prej 45-ditësh ose me pak ditë para një date pagese për përcaktimin e shumës së papaguar të Huas, vetëm për Datën e ardhshme pasuese të Pagesës.

6.4 Parapagimi. Sa më poshtë zbatohen për parapagimet:

a) E drejta për parapagim. Huamarrësi, në pajtim me paragrafët e mëposhtëm 0 b) (Njoftimi) deri te 0 e) (Kompensimi) ka të drejtë të shlyejë shuma Huaje para datës së kërkueshme të planifikuar nëse ky parapagim është të paktën në shumën e një kështi shlyerjeje në pajtim me nenin 0 (Grafiku i shlyerjes);

b) Njoftimi. Një parapagim i një shume Huaje në pajtim me nenin 0 a) (E drejta për parapagim) i nënshtrohet një njoftimi parapagimi nga Huamarrësi drejtuar KfW-së, jo më vonë se Dita e Punës (siç përcaktohet në nenin 0 (Dita e Punës) e

pesëmbëdhjetë para datës së synuar të parapagimit. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të caktojë datën dhe shumën e parapagimit dhe detyron Huamarrësin t’i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e deklaruar;

c) Kompensimi i parapagimit. Nëse Huamarrësi parapaguan një shumë Huaje me normë fikse interesi, Huamarrësi, do t’i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesë, shumën që është e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar nga KfW-ja si rezultat i këtij parapagimi (“Kompensimi i parapagimit”). KfW-ja do të përcaktojë shumën e Kompensimit të Parapagimit dhe do t’ia komunikojë Huamarrësit. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja do t’i japë Huamarrësit një të dhënë të shumës së tarifës së parapagimit para njoftimit të kërkuar të parevokueshëm për shlyerjen në bazë të nenit 0 b) (Njoftimi);

d) Shumat e kërkueshme. Së bashku me parapagimin në pajtim me nenin 0 a) (E drejta për parapagim), Huamarrësi do të paguajë shumat e mëposhtme:

i) çdo Kompensim Parapagimi të kërkueshëm si rezultat i parapagimit në pajtim me nenin 0 c) (Kompensimi i parapagimit); dhe

ii) të gjithë interesin e mbledhur mbi shumën e papaguar të Huas dhe çdo pagesë tjetër ende të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje që është akumuluar deri në datën e parapagimit;

e) Kompensimi. Neni 0 (Shumat e padisbursuara të Huas) zbatohet *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimeve.

6.5 Grafiku i rishikuar i shlyerjeve. Në rastin kur zbatohet neni 0 (Shlyerjet në rast të disbursimit të plotë) ose neni 0 (Parapagimi), KfW-ja do t’i dërgojë Huamarrësit një grafik të rishikuar shlyerjeje që do të bëhet pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 Llogaritja. Interesi, Tarifa e Angazhimit, kamatëvonesa në pajtim me nenin 0 (Kamatëvonesa), kompensimi i plotë për shumat e prapambetura në pajtim me nenin 0 (Kompensimi me shumë të plotë), Kompensimi i Mospranimit dhe Kompensimi i Parapagimit do të llogariten mbi bazën e një viti me 360 ditë, me muaj me tridhjetë ditë.

7.2 Data e kërkueshme. Nëse një pagesë që



duhet të kryhet në lidhje me këtë Marrëveshje bëhet e kërkueshme në një datë që nuk është Ditë Pune, Huamarrësi duhet ta kryejë këtë pagesë në Ditën pasuese të Punës. Nëse Dita pasuese e Punës bie në muajin e ardhshëm kalendarik, kjo pagesë duhet të kryhet në Ditën e fundit të Punës të muajit kalendarik aktual.

7.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit. Huamarrësi do të çlirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje, nëse dhe deri në masën që shumat përkatëse do t'i jenë kredituar KfW-së në disponim të saj të lirë pa asnjë zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10:00 paradite në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, në llogarinë e KfW-së në Frankfurt am Main, Republika e Gjermanisë, numër IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01 që përcakton datën e kërkueshme si një referencë shtesë (Ref. VVVVMMDD).

7.4 Kundërpretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të ngrejë asnjë pretendim mbajtjeje ose kompensimi apo të drejta të ngjashme ndaj detyrimeve për pagesa sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse këto të drejta nuk njihen nga një gjykim deklarues ose nuk miratohen nga KfW-ja.

7.5 Kamatëvonesa. Nëse ndonjë këst shlyerjeje ose parapagim në pajtim me nenin 0 (Parapagimi) nuk janë në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të caktojë kamatëvonesë në normën prej 200 pikësh bazë mbi Normën Fikse të Interesit në vit të përcaktuar në nenin 0 (Interesi) për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën në të cilën këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 0 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit). Kjo kamatëvonesë duhet të paguhet menjëherë me kërkesën fillestare të KfW-së.

7.6 Kompensimi me shumë të plotë. Për shumat e prapambetura (me përjashtim të kësteve të shlyerjeve dhe të parapagimeve të përmendura në nenin 0 (Kamatëvonesa), KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë kompensim në shumë të plotë nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës me një normë prej 200 pikësh bazë në vit mbi Normën Fikse të Interesit në bazë të nenit 0 (Interesi) të kësaj Marrëveshjeje. Kompensimi në shumë të plotë duhet të paguhet menjëherë pas kërkesës fillestare të KfW-së. Huamarrësi është i

lirë të provojë që nuk është shkaktuar asnjë dëm ose që dëmet kanë qenë në shumën më të vogla sesa kompensimi në shumë të plotë.

7.7 Kompensimi. KfW-ja ka të drejtë të kompensojë pagesat e marra kundrejt pagesave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshje të tjera huaje të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit. Për të shmangur dyshimet, në veçanti, kjo zbatohet në situata të një mospagimi ose në rast mospagimi të mundshëm nga ana e Huamarrësit.

7.8 Llogaritë e bëra nga KfW-ja. Në mungesë të gabimeve të dukshme, vlerat e llogaritura nga KfW-ja dhe llogaritjet e kryera nga KfW-ja të shumave të kërkueshme në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje përbëjnë të dhëna provuese *prima-facie* (*Anscheinsbeweis*).

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja do të marrë garanci nga Republika Federale e Gjermanisë për pretendimet e pagesave sipas kësaj Marrëveshjeje para disbursimit të parë.

9. Paligjshmëria

Nëse, në ndonjë juridiksion të zbatueshëm, përmbushja e detyrimeve të KfW-së, siç parashikon Marrëveshja ose financimi ose mbajtja e Huas, bëhen të paligjshme, pas njoftimit të Huamarrësit,

a) angazhimi i KfW-së anulohet menjëherë dhe

b) Huamarrësi shlyen të gjithë shumën e Huas së Disbursuar dhe të papaguar në datën e specifikuar nga KfW-ja në njoftimin që i është dërguar Huamarrësit (jo para datës së fundit të ndonjë periudhe mospagimi të zbatueshme që lejon ligji).

10. Kostot dhe detyrimet publike

10.1 Ndalimi i zbritjeve ose i mbajtjeve. Huamarrësi kryen të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje pa asnjë zbritje për taksat, detyrimet e tjera publike ose kosto të tjera. Në rastin kur Huamarrësi është i detyruar me ligj ose për arsye të tjera, të bëjë zbritje ose ndalesa të tilla mbi pagesat, pagesat e kryera nga Huamarrësi do të rriten në atë shumë që është e nevojshme për KfW-në, në mënyrë që të marrë të plotë shumat e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, pas zbritjes së taksave dhe detyrimeve.

10.2 Kostot. Huamarrësi do të mbulojë të gjitha shpenzimet dhe kostot që shkaktohen në lidhje me disbursimin dhe shlyerjen e Huas, veçanërisht kostot e remitancave dhe transferimit (duke



përfshirë tarifat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që shkaktohen në lidhje me mbajtjen ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me këtë Marrëveshje, si dhe të drejtave që burojnë prej saj.

10.3 Taksa dhe detyrime të tjera. Huamarrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë mbi lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje. Nëse KfW-ja parapaguan këto taksa ose detyrime, Huamarrësi do t'i transferojë ato pa vonesë, me kërkesë, në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 0 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit) ose në ndonjë llogari tjetër të përcaktuar nga KfW-ja.

11. Detyrime të veçanta

11.1 Detyrimet e Agjencisë për Zbatimin e Projektit lidhur me Projektin. Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) do të përgatitë, zbatojë, operojë dhe administrojë Projektin në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe teknike, standardet mjedisore dhe sociale, dhe kryesisht në pajtim me konceptimin e Projektit të rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) do t'ia caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të kualifikuar, të pavarur dhe zbatimin e Projektit firmave të kualifikuara;

c) do të japë kontrata për mallra dhe shërbime të që do të financohen nga Huaja (neni 11.1 b) të kësaj marrëveshjeje) pas ofertimit publik konkurrues ndërkombëtar;

d) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe të regjistrave që caktojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

e) do t'i japë mundësinë, në çdo kohë, KfW-së dhe agjentëve të saj që të inspektojnë ata libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër të lidhur me zbatimin dhe operimin e Projektit, si dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet e lidhura me të;

f) do t'i japë KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhëna të mbi Projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm që KfW-ja mund të kërkojë;

g) menjëherë dhe me iniciativë personale,

i) paraqesë KfW-së çdo pyetje të marrë nga

Huamarrësi nga OECD-ja ose anëtarët e tij, sipas të ashtuquajturës “Marrëveshjeje për Transparencën e Kredive ODA të Bashkuara” pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja dhe do të koordinojë përgjigjet e këtyre pyetjeve me KfW-në dhe

ii) njoftojë KfW-në mbi të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit.

11.2 Detaje të Zbatimit të Projektit. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë në lidhje me nenin 11.1 me Marrëveshjeje të Veçantë që do të kundërfirmoset nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

11.3 Detyrime të përbashkëta lidhur me projektin. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) do të garantojnë financimin e plotë të Projektit dhe do t'i japin KfW-së, sipas kërkesës, të dhëna që provojnë se kostot e paguara nga kjo Hua janë mbuluar dhe

b) menjëherë dhe me iniciativën e tyre do të njoftojnë KfW-në në lidhje me të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit.

11.4 Detyrimet e Huamarrësit në lidhje me Projektin. Huamarrësi do të ndihmojë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike për zbatimin e Projektit dhe përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, do t'i japë Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit.

11.5 Pajtueshmëria. Huamarrësi merr përsipër të zbatojë kurdoherë detyrimet e parashtruara në shtojcën 3a (Zotimet e pajtueshmërisë së Huamarrësit). Agjencia e Zbatimit të Projektit merr përsipër të zbatojë kurdoherë detyrimet e parashtruara në shtojcën 3b (Zotimet e pajtueshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit).

11.6 Transporti i furnizimeve. Dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen Qeveritare që janë të njohura për Huamarrësin dhe Agjencinë e Zbatimit të Projektit do të zbatohen për transportin e mallrave që financohen nga Huaja.

11.7 Renditje *pari passu*. Huamarrësi garanton dhe përfaqëson se detyrimet e tij sipas kësaj



Marrëveshjeje klasifikohen dhe do të shlyhen të paktën *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera të pasiguruara dhe jo të varura, dhe Huamarrësi do të garantojë në masën e lejuar me ligj që kjo renditje të garantohet edhe për të gjitha detyrimet e ardhshme të pasiguruara dhe jo të varura. Në këtë Marrëveshje, “Borxh i jashtëm” sipas përcaktimit të KfW-së nënkupton një detyrim të Huamarrësit, i cili:

- i) udhëhiqet nga një sistem ligjesh që nuk janë ato të Huamarrësit; ose
- ii) është i pagueshëm në një monedhë që nuk është ajo e vendit të Huamarrësit; ose
- iii) është i pagueshëm ndaj një personi të regjistruar, me vendqëndrim, rezident ose me zyra qendrore ose vend të parë biznesi jashtë vendit të Huamarrësit.

11.8 Pengjet. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të krijojnë ose lejojnë vazhdimin e ndonjë pengu mbi sendet pasurore të Projektit pa pëlqimin paraprak të KfW-së. Në këtë Marrëveshje “Peng” nënkupton një hipotekë, zotim, peng, tarifë, delegim ose transferim përmes sigurimit, hipotekimit ose interesit të garancisë, dhe çfarëdolloj kontrate apo marrëveshje tjetër, efektet e së cilës krijojnë një garanci ose të drejtë që akordon një prioritet pagese në lidhje me një detyrim ndaj një personi.

Ky detyrim nuk zbatohet në rastet e:

- i) detyrimeve ekzistuese ose që janë rënë dakord me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe u janë bërë të ditura KfW-së para nënshkrimit të Marrëveshjes;
- ii) detyrimeve që krijohen gjatë ecuresë normale të punës në kuadër të rregulloreve ligjore ose rregulloreve specifike kontraktuale për të siguruar detyrime (me përjashtim të detyrimeve nga huatë) ndaj furnitorëve ose ofruesve të tjerë të shërbimeve (p.sh. mbajtjen e të drejtave mbi tituj të zakonshëm në industri dhe barrët ligjore);
- iii) detyrimeve që ekzistojnë në kohën që një pasuri është blerë, me kusht që këto detyrime të shlyhen brenda tre muajve pas blerjes.

11.9 Në rast se AZP-ja i jep një pale të tretë garanci dhe të drejta të tjera që i mundësojnë palës së tretë të kërkojë përmbushje preferenciale të pretendimeve ndaj një pasurie, pronësie ose të ardhurave të Programit, KfW-ja mund të japë pëlqimin e saj në rast se Huamarrësi dhe/ose AZP-ja i japin edhe KfW-së garanci (shitesë) në të njëjtën

masë që siguron në mënyrë të barabartë dhe në të njëjtën vlerë pretendimet e KfW-së ndaj Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje të Huas.

Shitja e sendeve pasurore. Pa pëlqimin paraprak të KfW-së, as Huamarrësi, as Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të shesin një send pasuror të Projektit derisa detyrimet e huamarrësit të jenë përmbushur plotësisht.

12. Zgjidhja e Marrëveshjes

12.1 Arsyet për përfundim. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara në nenin 0 (Pasoja ligjore të ndodhjes së një arsyeje për zgjidhjen e Marrëveshjes), nëse lind një rrethanë që përbën shkak të rëndësishëm (*Wichtiger Grund*). Këto përfshijnë, në veçanti, rrethanat e mëposhtme:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet e pagesës ndaj KfW-së kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes të Veçantë, si dhe ndonjë marrëveshjeje tjetër ligjërisht detyruese ndaj kësaj Marrëveshjeje, janë shkelur;

c) kjo Marrëveshje ose ndonjë pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyrues ndaj Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit ose nuk mund të jetë më e zbatueshme ndaj Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit;

d) ndonjë deklaratë, konfirmim, informacion, përfaqësim ose garanci e konsideruar nga KfW-ja thelbësore për dhënien dhe mbajtjen e Huas, rezulton e rreme, çorientuese ose e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje;

f) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se shumata e Huas janë përdorur për qëllimin e caktuar;

g) Huamarrësi ndërpret pagesat e tij ndaj kreditorëve, nuk ka aftësi paguese ose fillon bisedimet me një ose më shumë prej kreditorëve të Huamarrësit mbi një moratorium, heqje dorë nga borxhet e papaguara, shtyrje të pagesave ose ndërprerje të shërbimit të borxhit;

h) nëse ka ndodhur një prej rasteve të përmendura në Marrëveshjen e Financimit të KIBP-së që i jep të drejtë KfW-së të pezullojë menjëherë disbursimet ose të kërkojë shlyerje të fondeve të disbursuara sipas Marrëveshjes së Financimit të KIBP-së.

12.2 Pasoja ligjore të ndodhjes së një arsyeje



për zgjidhjen e Marrëveshjes. Nëse ka ndodhur një prej rasteve të përmendura në nenin 0 (Arsyet për përfundim), KfW-ja mund të pezullojë menjëherë disbursimet sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse ky rast nuk është zgjidhur brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 0 a) ose në të gjitha rastet e tjera të specifikuara në nenin 0 (Arsyet për përfundim) 11.1/a) brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja që gjithsesi duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të zgjidhë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, me pasojën që detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje pushojnë dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të plotë ose të pjesshme të Shumës së Papaguar të Huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje. Nenet 0 (Kamatëvonesa) dhe 0 (Kompensimi me shumë të plotë) zbatohen për shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 Kompensimi për dëmet. Nëse kjo Marrëveshje zgjidhet pjesërisht ose tërësisht, Huamarrësi do të paguajë Kompensimin e mospranimit në përputhje me nenin 0 (Kompensimi i mospranimit) dhe/ose Kompensimin e parapagimit në përputhje me nenin 0 c) (Kompensimi i parapagimit).

13. Përfaqësimi dhe deklarimet

13.1 Përfaqësimi i Huamarrësit. Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj përfaqësojnë Huamarrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me anë të modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje dhe zbatimin e Projektit dhe kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të skadojë nëse revokimi i saj i shprehur nga përfaqësuesi i Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit të autorizuar në atë kohë, nuk është marrë nga KfW-ja.

13.2 Adresat: Deklarimet ose njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen si kopje origjinale ose me përjashtim të kërkesave për disbursime, me faks. Të gjitha njoftimet ose deklarimet e tjera të bëra në

lidhje me këtë Marrëveshje, duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW

Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Germany (Gjermani)
Faks: +49 69 7431-2944

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi Dëshmoret e Kombit, nr. 3
Tiranë
Shqipëri
Faks: +355 42228494
Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit
Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rr. “Samë Frashëri” 10
Telefon: +355 4234 885
Faks: +355 4234 885

13.3 Ndryshimet Ministri i Financave dhe Ekonomisë autorizohet të nënshkruajë çdo amendament që miratohet nga Këshilli i Ministrave. Amendimet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm periudhën e disponibilitetit (neni 3.2), nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave dhe as ratifikim. Amendamentet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit nuk kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

14. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me projektin

14.1 Publikimi i informacioneve lidhur me projektin nga KfW-ja. Për të qenë në përputhje me parimet e pranura në nivel ndërkombëtar për transparencë dhe efikasitet maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Projektin dhe mënyrën sesi është financuar gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa zbatohen marrëveshjet lidhur me Projektin dhe me fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës së Zhvillimit të KfW-së (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/en>).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja, ose palët e treta në pajtim me nenin për 0 (Transferimi



i informacioneve lidhur me projektin te palët e treta dhe publikimi i tyre) më poshtë), në lidhje me Projektin dhe mënyrën sesi financohet nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të detajuar sensitiv financiar ose biznesi në lidhje me palët e përfshira në Projekt ose financimin e tij, të tilla si

- a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;
- b) strategjitë e biznesit;
- c) udhëzime dhe raportet e brendshme të korporatës;
- d) të dhënat personale të personave fizikë;
- e) vlerësimin e brendshëm të KfW-së mbi pozicionin financiar të palëve.

14.2 Transferimi i informacioneve lidhur me projektin te palët e treta. KfW-ja ndan informacione të përzgjedhura mbi Projektin dhe mënyrën sesi është financuar gjatë Periudhës së Plotë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet me subjektet e poshtëpërmendura:

- a) filialet e KfW-së;
- b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet e saj kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet;
- c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;
- d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarëve të tyre, në veçanti, Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;
- e) palët në Kushtet e Përgjithshme të FPEBP-së;
- f) institucionet që administrojnë FPEBP-së;
- g) Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij.

14.3 Transferimi i informacioneve lidhur me projektin te palët e treta dhe publikimi i tyre. Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Projektin dhe mënyrën sesi financohet përgjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, që publikojnë seksionet që lidhen me qëllimin:

- a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Iniciativës së Transparencë së Ndihmës Ndërkombëtare (http://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen_fakten/transparenz-fuer-mehr

[Wirksamkeit/Transparenzstrategie/index.html](http://www.wirksamkeit-transparenzstrategie/index.html))

- b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI), për qëllime të informacionit të tregut (http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/welc_ome.html)

- c) OECD për qëllimin e raportimit të flukseve /qarkullimeve financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim (<http://www.oecd.org/>)

- d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal), për qëllime të vlerësimit të bashkëpunimit të përgjithshëm të zhvillimit gjerman për të garantuar transparencë dhe eficiencë (<https://www.deval.org/en/>);

- e) palët në Kushtet e Përgjithshme të FPEBP-së;

- f) institucionet që administrojnë FPEBP-në;
- g) Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij.

14.4 Transferimi i informacioneve lidhur me projektin te palët e treta (përfshirë publikimin e tyre). KfW-ja, gjithashtu, rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me projektin dhe mënyrën se si financohet ai gjatë Periudhës së Plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshme të Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit në informacionin që nuk transferohet i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshme të Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit, në veçanti, përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 0 (Publikimi i informacioneve lidhur me projektin nga KfW-ja), i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion te palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregullatore ose për të pohuar ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

15. Dispozitat e përgjithshme

15.1 Dita e Punës. Nëse i referohet kësaj Marrëveshjeje në lidhje me një “Ditë Pune”, kjo do të thotë një ditë e ndryshme nga e shtuna ose e diela në të cilën bankat tregtare në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, janë të hapura për biznes të përgjithshëm.



15.2 Vendi i përmbushjes. Vendi i përmbushjes për të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje është Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë.

15.3 Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose nëse ekziston një boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të saj. Palët e kësaj Marrëveshjeje do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme ligjërishit që është sa më afër frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët do të plotësojnë çdo boshllëk në dispozita me një dispozitë ligjërishit të vlefshme që është sa më afër frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

15.4 Ndryshimet me shkrim. Ndryshimet dhe shtesat në këtë Marrëveshje duhet të bëhen me shkrim. Palët mund të heqin dorë nga kjo kërkesë me shkrim vetëm me anë të formës me shkrim.

15.5 Transferimi. As Huamarrësi, as Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të delegojnë ose transferojnë, rëndojnë me peng ose hipotekë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje Huaje.

15.6 Ligji i zbatueshëm. Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji gjerman.

15.7 Periudha e kufizimit/parashkrimit. Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje skadojnë pas pesë vjetësh nga fundi i vitit në të cilën ky pretendim ka lindur dhe kur KfW-ja ka marrë dijeni për rrethanat që përbëjnë këtë pretendim ose mund të ishte vënë në dijeni të tyre pa neglizhencë flagrante.

15.8 Heqja dorë nga imuniteti. Nëse dhe në masën që Huamarrësi aktualisht ose në të ardhmen në çdo juridiksion pretendon për vete ose sendet e tij pasurore imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestroja ose proces tjetër ligjor, Huamarrësi bie dakord në mënyrë të parevokueshme që të heqë dorë nga ky imunitet ndaj padive dhe në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje në masën më të plotë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni.

Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet në lidhje me:

i) “vendin e misionit diplomatik” të tashëm ose të ardhshëm, i përcaktuar në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në vitin 1961, “vendi i konsullatës” së tashme ose të ardhshme, i përcaktuar në Konventën e Vjenës për

Marrëdhëniet e Konsullatës, të nënshkruar në vitin 1963 ose që përdoret nga një diplomat ose mision diplomatik në Shqipëri ose një agjenci ose organ;

ii) çdo pronë të paluajtshme sipas nenit 3, paragrafët 1-3 të ligjit të Shqipërisë nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme shtetërore”;

iii) çdo fond dhe/ose shumë monetare që duhet të shlyhej dhe është paguar në momentin ose ekzekutimin e përmbushjes së detyrimeve të Republikës së Shqipërisë sipas të drejtës publike, traktateve ndërkombëtare dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj.

15.9 Mosmarrëveshjet ligjore.

a) Arbitrazhi. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti do të zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në lidhje me këtë, zbatohen sa më poshtë:

i) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre arbitra që do të emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) të zbatueshme herë pas here;

ii) Gjykimi në arbitrazh do të kryhet në Frankfurt am Main. Gjuha e procedimit do të jetë gjuha angleze.

15.10 Hyrja në fuqi dhe efekt. Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi dhe efekt deri në datën që KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim nga Huamarrësi që:

i) Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën bazohet ka hyrë në fuqi dhe është bërë efektive; dhe

ii) Marrëveshja e Huas është ratifikuar.

Në rast se Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi pas gjashtë muaj nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje ose çdo afati tjetër të pranuar nga KfW-ja, që prej asaj date dhe deri në datën e hyrjes në fuqi, KfW-ja do të ketë të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja dhe kështu të përfundojë periudhën e pezullimit duke i dërguar njoftim me shkrim Huamarrësit.

Hartuar në tre kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, më 3.6.2019

KfW



Emri: Dr. Kirk Mildner
Titulli: Përgjegjës Divizioni

Emri: Bjorn Thies
Titulli:

REPUBLIKA E SHQIPËRIË,
e përfaqësuar nga Ministria e Financave
dhe Ekonomisë

Emri: Anila Denaj
Titulli: Ministër

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Emri: Dritan Agolli
Titulli: Drejtor Ekzekutiv

SHTOJCA 1 GRAFIKU I DISBURSIMIT

Grafiku më i shpejtë i mundshëm i disbursimit

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi (“Data efektive e përfundimit të periudhës” në përputhje me listën e mëposhtme), Huamarrësi mund të kërkojë disbursime deri në një masë që nuk tejkalon shumën kumulative të disbursimeve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

Periudha	Data efektive e fillimit të periudhës (përfshirë)	Data efektive e përfundimit të periudhës (përfshirë)	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (kumulative) (të gjitha shifrat në euro)
1	01.09.2019	01.03.2020	1.000.000,00
2	01.03.2020	01.09.2020	4.000.000,00
3	01.09.2020	01.03.2021	10.000.000,00
4	01.03.2021	01.09.2021	18.000.000,00
5	01.09.2021	01.03.2022	27.000.000,00
6	01.03.2022	01.09.2022	35.000.000,00
7	01.09.2022	01.03.2023	38.000.000,00
8	01.03.2023	01.04.2024	40.000.000,00



SHTOJCA 2

MODEL I OPINIONIT LIGJOR TË KËSHILLTARIT LIGJOR PËR HUAMARRËSIN

Shënim. Ju lutem ndryshoni siç dubet “Republika e VENDIT”/”VENDI”.

[Koka e letrës së Këshilltarit Ligjor]

KfW

Departamenti [____](data)

Në vëmendje të: [_____]

Palmengartenstrasse 5 - 9

Postfach 11 11 41

60325 Frankfurt am Main/Germany

Republika Federale e Gjermanisë

Marrëveshje e Huas e datës ____ dhe e lidhur ndërmjet KfW-së dhe [____] (“Huamarrësi”), për një shumë që nuk tejkalon shumën totale ____000 000 euro.

Të nderuar zotërinj,

Unë (ministri i Drejtësisë) (këshilltar ligjor i) (drejtues i departamentit ligjor) të _____ (ju lutem specifikoni ministrinë ose autoritetin tjetër) të Republikës së VENDIT Kam vepruar në këtë cilësi në lidhje me Marrëveshjen e Huas të datës _____ (“Marrëveshja e Huas”), të lidhur ndërmjet jush dhe Huamarrësit, në lidhje me një hua që do t’i jepni Huamarrësit në një shumë që nuk tejkalon shumën totale _____.000.000 euro.

1. Dokumentet e shqyrtuara

Unë kam shqyrtuar:

1.1 një kopje të nënshkruar autentike të Marrëveshjes së Huas;

1.2 dokumentet kushtetuese të Huamarrësit, veçanërisht:

(a) Kushtetutën e Republikës së VENDIT, të datës _____, të botuar sipas rregullave _____, nr. _____, faqe _____, të ndryshuar;

(b) Ligji(et) nr. _____ të datës _____, të botuar/a sipas rregullave në _____, nr. _____, faqe _____, të ndryshuar [ju lutem përfshini këtu, nëse ka, ligje (p.sh., ligjet e buxhetit) në lidhje me huamarrjen e parave nga Republika e VENDIT];

(c) _____ [ju lutem referojuni këtu dokumenteve të tjera, p.sh. dekreteve ose rezolutave të organeve qeveritare ose administrative të VENDIT, mbi lidhjen e marrëveshjeve të huave nga VENDI në përgjithësi ose mbi lidhjen e Marrëveshjes së Huas] dhe

(d) Marrëveshja e Bashkëpunimit Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së VENDIT dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, të datës _____ (“Marrëveshja e Bashkëpunimit”)

dhe ato ligje, rregullore, vërtetime, të dhëna, regjistrime dhe dokumente që i kam çmuar të nevojshme ose të dëshirueshme për shqyrtim. Përveç kësaj, kam kryer kërkimet që i kam konsideruar të nevojshme ose të dëshirueshme për qëllimin e dhënies së këtij opinion.

2. Opinioni

Për qëllimet e nenit _____ të Marrëveshjes së Huas, jam i mendimit që sipas ligjeve të Republikës së VENDIT të kësaj date:

2.1 Në pajtim me nenin _____ të Kushtetutës/nenit _____ të ligjit nr. _____ [ju lutem specifikoni sipas rastit] Huamarrësi ka të drejtë të lidhë Marrëveshjen e Huas dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas, veçanërisht në bazë të:



(a) ligjit/eve nr. _____ të datës _____ të Parlamentit të Republikës së *VENDIT* që ratifikon Marrëveshjen e Huas/miratton nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi/ _____ [ju lutem përfshini sipas rastit];

(b) rezoluta/t nr. _____ të datës _____ të Kabinetit të Ministrave/të komitetit të huave shtetërore/ _____ [ju lutem përfshini organet qeveritare ose administrative të *VENDIT*, sipas rastit];

(c) _____ [ju lutem referojuni rezolutave, vendimeve të tjera etj.].

2.2 Znj./Z. _____ (dhe Znj./Z. _____) është (janë) të autorizuar sipas _____ [p.sh. ligji për shkak të pozicionit të tij/saj (si Ministër i _____/ si _____), nga rezoluta qeveritare _____, me prokurë _____ të datës _____, etj.] të nënshkruajë individualisht/bashkërisht Marrëveshjen e Huas në emër të Huamarrësit. Marrëveshja e Huas e nënshkruar nga Znj./Z. _____ (dhe Znj./Z. _____) është nënshkruar sipas rregullave në emër të Huamarrësit dhe përbën detyrime ligjërish të detyruese të Huamarrësit të zbatueshme ndaj tij ligjërish në pajtim me kushtet e saj.

[Alternativa 1 për seksionin 2.3 që duhet të përdoret, nëse përveç dokumenteve të specifikuara në seksionet 2.1 dhe 2.2 duhet të merren autorizime të caktuara zyrtare sipas ligjeve të Republikës së *VENDIT*:]

2.3 Për ekzekutimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin të KfW-ja të të gjitha shumave të kërkueshme në monedhat e specifikuara në të), janë marrë miratimet, autorizimet, lejet, regjistrimet dhe/ose pëlqimet e mëposhtme zyrtare dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë:

(a) Miratimi i _____ [Bankës Qendrore /Bankës Kombëtare / _____], i datës _____, nr. _____;

(b) Pëlqimi i _____ [Ministrit / Ministrisë së _____], i datës _____, nr. _____; dhe

(c) _____ [ju lutem rendisni çdo autorizim, leje dhe /ose pëlqim tjetër zyrtar].

Asnjë autorizim, pëlqim, leje, regjistrim dhe/ose miratim tjetër zyrtar, i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/Kombëtare të Republikës së *VENDIT*) ose gjykate nuk kërkohet apo nuk rekomandohet në lidhje me ekzekutimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin të KfW-ja të të gjitha shumave që kërkohen në monedhat e specifikuara në të) dhe vlefshmëria dhe zbatueshmëria e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

[Alternativa 2 për seksionin 2.3 që duhet të përdoret vetëm nëse përveç dokumenteve të specifikuara në seksionet 2.1 dhe 2.2, asnjë autorizim zyrtar nuk duhet të merret sipas ligjeve të Republikës së *VENDIT*:]

2.3 Asnjë autorizim, pëlqim, leje, regjistrim dhe/ose miratim tjetër zyrtar i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/Kombëtare të Republikës së *VENDIT*) ose gjykate nuk kërkohet apo nuk rekomandohet në lidhje me ekzekutimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin të KfW-ja të të gjitha shumave që kërkohen në monedhat e specifikuara në të) dhe vlefshmëria dhe zbatueshmëria e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

2.4 Asnjë taksë vule ose taksë apo tatim i ngjashëm nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e Marrëveshjes së Huas.

2.5 Zgjedhja e ligjit gjerman për të rregulluar Marrëveshjen e Huas dhe paraqitjen për arbitrazh në pajtim me nenin _____ të Marrëveshjes së Huas është e vlefshme dhe detyruese. Vendimet e arbitrazhit kundër Huamarrësit do të njihen dhe do të jenë të zbatueshme në Republikën e *VENDIT*, në pajtim me rregullat e mëposhtme: _____ [ju lutem përfshini traktatin e zbatueshëm (nëse ka) p.sh. Konventën e Nju Jorkut të vitit 1958 dhe/ose parimet bazë në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit në *VENDIT*].

2.6 Gjykatat e Republikës së *VENDIT* kanë të drejtë të japin vendime të caktuara në monedhën ose monedhat e specifikuara në Marrëveshjen e Huas.



2.7 Huamarrja nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes së Huas, si dhe ekzekutimi dhe përmbushja e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi përbëjnë akte private dhe tregtare dhe jo akte publike ose qeveritare. As Huamarrësi, as ndonjë prej sendeve të tij pasurore nuk gëzon të drejtë imuniteti nga arbitrazhi, padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose procesi tjetër ligjor.

2.8 Marrëveshja e Bashkëpunimit është në fuqi dhe efekt të plotë sipas kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së *VENDIT*. [Në pajtim me nenin 3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit] [nëse Marrëveshja e Bashkëpunimit nuk ka hyrë në fuqi, por ekziston një marrëveshje e tatimit të dyfishtë] në bazë të _____ [ju lutem specifikoni traktatin ose ligjet dhe rregulloret e zbatueshme]/ Huamarrësit nuk do t'i kërkohej të bëjë asnjë zbritje ose ndalesë nga pagesa që Huamarrësi duhet të kryejë sipas Marrëveshjes së Huas dhe nëse një zbritje apo ndalesë e tillë duhet të vendoset më vonë, dispozitat e nenit _____ të Marrëveshjes së Huas do të zbatohen për t'i kërkuar Huamarrësit që të zhdëmtojë KfW-në.

2.9 KfW-ja nuk është dhe nuk konsiderohet të jetë rezidente, me vendqëndrim apo të zhvillojë biznes apo t'i nënshtrohet tatimit në Republikën e *VENDIT*, vetëm për shkak të nënshkrimit, përmbushjes ose ekzekutimit të Marrëveshjes së Huas. Nuk është e nevojshme apo e këshillueshme që KfW-ja të licencohet, të kualifikohet apo ndryshe të fitojë të drejtë për të zhvilluar biznes ose që KfW-ja të caktojë agjentë apo përfaqësues në Republikën e *VENDIT*.

Si rrjedhojë, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta dhe të pakushtëzuara, të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin dhe janë të zbatueshme ndaj Huamarrësit në pajtim me kushtet e tyre përkatëse.

Ky opinion ligjor kufizohet te ligjet e Republikës së *VENDIT*.

_____,
(Vendi) (Data)

[Nënshkrimi]

Emri: _____

Bashkëlidhur:

Shënim. Ju lutem bashkëlidhni kopje të vërtetuara të dokumenteve dhe të dispozitave ligjore të përmendura më sipër (në lidhje me ligjet e gjata ose me Kushtetutën e Republikës së *VENDIT*, një kopje e dispozitave përkatëse duhet të jetë e mjaftueshme) dhe t'i jepni KfW-së një përkthim të vërtetuar në gjuhën angleze ose gjermane të secilit prej dokumenteve të sipërpërmendura, nëse këto dokumente nuk janë lëshuar në anglisht ose në gjermanisht si gjuhë zyrtare ose nëse KfW-ja nuk ka përcaktuar se një gjuhë tjetër është e pranueshme.



SHTOJCA 3A
ZOTIMET E PAJTUESHMËRISË SË
HUAMARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

Praktikë shtrënguese: është pengimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të penguar ose dëmtuar drejtpërsëdrejti ose jo çdo palë ose pronën e çdo pale, me qëllim ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një pale;

Praktikë e marrëveshjes së fshehtë: është një marrëveshje midis dy ose më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një pale tjetër.

Praktikë korruptive: është premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja mbi, marrja, pranimi ose kërkesa e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazh i padrejtë i çdo natyre, për dikë ose nga kushdo, me qëllim që të ndikojë në veprimet e dikujt ose të bëjë që një person të mos veprojë;

Praktikë mashtrimi: është çdo veprim ose mungesë veprimi, duke përfshirë një keqinterpretim që me qëllim ose nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e përfuturit të një përfuturi financiar ose shmangies së një detyrimi;

Praktikë penguese: (i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja, me qëllimin e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i çdo pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit,

ose (ii) veprime, me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

Person: çdo person fizik, juridik, partneritet ose shoqatë e painkorporuar.

Praktikë e sanksionueshme: secila nga praktikat shtrënguese, të marrëveshjes së fshehtë, korruptive, mashtruese ose penguese (siç përkufizohen dhe këto terma këtu) që është (i) e paligjshme sipas ligjit gjerman ose atij të

zbatueshëm dhe (ii) që k, ose mund të ketë ndikim material ligjor ose në reputacion të Marrëveshja ndërmjet Huamarrësit, Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së ose në zbatimin e saj.

Sanksionet: sanksionet, rregulloret, embargot ose masat kufizuese ekonomike, financiare ose tregtare të administruara, miratuara ose zbatuara nga çdo Organ Sanksionues.

Organ sanksionues: nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Lista e sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve ose entiteteve të emëruara që janë objekt i Sanksioneve, siç miratohet nga çdo Organ Sanksionues.

2. Dhënia e informacionit

Huamarrësi,

a) me dhe sipas kërkesës së KfW-së, do të vendosë menjëherë në dispozicion të saj të gjithë informacionet përkatëse me “njih klientin tënd” ose informacione të ngjashme në lidhje me Huamarrësin;

b) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, paraqet menjëherë, me kërkesë të KfW-së, të gjitha informacionet dhe dokumentet e Huamarrësit dhe (nën)kontraktuesve të tij dhe palëve të tjera të lidhura, të cilat KfW-ja i kërkon për përmbushjen e detyrimeve për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të punës me Huamarrësin që nevojitet për këtë qëllim;

c) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, informon menjëherë dhe me iniciativën e saj, sapo merr dijeni ose ka dyshime për çdo Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash dhe/ose financim terrorizmi që lidhet me Projektin;

d) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, do t'i japë KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhëna mbi Projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm që KfW-ja mund të kërkojë për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, i jep mundësinë KfW-së dhe agjentëve të tij të inspektojnë kurdoherë të gjithë dokumentacionin e lidhur me Projektin që ka Huamarrësi dhe (nën) kontraktuesit e tij saj dhe palëve të lidhura dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse për qëllimet e kësaj shtojce.



3. Përfaqësimi dhe garancia

Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të Huamarrësit, Huamarrësi pretendon se asnjë person që vepron në emër të Huamarrësit me Projektin, nuk ka kryer ose kryen Praktika të Sanksionueshme, pastrim parash ose financim terrorizmi.

Përfaqësimi dhe garancia e parashtruar në këtë nen bëhen për herë të parë nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Ato do të duhet të përsëriten në çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë pagese të interesit, në çdo rast referuar rrethanave mbizotëruese të asaj dite.

4. Veprimet

Huamarrësi merr përsipër, sapo ai ose KfW-ja merr dijeni ose ka dyshime për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash ose financim terrorizmi, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e tij për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në veçanti, Huamarrësi i përgjigjet menjëherë dhe me hollësi të pranueshme çdo njoftimi nga KfW-ja dhe dorëzon dokumentet mbështetëse për çdo përgjigje ndaj kërkesave të KfW-së.

5. Mosveprimet

Huamarrësi nuk hyn në transaksione ose angazhohet në veprimtari të tjera në lidhje me Projektin që mund të përbëjnë shkelje të Sanksioneve.

SHTOJCA 3B

ZOTIMET E PAJTUESHMËRISË AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTT

1. Përkufizime

Praktikë shtrënguese: është pengimi ose dëmtimi ose kërcënim për të penguar ose dëmtuar drejtpërsëdrejti ose jo çdo palë ose pronën e çdo pale, me qëllim ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një pale;

Praktikë e marrëveshjes së fshehtë: është një marrëveshje midis dy ose më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një pale tjetër.

Praktikë korruptive: është premtimi, ofrimi, dhënia, bërja, këmbëngulja mbi, marrja, pranimi ose kërkesa e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazh i padrejtë i çdo natyre, për dikë ose nga kushdo, me qëllim që

të ndikojë në veprimet e dikujt ose të bëjë që një person të mos veprojë;

Kategoritë e përcaktuara të shkeljeve: kategoritë e mëposhtme të shkeljeve të përcaktuara nga Rekomandimet FATF-së dhe shënimet përkatëse interpretuese: pjesëmarrja në grup të organizuar kriminal dhe shantazhi: terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e njerëzve; shfrytëzimin seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve, trafikimin e jashtëligjshëm të substancave narkotike dhe psikotrope; trafikimin e jashtëligjshëm të armëve; trafikimin e jashtëligjshëm të mallrave të vjedhura dhe të tjera; korrupsionin dhe mitmarrja; mashtrimin; falsifikimin e parave; falsifikimin dhe piraterinë e produkteve; krimin mjedisor; vrasja, dëmtimin e rëndë trupor; rrëmbimin, mbajtjen e jashtëligjshme dhe pengmarrjen; vjedhjen ose grabitjen; kontrabandimin (duke përfshirë taksat dhe detyrimet tatimore dhe të akcizës); krimet tatimore (në lidhje me taksat direkte dhe indirekte); shantazhin; falsifikimin; piraterinë; tregtinë e brendshme dhe manipulimin e tregut.

Rekomandimet e FATF-it: rekomandime të tilla të përkufizuara herë pas here nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF). FATF-i është organi ndërqeveritar që synon të zhvillojë dhe promovojë politikat kombëtare dhe ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Praktikë mashtrimi: është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim që me qëllim ose nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e përfuturit të një përfitimi financiar ose shmangies së një detyrimi;

Natyrë e jashtëligjshme: është origjina e fondeve të marra nëpërmjet:

- a) çdo shkeljeje të renditur në Kategoritë e përcaktuara të shkeljeve;
- b) çdo praktikë korruptive;
- c) çdo praktikë mashtrimi; ose
- d) pastrim parash.

Praktikë penguese: (i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja, me qëllimin e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënim, ngacmimi apo frikësimi i



çdo pale për ta penguar nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit

ose (ii) veprime, me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

Person: çdo person fizik, juridik, partneritet ose shoqatë e painkorporuar.

Praktikë e sanksionueshme: secila nga praktikat shtrënguese, të marrëveshjes së fshehtë, korruptive, mashtruese ose penguese (siç përkufizohen dhe këto terma këtu) që është (i) e paligjshme sipas ligjit gjerman ose atij të zbatueshëm dhe (ii) që ka ose mund të ketë, një efekt material ligjor ose reputacional të Marrëveshja ndërmjet Huamarrësit, Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së ose në zbatimin e saj.

Sanksionet: sanksionet, rregulloret, embargot ose masat kufizuese ekonomike, financiare ose tregtare të administruara, miratuara ose zbatuara nga çdo Organ Sanksionues.

Organ sanksionues: nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Lista e sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve ose entiteteve të emëruara që janë objekt i Sanksioneve, siç miratohet nga çdo Organ Sanksionues.

2. Dhënia e informacionit

Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) vendos menjëherë në dispozicion të KfW-së të gjithë informacionet përkatëse me “njih klientin tënd” ose informacione të ngjashme në lidhje me Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe secilin prej aksionerëve të saj (të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë), filialeve dhe/ose degëve të tjera (nëse ka), sipas kërkesës së KfW-së;

b) pajis KfW-në, me kërkesë të kësaj të fundit, me të gjitha informacionet dhe dokumentet që lidhen me Projektin të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe (nën)kontraktuesit dhe palëve të tjera të lidhura, për të cilat KfW-ja ka nevojë për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të punës me Agjencinë e Zbatimit të Projektit që nevojitet për këtë qëllim;

c) informon menjëherë dhe me nismën e saj, sapo merr dijeni ose ka dyshime, KfW-në për çdo Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash dhe / ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj menaxheriale, drejtuese ose aksionerët e saj;

d) i jep KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhënat mbi Projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm që KfW-ja mund të kërkojë për qëllimet e kësaj shtojce;

e) i jep mundësinë KfW-së dhe agentëve të tij të inspektojnë kurdoherë të gjithë dokumentacionin e lidhur me Projektin të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe (nën) kontraktuesve të saj dhe palëve të lidhura, dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse për qëllimet e kësaj shtojce;

f) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e saj, për çdo rast që ndodh dhe e bën ose mund ta bëjë Agjencinë e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj menaxheriale ose qeverisëse ose aksionerët e saj, persona ose entitete të bllokuara me emërim të posaçëm kombëtar të përfshirë në Listën e Sanksioneve.

3. Përfaqësimi dhe garancia

Në përputhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të regjistrimit ligjor të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, Agjencia e Zbatimit të Projektit përfaqëson dhe garanton vërtetësinë dhe saktësinë e sa më poshtë:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të Huas, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin dhe për llogari të saj.

b) Në dijeni të informacioneve që ka dhe vetëm në lidhje me aksionerët që njeh Agjencia e Zbatimit të Projektit sipas rregulloreve të zbatueshme mbi tregun e aksioneve, kapitali dhe fondet e investuara nga Agjencia e Zbatimit të Projektit në këtë Projekt nuk janë të një natyre të paligjshme.

c) Askush nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, filialeve ose degëve të saj, ose persona të tjerë që veprojnë personalisht ose në emër të tyre nuk kanë kryer ose janë angazhuar në Praktika të Sanksionueshme, pastrim parash ose financim terrorizmi.

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk (i) ka hyrë në asnjë marrëdhënie pune me persona ose entitete të bllokuara me emërim të posaçëm kombëtar të përfshirë në Listën e Sanksioneve ose



(ii) është angazhuar në asnjë veprimtari tjetër që do të përbënte shkelje të Sanksioneve.

Përfaqësimi dhe garancia e parashtruar në këtë nen bëhen për herë të parë nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Ato do të duhet të përsëriten në çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë pagese të interesit, në çdo rast referuar rrethanave mbizotëruese të asaj date.

4. Veprimet

Agjencia e Zbatimit të Projektit merr përsipër

a) të respektojë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me rekomandimet FATF-së dhe të zbatojë, ruajë, dhe nëse është e nevojshme, të përmirësojë standardet dhe udhëzimet e saj të brendshme (duke përfshirë dhe jo vetëm, në lidhje me kujdesin e duhur ndaj klientit) të duhura për të shmangur Praktikën e Sanksionueshme, aktet e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja merr dijeni ose ka dyshime për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash ose financim terrorizmi, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e tij për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në veçanti, Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet menjëherë dhe me hollësi të pranueshme çdo njoftimi nga KfW-ja dhe dorëzon dokumentet mbështetëse për çdo përgjigje ndaj kërkesave të KfW-së.

5. Ndërmarrjet negative

Agjencia e Zbatimit të Projektit merr përsipër

a) të garantojë që kapitali dhe fondet e tjera që investon të mos jenë të një origjine të jashtëligjshme;

b) të garantojë që biznesi nuk do të nxisë praktika të sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit; dhe

c) nuk do të hyjë ose vazhdojë asnjë marrëdhënie pune me persona ose entitete të bllokuara me emërim të posaçëm kombëtar, të përfshirë në listën e sanksioneve, dhe angazhohet në asnjë veprimtari tjetër që do të përbënte shkelje të sanksioneve.

DEKRET

Nr. 11239, datë 26.7.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 49/2019 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ

Nr. 56/2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9636, DATË 6.11.2006, “PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT”, TË NDRYSHUAR²

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

² Ky projektligj përafrohet pjesërisht me direktivën 2014/40/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 3 prill 2014, “Mbi përafrimin e ligjit, rregullave dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare rreth prodhimit, prezantimit dhe shitesës së duhanit dhe produkteve të duhanit dhe shfuqizimi i Direktivës 2001/37/KE.

Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 127/1, datë 29.4.2014, CELEX nr. 32014L0040.



Neni 1

Në nenin 3, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pikat 1 dhe 7, ndryshohen si më poshtë:

“1. ‘Produkte duhani’ nënkupton produktet që mund të konsumohen dhe të përmbajnë, qoftë dhe pjesërisht, duhan të modifikuar gjenetikisht ose jo.”.

“7. ‘Pirje duhani’ është ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e çdo produkti duhani, si dhe e cigares elektronike e shishave/nargjileve.”.

2. Në pikën 18, pas fjalëve: “plotësisht me mure”, shtohen fjalët: “dhe çdo lloj materiali tjetër”.

3. Pas pikës 18, shtohen pikat 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35 e 36, me këtë përmbajtje:

“19. ‘Cigare’ nënkupton një mbështjellje duhani të grirë e cila konsumohet nëpërmjet procesit të djegies, përveç purove, cigarillove dhe mbështjelljeve të tjera të duhanit.

20. ‘Duhan kaush/për t’u dredhur’ nënkupton duhanin e grirë në fije të imëta që përdoret për pirje pa përpunim të mëtejshëm industrial.

21. ‘Duhan për llullë’ nënkupton duhanin e grirë trashë për pirje me llullë.

22. ‘Puro’ nënkupton duhanin e grirë, të mbështjellë me gjethe duhani ose me mbështjellëse letre me ngjyrë duhani, me ose pa filtër, që konsumohet nëpërmjet procesit të djegies.

23. ‘Duhan për nargjile (shisha)’ nënkupton duhanin që konsumohet në formë tymi ose avulli, duke kaluar detyrimisht në një enë uji, i cili mund të jetë ose jo i aromatizuar, ose i përzier me sheqer frutash ose melasë.

24. ‘Duhan për t’u nuhatur (burnot)’ nënkupton një produkt duhani pa tymosje, që konsumohet nëpërmjet nuhatjes.

25. ‘Duhan për përdorim oral’ nënkupton të gjitha produktet e duhanit për përdorim oral, me përjashtim të atyre produkteve që janë për t’u thithur me hundë apo për përtpje, të prodhuara tërësisht ose pjesërisht prej duhanit, në formë pluhuri, grimcash apo të kombinuara së bashku, që paketohen në qeska poroze.

26. ‘Duhan pa tym’ nënkupton një produkt duhani që nuk digjet, duke përfshirë duhanin për përtpje, duhanin për thithje me hundë, duhanin për përdorim oral dhe duhanin me ngrohje.

27. ‘Tym’ nënkupton grimcat e ngurta ose të lëngëta në ajër dhe gazet e krijuara kur një material digjet së bashku me sasinë e ajrit që përthithet apo përzihet me masën, përfshirë edhe tymin e nxjerrë prej mushkërive gjatë duhanpirjes.

28. ‘Djegje’ nënkupton një proces kimik oksidimi që ndodh me një shpejtësi aq të madhe sa të prodhojë nxehtësi dhe zakonisht dritë në formë inkandeshente ose flake.

29. ‘Produktet e reja të duhanit’ nënkuptojnë produktet e duhanit që:

a) nuk bëjnë pjesë në asnjë nga kategoritë e mëposhtme si: cigare, duhan kaush/për t’u dredhur, duhan për nargjile, puro, cigarillo, duhan për përtpje, duhan për thithje me hundë, duhan për përdorim nga goja;

b) vendosen në treg pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

30. ‘Cigare elektronike’ nënkupton një produkt që mund të përdoret për konsum të avullit që përmban nikotinë me anë të një pjese që vendoset pranë gojës ose çdo përbërës tjetër i atij produkti, duke përfshirë një mbajtëse, një depozitë dhe një pajisje pa mbajtëse ose depozitë. Cigaret elektronike mund të jenë njëpërdorimshme, me rimbushje me anë të një ene për rimbushje ose një depozite, ose mund të rikarikohen me një mbajtëse njëpërdorimshëm.

31. ‘Enë rimbushëse’ nënkupton një pajisje që mban një lëng me përmbajtje nikotine, e cila mund të përdoret për rimbushje të një cigareje elektronike.

32. ‘Duhan me ngrohje’ nënkupton një produkt duhani, posaçërisht i krijuar për t’u ngrohur, që përdoret për të çliruar aerosol që përmban nikotinë dhe substanca të tjera, i cili thithet nga përdoruesit nëpërmjet gojës.

33. ‘Shije karakteristike’ nënkupton një shije apo aromë qartësisht të dallueshme, e ndryshme nga ajo e duhanit si rezultat i përdorimit të një lënde shtesë apo i një kombinimi lëndësh shtesë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: fruta, erëza, barishte, alkool, karamеле, mentol ose vanilje, të cilat janë të kuptueshme para ose gjatë konsumit të produkteve të duhanit.

34. ‘Cigarillo’ nënkupton një lloj puroje, me peshë jo më të madhe se 3 gram.

35. ‘Substancë shtesë’ nënkupton një substancë të ndryshme nga duhani, e cila i shtohet një



produkti duhani, një njësie pakete ose çdo paketimi të jashtëm.

36. ‘Aromatizues’ nënkupton një substancë shtesë e cila mundëson aromë dhe/ose shije.”.

Neni 2

Në nenin 5, pas pikës 3, shtohen pikat 4, 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

“4. Çdo njësi paketimi e cigareve elektronike dhe paketim i rimbushjeve të lëngut të nikotinës duhet të përmbajë një fletë informuese në gjuhën shqipe, ku të përfshihet informacion rreth: instruksioneve të përdorimit dhe magazinimit të produktit, duke përfshirë dhe një referencë që ky produkt nuk rekomandohet të përdoret nga të rinjtë dhe nga joduhanpirësit; kundërrindikacionet e përdorimit; paralajmërimet për grupet e veçanta të riskut, paralajmërimet për efektet anësore; shkallën e varësisë dhe toksicitetit; detajet e kontaktit të prodhuesit ose importuesit.

5. Lëngu me përmbajtje nikotine vendoset në treg vetëm kur është në mbajtëse të dedikuara për rimbushje, me volum jo më shumë se 10 ml ose në formën e cigareve elektronike njëpërdorimshme, me volum jo më shumë se 2 ml.

6. Nuk lejohet vendosja në treg e lëngut që përmban më shumë se 20 mg/ml nikotinë.”

Neni 3

Neni 8, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

1. Prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të reja të duhanit, përfshirë cigaret elektronike dhe duhanin me ngrohje, janë të detyruar të njoftojnë Ministrinë përgjegjëse për Shëndetësinë për produktet e duhanit që qarkullojnë në tregun vendas, si dhe për çdo rast kur prej tyre hidhet në treg një produkt i ri duhani. Ky lajmërim duhet dorëzuar në formë elektronike, jo më vonë se 30 ditë para hedhjes në treg të produktit. Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) informacion kontakti të prodhuesit ose importuesit në Shqipëri;
- b) një përshkrim të detajuar të produktit;
- c) instruksionet e lidhura me përdorimin e tij;

d) një listë të të gjithë përbërësve të përdorur në fabrikimin e produktit të duhanit dhe sasitë e tyre, arsyen apo qëllimin e përdorimit të këtyre përbërësve, si dhe të përcaktojnë funksionimin dhe kategorinë e përbërësve. Kjo listë duhet të shoqërohet me të dhëna toksikologjike, të disponueshme prej fabrikuesit apo importuesit, për këta përbërës, në formë të djegur apo të padjegur, duke u shprehur në mënyrë të veçantë për efektet e tyre mbi shëndetin dhe duke vlerësuar çdo efekt që shkakton ose mendohet se mund të shkaktojë varësi të përdoruesit ndaj produktit të duhanit.

e) materialet e disponueshme të kërkimeve shkencore, rrezikun e varësisë dhe tërheqjen e produktit.”.

Neni 4

Në nenin 9, pas fjalëve: “produkteve të duhanit”, shtohen fjalët: “cigareve elektronike, shishave/nargjileve”.

Neni 5

Në nenin 10, pas fjalëve: “produkteve të duhanit”, shtohen fjalët: “cigareve elektronike, shishave/nargjileve”.

Neni 6

Në nenin 11, pas fjalisë së parë, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Ndalohej vendosja në treg e produkteve të duhanit me shije karakteristike. Nuk ndalohej përdorimi i substancave shtesë, të cilat janë të domosdoshme për prodhimin e produkteve të duhanit, siç është përdorimi i sheqernave që zëvendësojnë sheqerin e humbur gjatë procesit të përpunimit të duhanit, me kusht që këto substanca shtesë nuk shkaktojnë shije karakteristike dhe nuk rrisin në një nivel domethënës dhe të matshëm shkallën e varësisë, toksicitetit ose karakteristikave karcinogjene, mutagjene dhe toksicitetit për riprodhim të produktit të duhanit.

Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë përcakton nëse një produkt duhani konsiderohet produkt duhani me shije karakteristike. Procedurat për mënyrën e përcaktimit të produkteve të duhanit me shije karakteristike bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.



Ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit që përmbajnë aromatizues në secilin prej komponentëve, si filtra, letra, paketime, kapsula apo çdo modifikim teknik që lejon modifikimin e aromës ose shijes së produktit të duhanit ose intensitetin e tymit. Filtrat, letrat dhe kapsulat nuk duhet të përmbajnë duhan apo nikotinë.

Një njësi pakete cigare duhet të përmbajë të paktën 20 cigare. Një njësi pakete duhan për dredhje duhet të përmbajë jo më pak se 30 gram neto produkt duhani.”.

Neni 7

Në nenin 13, fjalia e fundit, e paragrafit të parë, ndryshohet si më poshtë:

“Ndalohet çdo lloj forme tjetër reklamimi e produkteve të duhanit, përfshirë promocionin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot e kompanive, ose promocionin nëpërmjet ekspozimit të produkteve që imitojnë paketimin e jashtëm të një produkti duhani.”.

Neni 8

Në nenin 19 dhe në gjithë përmbajtjen e ligjit, fjalët: “inspektorati që mbulon fushën e shëndetit”, zëvendësohen me fjalët: “struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit”.

Neni 9

Në nenin 20, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas germës “a”, të pikës 1, shtohet germa “a/a”, me këtë përmbajtje:

“a/a. Shkelja e nenit 8, dënohet me 500 000 lekë gjobë për prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të reja të duhanit.”

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Për shkelje të nenit 15 dy herë brenda një periudhe 3-mujore, subjekti i tatueshëm dënohet me gjobë sa dyfishi i gjobës së vendosur në nënndarjen “i”, të shkronjës “ë”, të këtij neni.

Nëse subjekti i tatueshëm i penalizuar për herë të dytë gjendet përsëri në shkelje të nenit 15, brenda një afati kohor 1-vjeçar, atëherë ndaj tij vendoset gjobë në vlerën e gjashtëfishit të gjobës së vendosur në nënndarjen “i”, të shkronjës “ë”, të

këtij neni, dhe pezullim i aktivitetit deri në shlyerjen e masave të gjobës.”.

Neni 10

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 6, të këtij ligji.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të paragrafëve të parë, të tretë dhe të katërt, të nenit 6, të këtij ligji, që hyjnë në fuqi 24 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.7.2019

Shpallur me dekretin nr.11240, datë 26.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET**Nr. 11240, datë 26.7.2019****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 56/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**



VENDIM
Nr. 518, datë 25.7.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE FEDERATËS SË
SHËN KRISTOFERIT (ST. KITTS) DHE
NEVISIT, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR
MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE, ZYRTARE DHE
TË ZAKONSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Federatës së Shën Kristoferit (*St. Kitts*) dhe Nevisit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të zakonshme, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FEDERATËS SË SHËN KRISTOFERIT (ST.
KITTS) DHE NEVISIT PËR HEQJEN E
VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE, ZYRTARE DHE
TË ZAKONSHME

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Federatës së Shën Kristoferit (*St. Kitts*) dhe Nevisit (në vijim të referuara secila si “Pala Kontraktuese” dhe bashkërisht si “Palët Kontraktuese”);

Me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet miqësore ekzistuese dhe bashkëpunimin, si dhe për lehtësimin e udhëtimit ndërmjet dy vendeve, si një mjet i rëndësishëm për të forcuar lidhjet dhe për të

mbështetur zhvillimin në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e të dy vendeve, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, zyrtare ose të zakonshme të lëshuara nga Palët Kontraktuese, përjashtohen nga kërkesat për vizë për hyrje, dalje ose transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për një periudhë që nuk kalon nëntëdhjetë (90) ditë brenda gjashtë muajve në çdo periudhë prej një qind e tetëdhjetë (180) ditësh.

Neni 2

Shtetasit e të dy vendeve, të referuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, të cilët synojnë të qëndrojnë më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë të pandërprera në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, janë të detyruar të marrin vizën përkatëse përpara se të mbërrijnë ose nëse ndodhen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duhet të aplikojnë për vizë përpara skadimit të periudhës prej nëntëdhjetë (90) ditësh të pandërprera.

Neni 3

Shtetasit e të dy vendeve, në përputhje me nenin 1, mund të hyjnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese ose të dalin në çdo kalim portual apo kufitar të hapur për trafik ndërkombëtar të pasagjerëve, me kusht që ata të përmbushin kërkesat e ligjeve dhe rregullave të vendit tjetër në lidhje me këtë rast për hyrjen, lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve.

Neni 4

1. Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike, zyrtare ose të zakonshme, të cilët janë caktuar në misionë diplomatike, konsullore ose në përfaqësi të organizatave ndërkombëtare në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të përjashtohen nga kërkesat për vizë për të hyrë, dalë apo kaluar transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, për periudhën e detyrave të tyre.



2. Dispozitat e paragrafit 1, të këtij neni do të zbatohen edhe ndaj anëtarëve të familjes së personave të varur, mbajtës të pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të zakonshme.

Neni 5

1. Shtetasit e secilës palë kontraktuese, në rastin e humbjes ose dëmtimit të dokumenteve të vlefshme, ndërsa ndodhen në territorin e Palës tjetër, do të dalin nga territori i këtij Shteti në bazë të dokumenteve të reja të vlefshme të lëshuara nga një mision diplomatik ose konsullor i vendit të tyre të shtetësisë, pa vizë ose autorizim tjetër nga autoritetet kompetente të Shtetit Pritës.

2. Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, të cilët nuk janë në gjendje të dalin nga territori i Palës tjetër Kontraktuese brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 3, të kësaj Marrëveshjeje, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme (sëmundje ose fatkeqësi natyrore) dhe kanë prova të dokumentuara apo mbështetëse të këtyre rrethanave, mund të aplikojnë tek autoritetet përkatëse për të marrë autorizim për zgjatje të kohës së qëndrimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për një periudhë të përshtatshme, e cila nevojitet për t'u kthyer në vendin e tyre të shtetësisë ose në vendbanimin e tyre të përhershëm.

Neni 6

Në frymën e mbrojtjes së interesave publike, luftës ndaj migrimit të paligjshëm dhe zgjidhjes së çështjeve të sigurisë së të dy vendeve, të dyja palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të ndaluar çdo person të padëshiruar dhe shtetas të vendeve të treta të hyjë në territoret e secilës palë.

Neni 7

1. Secila Palë Kontraktuese ka të drejtën të refuzojë hyrjen në territorin e saj të shtetasve të Palës tjetër Kontraktuese ose t'i anulojë ose shkurttojë kohën e qëndrimit të tyre në rastin kur individit kryen veprime që shkelin ligjet dhe rregulloret e Palës pritëse.

2. Secila Palë Kontraktuese mund të kërkojë largimin e menjëhershëm dhe pa formalitete të mëtejshme, të shtetasve të secilës Palë, të cilët u

kanë paraqitur autoriteteve kufitare të Palës tjetër dokumente të rreme ose të falsifikuara ose që e kanë tejkaluar periudhën e qëndrimit të lejuar nga viza e tyre ose që kanë shkelur rregullat ekzistuese që përcaktojnë procedurat e hyrjes dhe daljes të Palës tjetër.

Neni 8

1. Palët do të shkëmbejnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, modele të dokumenteve të vlefshme të udhëtimit të listuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rast të paraqitjes së dokumenteve të reja të udhëtimit të listuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje ose të ndonjë modifikimi të dokumenteve të vlefshme, Palët do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën dhe do të shkëmbejnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, modele të këtyre dokumenteve të udhëtimit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para hyrjes së tyre në fuqi.

Neni 9

Kjo marrëveshje nuk cenon detyrimin e shtetasve të dyja Palëve Kontraktuese për të respektuar ligjet dhe rregulloret në fuqi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 10

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtën e autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese të mos e lejuar një mbajtës të pasaportës diplomatike, zyrtare apo të zakonshme të Palës tjetër Kontraktuese, që të hyjë apo të qëndrojë, siç parashikohet në nenin 1, nëse ky person është konsideruar i padëshirueshëm ose *persona non grata*.

Neni 11

1. Secila nga Palët Kontraktuese mund që përkohësisht të pezullojë tërësisht ose pjesërisht, zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik apo shëndetit publik. Kur një Palë Kontraktuese vendos të pezullojë Marrëveshjen si më lart, do të njoftojë Palën tjetër për pezullimin nëpërmjet kanaleve diplomatike të



Palës tjetër jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë përpara këtij pezullimi.

2. Pala, e cila vendosi të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për arsyet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni, informon në të njëjtën mënyrë Palën tjetër për rinovimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

1. Secila Palë Kontraktuese i paraqet palës tjetër, modele të pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të zakonshme, të dokumenteve të udhëtimit të emergjencës dhe të dokumentit të identifikimit të detarit (sipas regjistrimeve nga lista e bordit të anijes apo të nxjerrë prej saj), nëpërmjet kanaleve diplomatike të paktën 30 (tridhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse paraqiten pasaporta të reja diplomatike, zyrtare apo të zakonshme të reja ose në rast të modifikimit të dokumenteve ekzistuese të njohura nga të dyja palët, Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë me njëra-tjetrën modele të pasaportave të vlefshme diplomatike, zyrtare dhe të zakonshme të paktën 30 (tridhjetë) ditë pas hyrjes së tyre në fuqi.

Neni 13

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave.

Neni 14

1. Kjo Marrëveshje mbetet e vlefshme për një periudhë të pacaktuar dhe hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të të cilit Palët konfirmojnë përfundimin e procedurave të brendshme ligjore që janë të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Secila Palë Kontraktuese mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë me anë të njoftimit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, dhe përfundimi/ndërprerja e marrëveshjes do të hyjë në fuqi 90 (nëntëdhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit nga pala tjetër.

3. Kjo Marrëveshje mund të amendohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve. Çdo amendim apo shtojcë e kësaj Marrëveshjeje, për të cilën Palët bien dakord, hyn në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke pasur autorizimin e duhur nga Qeveritë e tyre-përkatese, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Hartuar në 14.5.2019, në dy kopje origjinale secila në shqip dhe në anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjes në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze ka përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E FEDERATËS SË SHËN KRISTOFERIT (ST.KITTS) DHE NEVISIT

SHTOJCË E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FEDERATËS SË SHËN KRISTOFERIT (ST.KITTS) DHE NEVISIT, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, ZYRTARE DHE TË ZAKONSHME

1. Për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, për hyrje, dalje, transit dhe qëndrim në Federatën e Shën Kristoferit dhe Nevisit, dokumente të vlefshme gjatë udhëtimit janë:

1.1 Pasaporta e Zakonshme e një qytetari të Republikës së Shqipërisë;

1.2 Pasaporta Diplomatiqe e një qytetari të Republikës së Shqipërisë;

1.3 Pasaporta e Shërbimit e një qytetari të Republikës së Shqipërisë;

1.4 Dokument të vlefshëm udhëtimi për rikthim në Republikën e Shqipërisë (vetëm për kthim në Republikën e Shqipërisë);

1.5 Dokumenti i Identifikimit të Detarëve (me regjistrimin në listën e anijeve ose ekstraktin prej tij).

2. Për shtetasit e Federatës së Shën Kristoferit dhe Nevisit për hyrje, dalje, transit dhe qëndrim në Republikën e Shqipërisë dokumente të vlefshme gjatë udhëtimit janë:



2.1 Pasaporta e Zakonshme e një qytetari të Federatës së Shën Kristoferit dhe Nevisit;

2.2 Pasaporta Diplomatie e një qytetari të Federatës së Shën Kristoferit dhe Nevisit;

2.3 Pasaporta e Shërbimit të Federatës së Shën Kristoferit dhe Nevisit;

2.4 Dokument të vlefshëm udhëtimi për rikthim në Federatën e Shën Kristoferit dhe Nevisit (vetëm për kthim në Federatën e Shën Kristoferit dhe Nevisit);

2.5 Dokumenti i Identifikimit të Detarëve të Federatës së Shën Kristoferit dhe Nevisit (bazuar në regjistrimin në listën e anijeve ose ekstraktin prej tij).

VENDIM

Nr. 524, datë 25.7.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË (MARRËSI), FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT), DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR GRANTIN WBIF, PËR PROGRAMIN E FURNIZIMIT ME UJË TË ZONAVE RURALE IV

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për grantin WBIF, për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV, me një grant në shumën 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE FINANCIMI

E DATËS 3.6.2019 NDËRMJET KfW,
FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË
(“MARRËSI”) DHE FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT (FSHZH) (“AGJENCIA E
ZBATIMIT TË PROJEKTIT”) PËR SHUMËN
1.800.000,00 EURO

-FURNIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE
IV: GRANTI I WBIF

NUMRI I GRANTIT: WB19-ALB-ENV-017
BMZ-nr.: 3020 00 107

KfW-ja dhe Marrësi synojnë lidhjen e marrëveshjeve për programin e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale IV” (“Programi”). Për të plotësuar fondet e ofruara nga Qeveria Gjermane (duke përfshirë një marrëveshje të veçantë huaje që do të lidhet ndërmjet KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit (Marrëveshja e Huasë)) për financimin e Programit, Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor (EWBJF) do t’i ofrojë Marrësit fonde shtesë për Kuadrin e Investimit të Ballkanit Perëndimor (WBIF) nëpërmjet KfW-së.

Në bazë të Kushteve të Përgjithshme të EWBJF-së, datë 7 nëntor, të ndryshuara herë pas here dhe Formularit të Aplikimit për Grant, datë 18 qershor 2018, të ndryshuar herë pas here (referuar së bashku si “Dokumentacioni i WBIF-së”) Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen e Financimit (“Marrëveshja”) si më poshtë:

Neni 1

Shuma dhe Qëllimi i Kontributit Financiar

1.1 KfW-ja i ofron Marrësit një kontribut financiar deri në shumën

1.800.000,00 euro (“Kontributi Financiar”).

Ky Kontribut Financiar nuk është i shlyeshëm, përveçse kur parashikohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi e kanalizon të plotë kontributin financiar në Agjencinë e Zbatimit të Projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit e përdor Kontributin Financiar vetëm për të financuar



konsulentin e zbatimit, i cili përgatit modelet e detajuara dhe dokumentacionin e tenderimit për masat e investimit të Programit (“Shërbimet e Ekspertëve”). Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e Shërbimeve të Ekspertëve dhe mallrat e shërbimet që do të financohen nga Kontributi Financiar nëpërmjet Marrëveshjes së Veçantë që do të siglohet nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, si edhe tarifat e importit nuk financohen nga Kontributi Financiar.

Neni 2

Kanalizimi i Kontributit Financiar për Agjencinë e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrësi e kanalizon Kontributin Financiar tek Agjencia e Zbatimit të Projektit si një grant të pashlyeshëm, sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Përpara disbursimit të parë nga Kontributi Financiar, Marrësi i paraqet KfW-së përkthimin e vërtetuar në gjuhën angleze ose gjermane të Marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Kontributit Financiar nuk përbën asnjë detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson Kontributin Financiar në përputhje me progresin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë në Marrëveshjen e Veçantë procedurën e disbursimit dhe në veçanti provat që vërtetojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

3.2 Sipas nenit 4, KfW-ja është e detyruar t'i kryejë disbursimet vetëm në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje nëse dhe deri në masën që:

a) KfW-ja ka marrë fondet përkatëse në mbështetje të Dokumentacionit të WBIF-së.

b) KfW-ja dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit kanë lidhur Marrëveshjen e Veçantë

c) dhe kushti i parashtruar në Nenin 2.2 është përmbushur.

3.3 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë t'i kryejë disbursimet pas datës 1 janar 2021.

Neni 4

Pezullimi i Disbursimeve dhe Shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund t'i pezullojë disbursimet, përveçse kur:

a) Marrësi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) detyrimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje ose të marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje nuk janë përmbushur;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se Kontributi Financiar është përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) disbursimet pezullohen plotësisht ose pjesërisht bazuar në Dokumentacionin e WBIF-së;

f) KfW-së i kërkohet të bëjë kërkesë për shlyerjen e Kontributit Financiar që nuk është përdorur në përputhje me Dokumentacionin e WBIF-së;

g) Dokumentacioni i WBIF-së nuk është më i vlefshëm dhe i zbatueshëm, ose nuk ka më efekt;

h) ndodh një ngjarje që i jep të drejtën KfW-së ta zgjidhë Marrëveshjen e Huasë ose të pezullojë disbursimet;

i) paraqiten rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht lëvrinim ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

4.2 Nëse ka ndodhur ndonjë prej situatave të specifikuar në nenin 4.1 b), c), d) ose f) dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW-ja, që megjithatë është të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e caktuar në nenin 4.1 b), mund të kërkojë shlyerje të menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e nenit 4.1 d), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të këtyre shumave, pagesa e të cilave ndaj Marrësit ose lënia e tyre tek Marrësi përbëjnë shkelje të ligjit të zbatueshëm.



c) në rastet e përcaktuara në nenin 4.1 c) ose f), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të këtyre shumave kur Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk arrin të provojë se këto shuma janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

Neni 5

Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që lindin lidhur me disbursimin e Kontributit Financiar.

Neni 6

Deklaratat Kontraktuale dhe Prokura/Fuqia e Përfaqësimit

6.1 Në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Marrësi përfaqësohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe persona të caktuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe të autorizuar me prokurë/fuqi përfaqësimi të vërtetuar nga ai ose ajo. Në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit përfaqësohet nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, dhe persona të caktuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe të autorizuar me prokurë të vërtetuar nga ai ose ajo. Prokurat nuk skadojnë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të tyre nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftimet apo deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuese në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendament që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Amendamentet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave dhe miratim tjetër. Amendamentet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Marrësit, nuk kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

Çdo njoftim apo deklaratë e tillë merret menjëherë sapo të ketë mbërritur në adresën e

mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në adresa të tjera të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:

KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Republika Federale e Gjermanisë

Faks: +49 69 7431-2944

Republika e Shqipërisë,

e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Blv. “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë

Shqipëri

Faks: +35542228494

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Rr. “Sami Frashëri” 10

Telefon: +355 4234 885

Faks: +355 4234 885

Neni 7

Shërbimet e Ekspertëve

7.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) përgatit dhe lëvron Shërbimet e Ekspertëve në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, standardet mjedisore dhe sociale dhe veçanërisht në përputhje me konceptin e dakordësuar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së për Shërbimet e Ekspertëve, dhe për këtë qëllim përdor shërbimet e inxhinierëve konsultues të pavarur dhe të kualifikuar;

b) jep kontratat për mallrat dhe shërbimet për t'u financuar nga Kontributi financiar bazuar në ofertimin paraprak konkurrues ndërkombëtar;

c) fillon përgatitjen e termave të referencës për Shërbimet e Ekspertëve përpara datës 18.6.2019;

d) fillon lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve përpara datës 18.6.2020;

e) përfundon lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve përpara datës 18.6.2022;

f) mban ose siguron mbajtjen e librave, regjistrave dhe llogarive të sakta dhe të rregullta për lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve, duke treguar



në mënyrë transparente të gjitha kostot e shkaktuara në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe identifikuar qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Kontribut Financiar, në përputhje me standardet e pranuar në nivel ndërkombëtar;

g) iu mundëson përfaqësuesve të KfW-së që të inspektojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat, si dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës që lidhet me lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

h) i jep KfW-së brenda dy javëve nga bërja e kërkesës çdo dhe të gjitha informacionet dhe dëshmitë për Shërbimet e Ekspertëve dhe progresin e tyre të mëtejshëm, sipas kërkesës së KfW-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar në informacionet dhe raportet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të WBIF-së për të raportuar, në veçanti (i) raportet e zbatimit vjetor në fund të shkurtit të çdo viti që përshijnë pjesën përshkruese dhe atë financiare, si dhe (ii) të dhënat përkatëse për përditësimet gjashtë mujore në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të WBIF-së në fund të marsit dhe shtatorit të çdo viti;

i) merr masat e arsyeshme, në përputhje me rregulloret dhe rregullat e veta, për të siguruar se kandidatët ose tenderuesit apo aplikantët e mundshëm përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit dhe nga dhënia e kontratës së prokurimit të financuar nga BE-ja/WBIF-ja, nëse Agjencia e Zbatimit të Projektit merr dijeni se ndaj këtyre subjekteve:

i) ose personave me të drejta përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi këto subjekte është dhënë një vendim penal ose administrativ i formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizata kriminale, pastrim parash, vepra penale të lidhura me terrorizmin, punën e fëmijëve apo trafikimin e qenieve njerëzore;

ii) ose personave me të drejta përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi këto subjekte është dhënë një vendim penal ose administrativ i formës së prerë për parregullsi që cenojnë interesat financiare të BE-së;

iii) janë përgjegjës për keqpërfaqësim lidhur me ofrimin e informacionit të kërkuar si kusht për të marrë pjesë në procedurë, ose nëse nuk e ofrojnë këtë informacion.

7.2 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) sigurojnë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe me kërkesë, i vënë në dispozicion

KfW-së prova që vërtetojnë mbulimin e kostove të papaguara nga Kontributi Financiar;

b) informojnë KfW-në me nismën e tyre për çdo apo të gjitha rrethanat që mund të pengojnë, vonojnë, rrezikojnë apo ndikojnë negativisht në lëvrimin, operimin, menaxhimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

c) marrin masa efektive dhe proporcionale për zbutjen e rrezikut të Praktikave të Ndaluara ose të veprimtarive të jashtëligjshme lidhur me përdorimin e Kontributit Financiar dhe/ose lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve. Të gjitha rastet e Praktikave të Ndaluara që lidhen me Kontributin Financiar dhe/ose lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve, si dhe masat e lidhura me to, të marra nga Marrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit i duhen raportuar menjëherë KfW-së. Marrësi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, merr masa për zgjidhjen e kontratave me kontraktuesit, për të cilat është përcaktuar se këta kontraktues janë përfshirë në Praktika të Ndaluara lidhur me lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe merr masat e duhura për rikuperimin e Kontributit të keqpërdorur Financiar ose të një pjese të tij.

Praktika të Ndaluara nënkuptojnë një ose më shumë nga praktikat e mëposhtme:

i) Praktikë Shtrenguese, siç përkufizohet në shtojcën 1;

ii) Praktikë e Fshehtë, siç përkufizohet në shtojcën 1;

iii) Praktikë Korruptive, siç përkufizohet në shtojcën 1;

iv) Praktikë Mashtruese, siç përkufizohet në shtojcën 1;

v) vjedhja që nënkupton keqpërvetësimin e një prone që i përket një pale tjetër.

d) i mundëson Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, apo çdo përfaqësuesi të autorizuar të shqyrtojë dokumentacionin dhe të kryejë kontrolle pa paralajmërim për përdorimin e Kontributit Financiar (duke përfshirë edhe procedurat e dhënies së kontratave të financuara nga Kontributi Financiar) në bazë të dokumenteve mbështetëse të kontabilitetit dhe çdo dokumenti tjetër të lidhur me financimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

e) i mundëson Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (referuar në vijim si “OLAF”) të kryejë hetime, duke përfshirë edhe kontrolle pa



paralajmërim, në përputhje me dispozitat e parashikuara në legjislacionin e BE-së për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së ndaj mashtrimit, korrupsionit dhe çdo veprimtarie tjetër të paligjshme, dhe, kur është e zbatueshme, çdo marrëveshje të bashkëpunimit administrativ të lidhur ndërmjet OLAF-it dhe organeve kundër mashtrimit të KfW-së;

f) ndërmerr t'i ofrojë zyrtarëve të Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe agentëve të tyre të autorizuar, me kërkesë, informacion dhe akses në çdo dokument dhe të dhëna të kompjuterizuara lidhur me menaxhimin teknik dhe financiar të operacioneve të financuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe t'u japë akses në mjediset dhe vendet ku kryhen këto operacione. Dokumentet dhe të dhënat e kompjuterizuara mund të përfshijnë informacione që Marrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit i konsiderojnë konfidenciale, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e veta të përcaktuara ose siç rregullohet nga marrëveshja kontraktuale. Sapo t'i ofrohet Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve apo çdo përfaqësuesi tjetër të autorizuar, ky lloj informacioni trajtohet në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e konfidencialitetit të BE-së. Dokumentet duhet të jenë të aksesueshme dhe të ruajtura në mënyrë që të mundësojnë kontrollin. Marrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit kanë detyrimin të informojnë Komisionin Evropian, OLAF-in ose Gjykatën Evropiane të Audituesve për vendndodhjen e saktë të ruajtjes. Kur çmohet e përshtatshme, palët mund të bien dakord të dërgojnë kopje të këtyre dokumenteve për shqyrtim dokumentacioni dhe

g) të informojnë Komisionin Evropian nëse në lidhje me lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve, ndonjëri prej tyre ka konstatuar se një palë e tretë është përfshirë në një prej situatave të referuara më poshtë ose nëse ka zbuluar ndonjë mashtrim dhe/ose parregullsi. Komisioni Evropian e hedh këtë informacion në Sistemin e Gjurmimit dhe Përfshirimit të Hershëm. Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit e informojnë Komisionin Evropian nëse ndonjëri prej tyre merr dijeni se informacioni i përcjellë duhet korrigjuar, përditësuar apo hequr. Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit sigurohen se subjekti i

interesuar është informuar se të dhënat e tij po i përcillen Komisionit Evropian dhe mund të hidhen në Sistemin e Gjurmimit dhe Përfshirimit të Hershëm dhe të publikohen në faqen e internetit të Komisionit Evropian.

h) Ata sigurojnë edhe zbatimin e Udhëzimeve të Komunikimit dhe Vizibilitetit të WBIF-së, bashkëlidhur Marrëveshjes së Veçantë si shtojcë, të referuar në nenin 7.3.

7.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e neneve 7.1 dhe 7.2 me anë të Marrëveshjes së Veçantë që do të siglohet nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

7.4 Marrësi e ndihmon Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, dhe në veçanti, i japin Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve.

7.5 Gjatë dhënies së kontratës, Marrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, mund të marrin parasysh, siç të shihet e përshtatshme dhe nën përgjegjësinë e tyre të plotë, informacionin që ndodhet në Sistemin e Gjurmimit dhe Përfshirimit të Hershëm. Aksesin në informacion mund të ofrohet përmes personave të autorizuar, ose konsultimit me Komisionin Evropian.

Neni 8

Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Shërbimet e Ekspertëve

8.1 Për të përmbushur parimet e pranuar në nivel ndërkombëtar për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja e bën publik informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me Shërbimet e Ekspertëve dhe me fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit



“Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Bërja publike e informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 8.3 më poshtë) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrës së tyre të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm, sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Shërbimet e Ekspertëve ose në financimin e tyre, si:

- a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;
- b) strategjitë e biznesit
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;
- d) të dhëna personale për personat fizikë;
- e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

8.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

- a) filialet e KfW-së;
- b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;
- c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;
- d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;
- e) palët e Kushteve të Përgjithshme të FPEBP-së;
- f) institucionet administruese të FPEBP-së;
- g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e saj.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrës së tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme që botojnë artikuj që kanë lidhje me qëllimin:

- a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/we/ge/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

- b) Tregu&Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

- c) OECD për qëllimin e raportimit të rrjedhjes financiare në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

- d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të siguruar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);

- e) Palët e Kushteve të Përgjithshme të FPEBP-së;

- f) Institucionet administruese të FPEBP-së;

- g) Bashkimi Evropian dhe institucionet e saj.

8.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë tek palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshme të Marrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshme të Marrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 8.1 që përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t’iu transferojë informacion palëve të treta nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave statutores ose rregullatore, ose për të ruajtur dhe mbrojtur kërkesat dhe të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

Neni 9

Dispozita të Ndryshme

9.1 Marrësi ndërmerr të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1 a (Akti i Përputhshmërisë së Marrësit). Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1 b (Akti i



Përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit).

Shtojca 1a

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej kësaj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit mund të mos caktojnë ose transferojnë, zotojnë ose hipotekojë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.

9.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

9.5 Kjo Marrëveshje Financimi nuk hyn në fuqi dhe nuk ka efekt derisa Marrësi të informojë KfW-në me shkrim se procedurat që duhen kryer prej tij, kanë përfunduar.

Hartuar në tre kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
sot më 3.6.2019

Tiranë,
sot më 3.6.2019

KfW

Republika e Shqipërisë, e
përfaqësuar nga Ministria e
Financave dhe Ekonomisë

Emri: Kirk Mildner
Titulli: Shef Divizioni

Emri: Anila Denaj
Titulli: Ministër

Emri:
Titulli:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Emri: Dritan Agolli
Titulli: Drejtor Ekzekutiv

Shtojca

- 1a-Angazhime të Përputhshmërisë për Marrësin

- 1b- Angazhime të Përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit

Angazhime të Përputhshmërisë së Marrësit

1. PËRKUFIZIME

Praktikë Shtrënguese: dëmtimi apo lëndimi, ose kërcërimi për dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë një personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e atij personi;

Praktikë e Fshehtë: është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

Praktikë Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejtë ose tërthorazi i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

Praktikë Mashtruese: është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim, që ngatërron ose përpiket të ngatërrojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar, ose të shmangies së një detyrimi;

Praktikë Penguese: (i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi, ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore, ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi akuzën e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Kanosëse, Praktike të Fshehtë, ose kërcërimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka di për çështjen që lidhet me hetimin, ose nga kryerja e hetimit, ose (ii) çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi akuzat e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Kanosëse, ose Praktike të Fshehtë.

Person: një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

Praktikë e sanksionueshme: çdo Praktikë Shtrënguese, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktike Mashtruese, ose Praktike Penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje), që (i) është e paligjshme sipas



legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme, dhe që (ii) ka, ose mund të ketë efekt material ligjor ose të lidhur me reputacionin mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së apo zbatimi të saj.

Sanksionet: sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara nga zbatuara nga Organi Sanksionues.

Organ Sanksionues: Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

Lista e Sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve, apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen Sanksioneve, e lëshuar nga çdo Organ Sanksionues.

2. NDËRMARRJET LIDHUR ME INFORMACIONIN

Marrësi

a) i vë në dispozicion KfW-së në kohë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me njohjen e klientit, apo informacione të ngjashme për Marrësin;

b) i ofron KfW-së sipas kërkesës, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të gjithë informacionin dhe dokumentet mbi Shërbimet e Ekspertëve të Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera përkatëse tek të cilat KfW-ja mbështetet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave, dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Marrësin, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e tij, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Shërbimet e Ekspertëve;

d) i jep KfW-së, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, inspektimin në çdo kohë të dokumentacionit të Marrësit dhe palëve të tij (nën) kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Shërbimet e

Ekspertëve dhe kryerjen e vizitave për Shërbimet e Ekspertëve dhe të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. SIGURIMET DHE GARANCITË

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman, apo legjislacionit të vendit të Marrësit, ky i fundit garanton se asnjë prej personave që vepron në emër të Marrësit për Shërbimet e Ekspertëve nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash, apo financim të terrorizmit.

3.2 Sigurimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe kërkohet të përsëriten në çdo tërheqje të Kontributit Financiar, referuar rrethanave që mbizotërojnë në atë datë.

4. NDËRMARRJET POZITIVE

Marrësi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, sapo Marrësi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash, apo financim të terrorizmit, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Marrësi i përgjigjet në kohë dhe hollësisht çdo njoftimi të KfW-së në veçanti dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. NDËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk kryen transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Shërbimet e Ekspertëve që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

Shtojca 1b

Angazhime të Përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit

1. PËRKUFIZIME

Praktikë Shtrënguese: dëmtimi apo lëndimi, ose kërcënimi për dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë një personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e atij personi;

Praktikë e fshehtë: është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;



Praktikë Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejtë ose tërthorazi i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

Kategoritë e Përcaktuara të Shkeljeve: kategoritë e mëposhtme të shkeljeve, të përkufizuara sipas Rekomandimeve të FATF-së dhe shënimeve përkatëse interpretuese: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhur dhe mallrave të tjerë; korrupsioni dhe mitëmarrja/mitëdhënia; mashtrimi; falsifikimi i parave; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja me forcë dhe pengmarrja; grabitja dhe vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat e tarifave doganore dhe akcizat); krimet tatimore (lidhur me taksat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

Rekomandimet e FATF-së: këto rekomandime, siç përkufizohen herë pas here nga Grupi i Posaçëm për Veprimin Financiar (FATF). FATF është një organ ndërqeveritar, qëllimi i të cilit është zhvillimi dhe promovimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Praktikë mashtruese: është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë keqpërfaqësimin që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar, ose shmangien e një detyrimi;

Burim i paligjshëm: burimi i fondeve të siguruara përmes

a) shkeljeve të renditura në Kategorinë e Përcaktuar të Shkeljeve;

b) çdo Praktikë Korruptive;

c) çdo Praktikë Mashtruese; ose

d) pastrimi i parave.

Praktikë Penguese: (i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi, ose fshehja e qëllimshme e provave

materiale hetimore, ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi akuzën e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese, Praktike të Fshtetë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka di për çështjen që lidhet me hetimin, ose nga kryerja e hetimit, ose (ii) çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi akuzat e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrënguese, ose Praktike të Fshtetë.

Person: një person fizik, person juridik, partneritet, apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

Praktikë e sanksionueshme: çdo Praktikë Kanosëse, Praktikë e Fshtetë, Praktikë Korruptive, Praktike Mashtruese, ose Praktike Penguese (sipas termave të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që (i) është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme, dhe që (ii) ka, ose mund të ketë efekt material ligjor ose të lidhur me reputacionin mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së, apo zbatimin e saj.

Sanksionet: sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga Organi Sanksionues.

Organi Sanksionues: Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

Lista e Sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve, apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen Sanksioneve, e lëshuar nga çdo Organ Sanksionues.

2. NDËRMARRJET LIDHUR ME INFORMACIONIN

Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) i vë në dispozicion KfW-së në kohë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që ka të bëjë me njohjen e klientit, apo informacione të ngjashme për Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe aksionarëve (të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë), filialeve dhe/ose ortakëve të tjerë të saj (nëse ka);

b) i ofron KfW-së në kohë, sipas kërkesës, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të gjithë



informacionin dhe dokumentet mbi Shërbimet e Ekspertëve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese, apo palëve të tjera përkatëse, të cilat KfW-ja mbështetet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave, dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) e informon KfW-në në kohë dhe me nismën e saj, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj të menaxhimit, organeve të tjera qeverisëse, apo aksionarëve të saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce;

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj inspektimin në çdo kohë të dokumentacionit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën) kontraktore apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe kryerjen e vizitave për Shërbimet e Ekspertëve dhe të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

f) E informon KfW-në në kohë dhe me nismën e saj për çdo rast që mund të sjellë klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse, apo të aksionarëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë, ose persona apo subjekte të bllokuar, të renditur në ndonjë Listë Sanksionesh.

3. SIGURIMET DHE GARANCITË

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman ose të vendit të Marrësit për ngritjen e Agjencisë së Zbatimit të Projektit, kjo e fundit siguron dhe garanton se janë të vërteta dhe të sakta sa më poshtë:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari vet.

b) Në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionarët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të

Projektit dhe as fondet e investuara në Shërbimet e Ekspertëve nuk kanë Burim të Paligjshëm.

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, ortakët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit.

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk (i) ka lidhur ndonjë marrëdhënie pune me shtetas me emërtim të veçantë, apo persona dhe subjekte të bllokuar, të renditur në çdo listë sanksionesh; ose nuk (ii) është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

3.2 Sigurimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe kërkohet të përsëriten në çdo tërheqje të Kontributit Financiar, referuar rrethanave që mbizotërojnë në atë datë.

4. NDËRMARRJET POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me Rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa asnjë kufizim kujdesin ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave, ose financimin e terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash, apo financim të terrorizmit, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet në kohë dhe hollësisht çdo njoftimi të KfW-së në veçanti dhe ofron mbështetje në dokumente për këtë përgjigje me kërkesë të KfW-së.

5. NDËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) sigurojë se kapitali apo fondet e tjera që investon nuk kanë burim të paligjshëm;

b) sigurojë se proceset e saj të punës nuk lënë vend për praktika të sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit dhe

c) të mos lidhë apo të mos zhvillojë më tej asnjë marrëdhënie pune me shtetas me emërtim të veçantë, apo persona dhe subjekte të bllokuar, të



renditur në çdo listë sanksionesh; ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

VENDIM
Nr. 525, datë 25.7.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË
(MARRËSI), FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT (AGJENCIA E ZBATIMIT
TË PROJEKTIT), DHE KfW FRANKFURT
AM MAIN (KfW), PËR MASAT
SHOQËRUESE NË KUADËR TË
PROGRAMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
TË ZONAVE RURALE IV**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (Agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për masat shoqëruese në kuadër të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale IV, me një grant në shumën 2 000 000 (dy milionë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE FINANCIMI

E DATËS 3.6.2019 NDËRMJET KfW,
FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË
(“MARRËSI”) DHE FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT (FSHZH) (“AGJENCIA E
ZBATIMIT TË PROJEKTIT”) PËR SHUMËN
2.000.000,00 EURO

-FURNIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE
IV: MASAT SHOQËRUESE-
NR. I BMZ-SË. 201470. 111.

PËRMBAJTJA

Neni 1

1. Shuma dhe qëllimi i Kontributit Financiar
 2. Kanalizimi i Kontributit Financiar për Agjencinë e Zbatimit të Projektit
 3. Disbursimi
 4. Pezullimi i Disbursimeve dhe Shlyerja
 5. Kostot dhe Tarifatat Publike
 6. Deklaratat Kontraktuale dhe Prokura/Fuqitë e Përfaqësimit
 7. Shërbimet e Ekspertëve
 8. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Shërbimet e Ekspertëve
 9. Dispozita të Ndryshme
- Angazhime të Përputhshmërisë së Marrësit
Angazhime të Përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit

KfW-ja dhe Marrësi synojnë lidhjen e marrëveshjeve për programin e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale IV” (“Programi”). Për masat shoqëruese të masave të investimit të marrëveshjes së huas të lidhur ndërmjet KfW-së dhe Marrësit për qëllimet e Programit në shumën 40.000.000 Euro (“Marrëveshja e Huas”), Qeveria Gjermane ka ofruar fonde shtesë.

Projekti do të bashkëfinancohet nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor (“EWBJF”) në Kuadrin e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (“WBIF”) Për këtë qëllim, KfW-ja dhe Marrësi kanë lidhur marrëveshje të veçanta financimi (“Marrëveshja e Financimit e WBIF-së”).

Në mbështetje të marrëveshjes që mbetet për t’u lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës



Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar 2018 për programin Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV (“Marrëveshja Qeveritare”), Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të Financimit (“Marrëveshja”).

1. Shuma dhe qëllimi i Kontributit Financiar

1.1 KfW-ja i ofron Marrësit një kontribut financiar deri në shumën 2.000.000,00 euro (“Kontributi Financiar”).

Ky Kontribut Financiar nuk është shlyeshëm, përveçse kur parashikohet ndryshe në nenin 0.

1.2 Marrësi e kanalizon të plotë kontributin financiar në Agjencinë e Zbatimit të Projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit e përdor Kontributin Financiar vetëm për të financuar konsulentin e masave shoqëruese të Programit (“Shërbimet e Ekspertëve”) dhe për të paguar kryesisht kostot e këmbimit valutor. Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet dhe objektin e Shërbimeve të Ekspertëve që do të financohen nga Kontributi Financiar në një marrëveshje të veçantë (“Marrëveshja e Veçantë”) që do të siglohet nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësisht kontributet homologe që do të dorëzohen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit në Marrëveshjen e Veçantë që do të siglohet nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Agjencia e Zbatimit të Projektit i dorëzon kontributet homologe të plota dhe në kohën e duhur. Agjencia e Zbatimit të Projektit i jep KfW-së, sipas kërkesës, dëshmitë që vërtetojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, si edhe tarifat e importit nuk financohen nga Kontributi Financiar.

2. Kanalizimi i Kontributit Financiar për Agjencinë e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrësi e kanalizon Kontributin Financiar tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në formën e një granti të pashlyeshëm, sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Përpara disbursimit të parë nga Kontributi Financiar, Marrësi i paraqet KfW-së përktimin e

vërtetuar në gjuhën angleze ose gjermane të marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Kontributit Financiar nuk përbën asnjë detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

3. Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson Kontributin Financiar në përputhje me progresin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë në Marrëveshjen e Veçantë procedurën e disbursimit dhe në veçanti provat që vërtetojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

3.2 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë t'i kryejë disbursimet pas datës 30 mars 2025.

4. Pëzullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund ti pëzullojë disbursimet, përveçse, kur:

a) Marrësi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre,

b) detyrimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje ose të marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje, nuk janë përmbushur

c) ose Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se Kontributi Financiar është përdorur për qëllimin e përcaktuar,

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm,

e) paraqiten rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht lëvrimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

4.2 Nëse ka ndodhur ndonjë prej situatave të specifikuara në nenin 4.1 b), c) ose d) dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW-ja që megjithatë është të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e caktuar në nenin 4.1 b), mund të kërkojë shlyerje të menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e nenit 4.1 d), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të këtyre shumave, pagesa e të cilave ndaj Marrësit ose lënia e tyre tek Marrësi përbëjnë shkelje të ligjit të zbatueshëm.

c) në rastet e përcaktuara në nenin 4.1 c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave që Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk



arrin të provojë se këto shuma janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

5. Kostot dhe tarifat publike

Marrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që lindin lidhur me disbursimin e Kontributit Financiar.

6. Deklaratat Kontraktuale dhe Prokura/Fuqitë e Përfaqësimit

6.1 Në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Marrësi përfaqësohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, dhe persona të caktuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe të autorizuar nga modele nënshkrimesh të vërtetuara nga ai ose ajo. Në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit përfaqësohet nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe persona të caktuar nga ai ose ajo për KfW-në dhe të autorizuar me prokurë të vërtetuar nga ai ose ajo. Prokurat nuk skadojnë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të tyre nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftimet apo deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuese në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendament që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Amendamentet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave dhe nuk kërkojnë miratim të mëtejshëm qeveritar ose tjetër. Amendamentet e kësaj Marrëveshjeje që prekin vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Marrësit nuk kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

Çdo njoftim apo deklaratë merret menjëherë sapo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse, ose në adresa të tjera të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:

KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Republika Federale e Gjermanisë

Faqe | 8268

Faks: +49 69 7431-2944

Për Marrësin:

Republika e Shqipërisë,
e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe
Ekonomisë

Blv. “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë

Shqipëri

Faks: +35542228494

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Rr. “Sami Frashëri” 10

Telefon: +355 4234 885

Faks: +355 4234 885

7. Shërbimet e Ekspertëve

7.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) përgatit dhe lëvron Shërbimet e Ekspertëve në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, standardet mjedisore dhe sociale dhe veçanërisht në përputhje me konceptin e dakordësuar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së për Shërbimet e Ekspertëve, dhe për këtë qëllim përdor shërbimet e inxhinierëve konsultues të pavarur dhe të kualifikuar;

b) jep kontratat për mallrat dhe shërbimet për t'u financuar nga Kontributi financiar bazuar në ofertimin paraprak konkurrues ndërkombëtar;

c) mban ose siguron mbajtjen e librave, regjistrave dhe llogarive të sakta dhe të rregullta, duke treguar në mënyrë transparente të gjitha kostot e shkaktuara në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe identifikuar qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Kontribut Financiar;

d) iu mundëson përfaqësuesve të KfW-së që të inspektojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat, si dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës që lidhet me lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

e) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së;

7.2 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) sigurojnë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe me kërkesë, i vënë në dispozicion



KfW-së prova që vërtetojnë mbulimin e kostove të papaguara nga Kontributi Financiar;

b0 informojnë KfW-në me nismën e tyre për çdo apo të gjitha rrethanat që pengojnë apo rrezikojnë seriozisht lëvrimin, operimin, menaxhimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertëve.

7.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e neneve 0 dhe 0 të Marrëveshjes së Veçantë që do të siglohet nga Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

7.4 Marrësi e ndihmon Agjencinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, dhe në veçanti, i japin Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për lëvrimin e Shërbimeve të Ekspertëve.

8. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Shërbimet e Ekspertëve

8.1 Për të përmbushur parimet e pranuar në nivel ndërkombëtar për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja e bën publik informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me Shërbimet e Ekspertëve dhe me fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Bërja publike e informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 0 më poshtë) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm, sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Shërbimet e Ekspertëve ose në financimin e tyre, si:

- a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;
- b) strategjitë e biznesit

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) të dhëna personale për personat fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

8.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) palët e Kushteve të Përgjithshme të FPEBP-së;

f) institucionet administruese të FPEBP-së;

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e saj.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme që botojnë artikuj që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) Tregu&Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit përtregun

(<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD-ja për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të siguruar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);



e) palët e Kushteve të Përgjithshme të FPEBP-së;

f) institucionet administruese të FPEBP-së;

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e saj.

8.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë tek palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshme të Marrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshme të Marrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 0 që përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t'iu transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave statutores ose rregullore ose për të ruajtur dhe mbrojtur kërkesat dhe të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

9. Dispozita të ndryshme

9.1 Marrësi ndërmerr të pëmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në Shtojcën 1 a (Angazhime të Përputhshmërisë së Marrësit). Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të pëmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në Shtojcën 1 b (Angazhime të Përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit).

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej kësaj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund caktojnë ose transferojnë, zotojnë ose hipotekojnë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

9.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

9.5 Marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të vendosura nga kjo Marrëveshje, përfundojnë gjashtë vjet pas disbursimit të fundit.

9.6 Kjo Marrëveshje Financimi nuk hyn në fuqi dhe nuk ka efekt derisa të ketë hyrë në fuqi Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën është bazuar dhe derisa Marrësi të informojë KfW-në me shkrim se procedurat që duhen kryer prej tij kanë përfunduar.

Hartuar në tre kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,

sot më 03.06.2019

Tiranë,

sot më 3.6.2019

KfW

Emri: Dr. Kirk Mildner

Titulli: Përgjegjës Divizioni

Emri: Bjorn Thies

Titulli:

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Emri: Anila Denaj

Titulli: Ministër

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Emri: Dritan Agolli

Titulli: Drejtor Ekzekutiv

Shtojca

- 1a-Angazhime të Përputhshmërisë së Marrësit
- 1b-Angazhime të Përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit

SHTOJCA 1 A

ANGAZHIME TË PËRPUTHSHMËRISË
SË MARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

Praktikë Shtrënguese: dëmtimi apo lëndimi, ose kërcërimi për dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë një personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e atij personi;



Praktikë e Fshehtë: është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

Praktikë Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejtë ose tërthorazi i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

Praktikë Mashtruese: është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim, që ngatërrojnë ose përplojnë të ngatërrojnë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar, ose të shmangies së një detyrimi;

Praktikë Penguese: (i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi, ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore, ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi akuzën e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Kanosëse, Praktike të Fshehtë, ose kërcënimin, ngacmimin apo frikësimin të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka di për çështjen që lidhet me hetimin, ose nga kryerja e hetimit, ose (ii) çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi akuzat e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Kanosëse, ose Praktike të Fshehtë.

Person: një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

Praktikë e sanksionueshme: çdo Praktikë Shtrënguese, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktike Mashtruese ose Praktike Penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje) që (i) është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme dhe që (ii) ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose të lidhur me reputacionin mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së apo zbatimi të saj.

Sanksionet: sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga Organi Sanksionues.

Organ Sanksionues: Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

Lista e Sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve, apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen Sanksioneve, e lëshuar nga çdo Organ Sanksionues.

2. NDËRMARRJET LIDHUR ME INFORMACIONIN

Marrësi

a) i vë në dispozicion KfW-së në kohë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me njohjen e klientit apo informacione të ngjashme për Marrësin;

b) i ofron KfW-së sipas kërkesës, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të gjithë informacionin dhe dokumentet mbi Projektin të Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera përkatëse tek të cilat KfW-ja mbështetet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Marrësin, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e tij, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) i jep KfW-së, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj Shtojce dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, inspektimin në çdo kohë të dokumentacionit të Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave për Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. SIGURIMET DHE GARANCIA

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Marrësit, ky i fundit garanton se asnjë prej personave që vepron në emër të Marrësit për Projektin nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit.



3.2 Sigurimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe kërkohet të përsëriten në çdo tërheqje të Kontributit Financiar, referuar rrethanave që mbizotërojnë në atë datë.

4. NDËRMARRJET POZITIVE

Marrësi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, sapo Marrësi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash, apo financim të terrorizmit, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Marrësi i përgjigjet në kohë dhe hollësisht çdo njoftimi të KfW-së në veçanti dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. NDËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk kryen transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Projektin që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

SHTOJCA 1B

ANGAZHIME TË PËRPUTHSHMËRISË SË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTT

1. PËRKUFIZIME

Praktikë Shtrenguese: dëmtimi apo lëndimi ose kërcënim i për dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë një personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e atij personi;

Praktikë e Fshehtë: është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

Praktikë Korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejtë ose tërthorazi i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

Kategoritë e Përcaktuara të Shkeljeve: kategoritë e mëposhtme të shkeljeve, të përkufizuara sipas Rekomandimeve të FATF-së dhe shënimeve përkatëse interpretuese: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit;

trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhur dhe mallrave të tjerë; korrupsioni dhe mitëmarrja/mitëdhënia; mashtrimi; falsifikimi i parave; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja me forcë dhe pengmarrja; grabitja dhe vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat e tarifave doganore dhe akcizat); krimet tatimore (lidhur me taksat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

Rekomandimet e FATF-së: këto rekomandime, siç përkufizohen herë pas here nga Grupi i Posaçëm për Veprimin Financiar (FATF). FATF është një organ ndërqeveritar, qëllimi i të cilit është zhvillimi dhe promovimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Praktikë mashtruese: është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë keqpërfaqësimin, që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje një person, me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi;

Burim i paligjshëm: burimi i fondeve të siguruara përmes

a) shkeljeve të renditura në Kategorinë e Përcaktuar të Shkeljeve;

b) çdo Praktikë Korruptive;

c) çdo Praktikë Mashtruese ose

d) pastrimi i parave.

Praktikë Penguese: (i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi akuzën e një Praktike Korruptive, Praktike Mashtruese, Praktike Shtrenguese, Praktike të Fshehtë, ose kërcënim, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka di për çështjen që lidhet me hetimin, ose nga kryerja e hetimit, ose (ii) çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi akuzat e një Praktike Korruptive, Praktike



Mashtruese, Praktike Shtrënguese, ose Praktike të Fshehtë.

Person: një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

Praktikë e sanksionueshme: çdo Praktikë Kanosëse, Praktikë e Fshehtë, Praktikë Korruptive, Praktike Mashtruese, ose Praktike Penguese (sipas termave të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që (i) është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme, dhe që (ii) ka, ose mund të ketë efekt material ligjor ose të lidhur me reputacionin mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së, apo zbatimin e saj.

Sanksionet: sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga Organi Sanksionues.

Organi Sanksionues: Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

Lista e Sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve, apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që i nënshtrohen Sanksioneve, e lëshuar nga çdo Organ Sanksionues.

2. NDËRMARRJET LIDHUR ME INFORMACIONIN

Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) i vë në dispozicion KfW-së në kohë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që ka të bëjë me njohjen e klientit, apo informacione të ngjashme për Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe aksionarëve (të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë), filialeve dhe/ose ortakëve të tjerë të saj (nëse ka);

b) i ofron KfW-së në kohë, sipas kërkesës, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të gjithë informacionin dhe dokumentet mbi Shërbimet e Ekspertëve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese, apo palëve të tjera përkatëse, të cilat KfW-ja mbështetet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave, dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e saj, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë

Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj të menaxhimit, organeve të tjera qeverisëse, apo aksionarëve të saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj Shtojce;

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj inspektimin në çdo kohë të dokumentacionit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën) kontraktore apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe kryerjen e vizitave për Shërbimet e Ekspertëve dhe të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj Shtojce.

f) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e saj për çdo rast që mund të sjellë klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse apo të aksionerëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë, ose persona apo subjekte të bllokuar, të renditur në ndonjë Listë Sanksionesh.

3. SIGURIMET DHE GARANCITË

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman ose të vendit të Marrësit për ngritjen e Agjencisë së Zbatimit të Projektit, kjo e fundit siguron dhe garanton se janë të vërteta dhe të sakta sa më poshtë:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari vet.

b) Në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionerët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe as fondet e investuara në Shërbimet e Ekspertëve nuk kanë Burim të Paligjshëm.

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, ortakët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit.

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk (i) ka lidhur ndonjë marrëdhënie pune me shtetas me emërtim të veçantë, apo persona dhe subjekte të bllokuar, të renditur në çdo Listë Sanksionesh; ose nuk (ii) është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.



3.2 Sigurimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe kërkohet të përsëriten në çdo tërheqje të Kontributit Financiar, referuar rrethanave që mbizotërojnë në atë datë.

4. NDËRMARRJET POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me Rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa asnjë kufizim kujdesin ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e Praktikave të Sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim të terrorizmit, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet në kohë dhe hollësisht çdo njoftimi të KfW-së në veçanti dhe ofron mbështetje në dokumente për këtë përgjigje me kërkesë të KfW-së.

5. NDËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) sigurojë se kapitali apo fondet e tjera që investon nuk kanë burim të paligjshëm;

b) sigurojë se proceset e saj të punës nuk lënë vend për praktika të sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit; dhe

c) të mos lidhë apo të mos zhvillojë më tej asnjë marrëdhënie pune me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuar, të renditur në çdo listë sanksionesh; ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

VENDIM

Nr. 539, datë 25.7.2019

PËR MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR POLITIKËN QEVERISËSE DREJT NJË MJEDISI MUNDËSUES PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE 2019–2023, I RISHIKUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023, i rishikuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Kryeministria është përgjegjëse për bashkëveprimin dhe monitorimin për zbatimin e udhërrëfyesit.

3. Vendimi nr. 459, datë 27.5.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e udhërrëfyesit për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si edhe institucionet e tjera përgjegjëse të përcaktuara në shtojcën “Plani i veprimit”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

1. Udhërrëfyes për politikën e qeverisë drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023 i rishikuar

Akronime dhe shkurtime

1. Hyrje

2. Struktura e Udhërrëfyesit të Rishikuar

2.1 Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunim i institucionalizuar qeveri-shoqëri civile në politikëbërje dhe në integrimin evropian

Prioriteti 1: Krijimi dhe ruajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile



Prioriteti 2: Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të

Prioriteti 3: Përfshirja e qëndrueshme dhe efikase e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes

Prioriteti 4: Sigurimi i kontributit të OSHC-ve në procesin e aderimit në përputhje me praktikën e mira të BE-së

Prioriteti 5: Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive me fokus të veçantë në nivel lokal

2.2 Drejtimi Strategjik 2: Mundësimi i mjedisit ligjor & qeverisjes së të dhënave

Prioriteti 6: Krijimi i një kuadri më mundësues për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve

Prioriteti 7: Mbledhja dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile

2.3 Drejtimi strategjik 3: Kuadër fiskal dhe financues i favorshëm

Prioriteti 8: Krijimi i një kuadri të financimit publik për mbështetjen e programeve të OSHC-ve në përputhje me praktikën e mira të BE-së

Prioriteti 9: Raportimi financiar/kontabilizimi dhe tatimi i OSHC-ve

3. Përfundim

SHTOJCA

Shtojca 1 Organet qeveritare të përfshira në mekanizmin institucional OSHC – qeveri

Akronime dhe shkurtime

AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
EUD	Delegacioni i Bashkimit Evropian
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IPA	Instrument për Asistencë para Aderimit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MIS	Sistem për Menaxhimin e Informacionit
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
KKSHC	Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile
KKIE	Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian

OJQ

RAP

AT

ToR

TVSh

Organizatë Joqeveritare

Reforma e Administratës Publike

Asistencë Teknike

Termat e Referencës

Tatimi për Vlerën e Shtuar

1. Hyrje

Konteksti

Nga viti 2001 deri më 2017-n, në Shqipëri janë regjistruar 7580 organizata joqeveritare nga autoritetet si shoqata, fondacione ose qendra³. Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar ta përfshijë aktivisht shoqërinë civile në përcaktimin e agjendës politike të vendit, si dhe në zbatimin e politikave të monitorimit, sidomos në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2015–2021, si dhe Planit Kombëtar për Integrimin Evropian theksojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e integritetit evropian të vendit.

Nxjtja aktive dhe gjithëpërfshirëse e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave të tyre në jetën sociale, ekonomike dhe politike është karakteristike për shoqëritë demokratike. Një kuadër ligjor dhe fiskal/financiar mundësues dhe eficient për këto organizata, garantuar nga shteti, përbën një parakusht për mirëfunksionimin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit.

Kështu, krijimi i një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile është një nga parakushtet dhe masat për një demokraci të qëndrueshme në një shtet modern. Ky mjedis, i krijuar nga shteti, duhet të garantojë kushte të favorshme fiskale dhe ligjore për shoqërinë civile dhe të krijojë hapësirë për lirinë e medias, institucionet e pavarura, lirinë e fjalës, si dhe për të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit. Një nga veçoritë bazë të qeverive demokratike është detyrimi i shtetit për të qenë në shërbim të qytetarëve të tij. Dialogu dhe bashkëpunimi mes autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile janë në interesin e drejtpërdrejtë dhe në të mirë të publikut dhe, rrjedhimisht, një parakusht për mirëfunksionimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Bashkëpunimi i mirë midis një qeverie me

³ Të dhëna të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor të Tiranës në shkurt të vitit 2018.



mendësi të orientuar drejt shërbimit dhe një shoqërie civile aktive, kritike dhe konstruktive përbën një element të domosdoshëm të demokracisë pluraliste, e cila u jep mundësi qytetarëve të organizojnë lirisht grupe interesi dhe të marrin pjesë në ciklin e politikave dhe në proceset vendimmarrëse të vendit të tyre në mënyrë të rregulluar dhe transparente.

Udhërrëfyesi fillestar për një politikë mundësuese të qeverisë për zhvillimin e shoqërisë civile u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 27.5.2015, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 94 të vitit 2015⁴. Miratimi i Udhërrëfyesit u parapri nga konsultime të gjera me përfaqësues të OSHC-ve, si dhe me komunitetin e donatorëve. Po kështu, edhe Kuvendi i Shqipërisë më 24.12.2014 miratoi një *Rezolutë për njohjen edhe forcimin e rolit të shoqërisë civile* si një akt që mbështet fuqishëm të gjithë hapat e ndërmarrë nga qeveria dhe nga shoqëria civile. Në zbatim të Manualit të pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit, miratuar datë 11.11.2014, Kuvendi ka vendosur urat e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe grupet e interesit.

Udhërrëfyesi i rishikuar 2019–2023 pasqyron pikëpamjen e qeverisë, bazuar edhe në kontributin e:

- Përfaqësuesve të ministrive të linjës përgjegjëse për masa specifike parashikuar në Udhërrëfyes
- Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)
- Shoqërisë Civile përmes një sondazhi online publikuar nga AMSHC-ja në faqen e saj zyrtare
- Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC) që përfaqësojnë shoqërinë civile
- Konsultimeve individuale dhe në grupe me përfaqësues të sektorit të shoqërisë civile

Versioni i rishikuar iu prezantua komunitetit më të gjerë të donatorëve dhe rishikimi i tij u mbështet nga Delegacioni i BE-së.

Udhërrëfyesi përshkruan shkurtimisht situatën aktuale të masave të Udhërrëfyesit, si dhe sfidat kryesore. Ai fokusohet përgjithësisht në përcaktimin e masave që qeveria duhet të ndërmarrë muajt dhe vitet e ardhshme për përmirësimin e mjedisit ku operon shoqëria civile. Ai fokusohet po ashtu edhe në dialogun e

institucionalizuar mes shoqërisë civile dhe qeverisë dhe aktorëve të tjerë për reformën e politikave dhe integrimin evropian. Përveç kësaj, identifikon institucionet publike të Qeverisë së Shqipërisë përgjegjëse për zbatimin e Udhërrëfyesit dhe përshkruan sistemin e tij të monitorimit.

Me këtë Udhërrëfyes të rishikuar, qeveria shqiptare dëshiron të demonstrojë angazhimin e saj për të mundësuar një mjedis të favorshëm për shoqërinë civile. Ndonëse të vetëdijshëm për pengesat që has sektori i shoqërisë civile, qeveria shqiptare shpreh angazhimin e saj të prerë për të vazhdat dhe të për intensifikuar punën tashmë të filluar me Udhërrëfyesin e mëparshëm.

Rruga drejt së ardhmes

Dokumenti i rishikuar i Udhërrëfyesit paraqet një sërë veprimesh dhe masash konkrete në një larmi fushash politikash të ndërlydhura që plotësojnë njëra-tjetrën: kuadri ligjor me fokus përmirësimin e çështjes së regjistrimit, një kuadër më i fortë institucional për punën e OSHC-ve, mekanizma publike më të qartë dhe më transparente për programet e OSHC-ve, gjithëpërfshirje të OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve sociale në nivel kombëtar dhe lokal sipas standardeve, konsultime të rregulluara me OSHC-të në hartimin e ligjeve të reja, një politike të favorshme tatimore dhe një kuadri më të favorshëm ligjor, fiskal dhe institucional për nxitjen e vullnetarizmit dhe për mundësimin e nxitjes së filantropisë.

Janë identifikuar tre fusha strategjike me një paketë prej 42 masash që duhet të ndërmerren nga institucionet e përcaktuara për të krijuar dhe për të ruajtur një mjedis më të favorshëm për shoqërinë civile.

Për të garantuar monitorimin e duhur të procesit të zbatimit, janë vendosur 130 tregues për 42 masat e parashikuara.

Shoqëria civile shihet njëkohësisht edhe si partnere e afërt në zbatimin e masave të ndryshme të Udhërrëfyesit dhe në nxitjen e mëtejshme të një platforme për ndërtimin e një dialogu konstruktiv për zhvillimin e këtij sektori.

1. Bashkëpunimi i institucionalizuar qeveri – shoqëri civile

Me qëllim fillimin formal të negociatave të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian do të nevojitet dhe do të sigurohet një bashkëpunimi dhe bashkërendim më i ngushtë në

⁴ Fletore Zyrtare nr. 94, datë 9 qershor 2015.



të gjitha nivelet e qeverisë me platformat parlamentare dhe ato të shoqërisë civile në lidhje me çështjet e integritetit evropian.

Do të rritet më tej roli i OSHC-ve në Kombëtar të Integritetit Evropian (KKIE), ngritur më 2015-n. Roli dhe kontributi i OSHC-ve në punën e përgjithshme të Këshillit konsiderohet pjesë jetësore e procesit të negocimit të anëtarësimit në BE, veçanërisht sa i përket rolit të tyre në përfaqësimin e zërit të qytetarëve dhe në mbështetjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve të Shqipërisë në lidhje me ndikimin e integritetit në BE në jetën e tyre. Ministria e re për Evropën dhe Punët e Jashtme, e krijuar pas zgjedhjeve të qershorit të 2017-s është ministria e linjës përgjegjëse për garantimin e forcimit institucional të këtij bashkëpunimi dhe fillimit të masave të parashikuara në Udhërrëfyesin e 2019-s.

Që prej 2015-s, miratimi i ligjit për ngritjen e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC), i cili ka rol këshillues dhe konsultues në raport me Këshillin e Ministrave, ofroi kuadrin për një dialog dhe konsultime të institucionalizuara me organizatat e shoqërisë civile në të gjitha çështjet me interes për OSHC-të dhe në lidhje me reformat dhe politikat kyçe të ndërmarra nga qeveria.

Institucionalizimi i bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile do të kërkojë që të gjitha ministritë e përfaqësuara në Këshill të sigurojnë qarkullimin e duhur të informacioni, ngritjen dhe funksionimin e grupeve të punës së Këshillit, si dhe përfshirjen e anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit në procesin e vazhdueshëm të diskutimeve të grupeve ndërminstrore të punës. Ky është parakushti për të gjithë anëtarët e Këshillit në ushtrimin e mandatit të tyre siç parashikohet në ligj.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) është sekretariati teknik i Këshillit dhe e mbështet Këshillin në respektimin e ligjit dhe akteve nënligjore duke siguruar komunikim të gjerë publik të punës së Këshillit, si dhe duke rritur ndërgjegjësimin lidhur me Udhërrëfyesin si një platformë e përbashkët për avancimin më tej të përpjekjeve në krijimin e një mjedisi mundësues për punën e shoqërisë civile në Shqipëri.

Plani i punës i vitit 2019 i Këshillit, miratuar në mars 2019, do të rinovohet çdo vit sipas masave të miratuara që do të ndërmerren nga KKSHC-ja dhe anëtarët e saj shtetërorë dhe ata të shoqërisë civile dhe në kuadrin e një bashkërendimi më të gjerë, me

partnerët për zhvillim (ose me Grupin e Punës për Shoqërinë Civile) angazhuar në masat që lidhen me këtë Udhërrëfyes.

Sistemi i vendosur për zbatimin e ligjit nr. 146/2014 për njoftimin dhe konsultimin publik, i mbështetur gjerësisht nga shoqëria civile si një ligj kyç në ofrimin e hapësirave për një dialog të mirëstrukturuar, ndonëse ende në fazat e hershme të zhvillimit, ofron një mundësi të madhe dhe potencial për hapjen e hapësirave të dialogut dhe konsultimeve midis qeverisë qendrore, qeverisë vendore dhe shoqërisë civile, *think tank*-eve, partnerëve social dhe të gjithë aktorëve të tjerë në këtë sektor.

Në planin afatmesëm, platforma do të parashikojë edhe ofrimin e kontributeve individuale të OSHC-ve në platformën elektronike për identifikimin e OSHC-ve në kategorinë e organizatave jofitimprurëse.

Ligji për vullnetarizmin (nr. 45/2016) do të ketë nevojë për t'u zhvilluar më tej, duke rregulluar kështu qartësisht të gjitha mundësitë, të drejtat dhe detyrimet që lidhen me punën vullnetare. Do të miratohen akte nënligjore që rregullojnë marrëdhënien midis vullnetarëve dhe organizatave pritëse. ligji do të duhet të mishërohet në një koncept kombëtar për vullnetarizmin dhe qytetarinë aktive, i cili do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, duke ndjekur praktika evropiane të mira dhe të realizueshme në praktikë. Shërbimi Kombëtar për Punësimin dhe Formimin Profesional me degët e tij në të gjithë vendin është i pozicionuar mirë për të luajtur rol të rëndësishëm në skemën kombëtare të vullnetarizmit.

2. Mundësimi i mjedisit ligjor dhe qeverisjes së të dhënave

Të dhënat në lidhje me historikun dhe ndryshimet e statusit të OSHC-ve nuk janë të gatshme në mënyrë të menjëhershme, pavarësisht se ligji kërkon që ato të jenë të disponueshme. Përveç kësaj, të dhënat në lidhje me aktivitetet dhe burimet e të ardhurave të organizatave të shoqërisë civile shqiptare nuk disponohen në një formë të konsoliduar.

Mungesa e të dhënave paraqet sfida të kuptueshme për politikëbërje të bazuar në evidenca në fushën e shoqërisë civile. Ky problem do të zgjidhej me krijimin e një sistemi të centralizuar të menaxhimit të të dhënave të OSHC-ve, në të cilin



mund të hidheshin të gjitha të dhënat. Po kështu, të dhënat në lidhje me historikun dhe ndryshimet e statusit të OSHC-ve do të jenë të disponueshme siç e kërkon ligji. Përveç kësaj, të dhënat në lidhje me aktivitetet dhe burimet e të ardhurave të OSHC-ve shqiptare do të mblidhen mbi baza vullnetare dhe do të publikohen në faqen zyrtare të AMSHC-së.

Për të përcaktuar hapat e nevojshëm (të politikave) për mbështetjen e rritjes së shoqërisë civile shqiptare duhet të ekzistojnë të dhëna të besueshme dhe gjithëpërfshirëse për politikëbërësit, publikun, donatorët dhe partnerët.

Për këtë qëllim, procedurat dhe qasjet praktike që lidhen me regjistrimin dhe çregjistrimin e OSHC-ve do të adresohen dhe procedurat e ngarkuara dhe të vjetruara do të tejkalohen me identifikimin e institucioneve më të përshtatshme për proceset e regjistrimit në të ardhmen.

Gjithashtu, do të hartohen dhe do të miratohen një sërë aktesh të reja ligjore dhe nënligjore dhe do të bëhen studime në bazë të analizës së mangësive. Ministrinë e ngarkuara me zbatimin e ligjeve përkatëse siç janë përcaktuar më poshtë në Udhërrëfyes do të marrin përsipër përgjegjësinë për promovimin e ndryshimeve të sipërpërmendura legjislative.

3. Kuadri fiskal dhe financues

Tashmë ekzistojnë standarde të reja kombëtare për kontabilitetin për organizatat jofitimprurëse. Megjithatë, kuadri rregullator për çështjet fiskale që lidhen me nevojat e OSHC-ve duhet të përditësohet, pasi OSHC-të në Shqipëri hasin ende sfida në këtë aspekt.

Përmes këtij Udhërrëfyesi, Qeveria e Shqipërisë shpreh angazhimin e saj për përmirësimin e kuadrit rregullator për çështjet fiskale që lidhen me OSHC-të. Masat e parashikuara përfshijnë përmirësimin e procedurave aktuale për rimbursimin e TVSh-së në kuadrin e granteve të financuara nga Instrumenti për Asistencën e para Aderimit (IPA) apo Programeve të tjera të financuara nga BE, trajnimin e autoriteteve tatimore, rregullimin e financimit publik për nismat e OSHC-ve, projektet dhe programet si në nivel qendror ashtu dhe lokal, aplikimin e stimuljeve fiskale për individët dhe përmirësimin e stimuljeve për dhurimet e korporatave ndaj OSHC-ve.

Finalizimi i akteve nënligjore të ligjit për shërbimet sociale përbën një hap vendimtar drejt forcimit të bashkëpunimit dhe mbështetjes së

organizatave profesionale të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social në të gjithë vendin. ligji për ndërmarrjet sociale dhe aktet nënligjore përkatëse mund të hapin perspektiva të reja për mbështetjen e qëndrueshmërisë financiare dhe gjithëpërfshirjen e shoqërisë civile. Kuadri ligjor për të dy këto ligje do të mbështetet edhe me buxhete të përshtatshme për të garantuar zbatimin e duhur.

Që të gjitha angazhimet e mësipërme janë gjithashtu në linjë me “Udhëzimet për Mbështetjen nga Bashkimi Evropian të shoqërisë civile në vendet e zgjerimit 2014–2021”,⁵ të cilat janë hartuar nga Komisioni Evropian. Këto udhëzime ofrojnë një kuadër solid për matjen e progresit të arritur në zhvillimin e një demokracie me pjesëmarrje në vendet e aderimit dhe i japin mundësi shoqërisë civile të veprojnë në një mjedis të favorshëm politik, ligjor dhe financiar.

Ku Udhërrëfyes mbështetet nga një buxhet realist për zbatimin e tij dhe nga vullneti i qeverisë për t’u dhënë mundësi organeve përgjegjëse për zbatimin e tij që të krijojnë mjedisin e synuar mundësues. Kjo do të nxisë pavarësinë, eficiencën dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile, duke plotësuar kështu boshllëkun midis qytetarëve dhe institucioneve qeveritare.

2. Struktura e Udhërrëfyesit të Rishikuar

Ky Udhërrëfyes i rishikuar paraqitet përmes tre drejtimeve strategjike, të cilat mbulojnë kryesisht nëntë fushat prioritare fillestare të Udhërrëfyesit të 2015-s. Tre drejtimet strategjike dhe nëntë fushat prioritare marrin parasysh parimet dhe objektivat e përcaktuara në Udhëzimet për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile 2014–2021. Këto udhëzime janë konceptuar si një kuadër për rajonin e zgjerimit të BE-së si një i tërë. Ato ofrojnë bazën për një qasje që mund t’i përshtat secilit vend në nivel kombëtar në përputhje me kontekstin e vendit, por edhe për matjen e progresit të arritur në shkallë vendi, si dhe progresit të arritur në shkallë rajoni.

Udhërrëfyesi identifikon edhe institucionet përgjegjëse, treguesit e progresit, afatet dhe fushat e asistencës teknike. Plani i punës do të ndiqet, do të

⁵https://cdn3-eas.fpfis.tech.ec.europa.eu/cdn/farfuture/S6fLEcQ6_cLwV2jZ5YOg7w1fDMswI1kouzeIRO4VeZ8/mtime:1540212300/sites/eas/files/doc_guidelines_cs_support1.pdf



monitorohet dhe do të përditësohet nga secila ministri e linjës.

Kryeministria, në bashkëpunim të ngushtë me KKSHC-në, do të sigurojë monitorimin e përgjithshëm të progresit. Kështu, progresi i arritur do të paraqitet sistematikisht në takimet e KKSHC-së nga institucioni përgjegjës. Kjo do të kontribuojë në një bashkëpunim qeveri-shoqëri civile më transparent dhe më të orientuar drejt rezultateve si një parakusht për qëndrueshmërinë dhe pakthyeshmërinë e reformave të ndërmarra në procesin e integrimit evropian.

Prioritetet e tre drejtimeve strategjike janë:

Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunimi i institucionalizuar qeveri-shoqëri civile në politikëbërje dhe në integrimin evropian

Prioriteti 1: Krijimi dhe ruajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile

(5 masa, 16 tregues)

Prioriteti 2: Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të

(9 masa, 31 tregues)

Prioriteti 3: Përfshirja e qëndrueshme dhe efikase e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes dhe në integrimin evropian

(5 masa, 14 tregues)

Prioriteti 4: Garantimi i kontributit të OSHC-ve në procesin e anëtarësimit në BE në përputhje me praktikatat e mira të BE-së

(5 masa, 11 tregues)

Prioriteti 5: Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive me fokus të veçantë në nivelin vendor

(5 masa, 18 tregues)

Drejtimi Strategjik 2: Mjedis ligjor më mundësues & menaxhim i përshtatshëm i të dhënave

Prioriteti 6: Krijimi i një kuadri ligjor më mundësues për regjistrimin dhe operimin e

OSHC-ve

(3 masa, 12 tregues)

Prioriteti 7: Menaxhimi i të dhënave të OSHC-ve: mbledhja dhe analizimi i të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile në mënyrë të tillë që të kontribuojë në vendimmarrjen strategjike dhe në transparencën e skemave mbështetëse

(3 masa, 10 tregues)

Drejtimi Strategjik 3: Kuadri mundësues fiskal dhe financues

Prioriteti 8: Krijimi i një kuadri financues publik për mbështetjen e programeve të OSHC-ve në përputhje me praktikatat e mira të BE-së

(3 masa, 10 tregues)

Prioriteti 9: Garantimi i një trajtimi mbështetës të OSHC-ve në të gjithë vendin sa i përket raportimit të tyre financiar, kontabël dhe tatimor

(4 masa, 8 tregues)

Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunim i institucionalizuar qeveri-shoqëri civile në politikëbërje dhe në integrimin evropian

Prioriteti 1: Krijimi dhe ruajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile

Prioriteti 2: Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të

Prioriteti 3: Përfshirja e qëndrueshme dhe efikase e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes

Prioriteti 4: Garantimi i kontributit të OSHC-ve në procesin e anëtarësimit në BE në përputhje me praktikatat e mira të BE-së

Prioriteti 5: Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive

Prioriteti 1: Krijimi dhe ruajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile

Janë identifikuar pesë masa kryesore nën këtë prioritet dhe janë përcaktuar afatet:

1.1 Planifikimi dhe zbatimi i masave nga çdo ministri përgjegjës/institucion shtetëror pasqyruar në planet vjetore të punës.

Afati: 2019 dhe vitet në vazhdim deri në vitin 2024

1.2 Garantimi i përfshirjes aktive të OSHC-ve në ecurinë e Udhërrëfyesit përmes një dialogu gjithëpërfshirës me këtë sektor.

Afati: fillon në fund të vitit 2019, pastaj vazhdon çdo vit

1.3 Ngritja e një mekanizmi të brendshëm për ndjekjen e ecurisë së Udhërrëfyesit përmes instrumentit të Menaxhimit të Projekteve

Afati: fillon në fund të vitit 2019, pastaj vazhdon çdo vit



1.4 Mundësimi i identifikimit të OSHC-ve në Portalin e Qeverisë për Komunikimin me Publikun

Afati: fillon në fund të vitit 2019

1.5 Bazuar në arritjet e Udhërrëfyesit 2019–2023, pasqyruar në raportin e rishikimit afatmesëm dhe raportin përfundimtar të vlerësimit, do të hartohet një Strategji Kombëtare ose Udhërrëfyes (2024–2027), duke garantuar në të njëjtën kohë përfshirjen e gjerë të OSHC-ve.

Afati: Vlerësimi në vitin 2023, hartimi i dokumentit të ri strategjik në vitin 2024 për periudhën 2024–2027.

Udhërrëfyesi për periudhën 2019–2023 për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile përfshin një plan veprimi për zbatimin e Udhërrëfyesit për katër vitet e ardhshme, duke filluar nga momenti që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ai përfshin tregues specifikë dhe të matshëm për secilën masë, shoqëruar me një vlerësim financiar për të gjitha aktivitetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

KKSHC-së, me ndihmën e AMSHC-së do t'i duhet të luajë një rol të rëndësishëm në përfshirjen e sa më shumë OSHC-ve në procesin e zbatimit të Udhërrëfyesit. Përveç kësaj, në planet e rishikuara vjetore të punës do të përfshihet edhe një rishikim afatmesëm në vitin 2021 dhe një vlerësim përfundimtar i arritjeve dhe rezultateve të zbatimit të Udhërrëfyesit në vitin 2023. Rezultatet do të pasqyrohen në çdo dokument strategjik pasardhës. Nëse konsiderohet e nevojshme, versioni i vitit 2023 të Udhërrëfyesit do të përdoret si themeli i një Strategjie Kombëtare për Zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të Shoqërisë Civile. Nëse jo, atëherë do të hartohet një Udhërrëfyes i ri. Kjo strategji/Udhërrëfyes duhet të përcaktojë qartë qëllimin dhe metodat e mbështetjes qeveritare të OSHC-ve dhe bashkëpunimin mes tyre në vitet që vijnë deri në 2023-shin.

Udhërrëfyesi i rishikuar, së bashku me planin e tij të komunikimit dhe planin vjetor të punës do të kontribuojnë për një koordinim më të mirë të politikave në këtë fushë, përfshirë aktivitetet e një sërë ministrish dhe agjencive të tjera qeveritare. Udhërrëfyesi ofron një bazë solide për programimin e buxhetit të shtetit, partnerëve për zhvillim dhe për fondet për investim të BE-së për të gjithë sektorin e shoqërisë civile. Ai reflekton, gjithashtu, edhe një autorësi më të fuqishme vendase të reformave në këtë fushë të rëndësishme. Sektori privat shqiptar duhet të vazhdojë ta rrisë mbështetjen e tij për shoqërinë civile

Çështje gjithëpërfshirëse që lidhen me zbatimin e Udhërrëfyesit

Qeveria e Shqipërisë do të rrisë në të ardhmen edhe përfshirjen e grupeve vulnerabël të shoqërisë (p.sh. pakicat, personat me aftësi të kufizuara) në të gjitha fushat e zhvillimit të politikave për shoqërinë civile. Hapat për përfshirjen e OSHC-ve që i përfaqësojnë këto grupe në këtë proces janë pasqyruar tashmë në përbërjen e Këshillit Kombëtar për mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe do të ndiqet si praktikë edhe në këshilla të tjerë me përfaqësim të OSHC-ve. Praktikën e mira në disa procese konsultimi, si ai i Këshillit Kombëtar për Barazi Gjinore kanë demonstruar në të shkuarën përfitimet që vijnë nga përfshirja e ekspertizës së shoqërisë civile në procese të ndryshme politikëbërëse dhe mbi këtë bazë do të vazhdohet të ecet. Në zbatimin e Udhërrëfyesit do të merret parasysh, kurdo që të jetë e mundur, ndikimi në mjedisin e natyrës së Shqipërisë. Në zbatimin e masave të parashikuara në këtë Udhërrëfyes, qeveria do të marrë, gjithashtu parasysh edhe ndikimin e aktiviteteve të ndryshme në agjendën për barazi gjinore.

Masat e planifikuara:

Masa 1.1

Garantimi i planifikimit dhe zbatimit të duhur të masave nga çdo ministri/institucion shtetëror përgjegjës dhe pasqyrimi i tyre në planet vjetore të punës.

Masa 1.1.	Planifikimi dhe zbatimi i masave nga çdo ministri përgjegjës/institucion shtetëror dhe pasqyrimi i tyre në planet vjetore të punës.
Institucioni kryesor përgjegjës	Kryeministria në rolin e koordinatorit të përgjithshëm të Udhërrëfyesit



Partnerë në zbatim:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në cilësinë e kryesuesit Ministria e Brendshme (MB) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) Ministria e Kulturës (MK) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB)
Afati	2019 dhe në vazhdim deri në vitin 2023
Treguesit e zbatimit	1.Miratimi i versionit përfundimtar të Udhërrëfyesit 2019–2023 nga Këshilli i Ministrave në mes të vitit 2019, përfshirë buxhetin total dhe strategjinë e komunikimit 2.Garantimi i pasqyrimin të një buxheti realist për zbatimin e Udhërrëfyesit në buxhetin e shtetit dhe atë të partnerëve të ndryshëm për zhvillim nga viti 2020 e në vazhdim. 3.Pasqyrimi i masave dhe aktiviteteve që lidhen me to në planet e punës së ministrive përgjegjëse. 4.Publikimi i raporteve vjetore të grupit ndërmintor të punës në faqet zyrtare të ministrive dhe AMSHC-së. 5.Raportet mbi përfshirjen e OSHC-ve në vlerësimin e Udhërrëfyesit të jenë të disponueshme përmes AMSHC-së
Komente të tjera	Promovimi i vazhdueshëm i Udhërrëfyesit përmes faqes zyrtare të MSHMS-së dhe i aktiviteteve të tjera të realizuara nga KKSHC-ja me mbështetjen e AMSHC-së në faqen zyrtare, mediat sociale, buletineve informative dhe gjatë takimeve konsultative me OSHC-të. Plan komunikimi që do t'i shërbejë si komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm në nivel lokal dhe kombëtar. Vëmendje do t'i kushtohet integritetit të çështjeve gjithëpërfshirëse.
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Masa 1.2.

Garantimi i bashkëpunimit me OSHC-të përmes KKSHC-së në ecurinë e Udhërrëfyesit mes një dialogu gjithëpërfshirës me këtë sektor në takimet e KKSHC-së.

Masa 1.2.	Garantimi i përfshirjes aktive të OSHC-ve në ecurinë e zbatimit të Udhërrëfyesit.
Institucioni kryesor përgjegjës	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	KKSHC-ja dhe AMSHC-ja në funksionin e saj si Sekretariati i KKSHC-së Të gjitha ministritë përgjegjëse
Afati	Çdo vit, duke filluar nga viti 2019



Treguesit e zbatimit	1.Numri i konsulentëve/temave të konsultimeve të kryera sipas strategjisë së komunikimit dhe numri i pjesëmarrësve 2.Numri i komenteve dhe këshillave të OSHC-ve në faqen zyrtare të AMSHC-së 3.Numri i mbulimeve në media (sociale) pasqyruar në raportin vjetor të AMSHC-së 4.Numri i mbulimeve mediatike 5.Numri i çështjeve të adresuara nga ministritë e linjës ose institucione të tjera qeveritare
Komente të tjera	
AT që nevojitet	Jo relevante

Masa 1.3.

Ngritja e një mekanizmi të brendshëm për ndjekjen e ecures së Udhërrëfyesit përmes Instrumenteve të Menaxhimit të Projekteve

Aktiviteti 1.3	Ngritja e një mekanizmi të brendshëm për ndjekjen e ecures së Udhërrëfyesit përmes Instrumenteve të Menaxhimit të Projekteve
Institucioni kryesor përgjegjës	Kryeministria
Partnerë në zbatim:	Grupi ndërministror i punës i Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) AMSHC-ja
Afati	Fundi i vitit 2019
Treguesit e zbatimit	1.Krijimi i sistemit të brendshëm të ndjekjes së ecures së Udhërrëfyesit nga AKSHI. 2.Përdorimi sistematik i sistemit dhe përditësimi i ecures nga ministritë e linjës dhe institucionet përgjegjëse.
Komente të tjera	Instalimi i sistemit të ndjekjes së ecures nga AKSHI
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Masa 1.4.

Mundësimi i identifikimit të OSHC-ve në Portalin e Qeverisë për Komunikimin me Publikun

Aktiviteti 1.4	Mundësimi i identifikimit të OSHC-ve në Portalin e Qeverisë për Komunikimin me Publikun
Institucioni kryesor përgjegjës	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI)
Partnerë në zbatim:	Kryeministria AMSHC-ja KKSHC-ja
Afati	Fundi i vitit 2019
Treguesit e zbatimit	1.Identifikimi i OSHC-ve si kategori në platformën online të konsultimit publik
Komente të tjera	Pajisja e OSHC-ve nga autoritetet tatimore me një numër regjistrimi për



	qëllime tatimore Përveç kësaj, identifikimi i tyre nga autoritetet tatimore si biznese jofitimprurëse dhe ky mund të ishte një mekanizëm për identifikimin nga AKSHI të OSHC-ve në Portalin e Konsultimit Publik.
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Masa 1.5.

Hartimi i një Strategjie Kombëtare (2024–2027) ose i një Udhërrëfyese të ri bazuar në arritjet e Udhërrëfyesit 2019–2023, pasqyruar në raportet afatmesme dhe përfundimtare të vlerësimit⁶.

Aktiviteti 1.5.	Hartimi i Strategjisë Kombëtare/Udhërrëfyesit 2024–2027 për mbështetjen e OSHC-ve
Institucioni kryesor përgjegjës	Kryeministria
Partnerë në zbatim:	Të gjitha ministratë e përfshira të linjës KKSHC-ja dhe AMSHC-ja
Afati	Fundi i vitit 2023
Treguesit e zbatimit	1.Kryerja e vlerësimit afatmesëm dhe përfundimtar 2.Publiku i gjerë i rezultateve të vlerësimit përmes faqes zyrtare të Kryeministrisë dhe AMSHC-së 3.Përcaktimi i metodologjisë për hartimin e Udhërrëfyesit të ri/Strategjisë Kombëtare me kontributin e OSHC-ve nga fundi i vitit 2023
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Ekspertizë e Asistencës Teknike në vlerësimin dhe hartimin e strategjisë (45- 60 ditë)

Prioriteti 2: Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të

Nën këtë prioritet janë identifikuar nëntë masa kryesore për të cilat janë vendosur edhe afatet:

2.1 Garantimi i funksionimit eficient të KKSHC-së në përputhje me planin e tij të punës dhe me angazhimet e qeverisë. KKSHC-ja duhet të veprojë si organ këshillues i qeverisë së Shqipërisë për çështje të zhvillimit të shoqërisë civile, duke sjellë së bashku përfaqësues të organeve qeveritare përgjegjës për fushat kryesore të politikave që prekin OSHC-të, si dhe përfaqësuesit e OSHC-ve
Afati: nga viti 2019 e në vazhdim

2.2 Garantimi i mbështetjes administrative eficiente për KKSHC-në, përfshirë përgatitjen cilësore për të gjitha aktivitetet dhe garantimi i zbatimit si duhet të të gjitha vendimeve dhe aktiviteteve të Këshillit, duke i ofruar legjislacionin dhe burimet e duhura, përfshirë burime të mjaftueshme njerëzore në AMSHC.

Afati: të paktën gjatë kohëzgjatjes së këtij Udhërrëfyese.

2.3 Hartimi nga AMSHC-ja i një manuali për mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve të përvitshme të anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së bazuar në mbështetjen e mëparshme ofruar nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve

Afati: Nëntori i vitit 2019 që të përdoret për zgjedhjet e vitit 2019 e më pas.

⁶ Hartimi i një Udhërrëfyese tjetër ose i një strategjie të diskutuar gjerësisht me shoqërinë civile në Shqipëri dhe përcaktimi i nevojave të tyre, si dhe i angazhimeve të qeverisë.



2.4 Përfshirja e KKSHC-së si organ këshillimor në të gjitha nismat dhe programet e zhvillimit të shoqërisë civile.

Afati: në vazhdim nga viti 2019 deri në fund të vitit 2023.

2.5 Përditësimi i strategjisë së AMSHC-së për periudhën 2015–2021 dhe i planeve të saj vjetore të punës për arritjen e objektivave kryesore, përfshirë objektivat e AMSHC-së si Sekretariati i KKSHC-së.

Afati: 2019 e në vazhdim .

2.6 Mbështetje përmes një plani komunikimi dhe përmes burimeve për forcimin e reagimit të AMSHC-së ndaj kërkesave në rritje për informacion dhe për mbështetje nga OSHC-të lokale

Afati: 2019 e në vazhdim.

2.7 Vazhdimi i asistencës teknike për AMSHC-në për të zhvilluar më tej kapacitetet në fushat prioritare të planit të rishikuar strategjik të organizatës.

Afati: 2020

2.8 Përcaktimi i detyrave konkrete të Agjencisë për Dialogu dhe Bashkëqeverisje në funksionin e saj mbështetës për zbatimin dhe monitorimin e ecurisë së Udhërrëfyesit

Afati: 2019

2.9 Caktimi i personave të kontaktit për OSHC-të në ministritë me rëndësi strategjike për bashkëpunimin me OSHC-të, si dhe në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, dhe në Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Afati: fillimi i vitit 2020

Krijimi i një mjedisi të favorshëm për bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile kërkon ngritjen e strukturave dhe mekanizmave institucionalë cilësorë dhe ndërtimin e kapaciteteve të tyre për zbatimin efikas të detyrave kyçe, konkretisht:

- Mundësimin e një dialogu të strukturuar sistematik mes organeve qeveritare përkatëse dhe përfaqësuesve të OSHC-ve në të gjitha politikat që prekin shoqërinë civile

- Ofrimin e një financimi të qëndrueshëm publik të programeve të OSHC-ve dhe zhvillimin e partneriteteve strategjike me OSHC-të në ofrimin e shërbimeve sociale me interes të përgjithshëm

- Garantimi i një koordinimi qendror solid të hartimit dhe zbatimit të politikave qeveritare për zhvillimin e shoqërisë civile, përfshirë mbështetjen për programimin strategjik dhe eficient të mbështetjes së OSHC-ve nga shteti

- Mbështetja e përfshirjes së qenësishme të OSHC-ve në proceset politikëbërëse në të gjithë sektorët

Në Udhërrëfyesin e rishikuar janë identifikuar katër aktorë kryesorë si nxitës të ndryshimit dhe si organet përgjegjëse për përpjekjet e qeverisë për krijimin e një mjedisi mundësues për OSHC-të. Ata janë:

- KKSHC-ja (2.1-2.4) në rolin e saj këshillimor, i cili përfshin edhe disa funksione monitoruese

- AMSHC-ja (2.5 -2.7) në rolin mbështetës lehtësues ndaj KKSHC-së, si dhe në rolin e saj kyç të komunikimit me OSHC-të në nivel lokal

- Kryeministria (2.8.) si institucioni qeveritar që mban përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve të parashikuara nën këtë prioritet

- Ministritë e linjës (2.9) përgjegjëse për zbatimin e masave në fushat specifike të Udhërrëfyesit

Përshkrimi i detajuar i secilit prej mekanizmave institucionalë dhe disa informacione bazë për vizionin, misionin dhe objektivat e tyre, lidhjet me strukturat e tjera të propozuara, si dhe hapat kryesorë që duhet të ndërmerren për përmbushjen e objektivave, shoqëruar me fushat e mundshme për asistencë teknike të mëtejshme mund të gjenden në Shtojcën 1.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile

Instrumenti kryesor për dialog dhe konsultim mes Qeverisë së Shqipërisë dhe shoqërisë civile është Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile. ligji “Për ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” (nr. 119/2015) mbi bazën e të cilit u ngrit Këshilli u miratua në nëntor të vitit 2015. Këshilli e ka intensifikuar punën që prej dhjetorit të vitit 2017 dhe ka miratuar një plan pune për vitin 2019 në mars 2019

**Masat e planifikuara:****Masa 2.1. Garantimi i funksionimit eficient të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile në përputhje me planin e tij të punës dhe me angazhimet e qeverisë.**

KKSHC-ja duhet të veprojë si organ këshillimor i qeverisë shqiptare për çështje të zhvillimit të shoqërisë civile dhe për reformat kryesore që sjellin së bashku përfaqësuesit e organeve qeveritare përgjegjëse për fushat kryesore të politikave që prekin OSHC-të, si dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile.

Masa 2.1.	Garantimi i funksionimit eficient të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile në përputhje me planin e saj të punës dhe me angazhimet e qeverisë
Organi zbatues	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	Kryeministria Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksionin e tij si Kryetar i Këshillit sipas ligjit ⁷
Afati	2019
Treguesit e zbatimit	1.Rishikimi i ligjit për KKSHC-në për pasqyrimin e ndryshimeve në administratën publike 2.Respektimi i plotë i ligjit dhe akteve nënligjore për KKSHC-në 3.Zbatimi dhe financimi i planit të punës së KKSHC-së përmes buxhetit të Agjencisë 4.Mbështetja e përfshirjes së qenësishme të OSHC-ve në proceset politikëbërëse në të gjithë sektorët
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	AT: Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së dhe zgjedhësve të tyre siç përcaktohet në planin për Këshillin – 30- 50 ditë

Masa 2.2**Garantimi i mbështetjes administrative eficiente për Këshillin, përfshirë cilësinë përgatitjes për të gjitha aktivitetet dhe sigurimi i ndjekjes siç duhet të të gjitha takimeve dhe aktiviteteve të Këshillit.**

Masa 2.2	Garantimi i mbështetjes administrative eficiente për Këshillin, përfshirë përgatitjen cilësore për të gjitha aktivitetet dhe sigurimi i ndjekjes siç duhet të të gjitha takimeve dhe aktiviteteve të Këshillit.
Organi Zbatues	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksionin e saj si kryesuese e Këshillit, Kryeministria
Afati	2019–2023
Treguesit e zbatimit	1.Ofrimi i mbështetjes nga AMSHC-ja në përputhje me “Manualin për Masat Mbështetëse të KKSHC-së” 2.Vënia në dispozicion të AMSHC-së të të gjitha burimeve të nevojshme 3.Plotësimi me staf i Agjencisë

⁷ Roli i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksionin e saj si Kryesuese e Këshillit përcaktohet në nenin 14 të ligjit nr. 119/2015.



	4.Bërja publike e informacioneve të kontaktit dhe orarit të punës së punonjësve të AMSHC-së 5.Raporti i Asistencës Teknike për mbështetjen e CD-së;
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Asistencë Teknike për ndërtimin e kapaciteteve të AMSHC-së, duke përfshirë hartimin e “Manualit të Masave për Mbështetjen e KKSHC-së” AT (30 ditë)

Masa 2.3.

2.3 Hartimi nga AMSHC-ja i një manuali për mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve të anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së bazuar në mbështetjen e mëparshme ofruar nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve dhe organizimi i zgjedhjeve

Masa 2.3.	2.3 Hartimi nga AMSHC-ja i një manuali për mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve të përvitshme të anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së bazuar në mbështetjen e mëparshme ofruar nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve dhe organizimi i zgjedhjeve
Organi Zbatues	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në funksionin e saj si kryesuese e Këshillit
Afati	Për zgjedhjet në fund të vitit 2019 dhe për aplikimin e tyre për të gjitha zgjedhjet në vazhdim
Treguesit e zbatimit	1.Hartimi i “Manualit të Zgjedhjeve të KKSHC-së” në nëntor 2019, organizimi i zgjedhjeve të 2019-s në përputhje me të 2.Pjesëmarrja e madhe mbarëkombëtare falë komunikimit të mirë, proaktiv dhe gjithëpërfshirës dhe transparencës së lartë (të paktën 2/3 e OSHC-ve në bazën e të dhënave të AMSHC-së (aktualisht 581 gjithsej))
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	AT për ngritje kapacitetesh të AMSHC-së, përfshirë hartimin e Manualit të Zgjedhjeve të KKSHC-së Kërkesat për AT: Ekspert me eksperiencë në çështje që lidhen me OSHC-të, ku njohuritë në lidhje me kapacitetet në rajon përbëjnë avantazh (pjesë e 30 ditëve parashikuar në pikën 2.2)

Masa 2.4

Përfshirja e KKSHC-së si organ këshillimor në të gjitha nismat dhe programet e zhvillimit të shoqërisë civile.

Masa 2.4	Përfshirja e KKSHC-së si organ këshillimor në të gjitha nismat dhe programet e zhvillimit të shoqërisë civile.
Organi zbatues	Kryeministria/AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	Të gjitha ministratë e linjës AMSHC-ja
Afati	2023
Treguesite zbatimit	1.Konsultimi i të gjitha nismave dhe programeve të shoqërisë civile me KKSHC-në 2.Konsultimi i të gjithë legjislacionit për anëtarësimin në BE me KKSHC-në kur është e nevojshme



Komente të tjera	-
Asistenca Teknike që nevojitet	

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)

AMSHC-ja është agjenci shtetërore që rregullohet me statutin e saj dhe ligjin nr. 10093/2009.

Një nga funksionet e saj kryesore është shpërndarja e granteve OSHC-ve në bazë të thirrjeve kombëtare për propozime. Një tjetër funksion kryesor është zhvillimi i partneriteti dhe bashkëpunimit ndërsektorial mes organizatave të shoqërisë civile.⁸ Nga ky këndvështrim dhe veçanërisht që nga fundi i vitit 2017, Agjencia e ka rritur aktivitetin e saj si sekretariat i KKSHC-së.

Masa 2.5.

Përditësimi dhe zbatimi i strategjisë dhe planeve vjetore të punës së Agjencisë për periudhën 2015–2021 për arritjen e objektivave kryesore, përfshirë përmbushjen e rolit të saj si sekretariat i KKSHC-së.

Masa 2.5	Rishikimi i strategjisë për periudhën 2015–2021 dhe përdorimi i planeve vjetore të punës, përfshirë funksionet e përshkruara në Masën 2.2.
Institucioni kryesor përgjegjës	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	
Afati	Që nga viti 2019 e në vazhdim pas rishikimit
Treguesit e zbatimit	1.Përditësimi i strategjisë në vitin 2019, përfshirë funksionin si sekretariat i KKSHC-së 2.Pasqyrimi në raportin vjetor të vitit 2020 i zbatimit të strategjisë së rishikuar
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	AT parashikuar në pikën 2.2

Masa 2.6.

Hartimi dhe zbatimi i një plani komunikimi, informimi dhe shtrirjeje të AMSHC-së, në mënyrë që ajo të mund t'i përgjigjet kërkesës në rritje

Masa 2.6	Hartimi dhe zbatimi i një plani komunikimi, informimi dhe shtrirjeje të AMSHC-së, në mënyrë që ajo të mund t'i përgjigjet kërkesës në rritje për informim dhe mbështetje nga OSHC-të lokale
Organi zbatues	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	-
Afati	2019 e në vazhdim
Treguesit e zbatimit	1.Hartimi, publikimi dhe zbatimi i një plani komunikimi dhe shtrirjeje 2.Bërja e thirrjeve të rishikuara dhe në kohën e duhur për sesione

⁸Objektivat e AMSHC-së janë: “1) Inkurajimi i bashkëpunimit me organizatat jo-fitimprurëse, të cilët kanë si objekt të punës së tyre luftën kundër korrupsionit, kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe viktimave të tij, kundër dhunës në familje, si dhe kundër dhunës ndaj fëmijëve. 2) Inkurajimi i publikut për t'u përfshirë në aktivitete vullnetare dhe për të marrë pjesë në zhvillimin e komunitetit. 3) Nxitja dhe forcimi i qëndrueshmërisë së organizatave jofitimprurëse 4) Zhvillimi i bashkëpunimit ndërsektorial dhe ndërkombëtar me organizatat e shoqërisë civile. 5) Rritja e rolit dhe ndikimit të publikut dhe organizatave të shoqërisë civile. 6) Zhvillimi i nismave qytetare dhe angazhimi në organizatat jofitimprurëse. 7) Rritja e ndikimit të shoqërisë civile në politikë dhe vendimarrje,



	informimi të aplikantëve që mund të jenë të interesuar për të paraqitur propozime 3.Futja e një seksioni në raportin vjetor për përmirësimin e komunikimit, informimit dhe angazhimit 4.Evidenca të përmirësimit të dizajnit të faqes zyrtare dhe bazës së të dhënave 5.Nr. i takimeve ku diskutohen prioritetet e Udhërrëfyesit në nivel lokal
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	

Masa 2.7.

Asistencë teknike për AMSHC-në për të zhvilluar më tej kapacitetet në fushat prioritare të planit strategjik të organizatës

Masa 2.7	Vazhdimi i asistencës teknike për AMSHC-në për të zhvilluar më tej kapacitetet në fushat prioritare të planit të rishikuar strategjik të organizatës.
Institucioni kryesor përgjegjës	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	
Afati	2020
Treguesit e zbatimit	1.Stafi i trajnuar në fushat kryesore të strategjisë së rishikuar 2.Përmirësimi i ndjeshëm i komunikimit të AMSHC-së me OSHC-të në nivel lokal dhe kombëtar 3.Menaxhimi dhe monitorimi i projekteve me bazë rezultatet vërtetuar nga një kampion projektsh të financuara 4.Trajnimi i aplikantëve potencialë për përdorimin e metodës së matricave (Logframe) 5.Raporte vjetore për produktet dhe rezultatet e përzgjedhjes së granteve
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Mbështetje e Agjencisë me Asistencë Teknike për të paktën 30 ditë, përfshirë planin strategjik

Kryeministria

Kryeministria është përgjegjëse për të gjithë ndërveprimin dhe monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të Udhërrëfyesit nga ministrinë e linjës dhe agjencitë shtetërore. Si pasojë e kësaj, Kryeministria do të sigurojë partneritet të fortë mes qeverisë dhe shoqërisë civile në zhvillimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike. Kjo është thelbësore për rritjen e rolit dhe efikasitetit të shoqërisë civile në përgatitjen për anëtarësimin në BE.

Agjencia e sapokrijuar për Dialog dhe Bashkëqeverisje, e themeluar në nëntor të vitit 2017, nën varësinë e Kryeministrit (VKM nr. 638, datë 6.11.2017) do të mbështesë Kryeministrinë në rolin e saj si institucioni me përgjegjësinë kryesore për zbatimin e Udhërrëfyesit, si në hartimin e politikave, koordinimin e proceseve brenda strukturave qeveritare dhe garantimin e zbatimit nga institucionet e qeverisë përmes monitorimit.

Masa 2.8.

2.8 Përcaktimi i detyrave konkrete të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në funksionin e saj mbështetës për zbatimin dhe monitorimin e ecurisë së Udhërrëfyesit

Masa 2.8	2.8 Përcaktimi i detyrave konkrete të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në funksionin e saj mbështetës për zbatimin dhe monitorimin e ecurisë së Udhërrëfyesit
Institucioni kryesor përgjegjës	Kryeministria
Partnerë në zbatim:	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
Afati	2019
Treguesit e zbatimit	1.Lista e detyrave të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje 2.Raportet sistematike të Agjencisë për Kryeministrinë për vitin 2020.
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Nuk nevojitet asnjë asistencë teknike

Ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e masave në fushat specifike të Udhërrëfyesit

Ministritë e linjës luajnë rol të rëndësishëm në zbatimin e Udhërrëfyesit. Koordinim i mirë brenda ministrive, por edhe me sektorin e shoqërisë civile është i nevojshëm. Caktimi i personave të kontaktit për bashkëpunimin me OSHC-të në ministri dhe në organet e tjera qeveritare, në mënyrë të veçantë në ato ministri që punojnë intensivisht me OSHC-të si Ministria për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Drejtësisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Funkcioni i personit të kontaktit për OSHC-të mund të kombinohet me funksionin e punonjësit përgjegjës për kontaktin me publikun dhe për konsultimet publike.

Masat e planifikuara:

Masa 2.9 Caktimi i personave të kontaktit për OSHC-të në ministritë me rëndësi strategjike për bashkëpunimin me OSHC-të.

Ky funksion mund të lidhet me funksionin e koordinatorit për informim publik.

Ministritë me rëndësi strategjike janë kryesisht ato që tani ose në të ardhmen do të përfaqësohen në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministria e Kulturës; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Brendshme. Do të jetë detyra e Kryeministrit të garantojë koordinimin dhe takime informuese sistematike mes këtyre personave të kontaktit për sigurimin e një qasjeje të unifikuar dhe transparente nga secili person kontakti. AMSHC-ja do të përfshihet në këtë koordinim. Këta koordinatorë do të krijojnë lidhje të ngushta me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për të shkëmbyer informacione në lidhje me kornizat e reja ligjore në proces zhvillimi, me ngjarjet, konsultimet, etj. Me marrjen e këtyre informacioneve, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile mund të sigurojë shpërndarjen e gjerë të tij dhe angazhimin e shoqërisë civile në procese të ndryshme. Kështu, krijohet një kanal i ri për shkëmbim informacioni dhe për më shumë hapësirë.



Masa 2.9.	Caktimi i personave të kontaktit për OSHC-të në ministritë me rëndësi strategjike për bashkëpunimin me OSHC-tësi dhe në Kuvendin e Shqipërisë
Institucioni kryesor përgjegjës	Kryeministria
Partnerë në zbatim:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministria e Kulturës; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Brendshme
Afati	2020
Treguesit e zbatimit	1.Caktimi i të gjithë koordinatorëve dhe pasqyrimi i rolit të tyre në përshkrimet e punës 2.Vendosja e informacionit të kontaktit në faqet zyrtare të të gjitha ministrive 3.Integrimi i raporteve të secilit koordinator në raportin vjetor të progresit. 4.Takime një herë në dy vjet të koordinatorëve me Kryeministrinë/AMSHC-në dhe KKSHC-në
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Prioriteti 3: Përfshirja e qëndrueshme dhe efikase e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes

Nën këtë prioritet janë identifikuar pesë masa kryesore për të cilat janë vendosur edhe afatet:
3.1 Garantimi i zbatimit efikas të ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, siç kërkohet nga neni 22 i ligjit për të Drejtën e Konsultimit Publik (nr. 146/2014, datë 30.10.2014) dhe aktet nënligjore (VKM nr. 828, 7.10.2015) përmes ndërgjegjësimit në nivel lokal dhe kombëtar dhe përfshirjes sistematike të OSHC-ve.

Afati: 2020 e në vazhdim

3.2 Parashikimi në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike për t'i bërë OSHC-të të dukshme si kontribuuese

Afati kohor: deri në fund të 2020.

3.3 Zhvillimi i një metodologjie për raportimin vjetor mbi rezultatet e konsultimeve publike dhe për bërjen e transparencës së vendimarrjes, me informacionin e nevojshëm mbi numrin e akteve të miratuara nga organet publike gjatë një vit të caktuar, numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuar dhe të papranuara nga palët e interesuara gjatë procesit të vendimarrjes, si dhe numrin e takimeve publike të organizuara.

Afati kohor: deri në fund të vitit 2020.

3.4 Përgatitja e një manuali për nëpunësit civilë për kryerjen e konsultimeve publike efikase, me udhëzime të hollësishme hap-pas-hapi me mbështetjen e Sigma-s.

Afati kohor: deri në fund të 2020.

3.5 Ngritja e një programi zyrtar trajnimi për nëpunësit civilë që do të realizohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, duke u përqendruar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në bërjen e politikave publike dhe në fusha të ndryshme të konsultimeve publike dhe dialogut.

Afati kohor: deri në fund të vitit 2020.



Zhvillimi i një komunikimi të qenësishëm dhe efikas me publikun e interesuar i domosdoshëm për procesin e rritjes së nivelit të besimit të publikut dhe i jep mundësi qeverisë të përmirësojë llogaridhënien e institucioneve publike.

Detyrimi për t'u konsultuar me shoqërinë civile është i mishëruar në legjislacionin shqiptar, por mbeten ende për t'u miratuar akte të rëndësishme nënligjore dhe për t'u krijuar instrumente për zbatimin e tyre. Sipas rregullores, konsultimet duhet të jenë pjesë integrale e proceseve të përgatitjes së politikave dhe ministrive u duhen dhënë udhëzime për kryerjen e konsultimeve përmes Manualit për Hartimin e Ligjeve.

Duke qenë se ligji është ende i ri, organet qeveritare në të gjitha nivelet përballen me sfida të shumta në përgatitjen dhe realizimin e konsultimeve për hartimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave të reja dhe në ofrimin e kontributeve të duhura nga pjesëmarrësit në rezultatet e konsultimeve publike. OSHC-të shqiptare i kanë shprehur në mënyrë të përsëritur shqetësimet e tyre mbi rëndësinë e përcaktimit qartë të procedurave dhe rregullave të detyrueshme ligjore për përfshirjen e publikut të interesuar në proceset e vendimmarrjes, por edhe nevojës për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë për përfshirjen efikase të aktorëve joshitetorë në zhvillimin e politikave të reja publike. Masa kryesore do të përfshinte përshtatjen e instrumentit kryesor që përdoret për konsultime publike, faqen zyrtare <http://konsultimipublik.gov.al> për t'u dhënë mundësi kontributeve të veçanta të shoqërisë civile. Përveç kësaj, rezultatet e konsultimeve duhet të paraqiten në mënyrë të qartë dhe koherente dhe nëpunësit civilë duhet të trajnohen për mënyrën se si duhet ta trajtojnë këtë sektor, duke krijuar gjithnjë e më shumë një dialog dypalësh gjatë gjithë ciklit të politikave. Do të inkurajohet mbajtja e seancave sistematike dëgjimore me OSHC-të në parlament mbi zbatimin e ligjit për Konsultimet Publike

Masat e planifikuara:

Masa 3.1.

Garantimi i zbatimit efikas të ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, siç kërkohet nga neni 22 i ligjit për të Drejtën e Konsultimit Publik (nr. 146/2014, datë 30.10.2014) dhe aktet nënligjore (VKM nr. 828, 7.10.2015) përmes ndërgjegjësimit dhe përfshirjes sistematike të OSHC-ve.

Aktiviteti 3.1.	Garantimi i zbatimit efikas të ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin, siç kërkohet nga neni 22 i ligjit për të Drejtën e Konsultimit Publik (nr. 146/2014, datë 30.10.2014) dhe aktet nënligjore (VKM nr. 828, 7.10.2015) përmes ndërgjegjësimit dhe angazhimit të OSHC-ve
Organi Zbatues	Kryeministria/Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
Partnerë në zbatim:	Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, të gjitha ministrinë
Afati	2019
Treguesit e zbatimit	1.Numri i OSHC-ve që marrin pjesë aktivisht dhe që japin kontribute me shkrim 2.Numri i nismave ligjore influencuar nga OSHC-të
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	AT për fushatën e ndërgjegjësimit publik

Masa 3.2.

Përshtatja e regjistrit elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike për të përfshirë OSHC-të si një kategori më vete kontribuuesish.

Masa 3.2.	Parashikimi në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike për t'i bërë OSHC-të të dukshme si kategorikontribuuesish
Organi Zbatues	AKSHI dhe Kryeministria
Partnerë në zbatim:	Të gjitha ministrinë dhe Kuvendi
Afati	2020
Treguesit e zbatimit	1.Amendimi i regjistrit elektronik 2.Numri i OSHC-ve që e përdorin regjistrin
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Masa 3.3.

3.3 Zhvillimi i një metodologjie për raportimin vjetor mbi rezultatet e konsultimeve publike dhe për bërjen e transparencës së vendimmarrjes, me informacionin e nevojshëm mbi numrin e akteve të miratuara nga organet publike gjatë një vit të caktuar, numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuar dhe të papranuara nga palët e interesuara gjatë procesit të vendimmarrjes, si dhe numrin e takimeve publike të organizuara.

Masa 3.3.	Hartimi i një metodologjie për raportimin vjetor mbi rezultatet e konsultimeve publike dhe mbi transparencën e proceseve vendimmarrëse.
Organi zbatues	Kryeministria
Partnerë në zbatim:	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dhe Departamenti për Rregullimin dhe Pajtuëshmërinë Të gjitha ministrinë e linjës
Afati	2020
Treguesit e zbatimit	1.Konsultimi i metodologjisë me OSHC-të 2.Përgatitja dhe dërgimi i metodologjisë të gjitha ministrive 3.Aplikimi i metodologjisë në konsultimet në vazhdim 4.Publikimi i raporteve vjetore sipas metodologjisë
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	AT për zhvillimin e metodologjisë, sistemin e raportimit dhe raportimin vjetor.

Masa 3.4.

3.4 Përgatitja e një manuali për nëpunësit civilë për kryerjen e konsultimeve publike efikase, me udhëzime të hollësishme hap-pas-hapi.

Masa 3.4.	Përgatitja e një manual për nëpunësit civilë për kryerjen efektive të konsultimeve publike, me udhëzime të hollësishme hap-pas-hapi
Organi zbatues	Kryeministria
Partnerë në zbatim:	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dhe Departamenti Rregullator dhe Përputhshmërisë, në Kryeministri. Të gjitha ministrinë Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
Afati	2020



Treguesit e zbatimit	1.Përgatitja e Manualit 2.Shpërndarja e manualit tek të gjitha njësitë qeveritare 3.Përditësimi sistematik i Manualit për pasqyrimin e ndryshimeve të vazhdueshme (p.sh. integrimi evropian)
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	

Aktiviteti 3.5.

3.5 Ngritja e një programi zyrtar trajnimi për nëpunësit civilë që do të realizohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, duke u përqendruar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në bërjen e politikave publike.

Aktiviteti 3.5.	3.5 Ngritja e një programi zyrtar trajnimi për nëpunësit civilë që do të realizohet nga Shkolla shqiptare e Administratës Publike, duke u përqendruar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në bërjen e politikave publike.
Organi zbatues	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
Partnerë në zbatim:	Kryeministria Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dhe Departamenti Rregullator dhe Përputhshmërisë
Afati i zbatimit	2020
Treguesit e zbatimit	1.Trajnimi i nëpunësve civilë të njësive relevante të çdo ministrie 2.Vlerësimi i ndikimit të trajnimit 3.Përcaktimi çdo vit i numrit të konsultimeve dhe fushave të konsultimit publik
Komente të tjera	Shih 3.4.
Asistenca Teknike që nevojitet	

Prioriteti 4:Sigurimi i kontributit të OSHC-ve në procesin e anëtarësimit

Janë identifikuar pesëmasa kryesore nën këtë prioritet dhe janë përcaktuar afatet:

4.1 Hartimi i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, sikurse përcaktuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018
Afati: 2020

4.2 Përfshirja e OSHC-ve në procesin e anëtarësimit në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian
Afati: 2021

4.3 Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve në programimin e financimit të para-aderimit në BE , bazuar në parimin e partneritetit.
Afati: 2020

4.4 Garantimi i financimeve të mjaftueshme nga BE-ja për zhvillimin e shoqërisë civile, sidomos për programet që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve për monitorim efikas të *acquis* të BE-së për zbatimin dhe qëndrueshmërinë e reformave për anëtarësimin në BE.
Afati: 2020

4.5 Mundësimi i përfshirjes efikase të OSHC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian si një mekanizëm institucional kyç për konsultimin me OSHC-të për çështje të BE-së brenda



Kuvenditë Shqipërisë. Kuvendi (ligji 15/15) ka ngritur KKIE ku merr pjesë edhe SHC, prandaj një ndarje e tillë duhet të reflektohet edhe në kuvend sipas komisioneve parlamentare dhe në KKIE
Afati: 2020

Strategjia Kombëtare e Qeverisë Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim (2015–2021) thekson se vizioni i qeverisë është “krijimi i një mjedisi mundësues për një shoqëri civile të fortë dhe të konsoliduar që kontribuon në zhvillimin e shoqërisë dhe të vendit së bashku me një media të pavarur dhe të lirë”.

Për më tepër, Strategjia Kombëtare identifikon tre objektiva strategjike në fushën e shoqërisë civile:

i) krijimin e një mjedisi ligjor dhe kushteve financiare për mbështetjen e qëndrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile

ii) forcimin dhe institucionalizimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe institucionet publike, me qëllim krijimin e një partneriteti të bazuar tek vullneti, besimi dhe mirëkuptimi reciprok i interesave të përbashkët

iii) nxitja e organizatave të shoqërisë civile, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe rekomandimet e BE-së, duke përfshirë vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen qytetare

Integrimi evropian është një nga dimensionet më të rëndësishme të agjendës së politikës së jashtme dhe të brendshme të Shqipërisë. Për këtë arsye, si pjesë e arritjes të objektivit strategjik të dytë do të synohet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet strukturave negociuese, ministrive dhe institucioneve të tjera dhe shoqërisë civile në procesin e negociatave të anëtarësimit. Shoqëria civile pritët të luajë një rol të rëndësishëm në këtë proces në të gjitha nivelet, nga pjesëmarrja në bazë e qytetarëve deri tek organizatat ombrellë.

Për koordinimin e procesit të anëtarësimit, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. Në pikën IX të tij, Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton se përfshirja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, etj do të realizohet në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian. Kjo Platformë do të përcaktojë edhe modalitetet e informimit, konsultimit dhe komunikimit me të gjitha palët e interesuara në kuadër të procesit të negociatave të anëtarësimit.

Sikurse përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave të sipërcituar, format e pjesëmarrjes, funksionimi dhe struktura institucionale e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian do të miratohen me urdhër të Kryeministrit.

Masat e planifikuara:

Masa 4.1.

Hartimi i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian

Masa 4.1.	Hartimi i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian
Institucioni kryesor përgjegjës	MEPJ
Partnerë në zbatim:	Kryeministria Të gjitha ministratë dhe institucionet koordinuese të grupeve ndër-institucionale të punës për kapitujt negociues
Afati	2020
Treguesit e zbatimit	1.Dokumenti i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian i hartuar 2.Numri i aktiviteteve konsultuese për Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian 3.Dokumenti i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian i miratuar
Asistenca Teknike që nevojitet	Potencialisht asistencë teknike për hartimin dhe finalizimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian

Masa 4.2.

Përfshirja e OSHC-ve në procesin e anëtarësimit në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian

Masa 4.2.	Përfshirja e OSHC-ve në procesin e anëtarësimit në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian
Institucioni kryesor përgjegjës	MEPJ
Partnerë në zbatim:	Ministritë dhe institucionet koordinuese të kapitujve negociues, AMSHC-ja
Afati	2020 - 2021 në vijim
Treguesit e zbatimit	1. Numri i aktiviteteve informuese, konsultuese dhe komunikuese zhvilluar me organizatat e shoqërisë civile, grupet e interesit, etj.
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Potencialisht: Asistence teknike për të mbështetur rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuar në procesin e anëtarësimit dhe mbështetjes përmes thirrjes për grante.

Masa 4.3.

Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve në menaxhimin e instrumentit të financimit të para-aderimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit.

Masa 4.3.	Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve në menaxhimin e instrumentit të financimit të para-aderimit të fondeve të BE-së, bazuar në parimin e partneritetit.
Institucioni kryesor përgjegjës	MEPJ
Partnerë në zbatim:	Kryeministria/MFE
Afati	2020-2021
Treguesit e zbatimit	1. Organizimi i ditëve informuese dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile 2. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në aktivitete informuese dhe/ose konsultuese lidhur me procesin e menaxhimit të fondeve të BE-së 3. Pjesëmarrja e OSHC-ve në Komitetin e Monitorimit të IPAs dhe Grupet sektoriale të Menaxhimit të Integruar të Politikave 4. Publikimi i raporteve vjetore të zbatimit të Programeve IPA (AIR)
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Masa 4.4

Koordinimi i financimeve dhe Programeve të BE prej të cilave mund të përfitojë shoqëria civile

Masa 4.5	Koordinimi i financimeve dhe Programeve të BE prej të cilave mund të përfitojë shoqëria civile
Institucioni kryesor përgjegjës	MEPJ
Partnerë në zbatim:	Kryeministria



Afati	2020 - 2021
Treguesit e zbatimit	1.Publikimi i Programeve prej të cilave mund të përfitojnë OSHC-të si edhe i procedurave transparente të aplikimit dhe vlerësimit. 2.Publikimi i thirrjeve për projekt propozime në faqen zyrtare të MEPJ dhe faqet zyrtare të institucioneve të tjera përgjegjëse 3.Publikimi i rezultateve në faqen zyrtare të MEPJ dhe faqet zyrtare të institucioneve të tjera përgjegjëse 4.Publikimi i emrave dhe adresave elektronike të pikave të kontaktit në MEPJ për secilin Program të Bashkëpunimit Territorial 5.
Komente të tjera	Caktimi i fondeve nga BE-ja për këtë masë përmes modaliteteve të decentralizuara si edhe Programeve të Bashkëpunimit Territorial (IPA-CBC dhe IPA-Interreg)
Asistenca Teknike që nevojitet	Fondet për shoqërinë civile do të sigurohen nëpërmjet asistencës teknike. Në rastet e Programeve të Bashkëpunimit Territorial fondet do sigurohen nëpërmjet aplikimit të OSHC (në partneritet) gjatë thirrjeve për propozime

Masa 4.5.

Mundësimi i përfshirjes efikase të OSHC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian si një mekanizëm institucional kyç për konsultimin me OSHC-të për çështje të BE-së brenda Kuvendit të Shqipërisë.

Masa 4.5.	Mundësimi i përfshirjes efikase të OSHC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian
Institucioni kryesor përgjegjës	Kuvendi i Shqipërisë
Partnerë në zbatim:	Kryeministria MEPJ AMSHC-ja
Afati	2019
Treguesit e zbatimit	1.Numri i procesverbaleve të publikuara të takimeve siç parashikohet me ligj 2.Emrat e stafit kyç të Këshillit publikuar në faqen zyrtare të MEPJ-së 3.Pasqyrimi dhe marrja e parasysh e rekomandimeve/sugjerimeve të bëra nga Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian nga MEPJ-ja.
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Prioriteti 5: Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive me fokus të veçantë në nivel lokal

Nën këtë prioritet janë identifikuar pesë masa kryesore për të cilat janë vendosur edhe afatet:

5.1 Krijimi i një koncepti kombëtar për vullnetarizmit dhe qytetarinë aktive, duke përfshirë aktet nënligjore, rregullimin afatmesëm gjithëpërfshirës për vullnetarë dhe për organizatat që pranojnë vullnetarë sipas praktikave të mira të BE-së

Afati kohor 2020



5.2 Përmirësimi i ligjit për Vullnetarizmin bazuar në konceptin kombëtar të vullnetarizmit, duke përfshirë aktet nënligjore (p.sh. kodin për vullnetarët), rregullimin e plotë afatmesëm për vullnetarët dhe për organizatat që pranojnë vullnetarë sipas praktikave të mira të BE-së, p.sh. çështja e sigurimeve

Afati kohor: koncepti kombëtar në vitin 2020, zgjidhja e çështjes së sigurimeve në vitin 2020, kurse përmirësimi i ligjit, duke përfshirë aktet nënligjore, në fund të vitit 2021

5.3 Futja e skemave të financimit nga shteti për mbështetjen e gjithanshme të zhvillimit dhe menaxhimit të programeve të vullnetarëve nga OSHC-të

Afati kohor: fillon në vitin 2021 e në vazhdim, bazuar në konceptin kombëtar

5.4 Krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshhtësinë dhe përhapjen e aktiviteteve vullnetare (mundësisht përmes akteve nënligjore specifike që do të përcaktonin kërkesat e raportimit për organizuesit e punës vullnetare), si dhe mbi vlerën ekonomike dhe sociale të punës vullnetare

Afati: 2022

5.5 Mbështetja për përfshirjen e grupeve specifike si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe të papunët në të gjitha aksionet vullnetare

Afati: 2020 e në vazhdim

Shqipëria e ka njohur vullnetarizmin në historinë e kohëve të fundit, por regjimi i saj autoritar e ka aplikuar më shumë në formë abuzive dhe jo si një koncept demokratik. Kjo ka çuar në keqperceptime dhe madje edhe stereotipie në lidhje me kuptimin e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjen e qytetarëve. Prandaj, ekziston një nevojë e posaçme për hartimin e një dokumenti orientues, i cili jo vetëm që do të përkufizonte vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen qytetare, por edhe do t'i hapte rrugë hapave të mëtejshëm dhe zbatimit të këtij koncepti.

Strategjia Kombëtare e Qeverisë së Shqipërisë për Zhvillim dhe Integrim (2015–2021), miratuar në vitin 2016⁹, identifikon tre objektiva strategjike në fushën e shoqërisë civile: Objektivi strategjik Nr. 3 i dedikohet promovimit të shoqërisë civile në përputhje me prioritetet kombëtare dhe rekomandimet e BE-së duke përfshirë vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen qytetare.

Pjesëmarrja në një shoqatë si anëtar ose vullnetar e mban një person aktiv, ndihmon në shpërndarjen e informacionit, inkurajon të menduarin me në qendër shoqërinë dhe i bën njerëzit bashkë.

Do të futet një koncept kombëtar për vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen qytetare dhe do të hartohet dhe zbatohet një plan i qartë veprimi. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile do të kërkojë një ekip për asistencë teknike me ekspertë ndërkombëtare dhe vendas në hartimin mbi baza vullnetare të këtij koncepti, i cili do të konsultohet gjerësisht me sektorin.

Ligjit shqiptar për Vullnetarizmin (nr. 45/2016) ka qenë hapi i parë drejt promovimit të vullnetarizmit, por ligji nuk ishte i mishëruar në një koncept më të gjerë ose në një debat publik për kuptimin dhe të mirat e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes qytetare në Shqipëri.

Roli i Shërbimit Kombëtar të Punësimit (përmes infrastrukturës së tij në të gjithë vendin) do të jetë regjistrimi i OSHC-ve (dhe institucioneve të tjera jo-fitimprurëse) që janë të gatshëm të ofrojnë punë vullnetare, lëshimi i një numri reference dhe këto institucione mund të regjistrojnë më pas individë dhe t'i pajisin ata me librezë personale regjistrimi dhe dokumentet përkatëse. Dy ose tre herë në vit, këto organe do të duhet të paraqisnin një bazë të dhënash Shërbimit Kombëtar të Punësimit, duke përfshirë detaje mbi vullnetarë të regjistruar ose të angazhuar

Një tjetër sfidë është aktualisht edhe çështja e sigurimeve për vullnetarët. Duke qenë se ligji nuk e ka zgjidhur çështjen e sigurimeve në një mënyrë që i mbështet OSHC-të, do të duhet të gjendet një zgjidhje brenda vitit të ardhshëm.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do ta finalizojë punën tashmë të filluar në një Kod Sjelljeje për Vullnetarët në konsultim me OSHC-të për këtë çështje.

⁹ (Gazeta Zyrtare nr. 86, datë 2016, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 11.05.2016)

Disa OJQ shqiptare entuziaste janë duke u përpjekur që të promovojnë idenë e vullnetarizmit në bazë të praktikave të mira të BE-së dhe ekspertiza e tyre do të merret nga institucioni përgjegjës për krijimin e konceptit dhe krijimin, më pas, të një kuadri ligjor plotësisht funksional siç përcaktohet në konceptin kombëtar.

AMSHC-ja tashmë e ka mbështetur disa projekte OSHC-sh për vullnetarizmin vitet e fundit, dedikuar kryesisht ndërgjegjësimit për vullnetarizmin. Është shumë e rëndësishme të vlerësohet ndikimi i këtyre projekteve në promovimin e vullnetarizmit, si dhe vazhdimi i punës mbi përvojën e mbledhur në të kaluarën.

Sa më lart do të ndodhë në bashkëpunim të ngushtë me organizatat kombëtare të familjarizuara me një koncept më të gjerë për vullnetarizmin dhe me pjesëmarrjen e qytetarëve. KKSHC-ja do të luajë një rol të rëndësishëm në sigurimin e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile në të gjitha fazat e mëvonshme të procesit.

Masat e planifikuara:

Masa 5.1.

Krijimi i një koncepti kombëtar për vullnetarizmit dhe qytetarinë aktive, duke përfshirë aktet nënligjore, rregullimin afatmesëm gjithëpërfshirës për vullnetarë dhe për organizatat që pranojnë vullnetarë sipas praktikave të mira të BE-së

Masa 5.1.	Krijimi i një koncepti kombëtar për vullnetarizmin
Institucioni kryesor përgjegjës	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve Ministria e Financave dhe Ekonomisë Kryeministria AMSHC-ja
Afati	Koncepti kombëtar për vullnetarizmin dhe qytetarisë aktive në vitin 2020
Treguesit e zbatimit	1.Krijimi i konceptit kombëtar të vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive në vitin 2020, duke përfshirë rolin e qendrave vullnetare 2.Përfshirja e ekspertizës së OSHC-ve në konceptin kombëtar pas dialogut dhe diskutimit 3.Pasja nga AMSHC-ja e konceptit të brendshëm të vullnetarizmit që prej vitit 2020
Komente të tjera	Bashkëpunim i ngushtë me organizatat shqiptare me përvojë në fushën e vullnetarizmit
Asistenca Teknike që nevojitet	Asistencë teknike për krijimin e konceptit kombëtar dhe konceptit të Agjencisë (25 ditë)

**Masa 5.2.**

Përmirësimi i ligjit për Vullnetarizmin bazuar në konceptin kombëtar të vullnetarizmit, duke përfshirë aktet nënligjore, rregullimin e plotë afatmesëm për vullnetarët dhe për organizatat që pranojnë vullnetarë sipas praktikave të mira të BE-së, p.sh. çështja e sigurimeve

Masa 5.2.	Përmirësimi i ligjit dhe akteve nënligjore të nevojshme për vullnetarizmin dhe zgjidhja e çështjes së sigurimeve bazuar në konceptin kombëtar
Institucioni kryesor përgjegjës	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Partnerë në zbatim:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinisë Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve AMSHC-ja
Afati	Koncepti kombëtar në vitin 2020 Përmirësimi i ligjit, përfshirë aktet nënligjore, në fund të vitit 2021
Treguesit e zbatimit	Zgjidhja e çështjeve të lidhura me sigurimet në vitin 2020 1. Finalizimi i Kodit të Sjelljes për Vullnetarët me kontributin e gjerë të OSHC-ve në vitin 2020 2. Ndryshimi i ligjit dhe akteve nënligjore në vitin 2021 3. Ushtrimi i aktivitetit të Agjencisë Shtetërore Kombëtare për Punësimin dhe Formimin Profesional në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fund të vitit 2021
Komente të tjera	Bashkëpunim i ngushtë me organizatat shqiptare me përvojë në fushën e vullnetarizmit
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Masa 5.3.

Futja e skemave të financimit nga shteti për mbështetjen e gjithanshme të zhvillimit dhe menaxhimit të programeve të vullnetarëve nga OSHC-të

Aktiviteti 5.3.	Skema të financimit nga shteti për promovimin e punës vullnetare, siç përcaktohet tek Koncepti
Institucioni kryesor përgjegjës	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
Afati	Prej vitit 2021 e tutje, bazuar tek koncepti kombëtar
Treguesit e zbatimit	1. Alokimi dhe sigurimi i buxhetit vjetor në buxhetin kombëtar të MEF 2. Numri i thirrjeve të shpallura publikisht për propozime për projekte të vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive 3. Shuma faktike e alokuar çdo vit 4. Publikimi i raporteve të projekteve
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

**Masa 5.4.**

Krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshtësinë dhe përhapjen e aktiviteteve vullnetare (mundësisht përmes akteve nënligjore specifike që do të përcaktonin kërkesat e raportimit për organizuesit e punës vullnetare), si dhe mbi vlerën ekonomike dhe sociale të punës vullnetare

Masa 5.4.	Krijimi i instrumenteve dhe metodologjisë për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshtësinë dhe përhapjen e aktiviteteve vullnetare (mundësisht përmes akteve nënligjore specifike që do të përcaktonin kërkesat për raportimin për organizuesit e punës vullnetare), si dhe mbi vlerën ekonomike dhe sociale të punës vullnetare
Institucioni kryesor përgjegjës	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	Shërbimi Kombëtar i Punësimit Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Afati	2021
Treguesit e zbatimit	1. Identifikimi dhe autorizimi i organit përgjegjës për mbledhjen e të dhënave. 2. Aktet nënligjore të miratuara 3. Krijimi i instrumentit për mbledhjen e të dhënave 4. Analizimi dhe bërja publike e vlerës ekonomike dhe sociale të punës vullnetare
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Për AT-në, shih pikën 5.1., si pjesë e mbështetjes për krijimin e konceptit kombëtar

Masa 5.5.

5.5 Mbështetja për përfshirjen e grupeve specifike si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe të papunët në të gjitha aksionet vullnetare

Masa 5.5.	Mbështetje për përfshirjen e grupeve të veçanta si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, pakicat dhe të papunët në të gjitha aksionet vullnetare
Institucioni kryesor përgjegjës	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Partnerë në zbatim:	AMSHC-ja Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Afati	2020
Treguesit e zbatimit	1. Pasqyrimi në koncept i përfshirjes së grupeve vullnetare 2. Sigurimi i nxitjes së gjithëpërfshirjes 3. Trajnimi i organizatave pritëse 4. Krijimi i vendeve për vullnetarë për përfaqësues të grupeve të synuara
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Shih nën pikën 5.1.



2.2 Drejtimi Strategjik 2: Mundësimi i mjedisit ligjor & ADMINISTRIMIT të dhënave

Prioriteti 6: Krijimi i një kuadri më mundësues për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve

Nën këtë prioritet janë identifikuar tre masa kryesore për të cilat janë vendosur edhe afatet:

6.1 Ndryshimi i ligjit aktual të regjistrimit të OSHC-ve për futjen e një procedure më të thjeshtë dhe më efikase për OSHC-të dhe parashikimi në ligj i krijimit të Regjistrimit Elektronik të OSHC-ve

Afati kohor: 2020

6.2 Ndryshimi i ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe akteve të tjera që lidhen me të (akte nënligjore dhe rregulloret) për t'i dhënë mundësi QKB-së të marrë përsipër procesin e regjistrimit të OSHC-ve nëpërmjet krijimit të një Regjistri Kombëtar Elektronik të OSHC-ve.

Afati kohor: 2021

6.3 Miratimi i akteve të tjera të nevojshme ligjore dhe nënligjore në lidhje me OSHC-të

Afati: Në vitin 2021

Aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) rregullohen kryesisht me ligjin për Organizatat Jofitimprurëse dhe ligjin për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse (nr. 8789, datë 07.02.2001). Krijimi, regjistrimi, funksionimi, organizimi dhe veprimtaria e OSHC-ve rregullohet me ligjin për Organizatat Jofitimprurëse (nr. 8788, datë 07.05.2001). Sipas këtij ligji, OSHC-të përfshijnë: (1) organizatat më anëtarësi me të paktën pesë persona ose dy ente ligjore si anëtarë themelues dhe me një asamble të përgjithshme si organin më të lartë vendimmarrës; dhe (2) fondacionet dhe qendrat që mund të krijohen nga një ose më shumë persona ose me testament dhe që kanë një Bord Drejtues si autoritetin më të lartë vendimmarrës. Sipas Raportit të TACSO-s për Vlerësimin e Nevojave të vitit 2017, shumica e OSHC-ve janë të përqendruara në Shqipërinë qendrore, sidomos në Tiranë. Shumica e OSHC-ve të tjera janë të vendosura në qytetet e mëdha në veri (Shkodër) dhe në jug (Korçë, Fier, dhe Vlorë). Sektori i shoqërisë civile është më i dobët në rrethe të largëta dhe në veçanti në zonat rurale, ndërsa numri i grupeve aktive me bazë komunitetin është i ulët.

Ligji aktual për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse parashikon një sistem të centralizuar regjistrimi për OSHC-të vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës. Nga ana formale, ligji për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse përcakton një procedurë të qartë dhe të thjeshtë dhe nuk krijon ndonjë pengesë thelbësore për regjistrimin e OSHC-ve. Ai nuk kërkon dhurim në themelim për regjistrimin dhe vendos një afat ligjor 15-ditor nga kërkesa për regjistrim deri në zbardhjen e vendimit të regjistrimit. Megjithatë, në praktikë, neni 7 i këtij ligji, duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës si të vetmin organ kompetent për të gjitha regjistrimet dhe procedurat e shpërbërjes së OSHC-ve, përbën një barrë të panevojshme administrative dhe financiare për OSHC-të, veçanërisht për OSHC-të e reja jashtë Tiranës. Vendimet për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo vendim tjetër lidhur me hapat për regjistrimin e tyre, bëhet nga një gjyqtar i vetëm nga seksioni tregtar i gjykatës me kërkesë të subjektit të interesuar. Afati ligjor prej 15 ditësh rrallë respektohet në praktikë, me pretendimin se gjyqtarët janë shumë të ngarkuar me çështje të tjera.

Procedurat e centralizuara të regjistrimit bashkë me mungesën e një sistemi elektronik efikas regjistrimi kërkojnë që OSHC-të të udhëtojnë për në Tiranë disa herë për të ndjekur ecurinë e kërkesës së tyre për regjistrim, ose ndryshimet në aktet e tyre apo kërkesën për çregjistrim. Kostot e larta financiare të regjistrimit, procedurat e gjata dhe udhëtimet disa herë lidhur me to, si dhe mungesa e profesionistëve të specializuar për t'u marrë me çështjet e OSHC-ve mund të krijojnë pengesa të panevojshme për OSHC-të jashtë Tiranës, të cilat nuk kanë fillimisht akses në financim dhe mund të



mos e kenë mundësinë ose mund të dekurajohen nga çdo kosto që lidhet me procesin e regjistrimit.¹⁰

OSHC-të kanë avokuar për ndryshime ligjore për modernizimin e procedurave të regjistrimit, me qëllim thjeshtimin e procesit të regjistrimit, dhe për ndryshime në aktet e themelimit dhe çregjistrimit, si dhe për kalimin në një procedurë regjistrimi moderne, të shpejtë, miqësore për përdoruesin dhe jo të kushtueshme për OSHC-të në të gjithë Shqipërinë. Përveç kësaj, sistemi aktual manual i regjistrimit, i cila është vjetruar dhe i pamjaftueshëm për të siguruar informimin e saktë dhe në kohë për OSHC-të, do të kompjuterizohet. Modernizimi i procedurave të regjistrimit kërkon ndryshime në ligjin ekzistues dhe në ligjet e tjera që lidhen me të e që preken nga ky ndryshim. Angazhimi i OSHC-ve në të gjitha fazat e procesit të hartimit të këtyre ndryshimeve duhet t'u japë atyre një mundësi të konsiderueshme për të pasqyruar njëzet vjet përvojë të OSHC-ve dhe për të hequr kërkesat ligjore që pengojnë, vonojnë apo kufizojnë krijimin apo funksionimin e OSHC-ve në praktikë.¹¹

Përveç problematikës së regjistrimit, disa përparime janë bërë në krijimin e një mjedisi ligjor më mundësues për funksionimin e OSHC-ve.¹² Janë miratuar disa reforma legislative dhe institucioneve me pjesëmarrje më të madhe të OSHC-ve.¹³ ligji i mësipërm për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Ligjet për të Drejtën e Informimit, Vullnetarizmin, Taksën mbi Vlerën e Shtuar, ligji për Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile dhe Ndërmarrjet Sociale, kanë prodhuar efekte fillestare pozitive në krijimin e një hapësire ligjore dhe fiskale më miqësore për OSHC-të.¹⁴ Këto ligje garantojnë kushte më të mira për angazhimin e OSHC-ve me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore në hartimin e politikave kombëtare dhe vendore, si edhe në llogaridhënien publike të institucioneve shtetërore në lidhje me zbatimin e këtyre politikave. Megjithatë, ekzistojnë edhe mjaft ndërhyrje ligjore që do të krijonin mjedis edhe më mundësues për aktivitetet e OSHC-ve. Gjithashtu, disa ligje ekzistuese të miratuara vitet e fundit do të shoqërohen me aktet nënligjore të nevojshme. Prandaj, qeveria do të marrë masa për të miratuar legjislacion parësor të ri dhe për të plotësuar kuadrin nënligjor që duhet hartuar me qëllim krijimin e një mjedisi më të mirë ligjor për OSHC-të.

Masat e planifikuara:

Masa 6.1.

Ndryshimi i ligjit aktual të regjistrimit të OSHC-ve për futjen e një procedure regjistrimi më të thjeshtë dhe në efiente për OSHC-të dhe parashikimi me ligj i krijimit të një Regjistri Elektronik të OSHC-ve.

Masa 6.1.	Ndryshimi i ligjit aktual të regjistrimit të OSHC-ve për futjen e një procedure regjistrimi më të thjeshtë dhe në efiente për OSHC-të dhe parashikimi me ligj i krijimit të një Regjistri Elektronik të OSHC-ve
Institucioni kryesor përgjegjës	MFE / Ministria e Drejtësisë
Partnerë në zbatim:	Kryeministria Ministria e Drejtësisë KKSHC

¹⁰Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve të 2016 për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në Euroazi, USAID, korrik 2017.

¹¹ Për shembull, në Bullgari, procedurat e regjistrimit janë falas, ndërsa në Japoni kërkesa për regjistrimin e një OSHC-jetë re paraqitet në internet, ashtu sikurse edhe vendimi i regjistrimit, i cili komunikohet online.

¹² Raporti i TACSO 2016, Matrica e Monitorimit 2016, Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve të vitit 2016 për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë, USAID, korrik 2017.

¹³ Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve të 2016 për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në Euroazi, USAID, korrik 2017.

¹⁴ Rreth 66% e OSHC-ve të anketuara në vitin 2016 u shprehën pozitivisht për përmirësimet së fundmi të mjedisit ligjor për OSHC-të. Shih raportin e TACSO-s të vitit 2016, faqe 9.



	AMSHC-ja QKB-ja MSHMS
Afati	Në fund të vitit 2020 për Këshillin e Ministrave Tremujori i parë i vitit 2021 Brenda tremujorit të parë të vitit 2021 për Kuvendin e Shqipërisë
Treguesit e zbatimit	1.Kryerja e një procesi konsultimi me pjesëmarrje nën kujdesin e KKSHC-së për ndryshimin e ligjit aktual të regjistrimit 2.Hartimi dhe paraqitja në Kryeministri e një dokumenti ku përcaktohen opsionet e politikave dhe ku rekomandohen ndryshime për futjen e një regjimi modern regjistrimi, duke përfshirë mendimet e OSHC-ve 3.Miratimi i projektligjit për ndryshimin e procedurës aktuale të regjistrimit nga Këshilli i Ministrave 4.Miratimi i ndryshimeve të ligjit të regjistrimit të OSHC-ve nga Kuvendi i Shqipërisë
Arritjet në vitin 2019	
Komente të tjera	Kërkohet angazhimi i OSHC-ve në të gjithë fazën e hartimit
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Masa 6.2.

Ndryshimi i ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe akteve të tjera që lidhen me të (akte nënligjore dhe rregullore) për t'i dhënë mundësi QKB-së për të marrë përsipër procesin e regjistrimit të OSHC-ve përmes krijimit të një Regjistri Kombëtar Elektronik të OSHC-ve.

Masa 6.2.	Ndryshimi i ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe akteve të tjera që lidhen me të (akte nënligjore dhe rregullore) për t'i dhënë mundësi QKB-së për të marrë përsipër procesin e regjistrimit të OSHC-ve përmes krijimit të një Regjistri Kombëtar Elektronik të OSHC-ve
Institucioni kryesor përgjegjës	/ Ministria e Financave dhe Ekonomisë /Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Partnerë në zbatim:	Kryeministria AKSHI, KKSHC, AMSHC, Ministria e Drejtësisë, Qendra Kombëtare e Biznesit
Afati	2021
Treguesit e zbatimit	1.Përgatitja dhe paraqitja në Kryeministri e një analize juridike të ndikimit të ndryshimeve të bëra në procedurën e regjistrimit në funksionet e QKB-së të përcaktuara në ligjin për QKB-në dhe në aktet ligjore që lidhen me të; 2.Përgatitja e një projektligji për ndryshimin e mandatit dhe funksioneve të QKB-së për të marrë përsipër procesin e regjistrimit të OSHC-ve nëpërmjet krijimit të një Regjistri Kombëtar Elektronike të OSHC-ve; 3.Regjistri Kombëtar Elektronik i OSHC-ve operacional në vitin 2022
Komente të tjera	



Asistenca Teknike që nevojitet	AT për analizën juridike të ndikimit të ndryshimeve të bëra në procedurën e regjistrimit në funksionet e QKB-së Asistencë teknike për aplikimin e elementëve të një zgjidhjeje TIK për regjistrin kombëtar elektronik.
--------------------------------	---

Masa 6.3.**Miratimi i akteve të tjera të nevojshme ligjore dhe nënligjore lidhur me OSHC-të**

Masa 6.3.	Miratimi i akteve të tjera të nevojshme ligjore dhe nënligjore lidhur me OSHC-të
Institucioni kryesor përgjegjës	Ministria e Financave dhe Ekonomisë për studimet mbi filantropinë dhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit për Kontrollin Financiar Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për kryerjen e një studimi mbi mundësinë e ndryshimeve të ligjit për ndërmarrjet sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për aktet nënligjore për shërbimet sociale Ministria e Financave dhe Ekonomisë për aktet nënligjore për ligjin për inspektimin e financave publike dhe ligjin për vullnetarizmin
Partnerë në zbatim:	Kryeministria KKSHC AMSHC-ja Ministria e Drejtësisë
Afati	Në vitin 2020
Treguesit e zbatimit	1.Kryerja e një studimi krahasues të Rregullores së Filantropisë në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet kandidate, me qëllim krijimin e një baze ligjore më mundësuese për filantropinë nëpërmjet ofrimit të stimulave tatimorë për aktivitete filantropike; 2.Analiza e mangësive të legjislacionit ekzistues, lidhur me ligjin për Ndërmarrjet Sociale në RSH, e përfunduar Hartimi i akteve të tjera të mbetura nënligjore që kërkon neni 29 i ligjit për Vullnetarizmin nr. 45, datë 28.04.2016. 3.Hartimi i akteve të tjera të mbetura nënligjore që kërkon ligji për Inspektimin Financiar Publik. 4.Aktet nënligjore në zbatim të nenit 52 i ligjit për Shërbimet Sociale nr. 121, datë 24.11.2016, të miratuara
Komente të tjera	Kërkohet angazhimi i OSHC-ve në të gjithë fazën e hartimit
Asistenca Teknike që nevojitet	Asistencë teknike për kryerjen e studimit krahasues dhe identifikimin e praktikave të mira të BE-së në stimulimin e filantropisë nga individë apo kompani dhe kryerjen e një analize të mangësive të legjislacionit ekzistues, lidhur me ligjin për Ndërmarrjet Sociale në RSH (maksimumi 25 ditë) AT e nevojshme për aktet nënligjore të ligjit për vullnetarizmin

**Prioriteti 7: Mbledhja dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile**

Nën këtë prioritet janë identifikuar tre masa kryesore për të cilat janë vendosur edhe afatet:

7.1 Krijimi i Regjistrimit Kombëtar Elektronik të OSHC-ve me të gjitha funksionet.

Afati: 2022

7.2 Digjitalizimi i të dhënave dhe arkivave të OSHC-ve për të mundësuar një sistem për shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë statusin, vendndodhjen, llojin e aktivitetit, numrin e stafit, dhe informacione të tjera relevante për OSHC-të në bazë të ndryshimit të kuadrit ligjor.

Afati: 2022.

7.3 Ndërtimi i sistemit MIS të AMSHC-së dhe fillimi i publikimit të statistikave kryesore mbi kontributin e sektorit të shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit dhe shpërndarja gjerësisht të rezultateve.

Afati: 2022.

Të dhënat e konsoliduara për sektorin e OSHC-ve mund të forcojnë punën e shumë institucioneve publike që merren me OSHC-të, me qëllim që t'u garantojnë këtyre të fundit shërbime më cilësore. ligji për OSHC-të dhe legjislacioni përkatës nuk ngarkon ndonjë institucion shtetëror ose publik me detyrën e krijimit apo mirëmbajtjes së regjistrimit të OSHC-ve.

Në këto rrethana, kemi tri sfida për të dhënat e sektorit të OSHC-ve:

-Mungesa e të dhënave të sakta dhe të konsoliduara për sektorin e OSHC-ve:

Disa institucione publike, me nismë të tyre, kanë krijuar regjistra të thjeshtë të OSHC-ve që të lehtësojnë punën e përditshme. Sipas Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, 9 280 OSHC janë regjistruar që në 1993, vit kur ky funksion iu caktua vetëm gjykatave. Të dhënat mbahen kryesisht në formë shkresore dhe të paorganizuara në një databazë të strukturuar.

-Sipas DP të Tatimeve, në maj 2016 ishin 3 766 OSHC të regjistruara.

AMSHC-ja e filloi procesin e regjistrimit (me bazë vullnetare) të OSHC-ve në vitin 2012. Janë regjistruar 562 OSHC. Nga shifrat e ndryshme që japin institucionet kryesore, është e qartë se institucionet shtetërore përdorin të dhëna të konsoliduara për OSHC-të. Ndërhyrja imediate do të jetë ngritja e një Regjistrit Kombëtar Elektronik i OSHC-ve që të jetë i konsoliduar. Kjo do të përmirësojë shërbimet administrative që iu ofrohen OSHC-ve, do të ofrojë informacion të saktë dhe të konsoliduar për subjektet e interesuara, do të mundësojë shkëmbim të lehtë të informacionit, transparencë dhe llogaridhënie, si edhe performancë më të mirë të institucioneve shtetërore. Gjithashtu, regjistri elektronik i OSHC-ve duhet të përmbajë të gjitha raportet financiare të OSHC-ve, që mund të bëhen publike me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së OSHC-ve. Kjo do të kërkojë ndryshime në legjislacionin ekzistues që disiplinon regjistrimin dhe raportimin e OSHC-ve (shih Prioritetin 6).

-Mungesa e të dhënave digjitale për OSHC-të:

I gjithë procesi i regjistrimit, ndryshimeve dhe çregjistrimit të OSHC-ve në Gjykatën e Tiranës bëhet manualisht. Në mungesë të një regjistri elektronik, Gjykata has vështirësi në përditësimin e informacionit, si p.sh. ndryshimet e adresave apo anëtarësisë së bordeve. Përveç kësaj, pa një regjistër elektronik të OSHC-ve, gjykatës i mungojnë të dhënat e automatizuara apo dokumentet e skanuara të dosjeve të OSHC-ve. Nga këndvështrimi logjistik, nuk është e lehtë të merresh me rreth 9 280 dosje OSHC-sh dhe dokumente të shumta për secilën OSHC. Ndërhyrja e nevojshme për kapërcimin e kësaj problematike është skanimi dhe digjitalizimi i të gjitha arkivave dhe dokumenteve të OSHC-së. Kjo do të kërkojë sinkronizim të aktiviteteve me zhvillimin dhe zbatimin e Databazës Kombëtare të OSHC-ve, si edhe ndryshime në legjislacionin ekzistues për regjistrimin dhe raportimin e OSHC-ve, siç u përmend edhe më lart (shih Prioritetin 6).

-Nevoja për të dhëna të avancuara dhe analiza të sektorit të OSHC-ve:

Dispozitat ekzistuese për raportimin, përveç se joadekuate dhe të mbingarkuara, nuk mundësojnë as



statistika sistematike dhe të besueshme për sektorin jofitimprurës. Për shembull, INSTAT¹⁵ raporton se 2 465 subjekte janë regjistruar si OSHC nga fundi i vitit 2016, ndërsa sipas administratës tatimore ishin 1 507 OSHC që dorëzuan të paktën një deklaram tatimor vjetor; nga ana tjetër, gjykatat nuk arritën të japin të dhëna të sakta për numrin e organizatave të regjistruara. Rregulla më të hollësishme dhe specifike për OSHC-të do të mundësonin përpilimin e statistikave më të avancuara për zhvillimet e sektorit jofitimprurës (p.sh. të ardhurat totale, burimet e financimit, asetet, numri i punonjësve, numri i vullnetarëve, etj.), që janë të rëndësishme për programin bazuar në evidenca, monitorimin dhe vlerësimin e financimit të programeve të OSHC-ve. Qasja e ndjekur nga institucione të ndryshme në këtë drejtim ua lehtëson punën e përditshme, ama, kjo qasje ka krijuar problematike në lidhje me autenticitetin dhe cilësinë e të dhënave. Një tjetër ndërhyrje e nevojshme në administrimin e të dhënave që do të mundësonte studime dhe raporte të avancuara për sektorin e OSHC-ve, do të jetë edhe krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (SMI) të AMSHC-së, që do të shërbejë si platformë shkëmbimi informacioni për OSHC-të. SMI do të krijohet që të jetë ndërveprues me Regjistrimin Elektronik Kombëtar që parashikohet të ngrihet. Përveç të dhënave bazë për numrin dhe profilin e OSHC-ve, është e nevojshme të ndiqen edhe të dhëna të tjera që tregojnë impaktin social të programeve të OSHC-ve, si edhe mundësojnë vlerësimin e kontributit të OSHC-ve në rritjen e përgjithshme sociale dhe ekonomike, si p.sh.: fusha e aktivitetit, numri i punonjësve, të ardhurat totale, burimet e financimit, asetet, numri i vullnetarëve, etj.

Kjo do të kërkojë ndërhyrje në legjislacionin ekzistues për regjistrimin dhe raportimin e OSHC-ve, siç u përmend nën Prioritetin 6.

Masat e planifikuara

Masa 7.1.

Krijimi i një Regjistri Kombëtar Elektronik për OSHC-të me të gjitha funksionet. Duhet të përmbajë të gjitha informacionet relevante për OSHC-të (si data e regjistrimit, adresa/të dhënat e kontaktit, sektori/sectorët, aktivitetet, emri i presidentit/personave të tjerë të autorizuar për të përfaqësuar OSHC-në, etj.) dhe të jepet mundësia e kërkimit sipas kritereve të ndryshme (emri, grupi/nëngrupi i aktiviteteve, qyteti/rajoni i selie të OSHC-ve, etj.).

Masa 7.1.	Krijimi i një Regjistri Kombëtar Elektronik për OSHC-të me të gjitha funksionet.
Institucioni kryesor përgjegjës	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) Institucioni përgjegjës për Regjistrimin e OSHC-ve
Partnerë në zbatim:	Kryeministria AMSHC-ja Agjencia e Prokurimit Publik Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Afati	2022
Treguesit e zbatimit	1.Krijimi dhe realizimi i Regjistrimit Elektronik të OSHC-ve 2.Informacione të kërkueshme për OSHC-të nëpërmjet Internetit të aksesueshme për publikun 3.Një proces i integruar regjistrimi i OSHC-ve dhe një proces i integruar për ndryshimet dhe çregjistrimin e OSHC-ve 4.Informacione të kërkueshme nëpërmjet Internetit për raportet financiare të organizatave jofitimprurëse që mund të bëhen publike

¹⁵ Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistri-statistikor-i-nd%C3%ABrmarrjeve/#tab2>



Komente të tjera	Parakusht për fillimin e regjistrimit të OSHC-ve mund të ishte miratimi i ndryshimeve në ligjin për OSHC-të Koordinimi mes institucioneve përgjegjëse për procesin e regjistrimit dhe gjykatave të rretheve, ministrive të linjës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës për mbledhjen e të gjitha të dhënave Ndërfunksionim i Regjistrimit Kombëtar Elektronik të OSHC-ve dhe Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile duhet të jetë një parakusht;
AT e nevojshme	Nevojitet TA për hartimin e ndryshimeve ligjore në koordinim me ekspertin ligjor, përgatitjen e termave të referencës për Regjistrimin Kombëtar Elektronik të OSHC-ve, hartimin e propozimit për specifikimet teknike të pajisjeve dhe programeve kompjuterike për Regjistrimin Kombëtar Elektronik të OSHC-ve; Për përgatitjen e sistemit të përgjithshëm të kostimit të sistemit, lidhjes së tij me sistemet e tjera dhe pajisjet elektronike: për hartimin e manualëve/udhëzimeve, si dhe për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve.(TA 10 ditë)

Masa 7.2

Digjitalizimi i të dhënave dhe arkivave të OSHC-ve, duke mundësuar një sistem të përditësuar të shkëmbimit të informacionit në lidhje me statusin, vendndodhjen, llojin dhe statusin e OSHC-ve, llojin e aktiviteteve, numrin e personelit dhe informacione të tjera në përputhje me kuadrin ligjor.

Masa 7.2.	Digjitalizimi i të dhënave dhe arkivave të OSHC-ve
Nënaktivitetet	
Institucioni kryesor përgjegjës	AKSHI Institucioni përgjegjës për Regjistrimin e OSHC-ve
Partnerë në zbatim:	Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës Gjykatat e rretheve Agjencia e Prokurimit Publik AMSHC-ja
Afati	2022
Treguesit e zbatimit	1.Digjitalizimi i të gjitha të dhënave të OSHC-ve 2.Informacione të kërkueshme për OSHC-të nëpërmjet internetit të aksesueshme për publikun 3.Një proces i integruar regjistrimi për OSHC-të
Komente të tjera	Koordinimi mes gjykatave të rretheve, ministrive të linjës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Tiranës për mbledhjen e të gjitha të dhënave
Asistenca Teknike që nevojitet	AT për përcaktimin e metodologjisë, proceseve dhe standardeve që do të përdoren për digjitalizimin dhe konsolidimin; për përgatitjen e termave të referencës së digjitalizimit; përgatitjen e analizës për kostimin e procesit të digjitalizimit; harmonizimin e planit të aktiviteteve me krijimin e Regjistrimit Kombëtar Elektronik të OSHC-ve, përlogaritjen e kostove (AT 10 ditë)

**Masa 7.3.**

Ndërtimi i sistemit të menaxhimit të informacionit (MIS) për AMSHC-në, fillimi i publikimit të skedave me statistikat kyçe mbi kontributin e sektorit të shoqërisë civile në zhvillimin social-ekonomik të vendit dhe shpërndarja gjerësisht e rezultateve.

Masa 7.3.	Ndërtimi i sistemit MIS të AMSHC-së
Institucioni kryesor përgjegjës	AMSHC-ja
Partnerë në zbatim:	Kryeministria Agjencia e Prokurimit Publik AKSHI
Afati	2022
Treguesit e zbatimit	1.Zhvillimi dhe realizimi i sistemit MIS në AMSHC 2.Vënia në dispozicion të publikut të informacioneve të kërkueshme mbi sektorin e OSHC-ve 3.Publikimi i raporteve mbi sektorin e OSHC-ve, si trendi i OSHC-ve në vite, fusha e aktiviteteve, numri i punonjësve, numri i vullnetarëve, etj.
Komente të tjera	Krijimi i Regjistrat Kombëtar Elektronik të OSHC-ve është parakusht për këtë masë.
Asistenca Teknike që nevojitet	AT për përgatitjen e termave të referencës për sistemin e menaxhimit të informacionit të AMSHC-së; hartimin e propozimit për specifikimet e ndërlidhjes me sisteme të tjera dhe pajisjeve kompjuterike të sistemit MIS për AMSHC-në; përgatitjen e kostimit të saktë të sistemit, ndërlidhjes dhe pajisjeve kompjuterike; hartimin e manualëve/udhëzimeve, si dhe për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve.(AT 10 ditë)

2.3 Drejtimi strategjik 3: Kuadër fiskal dhe financues i favorshëm

Prioriteti 8: Krijimi i një kuadri të financimit publik për mbështetjen e programeve të OSHC-ve në përputhje me praktikën e mira të BE-së

Nën këtë prioritet janë identifikuar tre masa kryesore dhe janë përcaktuar afatet për to:

8.1Shqyrtimi në bazë të analizës së boshllëqeve i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OSHC-ve financuar nga institucionet qeveritare qendrore dhe lokale, përfshirë saktësimin e procedurave për thirrjet për propozime
Afati: 2020 për analizën e boshllëqeve. 2021 për rishikimin e legjislacionit

8.2Kryerja e procedurave të marrjes së statusit të NS dhe të procedurave të financimit të ndërmarrjeve sociale nëpërmjet tre formave të mbështetjes financiare
Afati: 2022

8.3Sigurimi i informacioneve gjithëpërfshirëse për mundësitë e financimit publik të programeve të OSHC-ve (plane financimi dhe raporte vjetore) dhe procedura për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social.
Afati: 2020 e në vazhdim

OSHC-të mbeten shumë të varura nga financimet e huaja. Mundësitë e financimit publik vendas për OSHC-të përfshijnë kontraktimin për ofrim shërbimesh, grantet për projekte të dhëna nga disa ministri të linjës si Ministria e Kulturës, disa bashki dhe grantet nga AMSHC-ja.

Shpërndarja e fondeve publike kërkon transparencë në fazën e shpalljes së thirrjeve, qartësi në



kriteret e përzgjedhjes, si dhe transparencë të plotë sa u takon përfituesve të fondeve publike.

Praktikat më të mira janë që shoqëria civile të marrë pjesë në procesin e identifikimit të prioriteteve që adreson qeveria përmes financimit publik. AMSHC-ja me konsultimet e saj para thirrjeve e ushtron tashmë këtë praktikë të mirë para thirrjes së përvitshme për propozime.

Këto kërkesa u shprehën edhe nga shoqëria civile e konsultuar në procesin e rishikimit të Udhërrëfyesit.

Në kuadrin e këtij Prioritet, qeveria do të shfrytëzojë përvojën e fituar me financimin publik në shkallë vendi nga AMSHC-ja. Ajo do të mësojë gjithashtu edhe nga eksperiencia dhe praktikat e mira të programeve dhe projekteve të zbatuara nga OSHC të ndryshme dhe nga partnerë për zhvillim në nivel lokal.

Nga qasjet e ndryshme të financimit publik, d.m.th (i) grantet përmes ministrive të linjës dhe bashkive, (ii) kontraktimit të shërbimeve nga organet publike, dhe (iii) ofrimit të pagesës për palët e treta përmes AMSHC-së, më transparentja si qasje aktualisht duket se është financimi publik përmes AMSHC-së, ndonëse kjo qasje ende provokon shumë kritika në sektorin e shoqërisë civile dhe kërkon më shumë hapa nga ana e Agjencisë për të fituar besim.

Do të arrihet qartësi sa u përket rregullave dhe procedurave për financimin publik të OSHC-ve në kuadrin e ofrimit të shërbimeve sociale. Informacionet mbi subvencionet apo grantet e dhëna nga ministritë apo bashkitë shqiptare do të bëhen menjëherë të gatshme e të disponueshme për përfituesit potencialë.

Duke vazhduar me pasqyrimin e sugjerimeve të OSHC-ve në lidhje me financimin publik, qeveria duhet të punojë në këto fusha: (1) Lehtësimin e procedurave dhe kriterëve të aplikimit; (2) Krijimin e një fondi për mbështetjen financiare e ndërmarrjeve sociale, si dhe ngritjen e shërbimeve sociale në kuadër të Fondit Social; dhe (3) shpërndarjen e të dhënave zyrtare nga institucionet publike të përfshira në procesin e financimit publik.¹⁶

Do të parashikohen rregulla të qarta për planifikimin dhe ndarjen e fondeve publike nga ministritë dhe bashkitë dhe rregulla të qarta për kontraktimin social të OSHC-ve në kuadrin e programeve të financimit të fondit social dhe ndërmarrjeve sociale.

Përveç kësaj, duke pasur parasysh thellimin e decentralizimit të shërbimeve sociale dhe reformën e re administrative në Shqipëri, do të forcohen kapacitetet e autoriteteve kontraktuese për ndërtimin e partneriteteve me OSHC-të në ofrimin e shërbimeve.

Siç përshkruhet në Prioritetin 6, do të garantohet miratimi i akteve nënligjore siç parashikohet në ligjin për Ndërmarrjet Sociale nr. 65, datë 09.06.2016, si dhe në ligjin për Shërbimet Sociale nr. 121, datë 24.11.2016¹⁷.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do ta finalizojë punën e saj në lidhje me aktet nënligjore për zbatimin e ligjit për Shërbimet Sociale 121/2016, ndërkohë që katër akte nënligjore tashmë janë vlerësuar nga Ministria e Drejtësisë dhe i janë kthyer AMSHC-së për përmirësime të mëtejshme. Do të krijohet një sistem i përshtatshëm në shkallë vendi kostimi për të garantuar standarde cilësore dhe siguri të ardhurash për ofruesit e shërbimeve. Do të vlerësohen disa projekte pilot si p.sh. përdorimi i aseteve të konfiskuara në të mirë të sektorit ose shërbimeve dhe ko fushë do të nxitet më tej në bazë të rregullave të përshtatshme. Kjo do t'i japë mundësi qeverisë të përcaktojë nevojat (deri në detajet e specifikimeve teknike – p.sh. standardet minimale të shërbimeve. Do të duhet të nxitet filantropia nga qytetarët dhe nga bizneset përmes një legjislacioni fiskal që e mundëson atë dhe që duhet të shoqërohet me një komunikim në shkallë vendi për këtë gjë¹⁸.

¹⁶ Matrica e Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile për Shqipërinë e vitit 2015. Partners Albania.

¹⁷ Raporti i rishikuar i vlerësimit të nevojave. TACSO 2017, EuropeAid/127427/C/SER/Multi/5.

¹⁸ Kjo masë motivohet nga studimi i bërë nga Partners Albania vitin e shkruar në sondazhet e tij për Filantropinë. Më shumë informacion ofrohet nga Ekipi në një dokument të veçantë për Filantropinë.

**Masat e planifikuara:****Masa 8.1.**

Rishikimi i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OSHC-ve nga institucionet lokale dhe qendrore të qeverisë bazuar në analizën e mangësive, duke përfshirë saktësimin e procedurave për thirrjet për propozime.

Masa 8.1.	Rishikimi i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OSHC-ve
Institucioni kryesor përgjegjës	MFE/ AMSHC
Partnerë	Kryeministria AMSHC-ja KKSHC MD
Afatet	2020 për analizën e mangësive 2021 për rishikimin e legjislacionit
Treguesit e zbatimit	1.bërja e analizës së mangësive ligjore 2.diskutimi i rezultateve dhe opsioneve në KKSHC (raportuar në procesverbal) 3.identifikimi i ligjeve që kanë nevojë për ndryshim 4.ndryshimi i legjislacionit
Komente të tjera	Koordinimi mes MFE dhe AMSHC është kyç për zbutjen e risqeve që mund të lidhen me këtë aktivitet.
Asistenca Teknike që nevojitet	AT për analizën e mangësive ligjore dhe identifikimin e ligjeve që kanë nevojë për rishikim, 15 ditë

Masa 8.2

Mbështetja financiare e Organizatave Jofitimprurëse nëpërmjet Programit të Ndërmarrjeve Sociale dhe atij të Fondit Social

Masa 8.2.	Kryerja e procedurave të marrjes së statusit të NS dhe të procedurave të financimit të ndërmarrjeve sociale nëpërmjet tre formave të mbështetjes financiare
Institucioni kryesor përgjegjës	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Partnerë Në zbatim	Kryeministria KKSHC Ministria e Drejtësisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë AMSHC-ja Qeveria vendore
Afati	2021
Treguesit e zbatimit	5.Parashikimi në PBA i fondeve të mbështetjes financiare të ndërmarrjeve sociale 2020-2022Mbledhja e Komisionit të Vlerësimit periodikisht Aprovimi i masave të mbështetjes financiare në bazë të vlerësimit të aplikimeve Raportimi periodik pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore sipas legjislacionit në fuqi Hartimi dhe zhvillimi i një programi informimi për shoqërinë civile 6.Përgatitja dhe zhvillimi i një fushate ndërgjegjësimi në lidhje me programin e financimit të NS



Komente të tjera	
Asistenca Teknikeqë nevojitet	AT për programin dhe modulën e trajnimit dhe ndërtimin e kapaciteteve. AT edhe për fushatën e ndërgjegjësimit. (afërsisht 20 ditë)

Masa 8.3**Kryerja e procedurave të vlerësimit të Planeve Sociale dhe të procedurave të miratimit të financimit të shërbimeve sociale nëpërmjet Programit të Fondit Social**

Aktiviteti 8.3.	Shërbime sociale të financuara nga buxheti qendror në kuadër të Programit të Fondit Social
Institucioni kryesor përgjegjës	MSHMS
Partnerë Në zbatim	MFE, MD, MEPJ, MB, KKSHC, AMSHC, Shoqata e Bashkive
Afati	2020-2022
Treguesit e zbatimit	1.Parashikimi në PBA i fondeve të mbështetjes financiare të shërbimeve sociale 2020-2022 2.Mbledhja e Komisionit të Vlerësimit periodikisht 3.Aprovimi i masave të mbështetjes financiare për ngritjen e shërbimeve sociale në bazë të vlerësimit të Planeve Sociale të miratuara dhe kostuara 4.Mbështetje e Qeverisë Vendore për hartimin e Planeve Sociale dhe parashikimin e ngritjes së shërbimeve sociale me bazë komunitare
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Lidhur me aktivitetin e katërt nevojitet asistencë nga organizatat e UN, aktorë në fushën e shërbimeve sociale

Masa 8.4**Garantimi i informacioneve të plota për mundësitë e financimit publik të programeve të OSHC-ve(plane financimi dhe raporte vjetore)**

Aktiviteti 8.4.	Publikimi i planeve të financimit dhe raporteve vjetore përfinancimin publik të programeve të OSHC-ve
Institucioni kryesor përgjegjës	AMSHC-ja
Partnerë Në zbatim	MSHMS, MD, MEPJ, MB, KKSHC, AMSHC, Shoqata e Bashkive
Afati	2020
Treguesit e zbatimit	5.Publikimi i të dhënave të financimit në faqet zyrtare të institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal
Komente të tjera	Detyrimi i institucioneve relevante për të publikuar raporte duhet të reflektohet në legjislacion. Duhet një koordinim më i mirë midis qeverisë qendrore dhe asaj lokale
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

**Prioriteti 9: Raportimi financiar/kontabilizimi dhe tatimi i OSHC-ve**

Në këtë Prioritet janë identifikuar katër masa kryesore dhe janë vendosur afatet:

9.1 Heqja e detyrimit ligjor për OSHC-të për të pasur një punonjës me kohë të plotë me pagë dhe të siguruar.

Afati: 2021

9.2 Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OSHC-ve sa i përket TVSh-së

Afati: 2020

9.3 Hartimi i një Manuali për Kontrollin Tatimor për inspektorët e tatimeve me qëllim trajtimin e OSHC-e në mënyrë të tillë që të merret parasysh specifika e sektorit

Afati: 2021

9.4 Ndryshimi i ligjit për Sponsorizimin të vitit 1995 dhe ligjeve të tjera tatimore për t'u dhënë mundësi të gjithë individëve që u dhurojnë OSHC-ve t'i zbresin këto dhurime për të inkurajuar filantropinë individuale

Afati: 2023

Trajtimi i duhur dhe i qartë fiskal i OSHC-ve është kyç për zhvillimin e tyre. Incentivat tatimore për korporatat dhe donatorët privatë janë një praktikë e përhapur në mbështetje të punës së shoqërisë civile të angazhuar për të mirën e publikut.

Katër janë fushat e identifikuar për përmirësimin e trajtimit fiskal të OSHC-ve në Shqipëri:

(i) Ndikimi negativ i kërkesës ligjore aktuale për të pasur një punonjës me kohë të plotë dhe të siguruar; (ii) trajtimi i OSHC-ve për TVSh-në; (iii) mungesa e kapaciteteve të administratës tatimore se si të zbatojnë në praktikë legjislacionin për OSHC-të; (iv) incentivat tatimore për dhurimet e OSHC-ve nga filantropë privatë si edhe strukturat e biznesit.

Kërkesa ligjore për OSHC-të që të kenë detyrimisht të regjistruar të paktën një punonjës dhe, rrjedhimisht, të paguajnë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që lidhen me pagën minimale, nuk përputhet me tipin e punës së shumë OSHC-ve, që punojnë me cikël projekti, dhe pengon zhvillimin e OSHC-ve të vogla, të sapokrijuara dhe me bazë komunitetin. Ndodh shpesh që OSHC-të të mos kenë ndonjë transaksion financiar për periudha të gjata, por gjithsesi janë aktive në ndjekje të misionit të tyre dhe përpiqen të kontribuojnë në komunitet edhe pa punësuar aktivistë/anëtarë. Duhet të ndryshojë ideja që ekziston tek autoritetet tatimore se nëse OSHC-të nuk ushtrojnë veprimtari tregtare për një periudhë mbi 12 muaj, ose nëse nuk bëjnë një deklaram tatimor për këtë periudhë, duhet të regjistrohen në regjistrin pasiv të personave të tatueshëm.

Problemi këtu është se nëse kategorizohen si “pasive”, këto organizata konsiderohen në praktikë si jofunksionale, madje edhe sikur nuk ekzistojnë. Kështu, ato nuk mund të aplikojnë për mbështetje financiare nga shteti apo grantdhënësit ndërkombëtarë për aktivitetet e tyre. Kjo e pengon rritjen e këtyre organizatave dhe të sektorit në tërësi dhe duhet të ndryshojë.

Ligji i ri për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 128, datë 13 gusht 2014) që hyri në fuqi më 1 janar 2015), mund të kishte sqaruar më mirë problematikën e TVSh-së. Megjithatë, klauzolat që lidhen me TVSh-në për OSHC-të u zhvlerësuan pothuaj menjëherë nga Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 6, datë 30.01.2015 i cili, në vend që të sqaronte procedurat e përjashtimit të OSHC-ve nga TVSh-ja (bazuar në nenin 3 të ligjit), e ktheu çështjen mbrapa në një vendim të miratuar nga Këshilli i Ministrave në 1996. Pra, një lëvizje legjislative për të zgjidhur këtë problem u bë nul brenda vetëm 30 ditësh. Kjo kontradiktë duhet zgjidhur, me qëllim që të rikthehet qartësia e synuar fillimisht me ligjin për TVSh-në të 13 gushtit 2014.

Udhëzimi (nr. 22, datë 19.11.2014, neni 7) i Ministrit të Financave rregullon se si auditohet një OSHC. Sipas këtij akti, çdo zyrë tatimore duhet të ketë inspektorë të trajnuar dhe të specializuar që auditojnë raportet financiare të OSHC-ve, duke u fokusuar në burimet financiare, aktivitetet ekonomike që ushtrojnë, burimet dhe përdorimin e fondeve, asetet, etj.

Rrjedhimisht, administrata tatimore do të hartojë një manual auditimi, vetëm për çështjet tatimore të OSHC-ve. Përmes trajnimit, administrata tatimore do të zhvillojë kapacitetet e nevojshme për të kuptuar natyrën dhe implikimet fiskale të sektorit të shoqërisë civile.

Incentiva të mjaftueshme nevojiten për dhurimet bamirëse për OSHC-të. Krijimi i mundësisë për të gjithë individët që dhurimet që iu bëjnë OSHC-ve të zbriten nga detyrimet tatimore personale të tyre, do të nxiste filantropinë individuale dhe do të kontribuonte në forcimin e qëndrueshmërisë financiare të përpjekjeve për zhvillimin e shoqërisë civile.

Bizneset shqiptare paguajnë tatim fitimi standard. Aktualisht, mund të kërkojnë kthimin e tatimit për dhurimet (klasifikuar si “sponsorizim” biznesi) për OSHC-të deri në 4% të të ardhurave të tatueshme. Për sipërmarrësit që paguajnë “tatim biznesi të vogël”, tatimi për dhurimet do të zbritet deri në 1% të të ardhurave të tatueshme.

Këto masa do të mbështesin krijimin e një mjedisi më të favorshëm për rritjen e financimeve të brendshme të sektorit të shoqërisë civile dhe do të kontribuojnë në kapërcimin e varësisë ndaj donatorëve ndërkombëtarë.

Masat e planifikuara:

Masa 9.1.

Heqja e detyrimit ligjor për OSHC-të për të pasur një punonjës me kohë të plotë të paguar dhe të siguruar.

Masa 9.1.	Heqja e detyrimit ligjor për OSHC-të për të pasur një punonjës me kohë të plotë të paguar dhe të siguruar
Institucioni kryesor përgjegjës	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Partnerë në zbatim	Kryeministria Ministria e Drejtësisë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale KKSHC AMSHC-ja
Afati	2021
Treguesit e zbatimit	1. Heqja e detyrimit ligjor
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Masa 9.2.

Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OSHC-ve në aspektin e TVSh-së

Masa 9.2	Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OSHC-ve në aspektin e TVSh-së
Institucioni kryesor përgjegjës	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Partnerë në zbatim	Kryeministria Ministria e Drejtësisë KKSHC AMSHC-ja
Afati	2020



Treguesit e zbatimit	1.Hartimi i akteve të reja nënligjore dhe harmonizimi i tyre me ligjin e ri për TVSh-në
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Jo relevante

Masa 9.3.

Hartimi i një Manuali për Kontrollin Tatimor për inspektorët tatimorë me qëllim ekskluziv trajtimin e OSHC-ve në mënyrë të tillë që të marrë parasysh specifikat e sektorit dhe bërjen e trajnimeve

Masa 9.3.	Hartimi i një Manuali për Kontrollin Tatimor për inspektorët tatimorë me qëllim ekskluziv trajtimin e OSHC-ve në mënyrë të tillë që të marrë parasysh specifikat e sektorit dhe bërjen e trajnimeve
Institucioni kryesor përgjegjës	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Partnerë Partnerë	Kryeministria Ministria e Drejtësisë AMSHC-ja Autoritetet tatimore KKSHC
Afati	2020-2021
Treguesit e zbatimit	1.Hartimi manualit 2.Hartimi i programit të trajnimit 3.Zhvillimi i trajnimit
Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	AT për përgatitjen e Termave të Referencës për manualin Nevojitet AT për hartimin e manualit për afërsisht 30 ditë Trajnimi i Drejtorive Tatimore në të gjithë vendin (30 ditë)

9.4 Ndryshimi i ligjit të vitit 1995 për Sponsorizimet dhe ligjet e tjera tatimore për t'u dhënë mundësi të gjithë individëve që të zbresin dhurimet që u bëjnë OSHC-ve me qëllim nxitjen e filantropisë individuale

Masa 9.4.	Ndryshimi i ligjit të vitit 1995 për Sponsorizimet dhe ligjet e tjera tatimore për t'u dhënë mundësi të gjithë individëve që të zbresin dhurimet që u bëjnë OSHC-vetë, me qëllim nxitjen e filantropisë individuale
Institucioni kryesor përgjegjës	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Partnerë në zbatim	Kryeministria Ministria e Drejtësisë Autoritetet tatimore AMSHC-ja KKSHC
Afati	2019-2021
Treguesit e zbatimit	1.analizë ligjore e stimujve aktualë në legjislacionin e hartuar 2.miratimi i ligjit të ndryshuar për sponsorizimet 3.Realizimi i një fushate ndërgjegjësimi për rëndësinë e zhvillimit të filantropisë individuale dhe në nivel korporatash



Komente të tjera	
Asistenca Teknike që nevojitet	Asistencë teknike për kryerjen e analizës juridike dhe propozimeve për ndryshimin e ligjit (30 ditë) AT e nevojshme për hartimin e fushatës së ndërgjegjësimit 15 ditë

Përfundim

Përmes zbatimit në kohë të masave të përcaktuara në këtë Udhërrëfyes të rishikuar 2019–2023, Qeveria e Shqipërisë do të krijojë një mjedis më se të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile në mbarë vendin dhe për avancimin e partneritetit, bashkëpunimit dhe institucionalizimit të dialogut me aktorët e shoqërisë civile në proceset e politikave dhe në drejtim të integritetit në BE.

Zbatimi i një Udhërrëfyesi të tillë kaq kompleks dhe gjithëpërfshirës kërkon ndarje përgjegjësisë, koordinim dhe marrje iniciativash nga një sërë organesh të administratës shtetërore. Në kuadrin e procesit të vazhdueshëm të reformave dhe negociatave të pritshme të anëtarësimit, objekti i punës së administratës është i gjerë dhe vetëm sa e prek shpesh bashkëpunimin dhe krijimin e parakushteve për zhvillimin e shoqërisë civile. Në këtë drejtim, në disa fusha, zbatimi i Udhërrëfyesit do të kërkojë më shumë burime njerëzore, nivel më të lartë njohurish dhe bashkëpunim konstruktiv të të gjithë aktorëve të interesuar, qeveritarë dhe joqeveritarë. Përveç kësaj, Shqipëria mund të përfitojë nga përvojat, praktikatat e mira dhe mësimet e nxjerra nga vendet e tjera në rajon që kanë kaluar sfida dhe procese të ngjashme.

Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi

Kryeministria është përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të të gjithë aktorëve të përfshirë. Do të garantohet plotësisht identifikimi i institucioneve përgjegjëse, treguesve për secilën masë, dhe një plan veprimi me afate të specifikuar, një mekanizëm monitorimi si brenda për brenda qeverisë, ashtu edhe publik, për ecurinë e procesit. Kryeministria do të organizojë një vlerësim të jashtëm afatmesëm, si dhe një vlerësim përfundimtar të këtij Udhërrëfyesi. Ajo do t'u japë mundësi vlerësuesve të kenë akses në të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Grupi ndërministror i punës si një instrument i brendshëm qeveriste do të ndjekë ecurinë dhe do të raportojë mbi progresin e arritur me zbatimin e Udhërrëfyesit.

KKSHC-ja jo vetëm që do të luajë një rol vendimtar në garantimin e mundësisë së OSHC-ve për të shprehur mendimin e tyre për zbatimin e këtij Udhërrëfyesi, duke i kanalizuar idetë dhe propozimet përmes KKSHC-së tek ministritë përkatëse dhe Kryeministrisë, por edhe do të sigurojë ndjekjen sistematike të zbatimit të masave të ndryshme.

Organet e mëposhtme do të përfshihen në monitorim, duke aplikuar këto instrumente:

Nga ana e qeverisë

1) Monitorim ndërqeveritar përmes AKSHI-t – shkëmbimit të raporteve të progresit mbi planet vjetore të punës

2) Grupi ndërministror i punës (anëtarë: të gjitha ministritë e përfshira në zbatim dhe siç përcaktohet më sipër plus Agjencia që është përgjegjëse për qëllimin e zbatimit dhe monitorimin e ecurisë së Udhërrëfyesit

3) Këshilli Kombëtar (shih më poshtë)

4) Konferenca kombëtare e anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së dhe rrjetet e tyre (shih më poshtë)

5) Informacion në faqet zyrtare përkatëse të qeverisë në raportet e tyre vjetore



Skema e monitorimit

Kush monitoron	Si: Me paketën e instrumenteve	Progresi i cilit institucion monitorohet?	Sa herë në vit?
Monitorim ndërqeveritar përmes AKSHI-t	Qarkullimi i matricës së planit të punës Nëpërmjet sistemit ekzistues online të qeverisë	Kryeministria	Raporti i hollësishëm vjetor në faqet zyrtare të AMSHC-së dhe ministrive të linjës që janë pjesë e Udhërrëfyesit Raporti periodik i progresit
Grupi ndërmnistror i punës për OSHC-të	Agjendat e takimeve dhe procesverbalet	Kryeministria	Takime periodike
Kryeministria	Përgatit raporte për Sekretarin e Përgjithshëm të Kryeministrit	Sekretari i Kryeministrit	Dy herë në vit
AMSHC-ja	Mbledh informacione të përditësuara nga Kryeministria	I raporton KKSHC-së në funksionin e saj si sekretariati teknik	
KKSHC	Agjendat e takimeve dhe procesverbalet e tyre, raporte vjetore në faqen zyrtare të AMSHC-së	Këshilli i Ministrave	Dy herë në vit
Konferenca kombëtare për anëtarët e shoqërisë civile të Këshillit dhe rrjeteve të tyre	Agjendat e konferencave dhe procesverbalet për qarkullim të jashtëm (në faqen zyrtare të AMSHC-së)	AMSHC-ja (financon eventin)	Një herë në vit
Informacion në faqet zyrtare të institucioneve qeveritare në raportet e tyre vjetore (ose një herë në dy vjet)	Çdo vit në faqet zyrtare të ministrive të linjës Plus raporti i Kryeministrit	Kryeministria	Një herë në vit

Monitorimi nga Shoqëria Civile

Përmes faqes zyrtare të AMSHC-së do të krijohet një mundësi në fund të çdo viti për të mbledhur opinione dhe kontribute nga shoqëria civile – kjo do të bëhet për të siguruar përfshirjen në shkallë vendi të OSHC-ve në monitorimin e Udhërrëfyesit. Kështu, Agjencia mund të përfitojë nga përvoja e fituar gjatë rishikimit të Udhërrëfyesit të vitit 2015 me mbështetjen e ekipit të Asistencës në zhvillimin e konsultimeve në grupe, si dhe sondazhin online.

AMSHC-ja duhet të raportojë mbi rezultatet në takimin e parë të vitit pasardhës të KKSHC-së.

AMSHC-ja do t'i referohet sistematikisht në njoftimet e saj procesit të zbatimit të Udhërrëfyesit.

Përveç kësaj dhe bazuar në rezultatet e monitorimit, do të bëhet edhe një vlerësim afatmesëm dhe një vlerësim përfundimtar me mbështetje teknike edhe me kontributin e shoqërisë civile.

Qeveria ka marrë përsipër detyrimin e sigurimit të mbështetjes financiare të Udhërrëfyesit, duke përfshirë edhe financimin vendas dhe atë ndërkombëtar. Përditësimet e përvitshme të progresit të Planit të Veprimit të Udhërrëfyesit 2019–2023, si dhe vlerësimi përfundimtar, janë shumë të rëndësishme për procesin e zbatimit.

Dokumenti që do të pasojë Udhërrëfyesin në vitin 2024 do të mbështetet në një debat dhe konsultime publike sistematike me të gjithë aktorët e shoqërisë civile si pjesë e procesit gjithëpërfshirës të prodhimit të dokumenteve të tjera të ardhshme, si një strategji kombëtare apo çdo kuadër tjetër strategjik dhe siç kërkohet nga ligji për njoftimin dhe konsultimin publik për krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile ë Shqipëri në vitin 2023, bazuar në rezultatet e vlerësimit të vitit 2022.

Nevojat e shoqërisë civile ndryshojnë me kalimin e kohës dhe me siguri do të shfaqen sfida të reja. Qeveria shqiptare do të punojë ngushtësisht dhe në partneritet me sektorin e



shoqërisë civile, si dhe me partnerë të tjerë për zhvillim me qëllim përshtatjen ndaj ndryshimeve që mund të ndodhin.

Të gjitha që u përmendën më sipër, i referojnë supozimet e mëposhtme të rëndësishme për marrjen e masave për risqet e mundshme, përfshirë:

1. Qeveria dhe të gjitha ministratë përkatëse të linjës do të kenë vullnetin që të çojnë përpara Udhërrëfyesin brenda afateve të vendosura.

2. KKSHC-ja do të jetë funksionale dhe mund të marrë përsipër rolin e saj të monitorimit të zbatimit të Udhërrëfyesit.

3. Anëtarët e KKSHC-së do të kenë vullnetin të monitorojnë ecurinë e Udhërrëfyesit dhe të marrin pjesë në proceset e debateve publike ofruar nga qeveria

4. Do të ekzistojë një vullnet i përgjithshëm politik për sigurimin e një mjedisi të favorshëm për OSHC-të me zbatimin e masave të përcaktuara dhe të miratuara në Udhërrëfyesin 2019–2023

Shtojca 1 Organet qeveritare të përfshira në mekanizmin institucional OSHC – qeveri

Informacioni i mëposhtëm është një përshkrim i detajuar i çdo mekanizmi institucional dhe informacione bazë mbi vizionin, misionin, objektivat dhe lidhjet me adresat e strukturave të tjera të propozuara, si dhe hapat kryesorë që duhen ndërmarrë për të çuar në përmbushjen e objektivave, shoqëruar me fushat e mundshme për asistencë teknike që mund të duhet në të ardhmen mund të gjendet në Shtojcën 1.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile

Instrumenti kryesor për dialog dhe konsultim mes Qeverisë së Shqipërisë dhe shoqërisë civile është Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile. ligji “Për ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” (nr. 119/2015) mbi bazën e të cilit u ngrit Këshilli u miratua në nëntor të vitit 2015. ligji ka tri synime kryesore:

- Krijimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile për të garantuar bashkëpunimin institucional me organizatat e shoqërisë civile në Republikën e Shqipërisë, në favor të zgjerimit të demokracisë, forcimit të mirëqeverisjes, rritjes së transparencës në vendimmarrjen publike nëpërmjet përfshirjes më të mirë të shoqërisë civile në këtë proces.

- Zhvillimin e bashkëpunimit institucional me organizatat e shoqërisë civile për hartimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare dhe Udhërrëfyesit të Qeverisë shqiptare për krijimin e një kuadri mundësues për sektorin e shoqërisë civile dhe marrëdhënieve ndërsektoriale të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile dhe për zhvillimin e filantropisë dhe kapitalit social.

- Përcaktimin e parimeve dhe procedurave sipas të cilave drejtohet dhe zhvillohet procesi i dialogut dhe konsultimit në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile

Ligji e përcakton KKSHC-në si strukturë kolegjiale të pavarur këshillimore pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që funksionon për të përmbushur tre qëllimet e renditura më lart. ligji parashikon se mbledhjet e KKSHC-së zhvillohen në mjediset e Kryeministrit dhe se KKSHC-ja ndihmohet nga AMSHC-ja që kryen funksione administrative dhe mbështetëse për KKSHC-në.

KKSHC përbëhet nga 27 anëtarë, 13 prej të cilëve janë përfaqësues të institucioneve publike, 13 përfaqësues të OSHC-ve dhe një përfaqësues i komunitetit të biznesit, anëtar i Këshillit Ekonomik Kombëtar.

Mandati i përfaqësuesve të institucioneve publike dhe përfaqësuesve të Këshillit Ekonomik Kombëtar në KKSHC shoqërohet me kohën gjatë të cilës ushtrojnë detyrën publike përkatëse, prej të cilës janë emëruar anëtarë të KKSHC-së.

OSHC-të përzgjedhin katër përfaqësues për secilin sektor më poshtë:

- Demokratizimi, shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE;

- Zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor;

- Mirëqenia, shërbimet sociale, mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës.

Detyrat e KKSHC-së janë:

- Këshillon Këshillin e Ministrave për përcaktimin e politikave shtetërore për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile.

2. I propozon Këshillit të Ministrave programet kryesore për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe përfshirjen e këtij sektori në problematika që lidhen me kryerjen e reformave në fushën ekonomike, sociale, integrimin evropian, respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe forcimin



e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në vend.

3. Këshillon Këshillin e Ministrave për përmirësime legjislative që ndikojnë zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrjen publike.

4. Jep rekomandime për politikat publike që lidhen apo ndikojnë në veprimtarinë dhe zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfshirjen e tyre në bashkëpunimin ndërsektorial.

5. Jep mendime, për Këshillin e Ministrave dhe AMSHC-në, për planifikimin e prioriteteve lidhur me shpërndarjen e fondeve publike, në mbështetje të programeve e projekteve të organizatave të shoqërisë civile, si dhe për analizën e raporteve vjetore të ministrive dhe agjencive të tjera qeveritare për projektet dhe programet e financuara.

6. I jep mendime Këshillit të Ministrave për përcaktimin e prioriteteve, në lidhje me fondet e Bashkimit Evropian apo institucioneve të tjera ndërkombëtare për Shqipërinë, që ndikojnë zhvillimin e shoqërisë civile.

Këshilli e mbajti mbledhjen e parë zyrtarë në shkurt 2017. Mbledhja e dytë u mbajt në dhjetor 2017, ku u zgjodh zv.Kryetari i Këshillit dhe u miratuan rregulloret e brendshme për funksionimin e Këshillit. Mbledhja e tretë në mars 2019 çoi në miratimin e planit vjetor të punës 2019 dhe ngritjen e grupeve të punës të regjistrimit të OSHC-ve, financimin publik, tatimet dhe ndërmarrjet sociale.

Ministritë shqiptare u reformuan pas zgjedhjeve të qershorit 2017, prandaj edhe struktura e anëtarësisë ka ndryshuar. Këshilli tani kryesohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

AMSHC-ja është agjenci shtetërore e rregulluar me ligjin nr. 10093/2009. Këshilli i Ministrave cakton organin drejtues, bordi mbikëqyrës. Me ligj, bordi përbëhet nga katër anëtarë të institucioneve shtetërore në administratën publike qendrore dhe pesë përfaqësues nga shoqëria civile, duke respektuar parimin e barazisë gjinore.

Një nga funksionet e saj kryesore është shpërndarja e granteve OSHC-ve në bazë të thirrjeve kombëtare për propozime. Drejtohet

nga bordi drejtues ku anëtarë janë si zyrtarë shtetërorë, edhe përfaqësues të shoqërisë civile. Që nga fundi i 2017-s, Agjencia po e rrit aktivitetin e vet si sekretariat i KKSHC-së. Do të sigurojë urgjentisht personel dhe buxhet vjetor nga 2019 për të përmbushur këtë rol si sekretariat mbështetës për KKSHC-së.

Financimi për grante vjen nga buxheti shtetëror vjetor. ligji specifikon se Shteti nuk mund t'i akordojë buxhet më të vogël Agjencisë sesa buxheti që i është dhënë vitin pararendës. Gjithashtu, buxheti shtetëror mbulon shpenzimet administrative të Agjencisë nga një linjë buxheti e veçantë dhe Shteti i siguron ambientet për ushtrimin e aktivitetit.

Në periudhën 2010-2017, Agjencia ka siguruar mbështetje me grante për 418 projekte, me një total prej 724,738,840 ALL (rreth 5,4 milionë EUR).

Strategjia 2015–2021 është miratuar dhe aktualisht po zbatohet. Vizioni i AMSHC-së është të kontribuojë në krijimin e një shoqërie civile aktive në Shqipëri. Misioni është ai që parashikohet në ligj, d.m.th. të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nismat qytetare për të mirën dhe në interes të publikut. ligji parashikon edhe që, në ushtrimin e detyrës së vet, AMSHC-ja udhëhiqet nga prioritetet strategjike të qeverisë për zhvillimin e shoqërisë civile.

Objektivat e AMSHC-së, janë:

- nxitja e zhvillimit të vullnetarizmit dhe e pjesëmarrjes së qytetarëve në zhvillimin e komunitetit;

- promovimi dhe forcimi i kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së OSHC-ve;

- krijimi i partneriteteve dhe bashkëpunimit ndërsektorial mes OSHC-ve;

- rritja e vizibilitetit dhe influencës publike të OSHC-ve;

- zhvillimi i ndërmarrjeve sociale dhe punësimit në OSHC;

- rritja e ndikimit të shoqërisë civile në formulim politikash dhe vendimmarrje;

- nxitja e bashkëpunimi me OSHC-të, që kanë rol në luftën kundër korrupsionit, trafikimit të personave, trajtimin e viktimave të trafikimit, si edhe dhunës në familje

OSHC-të konfirmojnë pritshmëritë e larta kundrejt Agjencisë si mekanizëm qendror për



financim publik të programeve të OSHC-ve në Shqipëri, si edhe në lidhje me funksionon e saj si njësi mbështetëse për OSHC-të. Agjencia duhet të veprojë edhe si ndërmjetëse mes shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore.

Në vitin 2016, Bordi i Agjencisë miratoi rregullat dhe procedurat për grantet. Agjencia ka organizuar seanca konsultimi në grupe në disa pjesë të vendit, para shpalljes së thirrjeve. Njëkohësisht, ka kritika të vazhdueshme në lidhje me transparencën dhe aksesin në fonde që jep Agjencia, që lindin edhe nga buxheti i kufizuar për grantdhënie.

Seancat informuese dhe konsultuese synojnë kryesisht të mbledhin idetë e OSHC-ve lokale në lidhje me formulimin e thirrjes për projekt-propozime; ato do të përmirësohen në konceptim dhe zbatim. Seancat do të shfrytëzohen për dhënie informacioni për lajmet më të fundit qeveritare në lidhje me shoqërinë civile dhe qytetarinë aktive.

Diskutimi me pjesëmarrësit e OSHC-ve gjatë seancave do të udhëhiqet nga objektivat kombëtarë strategjikë, dhe rezultatet e projekteve të financuara do të lidhen me nevojat komunitare vendore bazuar në evidenca, ose me probleme të gjera kombëtare.

Në menaxhimin dhe monitorimin e projekteve të financuara nga Agjencia, do të futet metoda e orientuar drejt rezultateve.

Që nga viti 2017, Agjencia po e rrit aktivitetin si Sekretariat i KKSHC-së. Do të sigurojë urgjentisht personel dhe buxhet vjetor që nga 2019 për të përmbushur këtë rol si sekretariat mbështetës i KKSHC-së.

Ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e masave në fushat specifike të Udhërrëfyesit

Ministritë e linjës luajnë rol të rëndësishëm në zbatimin e Udhërrëfyesit. Koordinim i mirë brenda ministrive, por edhe me sektorin e

shoqërisë civile është i nevojshëm. Sipas mundësive, do të në ministri dhe organe të tjera shtetërore do të caktohen koordinatorë për bashkëpunimin me OSHC-të, sidomos në ministrinë që punojnë intensivisht me OSHC-të si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Drejtësisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Procesi i caktimit të koordinatorëve për konsultime publike në të gjitha organet publike është parashikuar me ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe procesi ka filluar tashmë. Kështu, Kryeministria dhe nëntë ministri kanë publikuar detajet e kontaktit të koordinatorëve të tyre për të drejtën e informimit, duke ndërthurur pjesërisht detyrën e Koordinatorit për Shoqërinë Civile me atë të Koordinatorëve për Konsultimin Publik.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile janë komplementarë dhe nuk zëvendësojnë dialogun sistematik dhe të hapur mes të gjitha organeve publike me OSHC-të dhe qytetarët në kryerjen e detyrave të përditshme në përmbushje të qëllimeve strategjike brenda fushës së tyre. Dialogu kuptimplotë mes ministrive / agjencive shtetërore dhe shoqërisë civile do të garantohet. Përfshirja e OSHC-ve në proceset vendimmarrëse në të gjithë sektorët është një mjet i shkëlqyer për qeverisjen e mirë dhe menaxhimin e politikave publike, që do të mbështetet nga koordinatorët e emëruar nga fundi i vitit 2020. Prandaj, është thelbësore që të garantohet emërimi nga të gjitha organet publike me rëndësi strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile i një personi kontakti për bashkëpunimin me OSHC-të, ku fusha e komunikimit dhe bashkëpunimit në zbatimin e politikave specifike ose në dhënien e shërbimeve sociale është më e gjerë.



SHTOJCA: PLANI I VEPRIMIT TË UDHËRRËFYESIT

Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner në zbatim/institucion	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
Drejtimi strategjik 1: Institucionalizimi i bashkëpunimit qeveri - shoqëri civile për bashkëpunim në hartimin e politikave dhe integritimit në BE												
Prioriteti 1: Krijimi dhe mirëmbajtja e një politike strategjike mbarëkombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile: Masat 1.1.-1.5												
Pasqyrimi i planifikimit dhe zbatimit të duhur të masave nga çdo ministri/institucion përgjegjës në planet vjetore të punës	1.1	Planifikimi dhe zbatimi i duhur i Udhërrëfyesit sipas planeve të tyre tremujore dhe vjetore			122,220	67	33					
	1.1.1	Nxiti dhe diskutimi i Udhërrëfyesit 2019–2023 me ministrinë e linjës dhe Urdhrit nr. 71, datë 22.5.2017 për të siguruar autorësisë e të gjitha ministrave përgjegjëse mbi procesin	Kryeministria	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) Kryesuese e KKSHC-së Ministria e Brendshme (MB)	720	100	0	1.Miratimi i versionit përfundimtar të Udhërrëfyesit 2019–2023 nga Këshilli i Ministrave në mes të vitit 2019, përfshirë buxhetin total dhe strategjinë e komunikimit	2019			
	1.1.2	Marrja e masave që çdo ministri e përfshirë të ngarkojë një njësi/staf për zbatimin e masave të identifikuar	Kryeministria	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme (MEPJ) Ministria e Kulturës (MK)	6,000	100	0	2.Pasqyrimi i një buxheti realist në buxhetin vjetor të shtetit shqiptar dhe atë të partnerëve të ndryshëm për zhvillim nga viti 2020 e në vazhdim	2019	2020	2021	
	1.1.3	Garantimi i angazhimit të vazhdueshëm për zbatim të grupit ndërmënor të punës, përfshirë të gjitha ministrinë e linjës	Kryeministria	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, (MASR) Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE),	72,000	100	0	3. Pasqyrimi i veprimeve dhe aktiviteteve përkatëse në planet e punës së ministrave përgjegjëse	2019	2020	2021	
	1.1.4	Sigurimi i transparencës publike të procesit me anë të instrumenteve publike të AMSHC-së dhe Qeverisë	Kryeministria	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) Këshilli Kombëtar për	3,500	100	0	4.Publikimi i raporteve vjetore mbi ecurinë e zbatimit në faqet zyrtare të ministrave dhe mbi përfshirjen e OSHC-ve në vlerësimet afatmesme dhe përfundimtare	2019	2020	2021	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
	1.1.5	Sigurimi i fondeve të nevojshme në buxhetin e shtetit dhe në buxhetin e ministrive të linjës / bashkësisë ndërkombëtare për zbatimin e përgjithshëm të Udhërrëfyesit		Shoqëri Civile (KKSHC) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) Agjencia për Dialog dhe Bashkëpunim-Qeverisjes (ADB) Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ShAP)				5.Vënia në dispozicion të publikut e raporteve mbi përfshirjen e OSHC-ve në vlerësim përmes AMSHC-së	2020	2021		
Sigurimi i bashkëpunimit aktiv me OSHC-të, përmes KKSHC-të gjatë zbatimit të Udhërrëfyesit përmes një dialogu të plotë dhe gjithëpërfshirës me sektorin në takimet përkatëse të KKSHC-së.	1.2	Garantimi i përfshirjes aktive të OSHC-ve në ecurinë e Udhërrëfyesit përmes një dialogu gjithëpërfshirës me këtë sektor.			167,100	100	0					
	1.2.1	Marrja e masave nga Kryeministria përmes përfaqësimit të saj në AMSHC që kjo e fundit të përmbushë plotësisht rolin e saj si sekretariati i KKSHC-së	AMSHC	KKSHC-ja dhe AMSHC-ja në funksionin e saj si Sekretariati i KKSHC-së Të gjitha ministratë përgjegjëse	123,900	100	0	1.Numri i konsulentëve/temave të konsultimeve të kryera sipas strategjisë së komunikimit dhe numri i pjesëmarrësve	2019	2020	2021	
	1.2.2	Marrja e masave nga Kryeministria që raportet e ministrave të linjës mbi ecurinë e zbatimit të Udhërrëfyesit t'u vihen në dispozicion OSHC-ve	AMSHC	KKSHC dhe AMSHC në funksionin e saj si sekretariat i KKSHC-së Të gjitha ministratë e linjës përgjegjëse	43,200	100	0	2. Numri i komenteve dhe këshillave të OSHC-ve në faqen zyrtare të AMSHC-së	2019	2020	2021	
	1.2.3	Organizimi i debateve dhe konsultimeve publike sipas planit të komunikimit	AMSHC	KKSHC dhe AMSHC në funksionin e saj si sekretariat i KKSHC-së Të gjitha ministratë e linjës përgjegjëse	Mbuluar nën pikën 1.2.1			3. Numri i mbulimeve në media (sociale) pasqyruar në raportin vjetor të AMSHC-së	2019	2020	2021	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
	1.2.4	Sigurimi i mbulimit mediatic	AMSHC	KKSHC dhe AMSHC (Sekretariati i KKSHC) Të gjitha ministratë e linjës përgjegjëse	në pikën 1.2.1			4. Numri i mbulimeve mediatike Pasqyruar në raportet vjetore të AMSHC-së 5. Numri i çështjeve të adresuara nga ministratë e linjës ose institucione të tjera qeveritare	2019	2020	2021	
Ngritja e një mekanizmi të brendshëm për ndjekjen e ecurisë së Udhërrëfyesit përmes Instrumenteve të Menaxhimit të Projekteve	1.3	Ngritja e një mekanizmi të brendshëm për ndjekjen e ecurisë së Udhërrëfyesit përmes Instrumenteve të Menaxhimit të Projekteve			14,880	100	0					
	1.3.1	Shndërrimi i matricës së Udhërrëfyesit në një dokument që përdoret për ndjekjen e brendshme online të ecurisë nga AKSHI	Kryeministria	AKSHI Grupi ndërmintor i punës AMSHC	480	100	0	1. Krijimi i sistemit të brendshëm të ndjekjes së ecurisë së Udhërrëfyesit nga AKSHI	2019			
	1.3.2	Marrja e masave për raportimin në kohë mbi ecurinë e Udhërrëfyesit nga të gjithë ministratë e linjës	Kryeministria	AKSHI, Grupi ndërmintor i punës AMSHC	14,400	100	0	2. Përdorimi sistematik i sistemit dhe përditësimi i ecurisë nga ministratë e linjës dhe institucionet përgjegjëse	2019	2020	2021	
Mundësimi i identifikimit të OSHC-ve në Portalin e Qeverisë për Komunikimin me Publikun	1.4	Mundësimi i identifikimit të OSHC-ve në Portalin e Qeverisë për Komunikimin me Publikun	AKSHI			100	0	1. Mundësimi i identifikimit të OSHC-ve në Portalin e Qeverisë për Komunikimin me Publikun	2019			
Bazuar në arritjet e Udhërrëfyesit 2019–2023, pasqyruar në raportin e rishikimit afatmesëm dhe raportin përfundimtar të vlerësimit, do të hartohet një Strategji Kombëtare ose	1.5	Hartimi i Strategjisë Kombëtare/Udhërrëfyesit 2024-2028 për mbështetjen e OSHC-ve			82,240	15	85					
	1.5.1	Kryerja e vlerësimit të Udhërrëfyesit në vitin 2021 dhe 2023	Kryeministria	ministratë e linjës KKSHC, AMSHC	49,800	5	95	1. Vlerësimet afatmesme dhe vlerësimi përfundimtar			2021	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
Udhërrëfyes (2024-2028)	1.5.2	Përdorimi i rezultatit të vlerësimit për të filluar hartimin e Strategjisë Kombëtare/Udhërrëfyesit në fillim të vitit 2024	Kryeministria	ministrinë e linjës KKSHC, AMSHC	1,440	0	95	2. Publikimi në shkallë të gjerë të rezultateve të vlerësimit në faqen e Kryeministrit dhe të Agjencisë				
	1.5.3	Hartimi dhe miratimi i një Strategjie Kombëtare ose një Udhërrëfyesi të ri për mbështetjen e OSHC-ve	Kryeministria	ministrinë e linjës KKSHC, AMSHC	31,000	100	0	3. Përcaktimi i metodologjisë për hartimin e Udhërrëfyesit të ri/Strategjisë Kombëtare në fund të vitit 2023				
Prioriteti 2: Institucione qeveritare me mendësi shërbimi që vlerësojnë bashkëpunimin me OSHC-të: Masat 2.1-2.9												
Garantimi i funksionimit eficient të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile në përputhje me planin e tij të punës dhe me angazhimet e qeverisë	2.1	Garantimi i funksionimit eficient të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile në përputhje me planin e tij të punës dhe me angazhimet e qeverisë			108,000	72	28			2020	2021	
	2.1.1	Rishikimi i ligjit për KKSHC-në për pasqyrimin e ndryshimeve në administratën publike	AMSHC	Kryeministria MSHMS (Kryesuese e Këshillit)	6,000	100	0	1. Rishikimi i ligjit të KKSHC-së për të pasqyruar ndryshimet në administratën publike	2019	2020	2021	
	2.1.2	Sigurimi i fondeve për planin e punës së KKSHC-së	AMSHC	Kryeministria MSHMS (Kryesuese e Këshillit)				2. Respektimi i plotë i ligjit dhe akteve nënligjore për KKSHC-në	2019	2020	2021	
	2.1.3	Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë të qeverisë në aktivitetet e KKSHC-së 3 herë në vit plus në grupet e punës	AMSHC	Kryeministria MSHMS (Kryesuese e Këshillit)	72,000	100	0	3. Ndjekja e planit të punës së KKSHC-së siç reflektohet në procesverbalet e takimeve të publikuara në faqen e AMSHC-se. Financimi i planit çdo vit	2019	2020	2021	
	2.1.4	Sigurimi i AT-së për zhvillimin e kapaciteteve të Këshillit			30,000	0	100	4. Mbështetja e përfshirjes së OSHC-ve në proceset politikëbërëse në të gjithë sektorët	2019	2020		



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
Garantimi i mbështetjes administrative eficiente për Këshillin, përfshirë cilësinë përgatitjes për të gjitha aktivitetet dhe sigurimi i ndjekjes siç duhet të të gjitha takimeve dhe aktivitetëve të Këshillit	2.2	Garantimi i mbështetjes administrative eficiente për Këshillin, përfshirë cilësinë përgatitjes për të gjitha aktivitetet dhe sigurimi i ndjekjes siç duhet të të gjitha takimeve dhe aktivitetëve të Këshillit.			163,900	82	18	1. Mbështetja e ofruar nga AMSHC-ja në përputhje me "Manualin e Mbështetjes së KKSHC-së"	2019	2020	2021	
	2.2.1	Hartimi i "Manualit të KKSHC-së për Masat Mbështetëse" për përdorim midis KKSHC-së dhe AMSHC-së	AMSHC	MSHMS si Kryesuese Kryeministria	30,000	0	100	2. Pajisja e AMSHC-së me të gjitha burimet e nevojshme	2019	2020	2021	
	2.2.2	Marrja e masave për plotësimin me staf të AMSHC-së	AMSHC	MSHMS si Kryesuese Kryeministria	123,900	100	0	3. Plotësimi me staf i Agjencisë	2019	2020	2021	
	2.2.3	Pajisja e AMSHC-së me burimet e nevojshme për mbështetjen e KKSHC-së	AMSHC	MSHMS si Kryesuese Kryeministria	10,000	100	0	4. Bërja publike e personave të kontaktit dhe orarit të punës së AMSHC-së që mbështesin Këshillin	2019	2020	2021	
Hartimi nga AMSHC-ja i një manuali për mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve të anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së bazuar në mbështetjen e mëparshme ofruar nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve dhe organizimi i zgjedhjeve	2.3	Hartimi nga AMSHC-ja i një manuali për mënyrën e zhvillimit të zgjedhjeve të anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së bazuar në mbështetjen e mëparshme ofruar nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve dhe organizimi i zgjedhjeve				100	0			2020		
	2.3.1	Hartimi i "Manualit të KKSHC-së për Zgjedhjet" për përdorim nga AMSHC-ja	AMSHC	MSHMS si Kryesuese Kryeministria		kosto stafi		1 Hartimi i "Manualit të Zgjedhjeve të KKSHC-së" në nëntor 2019, organizimi i zgjedhjeve të 2019-s në përputhje me të		2020	2021	
	2.3.2	Organizimi i zgjedhjeve sipas ligjit		MSHMS si Kryesuese Kryeministria		kosto stafi		Pjesëmarrja e madhe mbarëkombëtare falë komunikimit të mirë, proaktiv dhe gjithëpërfshirës dhe transparencës së lartë (të paktën 2/3 e OSHC-ve në bazën e të dhënave të AMSHC-së (aktualisht 581 gjithsej)	2019			



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
Përfshirja e KSHC-së si organ këshillimor në të gjitha nismat dhe programet e zhvillimit të shoqërisë civile	2.4	Përfshirja e KSHC-së si organ këshillimor në të gjitha nismat dhe programet e zhvillimit të shoqërisë civile			15,600	100	0	1. Konsultimi i të gjitha nismave dhe programeve të shoqërisë civile me KSHC-në				
	2.4.1	Monitorimi i të gjitha nismave që lidhen me shoqërinë civile	Kryeministria/AMSHC	Ministritë e linjës/AMSHC	12,000	100	0	2. Konsultimi i të gjithë legjislatorit që lidhet me anëtarësimin në BE me KSHC-në	2019	2020	2021	
	2.4.2	Përfshirja e KSHC-së në të gjitha nismat e mësipërme	Kryeministria/AMSHC	Ministritë e linjës AMSHC	3,600	100	0					
Përditësimi dhe zbatimi i strategjisë dhe planeve vjetore të punës së Agjencisë për periudhën 2015–2021 për arritjen e objektivave kryesore, përfshirë përmbytjen e rolit të saj si sekretariat i KSHC-së.	2.5	Përditësimi dhe zbatimi i strategjisë dhe planeve vjetore të punës së Agjencisë për periudhën 2015–2021 për arritjen e objektivave kryesore, përfshirë përmbytjen e rolit të saj si sekretariat i KSHC-së.				100	0	1.Përditësimi i strategjisë në vitin 2019, përfshirë funksionin si sekretariat i KSHC-së				
	2.5.1	Përfshirja aktive si e bordit ashtu edhe e stafit në rishikimin dhe zbatimin e strategjisë së përditësuar	AMSHC			kosto stafi		2. Pasqyrimi në raportin vjetor të vitit 2020 i zbatimit të strategjisë së rishikuar	2019	2020	2021	
	2.5.2	Ofrimi nga Agjencia i shërbimeve për të cilat është rënë dakord në kohë KSHC-së	AMSHC			kosto stafi						
Hartimi dhe zbatimi i një plani komunikimi, informimi dhe shtrirjeje të AMSHC-së, në mënyrë që ajo të mund t'i përgjigjet kërkesës në rritje për informim dhe mbështetje nga OSHC-të lokale	2.6	Hartimi dhe zbatimi i një plani komunikimi, informimi dhe shtrirjeje të AMSHC-së, në mënyrë që ajo të mund t'i përgjigjet kërkesës në rritje për informim dhe mbështetje nga OSHC-të lokale				100	0	1.Publikimi dhe zbatimi i planit të komunikimit 2.Bërja e thirrjeve të rishikuara dhe në kohën e duhur për sesione informimi të aplikantëve që mund të jenë të interesuar për të paraqitur propozime 3.Futja e një seksioni në raportin vjetor për përmirësimin e komunikimit, informimit dhe angazhimit				
	2.6.1	Zbatimi i planit të komunikimit dhe shtrirjes	AMSHC			kosto stafi			2019	2020	2021	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirëvlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
	2.6.2	Përmirësimi i bazës së të dhënave	AMSHC			kosto stafi		4.Evidenca të përmirësimit të dizajnit të faqes zyrtare dhe bazës së të dhënave 5.Nr. i takimeve ku diskutohen prioritetet e Udhërrëfyesit në nivel lokal				
Vazhdimi i asistencës teknike për AMSHC-në për të zhvilluar më tej kapacitetet në fushat prioritare të planit të rishikuar strategjik të organizatës	2.7	Vazhdimi i asistencës teknike për AMSHC-në për të zhvilluar më tej kapacitetet në fushat prioritare të planit të rishikuar strategjik të organizatës				100	0	1. Stafi i trajnuar në fushat kryesore të strategjisë së rishikuar	2019	2020	2021	
	2.7.1	Identifikimi i kapaciteteve të stafit sa u takon aftësive që kërkohen	AMSHC			kosto stafi		2. Përmirësimi i ndjeshëm i komunikimit të AMSHC-së me OSHC-të në nivel lokal dhe kombëtar	2019	2020	2021	
	2.7.2.	Puna proaktive për përmirësimin e imazhit të Agjencisëbrendapërbrenda sektorit	AMSHC			kosto stafi		3Menaxhimi dhe monitorimi i projekteve me bazë rezultatet vërtetuar nga një kampion projektsh të financuara				
	2.7.3	Futja e njësisë për menaxhimin dhe monitorimin e projekteve duke pasur në qendër rezultatet, sidhe futja e një matrice (logframe) të thjeshtuar në skemën e granteve	AMSHC			kosto stafi		4. Trajnimi i aplikantëve potencialë për përdorimin e metodës së matricave (logframe) 5. Raporte vjetore për produktet dhe rezultatet e përzgjedhjes së granteve	2019	2020	2021	
Përcaktimi i detyrave konkrete të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në funksionin e saj mbështetës për zbatimin dhe monitorimin e ecuresë	2.8	Përcaktimi i detyrave konkrete të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në funksionin e saj mbështetës për zbatimin dhe monitorimin e ecuresë				100	0					
	2.8.1	Instruktimi i Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje me detyra të qarta	Kryeministr ia	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje		kosto stafi		1.Lista e detyrave të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje	2019			



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
Udhërrëfyesit	2.8.2	Organizimi i një bashkëpunimi të ngushtë me Agjencinë	Kryeministria	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje		kosto stafi		2. Raportet sistematike të Agjencisë për Kryeministrinë për vitin 2020.	2019	2020	2021	
	2.8.3	Sigurimi i një bashkëpunimi të ngushtë me pikat fokale të OSHC-ve/koordinatorët në ministri	Kryeministria	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje		kosto stafi				2020	2020	
2.9. Caktimi i personave të kontaktit për OSHC-të në ministrinë me rëndësi strategjike për bashkëpunimin me OSHC-të	2.9	Caktimi i personave të kontaktit për OSHC-të në ministrinë me rëndësi strategjike për bashkëpunimin me OSHC-të			27,120	100	0					
	2.9.1	Instruktimi nga Kryeministria i të gjitha ministrave të përfshira për caktimin e një pike kontakti me OSHC-të duke filluar nga viti 2020	Kryeministria	Ministritë përfaqësuar në Këshill	23,040	100	0	1. Caktimi i të gjithë koordinatorëve dhe pasqyrimi i rolit të tyre në përshkrimet e punës		2020	2021	
	2.9.2	Hartimi i listës së detyrave të koordinatorëve të OSHC-ve	Kryeministria	Ministritë përfaqësuar në Këshill	480	100	0	2. Vendosja e informacionit të kontaktit në faqet zyrtare të të gjitha ministrave		2020	2021	
	2.9.3	Parashikimi i një zëri përkatës çdo vit në buletinet e ministrave të linjës		Ministritë përfaqësuar në Këshill				3. Integrimi i raporteve të secilit koordinator në raportin vjetor të progresit		2020	2021	
	2.9.4	Organizimi nga Kryeministria e takimeve sistematike të të gjithë koordinatorëve plus Agjencisë dhe përdorimi i informacionit për formulimin e politikave të mëtejshme kur është e mundur	Kryeministria	Ministritë përfaqësuar në Këshill	3,600	100	0	4. Takime një herë në dy vjet të koordinatorëve me Kryeministrinë/AMSHC-në dhe KSHC-në	2019	2020	2021	
Prioriteti 3: Përfshirja e qëndrueshme dhe efiçente e OSHC-ve në procesin e politikëbërjes												
Garantimi i zbatimit efikas të ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin përmes ndërgjegjësimin në nivel lokal dhe kombëtar dhe përfshirjes sistematike të	3.1	Garantimi i zbatimit efikas të ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin përmes ndërgjegjësimin në nivel lokal dhe kombëtar dhe përfshirjes sistematike të				100	0		2019			
	3.1.2	Zbatimi i ligjit 146/2014 në tërësinë e vet	Kryeministria/AKSHI	MD ADACG të gjitha ministratë		Kosto stafi		1. Numri i OSHC-ve që marrin pjesë aktivisht dhe që japin kontribute me shkrim	2019			



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
OSHC-ve	3.1.2	Publikimi i të dhënave për kontributin e OSHC-ve në konsultime	Kryeministria/AKSHI	MD ADACG të gjitha ministrisë		kosto stafi		2. Numri i nismave ligjore influencuar nga OSHC-të publikuar dhe paraqitur në raportin mbi ligjin e Njoftimeve Publike	2019	2020	2021	
Përshtatja e regjistrit elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike për të përfshirë OSHC-të si një kategori më vete kontribuuesish	3.2	Përshtatja e regjistrit elektronik të njoftimeve dhe konsultimeve publike për të përfshirë OSHC-të si një kategori më vete kontribuuesish				100	0	1. Amendimi i regjistrit elektronik	2019			
	3.2.1	Amendimi i regjistrit elektronik	AKSHI dhe Kryeministria	të gjitha ministrisë		kosto stafi		2. Numri i OSHC-ve që e përdorin regjistrin	2019	2020	2021	
	3.2.2	Kryerja e vlerësimit vjetor të përdorimit të regjistrit	AKSHI dhe Kryeministria	të gjitha ministrisë		kosto stafi				2020	2021	
	3.2.3	Publikimi i të dhënave mbi përdorimin nga OSHC-të të regjistrit elektronik	AKSHI dhe Kryeministria	të gjitha ministrisë		kosto stafi				2020	2021	
Zhvillimi i një metodologjie për raportimin vjetor mbi rezultatet e konsultimeve publike dhe për bërjen e transparencës së vendimmarrjes	3.3	Zhvillimi i një metodologjie për raportimin vjetor mbi rezultatet e konsultimeve publike dhe për bërjen e transparencës së vendimmarrjes				100	0	1. Konsultimi i metodologjisë me OSHC-të 2.. Përgatitja dhe dërgimi i metodologjisë të gjitha ministrive 3. Aplikimi i metodologjisë në konsultimet në vazhdim 4. Publikimi i raporteve vjetore sipas metodologjisë		2020		
	3.3.1	Hartimi i udhëzimeve për raportimin vjetor, duke përfshirë në këtë proces OSHC-të	Kryeministria	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dhe Departamenti për Rregullime Ligjore dhe Përputhshmërinë All ministrisë e linjës		kosto stafi				2020		
	3.3.2	Dërgimi i udhëzimeve të gjitha ministrive	Kryeministria	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dhe Departamenti për Rregullime Ligjore dhe Përputhshmërinë		kosto stafi				2020		



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
				All ministrinë e linjës								
	3.3.3	Aplikimi i udhëzimeve në të gjitha raportet	Kryeministria	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dhe Departamenti për Rregullime Ligjore dhe Përpunshmërinë		kosto stafi			2020			
				All ministrinë e linjës								
	3.4	Përgatitja e një manuali për nëpunësit civilë për kryerjen e konsultimeve publike efikase, me udhëzime të hollësishme hap-pas-hapi				100	0					
Përgatitja e një manuali për nëpunësit civilë për kryerjen e konsultimeve publike efikase, me udhëzime të hollësishme hap-pas-hapi	3.4.1	Përgatitja e manualit dhe udhëzimeve	Kryeministria	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dhe Departamenti për Rregullimet dhe Pajtushmërinë, Të gjitha ministrinë Shkollë Shqiptare e Administratës Publike		kosto stafi		1. Përgatitja e Manualit përfshirë standardet e konsultimit publik	2020			
	3.4.2	Shpërndarja e manualit të gjitha njësive qeveritare	Kryeministria	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dhe Departamenti për Rregullimet dhe Pajtushmërinë, Të gjitha ministrinë Shkollë Shqiptare e Administratës Publike		kosto stafi			2020			



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner në zbatim/institucion	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirëvlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
	3.4.3	Përditësimi sistematik i manualit për të reflektuar ndryshimit në mjedisin e politikavetë ndryshme	Kryeministr ia	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dheDepartamenti për Rregulloret dhe Pajtueshmërinë, Të gjitha ministritë Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		kosto stafi		2. Shpërndarja e manualit tek të gjitha njësitë qeveritare		2020	2021	
	3.4.4	Përdorimi i manualit në të gjitha programet e trajnimit (shih pikën 3.5.)	Kryeministr ia	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike Të gjitha ministritë		kosto stafi						
Ngritja e një programi zyrtar trajnimi për nëpunësit civilë që do të realizohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, duke u përqendruar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në bërjen e politikave publike	3.5.	Ngritja e një programi zyrtar trajnimi për nëpunësit civilë që do të realizohet nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, duke u përqendruar në bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile në bërjen e politikave publike				100	0	1.Trajnimi i nëpunësve civile të njësive relevante të çdo ministrie		2020		
	3.5.1	Trajnimi i nëpunësve civilë nga të gjitha ministritë	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	Departamenti për Zhvillim dheMirëqeverisje dheDepartamenti për Rregulloret dhePajtueshmërinë Kryeministria		kosto stafi		2. Vlerësimi i ndikimit të trajnimit		2020	2021	
	3.5.2	Vlerësimi i programit të trajnimit	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike			kosto stafi		3. Përcaktimi çdo vit i numrit të konsultimeve dhe fushave të konsultimit publik		2020	2021	
	3.5.3	Vendosja e standardeve të konsultimeve me kontributin e OSHC-ve nëçdo ministri	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike							2020	2021	
	Prioriteti 4: Sigurimi i kontributit të OSHC-ve në procesin e aderimit në BE në përputhjen me praktikat e mira të BE-së											



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
Hartimi i Platformës së përfshirjes shoqërisë civile në procesin e negociatave anëtarësimit të Republikës Shqipërisë Bashkimit Evropian	4.1	Hartimi i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian				100	0					
	4.1.1	Hartimi i projektplatformës së Partneritetit për Integrimin Evropian	MEPJ	Kryeministria		kosto stafi		1. Dokumenti i Projektplatformës i hartuar nga MEPJ		2020	2021	
	4.1.2	Konsultimi i projektplatformës së Partneritetit për Integrimin Evropian	MEPJ	Kryeministria		kosto stafi		2. Numri i aktiviteteve konsultuese për dokumentin e projektplatformës		2020		
	4.1.3	Miratimi i Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian	MEPJ	Kryeministria		kosto stafi		3. Dokumenti i Platformës i miratuar		2020		
Përfshirja e OSHC-ve në procesin e anëtarësimit në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian	4.2	Përfshirja e OSHC-ve në procesin e anëtarësimit në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian	MEPJ	Ministritë koordinuese, AMSHC		100%	0			2020	2021	
	4.2.1	Organizimi i takimeve në përputhje me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian	MEPJ	Ministritë koordinuese, AMSHC		100	0	Numri i aktiviteteve		2020	2021	
Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve në menaxhimin e instrumentit të para-aderimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit	4.3	Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve në menaxhimin e instrumentit të para-aderimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit				100	0	1. Organizimi i ditëve informuese dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile 2. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në aktivitetet informuese dhe/ose konsultuese lidhur me procesin e menaxhimit të fondeve të BE-së 3. Pjesëmarrja e OSHC-ve në Komitetin e Monitorimit të IPAs dhe Grupet sektoriale të Menaxhimit të Integruar të Politikave				
	4.3.1	Informimi dhe konsultim me shoqërinë civile lidhur me instrumentin e ri financiar IPA III	MEPJ	Kryeministria		kosto stafi				2020	2021	
	4.3.2	Pjesëmarrja e shoqërisë civile në aktivitetet monitoruese me Bashkimin Evropian, lidhur me fondet e BE-së/Komiteti i Monitorimit të IPA-s	MEPJ	Kryeministria		kosto stafi				2020	2021	
	4.3.3	Publikimi i të dhënave mbi treguesit e realizimit të projekteve/programeve	MEPJ	Kryeministria		kosto stafi				2020	2021	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
		IPA						4. Publikimi i raporteve vjetore të zbatimit të Programeve IPA (AIR)				
Koordinimi ifinancimeve dhe Programeve të BE për zhvillimin e shoqërisë civile	4.4	Koordinimi i financimeve dhe Programeve të BE prej të cilave mund të përfitojë shoqëria civile				0	100					
	4.4.1	Koordinimi i proceseve të lidhura me financimet nga Programe dhe instrumenta të ndryshme të BE për zhvillimin e shoqërisë civile.	MEPJ /MFE	Kryeministria		kosto stafi	BE-ja dhe donatorë të tjerë	1. Publikimi i Programeve prej të cilave mund të përfitojnë OSHC-të si edhe i procedurave transparente të aplikimit dhe vlerësimit. 2. Publikimi i thirrjeve për projekt propozime në faqen zyrtare të MEPJ dhe faqet zyrtare të institucioneve të tjera përgjegjëse 3. Publikimi i rezultateve në faqen zyrtare të MEPJ dhe faqet zyrtare të institucioneve të tjera përgjegjëse 4. Publikimi i emrave dhe adresave elektronike të pikave të kontaktit në MEPJ për secilin Program të Bashkëpunimit Territorial	2019	2020	2021	
	4.4.2	Përgatitja e thirrjeve për propozime	MEPJ /MFE	Kryeministria		kosto stafi	BE-ja dhe donatorë të tjerë		2019	2020	2021	
	4.4.3	Organizimi i Ditëve të informimit mbi modalitetet e thirrjeve për projekt propozime				kosto stafi	BE-ja dhe donatorë të tjerë		2019	2020	2021	
	4.4.4	Përzgjedhja e propozimeve në bashkëpunim me strukturat menaxhuese të Programeve specifike	MEPJ /MFE	Kryeministria		kosto stafi			2019	2020	2021	
	4.4.5	Publikimi i rezultateve të vlerësimit	MEPJ /MFE	Kryeministria		kosto stafi			2019	2020	2021	
Mundësimi i përfshirjes efektive të OSHC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian si një mekanizëm institucional kyç për konsultimin me i OSHC-të për çështje të BE-së brenda Parlamentit të Shqipërisë	4.5	Mundësimi i përfshirjes efektive të OSHC-ve në punën e Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian				100	0		2019	2020	2021	
	4.5.1	Njoftimi i takimeve të Këshillit në kohën e duhur dhe publikimi i procesverbaleve të tyre	Parlamenti AMSHC	Kryeministria		kosto stafi		1. Numri i procesverbaleve të takimit të publikuara siç e parashikon ligji	2019	2020	2021	
	4.5.2	Publikimi i emrave të punonjësve kryesorë në faqen zyrtare të MEPJ-së	Parlamenti, AMSHC	Kryeministria		kosto stafi		2. Bërja publike e emrave të stafit të Këshillit 3. Rekomandimet /sugjerimet e bëra nga anëtarët e shoqërisë civile të	2019	2020	2021	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
								Këshillat dhe marrja parasysh e tyre nga MEPJ-ja në faqen zyrtare të MEPJ-së				
Prioriteti 5: Mbështetja e vullnetarizmit të OSHC-ve dhe qytetarisë aktive duke u fokusuar veçanërisht në nivelin lokal												
Krijimi i një koncepti kombëtar për vullnetarizmit dhe qytetarinë aktive, duke përfshirë aktet nënligjore, rregullimin afatmesëm gjithëpërfshirës për vullnetarë dhe për organizatat që pranojnë vullnetarë d	5.1	Krijimi i një koncepti kombëtar për vullnetarizmin			25,000	0	100					
	5.1.1	Ngarkimi nga ana e Agjencisë i një ekipe të Asistencës Teknike për krijimin e konceptit	AMSHC	MSHMS	25,000	0	100	1. Krijimi i konceptit kombëtar të vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive në vitin 2020, duke përfshirë rolin e qendrave vullnetare		2020		
	5.1.2	Organizimi nga Agjencia i një debati kombëtar për këtë koncept	AMSHC	MSHMS		kosto stafi		2. Përfshirja e ekspertizës së OSHC-ve në konceptin kombëtar pas dialogut dhe diskutimit		2020		
	5.1.3	Krijimi nga Agjencia i një koncepti të vet për promovimin e vullnetarizmit	AMSHC	MSHMS		kosto stafi		3. Pasja nga AMSHC-ja e konceptit të brendshëm të vullnetarizmit që prej vitit 2020		2020		
Përmirësimi i ligjit për Vullnetarizmin bazuar në konceptin kombëtar të vullnetarizmit, duke përfshirë aktet nënligjore, rregullimin e plotë afatmesëm për vullnetarët dhe për organizatat që pranojnë vullnetarë sipas praktikave të mira të BE-së, p.sh. çështja e sigurimeve	5.2	Përmirësimi i ligjit dhe akteve nënligjore të nevojshme për vullnetarizmin dhe zgjidhja e çështjes së sigurimeve bazuar në konceptin kombëtar				100	0			2020		
	5.2.1	Zgjidhja e çështjeve të lidhura me sigurimet në vitin 2020	MSHMS			kosto stafi		1. Zgjidhja e çështjeve të lidhura me sigurimet në vitin 2020		2020		
	5.2.2	Ndryshimi i ligjit dhe akteve nënligjore në vitin 2021 dhe Finalizimi i Kodit të Sjelljes për Vullnetarët me kontributin e gjerë të OSHC-ve në vitin 2020	MSHMS	MFE, AMSHC MYES,		kosto stafi		2. Finalizimi i Kodit të Sjelljes për Vullnetarët me kontributin e gjerë të OSHC-ve në vitin 2020		2020	2021	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
	5.2.3	Instruktimi i Agjencisë Kombëtare Shtetërore të Punësimit dhe Formimit Profesional që të veprojë në përpunje me ligjet dhe aktet nënligjore të ndryshuara	MSHMS	MFE, AMSHC MYES,		kosto stafi		3.Ndryshimi i ligjit dhe akteve nënligjore në vitin 2021 4.Ushtrimi i aktivitetit të Agjencisë Shtetërore Kombëtare për Punësimin dhe Formimin Profesional në përpunje me ligjin dhe aktet nënligjore në fund të vitit 2021			2021	
Futja e skemave të financimit nga shteti për mbështetjen gjithanshme të zhvillimit dhe menaxhimit të programeve vullnetarëve nga OSHC-të	5.3	Skema të financimit nga shteti për promovimin e punës vullnetare				100	0					
	5.3.1	Sigurimi i fondeve çdo vit	AMSHC	MFE		kosto stafi		1. Alokimi dhe sigurimi i buxhetit vjetor në buxhetin kombëtar të MEF			2021	
	5.3.2	Caktimi i organit përgjegjës për shpalljen e thirrjeve për propozime	AMSHC	MFE		kosto stafi		2.Numri i thirrjeve të shpallura publikisht për propozime për projekte të vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive 3.Shuma faktike e alokuar çdo vit 4. Publikimi i raporteve të projekteve				
Krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshësinë dhe përhapjen e aktivitetave vullnetare (mundësisht përmes akteve nënligjore specifike që do të përcaktonin kërkesat)	5.4	Krijimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave mbi shpeshësinë dhe përhapjen e aktivitetave vullnetare				100	0				2021	
	5.4.1	Identifikimi dhe autorizimi i organit përgjegjës për mbledhjen e të dhënave (ose Shërbimi Shtetëror për Punësimin ose AMSHC-ja)	Kryeministria	NES,MFE AMSHC		kosto stafi	AT Pjesë e 5.1	1.Identifikimi dhe autorizimi i organit përgjegjës për mbledhjen e të dhënave			2021	
	5.4.2	Krijimi i instrumentit për mbledhjen e të dhënave	AMSHC	NES		kosto stafi		2.Miratimi i akteve nënligjore			2021	
	5.4.3	Miratimi i akteve nënligjore	MSHMS	NES		kosto stafi		3.Krijimi i instrumentit për mbledhjen e të dhënave			2021	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
raportimit për organizuesit e punës vullnetare), si dhe mbi vlerën ekonomike dhe sociale të punës vullnetare	5.4.4	Analizimi dhe bërja publike e vlerës ekonomike dhe sociale të punës vullnetare	AMSHC	MFE		kosto stafi		4. Analizimi dhe bërja publike e vlerës ekonomike dhe sociale të punës vullnetare			2021	
Mbështetja për përfshirjen e grupeve specifike si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe të papunët në të gjitha aksionet vullnetare	5.5	Mbështetja për përfshirjen e grupeve specifike si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe të papunët në të gjitha aksionet vullnetare				100	0	1. Pasqyrimi në koncept i përfshirjes së grupeve vullnetare 2. Sigurimi i nxitjes së gjithëpërfshirjes 3. Trajnimi i organizatave pritëse 4. Krijimi i vendeve për vullnetarë për përfaqësues të grupeve të synuara			2021	
	5.5.1	Përfshirja e grupeve vulnerabel në Konceptin Kombëtar për vullnetarizmin dhe qytetarinë aktive. Identifikimi i organizatave që mund të pranojnë vullnetarë dhe marrja e masave për trajnimin e duhur të tyre	MSHMS	AMSHC, KKSHC, MASR		kosto stafi					2021	
	5.5.2	Krijimi i vendeve për vullnetarë për përfaqësues të grupeve të synuara	MSHMS	AMSHC, KKSHC, NES		kosto stafi						
Drejtimi Strategjik 2: Mundësimi i mjedisit ligjor & qeverisjes së të dhënave												
Prioriteti 6: Krijimi i një kuadri më mundësues për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve												
Ndryshimi i ligjit aktual të regjistrimit të OSHC-ve për futjen e një procedure regjistrimi më të thjeshtë dhe në eficientë për OSHC-të dhe parashikimi me ligj i krijimit të një Regjistri Elektronik të	6.1	Ndryshimi i ligjit aktual të regjistrimit të OSHC-ve për futjen e një procedure regjistrimi më të thjeshtë dhe në eficientë për OSHC-të dhe parashikimi me ligj i krijimit të një Regjistri Elektronik të	MD		15,000	0	100					
	6.1.1	Nisja e një procesi konsultimi me pjesëmarrje nën kujdesin e KKSHC-së për ndryshimin e ligjit aktual të regjistrimit Brenda vitit 2019	MFE/MD	Kryeministria, MSHM S, KKSHC, AMSHC		kosto stafi		1. Kryerja e një procesi konsultimi me pjesëmarrje nën kujdesin e KKSHC-së për ndryshimin e ligjit aktual të regjistrimit	2019			



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
OSHC-ve	6.1.2	Angazhimi i disa OSHC-ve edhe jashtë KSHC-së, si dhe aktorëve të tjerë të interesuar, si drejtuesit e gjykatës, QKB-ja, institucionet e përfshira në luftën kundër pastrimit të parave për hartimin e një Dokumenti Pune/Propozimi për Opsionet e Politikave që mund të ndërmerren për në mjedis më të favorshëm për regjistrimin e OSHC-ve brenda vitit 2019	/MD/ MFE	Kryeministria KSHC, AMSHC, MSHMS		kosto stafi		2. Hartimi dhe paraqitja në Kryeministri e një dokumenti ku përcaktohen opsionet e politikave dhe ku rekomandohen ndryshime për futjen e një regjimi modern regjistrimi, duke përfshirë mendimet e OSHC-ve 3. Miratimi i projektligjit për ndryshimin e procedurës aktuale të regjistrimit nga Këshilli i Ministrave 4. Miratimi i ndryshimeve të ligjit të regjistrimit të OSHC-ve nga Kuvendi i Shqipërisë	2019			
	6.1.3	Përgatitja e projektligjit për ndryshimet në ligjin e regjistrimit brenda vitit 2020	MFE/MD	Kryeministria, KSHC, AMSHC, MSHMS	15,000	kosto stafi	15,000			2020		
	6.1.4	Miratimi i projektligjit nga Kuvendi i Shqipërisë brenda 4/2021	MFE/MD	Kryeministria, KSHC, AMSHC, MSHMS		kosto stafi					2021	
	6.1.5	Miratimi i projektligjit nga Kuvendi i Shqipërisë brenda vitit tremujorit të parë të vitit 2021	MFE/MD	Kryeministria, KSHC, AMSHC, MSHMS							2021	
Ndryshimi i ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe akteve të tjera që lidhen me të (akte nënligjore dhe rregullore) për t'i dhënë mundësi QKB-së për të marrë përsipër procesin e regjistrimit të OSHC-ve përmes krijimit të një Regjistri Kombëtar Elektronik të OSHC-ve	6.2	Ndryshimi i ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe akteve të tjera që lidhen me të (akte nënligjore dhe rregullore) për t'i dhënë mundësi QKB-së për të marrë përsipër procesin e regjistrimit të OSHC-ve përmes krijimit të një Regjistri Kombëtar Elektronik të OSHC-ve			15,000	0	100	1. Përgatitja dhe paraqitja në Kryeministri e një analize juridike të ndikimit të ndryshimeve të bëra në procedurën e regjistrimit në funksionet e QKB-së të përcaktuara në ligjin për QKB-në dhe në aktet ligjore që lidhen me të dhe paraqitja e ndryshimeve të rekomandimeve në Kryeministri në tremujorin e parë të vitit 2020				
	6.2.1	Kryerja e një analize juridike të ndikimit të ndryshimeve të bëra në procedurën e regjistrimit në funksionet e QKB-së të përcaktuara në ligjin për QKB-në dhe në aktet ligjore që lidhen me të dhe paraqitja e ndryshimeve të rekomandimeve në Kryeministri në tremujorin e parë të vitit 2020	/MFE	Kryeministria AKSHI, KSHC, AMSHC, QKB, MD, MSHMS	15,000	0	100	2. Përgatitja e një projektligji për ndryshimin e mandatit dhe funksioneve të QKB-së për të marrë përsipër procesin e regjistrimit të OSHC-ve nëpërmjet krijimit të një Regjistri Kombëtar Elektronike të OSHC-ve; 3. Regjistri Kombëtar Elektronik i OSHC-ve operacional në vitin 2022			2021	
	6.2.2	Përgatitja e një projektligji për ndryshimin e mandatit dhe funksioneve të QKB-së për të marrë përsipër procesin e regjistrimit të OSHC-ve nëpërmjet krijimit të një	/MFE	Kryeministria, AKSHI, KSHC, AMSHC, QKB, MD, MSHMS		kosto stafi					2021	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
		Regjistri Kombëtar Elektronike të OSHC-ve										
	6.2.3	Miratimi i projektligjit nga Kuvendi i Shqipërisë brenda vitit 2020	/MFE	Kryeministria, AKSHI, KKSHC, AMSHC, QKB, MD, MSHMS		kosto stafi					2021	
	6.2.4	Funksionimi i Regjistrat Kombëtar Elektronik në vitin 2022	/MFE	Kryeministria QKB, KKSHC, AMSHC, MSHMS		kosto stafi					2022	
Miratimi i akteve të tjera të nevojshme ligjore dhe nënligjore lidhur me OSHC-të	6.3.	Miratimi i akteve të tjera të nevojshme ligjore dhe nënligjore lidhur me OSHC-të			25,000	0	100	1. Hartimi i akteve të tjera të mbetura nënligjore që kërkon ligji për Inspektimet Financiare Publike 2. 3 Akte nënligjore të miratuara në zbatim të nenit 52 të ligjit për Shërbimet e kujdesit shoqëror			2020	
	6.3.1	Kryerja e një studimi krahasues të Rregullores së Filantropisë në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet kandidatë, me qëllim krijimin e një baze ligjore më mundësuese për filantropinë nëpërmjet ofrimit të stimuljeve tatimore për aktivitete filantropike brenda vitit 2020	MFE MSHMS	Kryeministria, KKSHC, AMSHC, MFE	25,000	0	100	1. Kryerja e një studimi krahasues				
	6.3.2	Kryerja e një studimi mbi mundësinë e ndryshimeve në ligjin për Ndërmarrjet Sociale nr. 65, datë 09.06.2016 brenda vitit 2020	MFE MSHMS	Kryeministria, KKSHC, AMSHC, MFE		kosto stafi		2. Analiza e mangësive të ligjit për Ndërmarrjet Sociale në RSH, e përfunduar		2020		
	6.3.3	Hartimi i akteve të tjera të mbetura nënligjore që kërkon neni 29 i ligjit për Vullnetarizmit nr. 45, datë 28.04.2016 brenda vitit 2021	MFE	Kryeministria, KKSHC, AMSHC, MFE		kosto stafi			2019			
	6.3.4	Hartimi i akteve të tjera të mbetura nënligjore që kërkon ligji për Inspektimet Financiare Publike brenda vitit 2020	MFE	Kryeministria, KKSHC, AMSHC, MFE		kosto stafi			2019			



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
	6.3.5	Finalizimi i miratimit të akteve nënligjore në zbatim të nenit 52 i ligjit për Shërbimet Sociale nr. 121, datë 24.11.2016 brenda vitit 2020	MSHMS, MFE	Kryeministria, KKSHC, AMSHC, MFE		kosto stafi		3. akte nënligjore të miratuara		2020		
Prioriteti 7: Mbledhja dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile												
Krijimi i një Regjistri Kombëtar Elektronik për OSHC-të me të gjitha funksionet. Duhet të përmbajë të gjitha informacionet relevante për OSHC-të (si data e regjistrimit, adresa/të dhënat e kontaktit, sektori/sectorët, aktivitetet, emri i presidentit/personave të tjerë të autorizuar për të përfaqësuar OSHC-në, etj.) dhe të jepet mundësia e kërimit sipas kriterëve të ndryshme (emri, grupi/nëngrupi i aktivitetëve, qyteti/rajoni i selie të OSHC-ve, etj.).	7.1	Krijimi i një Regjistri Kombëtar Elektronik për OSHC-të me të gjitha funksionet			140,000	93	7					
	7.1.1	Hartimi dhe miratimi i termave të referencës për Regjistrin Kombëtar Elektronik	AKSHI	Kryeministria, AMSHC, APP-ja DPT-ja	10,000	100	0	1. Krijimi dhe realizimi i Regjistrit Elektronik të OSHC-ve dhe lëshimi automatik i numrit NUIS.			2022	
	7.1.2	Përgatitja e dokumentacionit të tenderit	AKSHI	Kryeministria, AMSHC, APP-ja DPT-ja	10,000	0	100	2. Informacione të kërkueshme nëpërmjet Internetit për raportet financiare të organizatave jofitimprurëse që mund të bëhen publike			2022	
	7.1.3	Kryerja e procesit të tenderimit	AKSHI	Kryeministria, AMSHC, APP-ja DPT-ja				3. Një proces i integruar regjistrimi i OSHC-ve dhe një proces i integruar për ndryshimet dhe çregjistrimin e OSHC-ve			2022	
	7.1.4	Zbatimi i sistemit	AKSHI	Kryeministria, AMSHC, APP-ja DPT-ja	120,000	100	0	4. Informacion i kërkueshëm në internet në lidhje me raportet financiare të OJQ-ve që mund të bëhen publike			2022	
Digjitalizimi i të dhënave dhe	7.2	Digjitalizimi i të dhënave dhe arkivave të OSHC-ve			225,000	93	7					



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
arkivave të OSHC-ve, duke mundësuar një sistem të përditësuar të shkëmbimit të informacionit në lidhje me statusin, vendndodhjen, llojin dhe statusin e OSHC-ve, llojin e aktiviteteve, numrin e personelit dhe informacione të tjera në përputhje me kuadrin	7.2.1	Hartimi termave të referencës për përlogaritjen e procesit të digitalizimit dhe skanimit	AKSHI	Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës Gjykatat e Rretheve APP-ja AMSHC	15,000	100	0	1. Digitalizimi i të gjitha të dhënave të regjistrimit të OSHC-ve			2022	
	7.2.2	Kryerja e procesit të tenderimit	AKSHI	Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës Gjykatat e Rretheve APP-ja AMSHC	0	100	0	2. Informacion i kërkueshëm në internet mbi OSHC-të, i aksesueshëm për publikun			2022	
	7.2.3	Digitalizimi dhe skanimi i të gjithë dokumentacionit	AKSHI	Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës Gjykatat e Rretheve APP-ja AMSHC	0	100	0	3. Një proces i integruar i korigjimit të të dhënave historike të OSHC-ve			2022	
	7.2.4	Konsolidimi i të dhënave për Regjistrin Kombëtar Elektronik të OSHC-ve	AKSHI	Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës Gjykatat e Rretheve APP-ja AMSHC	210,000	0	100	4. Të dhëna të konsoliduara për OSHC-të midis Institucioneve Regjistruese dhe Autoriteteve Tatimore			2022	
Ndërtimi i sistemit të menaxhimit të informacionit (MIS) për AMSHC-në, fillimi i publikimit të skedave me statistikat kyçe mbi kontributin e sektorit të shoqërisë civile në zhvillimin social-ekonomik të vendit dhe shpërndarja gjerësisht e rezultateve.	7.3	Ndërtimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të AMSHC-së			90,000	89	11					
	7.3.1	Hartimi dhe miratimi i termave të referencës për sistemin MIS	AMSHC	Kryeministria, APP-ja, AKSHI	10,000	100	0					
	7.3.2	Kryerja e procesit të tenderimit	AMSHC	Kryeministria, APP-ja, AKSHI	0	100	0	1. Vënia në dispozicion të publikut të informacioneve të kërkueshme mbi sektorin e OSHC-ve			2022	
	7.3.3	Zbatimi i sistemit dhe shkëmbimi i të dhënave me regjistrin elektronik të OSHC-ve	AMSHC	Kryeministria, APP-ja, AKSHI	80,000	0	100				2022	
Drejtimi strategjik 3: Kuadër fiskal dhe financues i favorshëm												



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirëvlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
Prioriteti 8: Krijimi i një kuadri të financimit publik për mbështetjen e programeve të OSHC-ve në përpunje me praktikat e mira të BE-së												
Rishikimi i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OSHC-ve nga institucionet lokale dhe qendrore të qeverisë bazuar në analizën e mangësive, duke përfshirë saktësimin e procedurave për thirrjet për propozime	8.1.	Rishikimi i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OSHC-ve nga institucionet lokale dhe qendrore të qeverisë bazuar në analizën e mangësive, duke përfshirë saktësimin e procedurave për thirrjet për propozime			15,500	3	97					
	8.1.1	Përgatitja e termave të referencës për asistencën teknike	MFE/MSH MS	Kryeministria, AMSHC, KKSHC MD	15,200	1	99	1. Bërja e analizës së mangësive ligjore	2019			
	8.1.2	Ngritja e një grupi ndërmarrës pune për përgatitjen e projektndryshimeve në legjislacion	MFE/MSH MS	Kryeministria, AMSHC, KKSHC, MD	300	100	0	2.Identifikimi i ligjeve që kanë nevojë për ndryshim	2019			
	8.1.3	Miratimi i projektndryshimeve	MFE/MSH MS	Kryeministria, AMSHC, KKSHC, MD	0	100	0	3. Ndryshimi dhe miratimi i legjislacionit			2021	
Mbështetja financiare Organizatave Jofitimprurëse nëpërmjet Programit të Ndërmarrjeve Sociale dhe atij të Fondit Social	8.2.	Kryerja e procedurave të marrjes së statusit të NS dhe të procedurave të financimit të ndërmarrjeve sociale nëpërmjet tre formave të mbështetjes financiare			26.000	4	96	nr. i Ndërmarrjeve Sociale që kanë statusin e NS dhe nr. i ndërmarrjeve sociale te mbështetura financiarisht			2020-2022	
	8.2.1	Parashikimi në PBA i fondeve të mbështetjes financiare të ndërmarrjeve sociale 2020-2022	MSHMS	Kryeministria, MFE	0	100	0	1.Ligji për buxhetin e shtetit i miratuar			2020-2022	
	8.2.2	Mbledhja e Komisionit të Vlerësimit periodikisht	MSHMS		0	Kosto stafi	0	2.Nr. i mbledhjeve të Komisionit të Vlerësimit			2020 - 2022	
	8.2.3	Aprovimi i masave të mbështetjes financiare në bazë të vlerësimit të aplikimeve	MSHMS		0	100	0	3.Nr. i aplikimeve të shqyrtuara dhe fondi i mbështetjes i miratuar			2020-2022	
	8.2.4	Raportimi periodik pranë Komisionit të Ndhmës Shtetërore sipas legjislacionit në fuqi	MSHMS	MFE	0	kosto stafi	0	4.Nr. i raporteve			2020-2022	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partneri zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
	8.2.5	Hartimi dhe zhvillimi i një programi informimi për shoqërinë civile	MSHMS	Kryeministria, KKSHC, MD, MFE AMSHC Qeveria vendore	20,500	2	98	5. Programi i miratuar dhe nr. i takimeve informuese				
	8.2.6	Përgatitja dhe zhvillimi i një fushate ndërgjegjësimi në lidhje me programin e financimit të NS	MSHMS	Kryeministria, KKSHC, MD, MFE AMSHC Qeveria vendore	5,500	9	91	6. Programi i miratuar dhe nr. i takimeve ndërgjegjëse			2020-2022	
	8.3	Kryerja e procedurave të vlerësimit të Planeve Sociale dhe të procedurave të miratimit të financimit të shërbimeve sociale nëpërmjet Programit të Fondit Social	MSHMS	Kryeministria, MFE AMSHC Qeveria vendore	0	100	0	Shërbime sociale të financuara nga buxheti qendror			2020-2022	
	8.3.1	Parashikimi në PBA i fondeve të mbështetjes financiare të shërbimeve sociale 2020-2022	MSHMS	MFE	0	Kosto stafi	0	1. Ligji për buxhetin e shtetit i miratuar			2020-2022	
	8.3.2	Mbledhja e Komisionit të Vlerësimit periodikisht	MSHMS		0	Kosto stafi	0	2. Nr. i mbledhjeve të Komisionit të Vlerësimit			2020 - 2022	
	8.3.3	Aprovimi i masave të mbështetjes financiare për ngritjen e shërbimeve sociale në bazë të vlerësimit të Planeve Sociale të miratuara dhe kostuara	MSHMS	MFE Qeveria vendore	0	100	0	3. Nr. i aplikimeve të shqyrtuara dhe fondi i mbështetjes i miratuar			2020 - 2022	
	8.3.4	Mbështetja e Qeverisë Vendore për hartimin e Planeve Sociale dhe parashikimin e ngritjes së shërbimeve sociale me bazë komunitare	MSHMS	AMSHC Qeveria vendore		0	100	Plane sociale të hartuara sipas udhëzimit të miratuar			2020 - 2022	
Garantimi i informacioneve të plota për mundësitë e financimit publik të programeve të OSHC-ve (plane financimi dhe raporte vjetore)	8.4.	Garantimi i informacioneve të plota për mundësitë e financimit publik të programeve të OSHC-ve (plane financimi dhe raporte vjetore)	AMSHC	MSHMS, MD, MFE, MB, KKSHC, AMSHC, Shoqata e Bashkive,	2,400	100	0			2020		
	8.4.1	Përgatitja nga çdo institucion publik në nivel qendror dhe lokal i një analize të fushave kryesore dhe përfituesve të granteve, si dhe të dhëna të sakta në lidhje me punën e të gjitha organeve publike që u ofrojnë financim programeve të OSHC-ve në lidhje me respektimin e standardeve, parimeve dhe procedurave të vendosura me rregullore	AMSHC	MSHMS, MD, MFE, Ministria Brendshme, KKSHC, AMSHC, Shoqata e Bashkive	960	100	0	1. Përgatitja e formularëve të duhur për t'i prezantuar publikut informacione dhe të dhëna			2020	



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
	8.4.2	Përgatitja e formularëve të duhur për t'i prezantuar publikut informacione dhe të dhëna	AMSHC	MSHMS, MD, MFE, MB, KKSHC, MSHC, Shoqata e Bashkive	960	100	0	2. Publikimi i të dhënave të financimeve publike (planeve) në faqet zyrtare të institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal		2020		
	8.4.3	Publikimi i planeve të financimit dhe raporteve vjetore në faqet zyrtare të institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal	AMSHC	MSHMS, MD, MFE, MB, KKSHC, AMSHC, Shoqata e Bashkive,	480	100	0	3. Publikimi i të dhënave të financimeve publike (planeve) në faqet zyrtare të institucioneve publike në nivel qendror dhe lokal		2020		
Prioriteti 9: Raportimi financiar/kontabilizimi dhe tatimi i OSHC-ve												
Heqja e detyrimit ligjor për OSHC-të për të pasur një punonjës me kohë të plotë të paguar dhe të siguruar.	9.1.	Heqja e detyrimit ligjor për OSHC-të për të pasur një punonjës me kohë të plotë të paguar dhe të siguruar.	MFE			100	0					
	9.1.1	Ngritja e një grupi pune në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për përgatitjen e projektndryshimeve të legjislacionit	MFE	Kryeministria, MD, MSHMS, KKSHC, AMSHC		kosto stafi			2019			
	9.1.2.	Konsultimi i grupeve të punës me KKSHC-në	MFE	Kryeministria, MD, MSHMS, KKSHC, AMSHC		kosto stafi			2019			
	9.1.3	Miratimi i projektndryshimeve	MFE	Kryeministria, MD, MSHMS, KKSHC, AMSHC		kosto stafi		1.Heqja e detyrimit ligjor për OSHC-të			2021	
Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OSHC-ve në aspektin e TVSh-së	9.2	Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OSHC-ve në aspektin e TVSh-së				100	0					
	9.2.1	Ngritja e një grupi pune për përgatitjen e projektndryshimeve në legjislacion	MFE	Kryeministria, MFE MSHMS, KKSHC, AMSHC		kosto stafi		1. Akte nënligjore të miratuara dhe të harmonizuara me ligjin e ri për TVSH-në	2019			
	9.2.2.	Miratimi i projektndryshimeve	MFE	Kryeministria, MFEMSHMS, KKSHC, AMSHC		kosto stafi				2020		



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucio ni kryesor përgjegjës	Partner zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
Hartimi i një Manuali për Kontrollin Tatimor për inspektorët tatimorë me qëllim ekskluziv trajtimin e OSHC-ve në mënyrë të tillë që të marrë parasysh specifikat e sektorit dhe bërjen e trajnimeve	9.3	Hartimi i një Manuali për Kontrollin Tatimor për inspektorët tatimorë me qëllim ekskluziv trajtimin e OSHC-ve në mënyrë të tillë që të marrë parasysh specifikat e sektorit dhe bërjen e trajnimeve			10,000	0	100			2020		
	9.3.1	Ngritja e një grupi punemidis MFE, Autoritetet tatimore dhe KKSHC/AMSHC/OSHC-të të bien dakord për përmbajtjen e manualit	MFE	Kryeministria, MD, AMSHC , Autoritetet tatimore KKSHC		kosto stafi						
	9.3.2	Përditësimi i informacionit në Zyrën e të Ardhurave Publike në Shqipëri: https://eet.tatime.gov.al/eng/c/5/ng-os-public-entities sapo Masat 6.1 dhe 6.2 të realizohen	MFE	Autoritetet tatimore		kosto stafi		1. Hartimi manualit		2020		
	9.3.3	Përgatitja dhe përditësimi i manualit të kontrollit tatimor	MFE	Kryeministria, MD, AMSHC , Autoritetet tatimore KKSHC	10,000	0	100	2. Hartimi i programit të trajnimit		2020		
	9.3.4	Hartimi i një programi trajnimi për autoritetet tatimore për trajtimin e OSHC-ve sa i takon TVSH-së	MFE	Kryeministria, MD, AMSHC , Autoritetet tatimore KKSHC		kosto stafi				2020		
	9.3.5	Trajnimi i inspektorëve tatimorë në të gjithë vendin siç përcaktohet në manual	MFE	Autoritetet tatimore		kosto stafi		3. Zhvillimi i trajnimit		2020		
Ndryshimi i ligjit të vitit 1995 për Sponsorizimet dhe ligjet e tjera tatimore për t'u dhënë mundësi të gjithë individëve që të zbresin dhurimet që u bëjnë OSHC-ve me qëllim nxitjen e filantropisë individuale	9.4.	Ndryshimi i ligjit të vitit 1995 për Sponsorizimet dhe ligjet e tjera tatimore për t'u dhënë mundësi të gjithë individëve që të zbresin dhurimet që u bëjnë OSHC-ve me qëllim nxitjen e filantropisë individuale			18,800	20	80			2020		
	9.4.1	Termat e referencës për asistencën teknike	MFE	Kryeministria MD, Autoritetet tatimore, AMSHC , KKSHC	15,200	1	99			2020		



Nr.	I masave	Nënaktivitetet për çdo masë	Institucioni kryesor përgjegjës	Partneri zbatim/institucion në	Shuma e kostove në Euro	Burimet e financimit		Treguesit	Afati i zbatimit/Targeti 2019-2021* *2022 e në vazhdim, përfshirë vlerësimin afatmesëm. Hapat e ndërmarrë në vite,			Statusi i zbatimit
						Buxheti i Shtetit (%)	Partnerët për zhvillim (%)					
	9.4.2	Ngritja e një grupi ndërmarrës pune për përgatitjen e projektdryshimeve në legjislacion	MFE	Kryeministria MD, Autoritetet tatimore, AMSHC, KKSHC	3,000	100	0	1. Analizë ligjore e stimujve aktualë në legjislacionin e hartuar		2020		
	9.4.3	Miratimi i projektdryshimeve	MFE	Këshilli i Ministrave, Parlamenti	0	100	0	2. Miratimi i ligjit të ndryshuar për sponsorizimet		2020		
	9.4.4	Përgatitja dhe zhvillimi i një fushate nga AMSHC-ja dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë	MFE	AMSHC	600	100	0	3. Realizimi i një fushate ndërgjegjësimi për rëndësinë e zhvillimit të filantropisë individuale dhe në nivel korporatash		2020		

**VENDIM****Nr. 542, datë 25.7.2019****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT
TË KLASIFIKUAR QË TRAJTOHET NË
SISTEMET E KOMUNIKIMIT DHE TË
INFORMACIONIT (SKI)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI)”.

2. Ngarkohen Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Drejtoria e Shifrës për ngritjen e autoriteteve përkatëse brenda vitit 2020.

3. Institucionet shtetërore, të cilat nuk përmbushin standardet e sigurisë për ngritjen e strukturave të parashikuara në këtë vendim, të marrin masat për arritjen e standardeve brenda vitit 2021.

4. Ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë duhet që, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzimet përkatëse për zbatimin e tij.

5. Vendimi nr. 922, datë 19.12.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

RREGULLORE

**PËR “SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR QË TRAJTOHET NË
SISTEMET E KOMUNIKIMIT DHE TË
INFORMACIONIT (SKI)”¹⁹**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1**Hyrje**

1. Institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomik/kontraktorët që për nevoja të punës, prodhojnë, ruajnë, përpunojnë, shpërndajnë ose transmetojnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe/ose organizatave të huaja me të cilat RSH-ja ka marrëveshje sigurie nëpërmjet sistemeve të komunikimit dhe informacionit, duhet t'u përmbahen kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Kjo rregullore zbatohet për sistemet e komunikimit dhe informacionit që trajtojnë ose që do të trajtojnë informacion të klasifikuar “Sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe / ose organizatave të huaja me të cilat RSH ka marrëveshje sigurie (këtej e tutje referuar si SKI).

3. Me kërkesë të DSIK, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomik/kontraktorët japin informacion në lidhje me zbatimin e masave të sigurisë në sistemet e klasifikuara.

Neni 2**Objekti dhe qëllimi**

1. Dispozitat e përcaktuara në këtë rregullore kanë për qëllim garantimin e sigurisë së sistemeve të klasifikuar dhe informacionit të klasifikuar që trajtohet në to.

2. Objekti i kësaj rregulloreje është:

a) Identifikimi i autoriteteve kombëtare të sigurisë së SKI-ve dhe përcaktimi i detyrave kryesore të tyre.

b) Përcaktimi i kërkesave minimale që duhet të implementohen për sigurinë e SKI-ve.

¹⁹ Referuar “Vendimit të Këshillit të datës 23 Shtator 2013 “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE (2013/488 / BE). Nr. CELEX: EUR-Lex-32013D0488. Nr. Natyral: 2013/488/EU



c) Përcaktimi i procedurës për aktivitetet e certifikimit dhe akreditimit të sigurisë së SKI-ve.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë rregullore termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Certifikim i sistemit të komunikimit dhe informacionit” është procesi i vlerësimit, testimit dhe ekzaminimit të masave/ kontrolleve të sigurisë të sistemit, në bazë të standardeve specifike të sigurisë, si dhe identifikimi i dobësive të sistemit dhe përpilimi i planit të masave minimizuese të këtyre dobësive.

2. “Akreditim i sistemit të komunikimit dhe informacionit” është procesi i pranimit të riskut të mbetur, lidhur me vazhdimësinë e operimit të sistemit të komunikimit dhe informacionit dhe autorizimit të tij për të operuar për një kohë të përcaktuar.

3. “Siguria e sistemeve të komunikimit dhe informacionit” është aplikimi i masave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit dhe SKI-ve sipas objektivave të sigurisë.

4. “Siguria e informacionit” përfshin përcaktimin dhe zbatimin e masave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që trajtohet në SKI nga humbja aksidentale apo e qëllimshme e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë, dhe masat për parandalimin, humbjen e integritetit dhe disponueshmërisë së këtyre sistemeve.

5. “Ngjarje e sigurisë” është çdo ngjarje që rezulton ose mund të rezultojë në padisponueshmëri të sistemit ose të komponentëve të tij kryesorë, zbulim të informacionit të klasifikuar, humbje ose ndryshim të padëshiruar të informacionit, shkatërrim ose humbje të pajisjeve ose aseteve.

6. “Emetim elektromagnetik kompromentues” është rrezatimi elektromagnetik i pakontrolluar që mundëson, ekspozimin e pa autorizuar të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”.

7. “TEMPEST” është studimi dhe kontrolli i emetimeve elektromagnetike komprometuese.

8. “Menaxhimi i riskut” është procesi i identifikimit, analizimit dhe vlerësimit të riskut të sigurisë së informacionit si dhe marrjes së masave për reduktimin e tij brenda një niveli të pranueshëm.

9. “Aset” është çdo gjë me vlerë, si pajisje e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, komponent softëare dhe informacioni.

10. Kërcënimet, në terma të përgjithshëm, përcaktohen si mundësi për komprometimin e qëllimshëm ose jo të sigurisë. Në rastin e sigurisë së sistemeve, komprometimet e tilla përfshijnë humbjen e një ose më shumë objektivave të sigurisë së SKI-ve.

11. Dobësitë janë mangësi në fortësinë, plotësinë ose konsistencën e kontrolleve dhe mund të jenë të natyrës teknike, procedurale ose operacionale.

12. “Risk” probabiliteti që një ngjarje të shfrytëzojë një dobësi duke cënuar objektivat e sigurisë.

13. “Risku i mbetur” është risku që mbetet pas implementimit të masave të sigurisë në SKI, duke marrë parasysh që jo të gjithë kërcënimet dhe dobësitë mund të eliminohen apo reduktohen.

14. “Incident i sigurisë së sistemit” është çdo anomali e detektuar që komprometon apo ka aftësinë të kompromentojë informacionin ose SKI-të.

15. “Entitet” në kuptim të kësaj rregulloreje përfshin individë, pajisje ose shërbime.

16. “Nevoja për njohje” është nevoja për të pasur akses tek informacioni i klasifikuar, në kuadrin e një pozicioni zyrtar dhe me qëllim përmbushjen e një detyre specifike.

17. “Metodë e kombinuar autentifikimi” është një mënyrë e përbërë nga dy ose më shumë elementë sigurie.

18. “Veprim i privilegjuar” përfshin, por pa u kufizuar në, ndryshimin e konfigurimeve të sistemit, ndryshimin e parametrave të sistemit, aksesin në lojet e auditimit dhe sigurisë, aksesin në të dhëna, skedar dhe llogari që përdoren nga përdoruesit e tjerë përfshirë *back-up*-et dhe mediat elektronike.

19. “Konfidencialiteti” është aftësia për të provuar që informacioni nuk është i ekspozuar për entitete të paautorizuara.

20. “Integriteti” është aftësia për të ruajtur saktësinë dhe plotësinë e aseteve.

21. “Disponueshmëria” është aftësia e aseteve për të qenë të arritshme dhe të përdorshme kur nevojiten.



22. “Autenticiteti” është aftësia për të provuar se informacioni është i vërtetë dhe nga burime të sigurta.

23. “Pamohueshmëria” është aftësia për të provuar që një veprim ose ngjarje ka ndodhur, në mënyrë që ngjarja ose veprimi nuk mund të mohohen më vonë.

24. “Material kriptografik” përfshin çelësat në të gjitha format e tyre, dokumentet, pajisjet që përmbajnë informacion kriptografik e që janë të rëndësishëm për kriptimin dhe dekriptimin e informacionit.

25. “Autorizim krypto” është dokumenti që autorizon një individ për të aksesuar ose menaxhuar materialet kriptografike.

26. Mjedis i sigurt global i sistemit (MSG - *global secure environment*) është rrethina e objektit ku është instaluar dhe operon sistemi.

27. Mjedis i sigurt lokal i sistemit (MSL) është objekti ku është instaluar dhe operon sistemi.

28. “Mjedis i sigurt elektronik i sistemit (MSE)” janë sistemi *software* dhe *hardware*.

29. “Mënyra e dedikuar” është mënyra e operimit në të cilën të gjithë individët me të drejtë akses në SKI janë të certifikuar në nivelin më të lartë të klasifikimit që trajtohet në SKI dhe me nevojë të përbashkët për njohje për të gjithë informacionin që trajtohet në SKI.

30. “Mënyra e lartë” është mënyra e operimit në të cilën të gjithë individët me të drejtë akses në SKI janë të certifikuar në nivelin më të lartë të klasifikimit që trajtohet në SKI, por jo të gjithë individët kanë të njëjtën nevojë për njohje për informacionin që ruhet, përpunohet ose transmetohet në sistem. Aprovimi për akses në informacionin që trajtohet në sistem jepet në nivel individual sipas funksionit që ka individi.

31. “Mënyra me shumë nivele” është mënyra e operimit në të cilën jo të gjithë individët me të drejtë akses në SKI janë të certifikuar në nivelin më të lartë të klasifikimit që trajtohet në SKI dhe jo të gjithë individët me të drejtë akses në SKI kanë të njëjtën nevojë për njohje me informacionin që ruhet, përpunohet ose transmetohet në sistem.

32. Ndërlidhje e sistemeve nënkupton lidhjen direkte të dy ose më shumë SKI-ve me qëllim shkëmbimin e të dhënave ose shërbimeve.

Neni 4

Objektivat e sigurisë

1. Objektivat e sigurisë, janë:

a) Konfidencialiteti – të sigurohet konfidencialiteti i informacionit nëpërmjet kontrollit të aksesit në informacionin e klasifikuar, shërbimet dhe burimet e sistemit.

b) Integriteti – të sigurohet integriteti i informacionit të klasifikuar, i shërbimeve dhe burimeve të sistemit.

c) Disponueshmëria – të sigurohet disponueshmëria e informacionit të klasifikuar, i shërbimeve dhe burimeve të sistemit.

d) Autenticiteti – të sigurohet identifikimi dhe autentifikimi i personave, pajisjeve dhe shërbimeve që aksesojnë SKI-të që trajtojnë informacion të klasifikuar.

e) Pamohueshmëria – të sigurohet mos refuzimi i entiteteve që kanë përpunuar informacion.

2. Niveli i aplikimit të këtyre objektivave të sigurisë është specifik për SKI të ndryshme dhe përcaktohet nga misioni i sistemit, kërkesat minimale të sigurisë dhe rezultatet e procesit të menaxhimit të riskut.

Neni 5

Kriteret themelore të sigurisë

1. SKI-të ndjekin këto kriteret sigurie:

a) Menaxhimi i riskut të sigurisë: Aplikimi i procesit të menaxhimit të riskut për monitorimin, reduktimin, eliminimin, shmangien ose pranimin e riskut që lidhet me sigurinë e SKI-ve.

b) Funksionalitetet dhe privilegjet minimale: Instalimi dhe përdorimi vetëm i funksioneve, protokolleve dhe shërbimeve që kërkohen për të përmbushur misionin operacional të sistemit. Entitetit që përdor SKI-në i lejohen vetëm privilegjet dhe autorizimet që nevojiten për kryerjen e detyrave.

c) Nyja vetëmbrojtëse. Secili SKI i ndërlidhur të trajtojë SKI-në tjetër si të huaj dhe të implementohen masa për kontrollin e shkëmbimit të informacionit me SKI-në tjetër.

d) Mbrojtja shumënivelshe. Masat e sigurisë së SKI-ve të implementohen në mënyrë të tillë që të ketë më shumë se një nivel mbrojtjeje.

e) Përditësimi i masave të sigurisë. Rishikim herë pas herë i implementimit dhe efektivitetit të masave



të sigurisë së SKI-ve në varësi të ndryshimeve në mjedisin e kërcënimeve dhe dobësive.

f) Akreditimi i SKI-ve. Akreditimi i SKI-ve përshtatshëmrisht me nivelin e informacionit që trajtohet në to.

2. DSIK verifikon periodikisht aplikimin e këtyre kriterëve dhe implementimin e vazhdueshëm të standardeve të sigurisë.

PJESA I QEVERISJA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

KREU I AUTORITETET E SIGURISË

Neni 6

Autoritetet e sigurisë së SKI-ve

Për vlerësimin dhe trajtimin e aspekteve të sigurisë së SKI-ve krijohen këto autoritete sigurie.

1. Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë (AKAS).

2. Autoriteti Kombëtar i Testimit, Vlerësimit dhe Certifikimit të Sigurisë (AKTVCS).

3. Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Komunikimeve (AKSK).

4. Autoriteti Kombëtar i Shpërndarjes (AKSH).

5. Autoriteti Kombëtar TEMPEST (AKT).

6. Autoriteti Kombëtar i Mbrojtjes Kibernetike (AKMK).

7. Autoriteti i Operimit të Sistemit (AOS).

Neni 7

Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë (AKAS)

1. Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë (AKAS) është përgjegjës për akreditimin e sigurisë së SKI-ve që trajtojnë informacion të klasifikuar, në një nivel të caktuar klasifikimi në mjedisin e tyre operacional. Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë është Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

2. AKAS-i ka këto detyra:

a) Shqyrton kërkesat për akreditimin e sistemeve;

b) Bashkëpunon me autoritetet e sigurisë për identifikimin e komponentëve dhe sistemit që duhet të testohet, vlerësohet dhe certifikohet.

c) Përcakton rolet dhe përgjegjësitë e strukturave të sigurisë, kushtet në të cilat do të akreditohet sistemi dhe harton e miraton Planin e Akreditimit të Sigurisë së Sistemit.

d) Koordinon punën për akreditimin e sigurisë së sistemeve me strukturat përkatëse të sigurisë;

e) Verifikon zbatimin e masave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë përpunimit, ruajtjes ose transmetimit në sistemet e komunikimit dhe të informacionit nga çenimi aksidental ose i qëllimshëm i objektivave të sigurisë:

i) Verifikon zonat e sigurisë ku është instaluar dhe operon sistemi;

ii) Verifikon nëse përdoruesit e sistemit janë të pajisur me certifikata sigurie;

iii) Verifikon nëse aplikohen aspekte të sigurimit industrial;

iv) Verifikon nëse aplikohen marrëveshje sigurie me struktura të tjera brenda apo jashtë vendit;

v) Verifikon dokumentacionin e sigurisë së sistemit;

vi) Verifikon zbatimin e kërkesave të sigurisë së komunikimeve, sigurisë kriptografike dhe sigurisë së emetimeve, nëse aplikohen, në bashkëpunim me autoritetet e sigurisë;

vii) Inspekton MSG/MSL;

viii) Verifikon nëse masat e sigurisë së sistemit janë në përputhje me Planin e Menaxhimit të Riskut.

f) Analizon dhe vlerëson gjendjen e sigurisë së sistemit në varësi të dokumentacionit të sigurisë së sistemit, dokumenteve të lëshuar nga autoritetet e sigurisë dhe rezultateve të inspektimeve.

g) Pranon riskun e mbetur të sistemit dhe harton akt vlerësimin për zbatimin e masave të sigurisë.

h) Lëshon deklaratën e akreditimit, që autorizon sistemin për të trajtuar informacion të klasifikuar. Kjo deklaratë lëshohet bazuar në vlerësimin pozitiv të sigurisë së SKI-s.

i) Menaxhon databazën e sistemeve të klasifikuar kombëtare, të NATO-s, shteteve dhe organizatave të huaja të akredituar nga DSIK.

j) Trajton personelin/strukturat e SKI mbi aspekte të përmbushjes së detyrimeve për akreditimin e sigurisë.



Neni 8

Autoriteti i Operimit të Sistemit (AOS)

1. Institucionet shtetërore që kanë në zotërim një ose më shumë SKI marrin rolin e Autoritetit të Operimit të Sistemit (AOS).

2. Autoriteti i Operimit të Sistemit (AOS) është përgjegjës për administrimin e përditshëm të operimit të sigurt të sistemit si dhe aspekteve të ndërlidhjes së sistemit me sisteme të tjera.

3. AOS-ja ka këto detyra:

a) Është përgjegjës për operimin e sigurt të sistemeve të klasifikuar që ka në zotërim.

b) Është përgjegjës për të kërkuar akreditimin e sistemeve dhe menaxhuar sistemet e akredituara që ka në zotërim.

c) Cakton Oficerin/Strukturën e Sigurisë së SKI-ve për menaxhimin e aspekteve të sigurisë së sistemeve, përgjegjës për garantimin e përputhshmërisë së masave të sigurisë së SKI-ve me politikat, standardet dhe legjislacionin për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”.

2. Kjo strukturë:

i. Formulon dhe mirëmban dokumentet e sigurisë së sistemit, në bashkëpunim me personin/strukturën përgjegjëse për implementimin dhe monitorimin e masave të sigurisë teknike të SKI-ve.

ii. Këshillon mbi sigurinë e SKI-së dhe ndërgjegjëson administratorët dhe përdoruesit e sistemit, përfshirë nivelet drejtuese, për aspektet e sigurisë së SKI-së;

iii. Mirëmban listën e personave të autorizuar për përdorimin e SKI-së si dhe nivelin e autorizimit dhe siguron që këta persona janë të certifikuar përshtatshëmrisht dhe kanë nevojë për njohje për informacionin që trajtohet në SKI;

iv. Kryen ose koordinon ekzekutimin e vlerësimeve periodike të sigurisë së SKI-së (p.sh. vlerësim risku, testim dhe vlerësim i sigurisë, inspektim i sigurisë, vlerësim i dobësive);

v. Raporton në instancat përkatëse mbi mangësitë dhe dobësitë e konstatuara që lidhen me sigurinë e SKI-së;

vi. Menaxhon dhe investigon incidentet e sigurisë së SKI-së në bashkëpunim me strukturën e sigurisë sipas rastit, dhe raporton në instancat përkatëse.

Neni 9

Autoriteti Kombëtar i Testimit, Vlerësimit dhe Certifikimit të Sigurisë (AKTVCS)

1. Autoriteti Kombëtar i Testimit, Vlerësimit dhe Certifikimit të Sigurisë është Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoritet i Sigurisë Kombëtare).

2. AKTVCS ka këto detyra:

a) Përcaktimin e komponentëve specifikë të sistemit që duhet të testohen dhe vlerësohen, masave të sigurisë dhe pritshmërive për secilin element;

b) Përzgjedhjen, përgatitjen dhe aprovimin e procedurave dhe metodave të testimit dhe vlerësimit të komponentëve specifikë të sistemit;

c) Përzgjedhjen e mjeteve të testimit të komponentëve specifikë të sistemit;

d) Auditimin e implementimit të kërkesave të sigurisë në sistem dhe vlerësimin e operimit korrekt të masave të sigurisë të implementuara në sistem;

e) Vlerësimin e nivelit të përputhshmërisë së dokumentacionit të sistemit dhe zbatimit në praktikë të masave të deklaruara në dokumentacion për MSE;

f) Kryerjen e aktiviteteve të testimit të kontroleve specifike teknologjike: hardware, software, të sistemit operativ, aplikacioneve dhe databazave në sistem;

g) Testimin dhe vlerësimin e dobësive të sistemit;

h) Kontribuon në vlerësimin e riskut të sigurisë së sistemit;

i) Dokumentimin e saktë të procedurave dhe rezultateve të testimit dhe gjenerimin e raporteve të vlerësimit të sigurisë;

j) Lëshimin e certifikatës së sigurisë së sistemit bazuar në raportet e vlerësimit të sigurisë, sipas rasteve të parapërcaktuara në Planin e Akreditimit të Sigurisë së Sistemit;

k) Menaxhon databazën e sistemeve të certifikuar nga DSIK.

Neni 10

Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Komunikimeve (AKSK)

1. Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Komunikimeve është Drejtoria e Shifrës.

2. AKSK-i ka këto detyra kryesore:



a) Përcakton kërkesat e sigurisë specifike për sistemet, produktet dhe mekanizmat kriptografikë dhe kontrollon zbatimin e tyre nga institucionet shtetërore;

b) Përcakton procedurat për përzgjedhjen, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve, produkteve dhe mekanizmave kriptografikë dhe kontrollon zbatimin e tyre nga institucionet shtetërore;

c) Administron infrastrukturën e materialit kriptografik të pajisjeve/sistemeve të përzgjedhur.

d) Vlerëson sistemet, produktet dhe mekanizmat kriptografikë dhe harton Akt vlerësimin përkatës dhe ia përcjell AKAS në funksion të procesit të akreditimit të sigurisë;

e) Inspekton strukturat kriptografike në institucionet shtetërore për masat për zbatimin e mbrojtjes kriptografike të informacionit të klasifikuar, instalimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, sistemeve dhe incidentet kriptografike;

f) Menaxhon databazën e sistemeve, produkteve dhe mekanizmave kriptografikë të vlerësuar dhe që përdoren nga institucionet shtetërore.

Neni 11

Autoriteti Kombëtar i Shpërndarjes (AKSH)

1. Autoriteti Kombëtar i Shpërndarjes është Drejtoria e Shifrës.

2. AKSH ka këto detyra:

a) Administron materialet kriptografike që përdoren për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

b) Mban databazën e pajisjeve dhe programeve kriptografike, materialit çelës, dokumenteve e procedurave përkatëse për menaxhimin e tyre;

c) Shpërndan materialin kriptografik në institucionet shtetërore;

d) Administron sistemet e shkëmbimit elektronik të çelësave kriptografikë dhe të llogarisë së materialit kriptografik kombëtar, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

e) Zbaton rregullat e sigurimit fizik dhe elektronik sipas akteve nënligjore në fuqi për ruajtjen e materialit kriptografik;

f) Siguron që materiali kriptografik të jetë në çdo kohë në kushte pune;

g) Shkatërron materialin kriptografik, sipas rregullores kur është e nevojshme;

h) Harton procedurat që duhen ndjekur për raportimin e incidenteve;

i) Harton procedurat që duhen ndjekur në rastet e emergjencës;

j) Siguron që i gjithë personeli që ka akses në materialin kriptografik është i autorizuar, i certifikuar dhe i trajnuar sipas akteve nënligjore në fuqi.

Neni 12

Autoriteti Kombëtar TEMPEST (AKT)

1. Autoriteti Kombëtar TEMPEST është Drejtoria e Shifrës.

2. AKT ka këto detyra:

a) Harton politika, standarde e procedura për mbrojtjen nga emetimet elektromagnetike kompromentuese;

b) Përzgjedh, siguron dhe administron pajisjet elektronike për realizimin e matjeve TEMPEST të ambienteve dhe pajisjeve;

c) Kryen periodikisht matjet TEMPEST, dhe përgatit raportin me rezultatet e matjeve për DSIK-në dhe institucionet përkatëse;

d) Kontrollon dhe rekomandon masat që duhen zbatuar për të mënjeluar riskun nga emetimet elektromagnetike kompromentuese;

e) Mban databazën me historikun e rezultateve të matjeve TEMPEST.

Neni 13

Autoriteti Kombëtar i Mbrojtjes Kibernetike (AKMK) për SKI –të

1. Autoriteti Kombëtar i Mbrojtjes Kibernetike (AKMK) është Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoritet i Sigurisë Kombëtare).

2. AKMK ka këto detyra:

a) Harton dhe zhvillon konceptet, strategjinë, politikat etj., për mbrojtjen kibernetike të sistemeve të klasifikuar;

b) Zhvillon procedurat dhe standardet teknike në përputhje me përcaktimet e NATO-s dhe ato Evropiane;

c) Organizon dhe realizon ndërgjegjësimin, edukimin dhe trajnimin e personelit për mbrojtjen kibernetike;

d) Siguron ndërvëprimin me strukturat përkatëse shtetërore, të NATO-s, BE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare për të zhvilluar



konceptin e mbrojtjes kibernetike si dhe të masave reaguese;

e) Shërben si pikë kontakti me struktura të tjera homologe jashtë vendit;

f) Evidenton, vlerëson dhe paralajmëron për rreziqet dhe kërcënimet kibernetike;

g) Teston dhe vlerëson masat e mbrojtjes kibernetike;

h) Rekomandon dhe këshillon për implementimin e masave të sigurisë;

i) Përcakton mjetet e nevojshme teknike për evidentimin dhe reagimin ndaj incidenteve;

j) Siguron monitorimin e vazhdueshëm të sistemeve të klasifikuara, nëpërmjet nënstrukturave të ngritura në ministri e institucione shtetërore;

k) Mbledh dhe regjistron informacion në lidhje me cenimin e sigurisë së sistemeve të komunikimit dhe të informacionit dhe administron listën e incidenteve të ndodhura më parë në këto sisteme;

l) Azhurnon listën e kërcënimeve të reja që mund të ndodhin në SKI-të;

m) Shpërndan informacionin me strukturat e tjera përgjegjëse që përballen me kërcënimet e reja;

n) Punon për reduktimin e dobësive të SKI-ve;

o) Punon për të ulur mundësinë e krizave në SKI;

p) Punon për njohjen e shtrirjes së kërcënimeve në SKI-të;

q) Përcakton një shkallë matëse për sulmet duke filluar nga sulmet më të thjeshta tek ato më të komplikuar dhe me shkallë më të gjerë;

r) Përcakton dhe klasifikon riskun dhe kërcënimet në fushën e mbrojtjes kibernetike dhe siguron që masat e marra u paraprijnë incidenteve që mund të ndodhin.

3. AKMK në rast krize në SKI:

a) Përgjigjet në mënyrë të menjëhershme duke marrë masa reaguese ndaj sulmeve kibernetike për minimizimin / eliminimin e riskut dhe tejkalimin e krizës;

b) Kufizon shtrirjen më të gjerë të krizës;

c) Mbledh dhe analizon rezultatet.

KREU II

MENAXHIMI I RISKUT TË SIGURISË SË INFORMACIONIT

Neni 14

Identifikimi dhe vlerësimi i riskut të sigurisë

Institucionet shtetërore të identifikojnë dhe vlerësojnë riskun e sigurisë në informacionin dhe SKI-të që kanë në zotërim.

Neni 15

Procesi i Menaxhimit të Riskut

1. Institucionet shtetërore implementojnë një metodë të menaxhimit të riskut për të mbuluar të gjitha aspektet e sigurisë së informacionit, e cila miratohet nga titullari i institucionit.

2. Institucionet shtetërore kryejnë proceset e menaxhimit të riskut të sigurisë për monitorimin, reduktimin, eliminimin, shmangien ose pranimin e rreziqeve që lidhen me SKI-të.

3. Procesi i menaxhimit të riskut të sigurisë kryhet nga përfaqësues të disiplinave të ndryshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

4. Procesi i menaxhimit të riskut përfshin:

a) Identifikimin dhe vlerësimin e aseteve;

b) Identifikimin e agjentëve kërcënues (person, proces kompjuterik, pajisje etj);

c) Identifikimin e kërcënimeve që vijnë si pasojë e veprimit të agjentëve;

d) Identifikimin e dobësive që mund të shfrytëzohen nga agjentët kërcënues;

e) Identifikimin e riskut;

f) Vlerësimin e masave ekzistuese të sigurisë;

g) Vlerësimin e riskut ose përcaktimin e nivelit të riskut;

h) Identifikimin e masave përkatëse për monitorimin, reduktimin, eliminimin, shmangien ose pranimin e riskut;

i) Përcaktimin e riskut të mbetur.

Neni 16

Plani i Menaxhimit të Riskut

1. Institucionet shtetërore të dokumentojnë riskun e sigurisë si dhe procesin e menaxhimit të tij në Planin e Menaxhimit të Riskut.

2. Plani i Menaxhimit të Riskut përfshin:



- a) Rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të grupit për menaxhimin e riskut;
- b) Objektivat e grupit për menaxhimin e riskut;
- c) Proceset formale të identifikimit të riskut;
- d) Lidhjen e riskut me masat ekzistuese.

Neni 17

Risku i mbetur

1. Risku i sigurisë që konsiderohet si i pranueshëm miratohet formalisht nga DSIK gjatë procesit të akreditimit të sigurisë së SKI-ve dhe mbahet nën monitorim të vazhdueshëm nga Autoriteti i Operimit të Sistemit.

2. Risku i sigurisë që konsiderohet si i papranueshëm duhet të trajtohet nëpërmjet aplikimit të masave shtesë ose masave alternative të sigurisë.

KREU III**DOKUMENTACIONI I SIGURISË SË SISTEMIT**

Neni 18

Dokumentacioni i sigurisë së sistemit

1. Dokumentacioni i sigurisë së sistemit është tërësia e dokumentave që kërkohen për akreditimin e sigurisë së SKI-së dhe shërben si standard për vlerësimin e tij.

2. Dokumentacioni i sigurisë së sistemit:

- a) Hartohet nga personeli/struktura e sigurisë së SKI-së;
- b) Përmbajtja e dokumenteve të jetë në përputhje me legjislacionin për sigurinë e informacionit dhe të përcaktojë qëllimin, kërkesat e sigurisë, masat e sigurisë së SKI-së që do të akreditohet si dhe përgjegjësitë dhe autoritetet e institucioneve të përfshira në procesin e akreditimit të sigurisë;
- c) Miratohet nga titullari i institucionit;
- d) I vihet në dispozicion personelit që ka akses në sistem në përputhje me nevojën për njohje;
- e) Përditësohet rregullisht.

3. Dokumentacioni i sigurisë së sistemit përbëhet nga:

- a) Udhëzim për sigurinë e SKI-ve;
- b) Koncepti i Operimit (KO);
- c) Deklarata e Përbashkët e Kërkesave të Sigurisë (DPKS);

d) Deklarata e Kërkesave të Sigurisë së Ndërlidhjes së Sistemit (DKSNS);

e) Deklarata e Kërkesave të Sigurisë Specifike të Sistemit (DKSSS);

f) Procedurat e Operimit të Sigurt (POS);

g) Plani i Menaxhimit të Riskut (PMR);

h) Procedurat e Testimit dhe Vlerësimit të Sigurisë (PVTs);

i) Plani i përgjigjes ndaj incidenteve;

j) Procedurat në rastet e emergjencave;

k) Urdhri për ndarjen e Zonave të Sigurisë.

4. Gjatë procesit të akreditimit të sigurisë së sistemit gjenerohen dokumente shtesë, të cilat i bashkëlidhen dokumentacionit të sigurisë së sistemit, ku përfshihen:

a) Plani i Akreditimit të Sigurisë së Sistemit (PASS);

b) Raporti i rezultateve të matjeve TEMPEST të Mjedisëve;

c) Plani i menaxhimit të materialeve kriptografikë;

d) Plani i Testimit dhe Vlerësimit të Sigurisë së Komponentëve të Sistemit (PVTSKS);

e) Raportet e testimit dhe vlerësimit të sigurisë;

f) Raportet e inspektimit;

g) Certifikata TEMPEST e pajisjeve (nëse aplikohet);

h) Deklarata e Akreditimit të Sigurisë.

Neni 19

Rishikimi i dokumentacionit

1. Dokumentacioni i sigurisë së sistemit rishikohet në këto raste:

a) Periodikisht minimumi një herë në vit.

b) Në përgjigje të ndryshimeve në sistem, mjedis ose operimin e sistemit.

2. Dokumentacioni i sigurisë së sistemit duhet të ketë të regjistruar datën e rishikimit të fundit.

Neni 20

Kërkesa të tjera shtesë për dokumentacionin

1. AKAS-i ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë, nëse e gjykon të nevojshme për sistemet e integruara në programe ndërkombëtare.

2. Për sistemet e shteteve ose organizatave ndërkombëtare dokumentet plotësohen në 2 kopje, një në gjuhën angleze dhe një në gjuhën shqipe.



KREU IV AKREDITIMI I SIGURISË SË SKI

Neni 21 Të përgjithshme

1. Sistemet që trajtojnë informacion të klasifikuar duhet të akreditohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Institucionet shtetërore janë përgjegjëse për iniciimin e kërkesave për akreditimin e sigurisë së SKI-ve që operojnë ose duan të operojnë.

3. DSIK është përgjegjës për ndjekjen e procesit të akreditimit të sigurisë së SKI-ve.

4. Procesi i akreditimit të sigurisë përcakton nivelin e përshtatshëm të mbrojtjes së sistemit si dhe identifikon dhe pranon riskun e mbetur, që duhet të monitorohet përgjatë jetëgjatësisë së sistemit.

5. DSIK-ja mban, administron dhe përditëson bazën qendrore të të dhënave ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për akreditim si dhe statusi i akreditimit të SKI-ve kombëtare dhe shteteve apo organizatave ndërkombëtare që operojnë në institucionet shtetërore.

Neni 22 Mjediset e sigurisë së sistemeve

1. Ndarja e mjedisëve të sigurisë së sistemeve bëhet me qëllim përcaktimin e përgjegjësive për sigurinë e SKI-ve.

2. Mjediset e sigurisë së sistemeve janë:

a) Mjedisi i Sigurisë Globale (MSG) përfaqëson zonën e sigurisë ku ndodhet sistemi, por që është jashtë kontrollit të AOS. MSG përfshin aspektet e sigurisë së ndërtesës ose të site-t, vendndodhjen gjeografike, sigurinë e ndërlidhjes së sistemeve dhe mjedisin e përgjithshëm të kërcënimeve.

b) Mjedisi i Sigurisë Lokale (MSL) është zona e sigurisë nën ndikimin e AOS. MSL përfshin masat e sigurimit fizik, sigurisë së personelit, sigurisë së informacionit dhe sigurisë procedurale.

c) Mjedisi i Sigurisë Elektronike (MSE) është zona e sigurisë që përfshin mekanizmat e sigurisë elektronike të SKI-ve të implementuar brenda arkitekturës së sigurisë së sistemit dhe që ofrojnë funksionet e nevojshme të sigurisë. MSE përfshin:

i) ndërfaqet individ-makinë;

ii) ndërfaqet e brendshme (ndërfaqet ndërmjet pjesëve të sistemit që përfaqësojnë klasa të ndryshme të sigurisë p.sh. particionet e sigurisë në sistem);

iii) ndërfaqet e jashtme (ndërfaqet e sistemeve me DSS të ndryshme ose të aprovuar nga AKAS të ndryshme, *firewalls*, *gateways* etj.).

Neni 23 Mënyra e sigurisë së operimit të sistemit

1. SKI-të që trajtojnë informacion të klasifikuar në nivel “Konfidencial” e lart të operojnë në një nga mënyrat e mëposhtme të sigurisë:

- a) Mënyrë e dedikuar.
- b) Mënyrë e lartë.
- c) Mënyrë me shumë nivele.

2. SKI-të që trajtojnë informacion të klasifikuar në nivel “i Kufizuar” të operojnë në një nga mënyrat e mëposhtme të sigurisë:

- a) Mënyrë e dedikuar.
- b) Mënyrë e lartë.

Neni 24 Bazat e akreditimit të sigurisë

Bazë për akreditimin e sigurisë së SKI-së konsiderohet si më poshtë:

1. Vlerësimi i arkitekturës së sigurisë së sistemit.

2. Vlerësimi i dokumentacionit të sigurisë së sistemit.

3. Verifikimi i implementimit dhe efektivitetit të masave të sigurisë së SKI-së, nëpërmjet testimeve të komponentëve të caktuar të sistemit bazuar në planin e T&VS si dhe nëpërmjet inspektimit të ambienteve ku shtrihet sistemi dhe intervistimit të personave që punojnë në sistem ose menaxhojnë aspektet e sigurisë së informacionit.

4. Analiza e riskut të mbetur dhe proceseve për menaxhimin e vazhdueshëm të riskut të sigurisë.

5. Monitorimi i vazhdueshëm i statusit të sigurisë së SKI-së.

Neni 25 Procesi i akreditimit të sigurisë

1. Procesi i akreditimit të sigurisë është tërësia e hapave që duhet të ndërmerren për të përcaktuar nëse masat e sigurisë së sistemit janë implementuar sipas kërkesave të kësaj rregulloreje. Procesi i



akreditimit të sigurisë është mekanizmi që garanton sigurinë e SKI-ve.

2. Procesi i akreditimit të sigurisë ndryshon në varësi të arkitekturës së SKI-së, në përputhje me këtë rregullore.

3. Procesi i akreditimit të sigurisë përfshin dy nivele:

- a) Certifikimi.
- b) Akreditimi.

Neni 26

Fazat e procesit të akreditimit të sigurisë

Procesi i akreditimit kalon në fazat si më poshtë:

1. Fillimi i procesit;
2. Verifikimi i sistemit;
3. Miratimi;
4. Aktivitet pas akreditimit.

Neni 27

Fillimi i procesit

1. Fillimi i procesit të akreditimit ka si objektiv njohjen me misionin e sistemit, përshkrimin e aspekteve funksionale dhe arkitekturën e sigurisë së sistemit, caktimin e roleve dhe përgjegjësi, me qëllim përcaktimin e kërkesave për akreditimin e sistemit.

2. Kjo fazë përfshin këto aktivitete:

a) inicimi i kërkesës:

i. kërkesa për akreditimin e sistemit drejtuar DSIK-së, duhet të përfshijë përshkrimin e sistemit sipas konceptit të operimit;

ii. pas marrjes së kërkesës, DSIK-ja e konsideron procesin e akreditimit të hapur dhe kërkon shpjegime të nevojshme ose korrigjime, nëse nevojitet;

iii. në rastet e kërkesës për riakreditim dërgohet versioni i fundit i Konceptit të Operimit;

b) negocimi, fazë në të cilën hartohet PASS:

i) AOS-i raporton tek AKAS-i datën në të cilën sistemi dhe mjedisi i sigurisë së tij (mjedisi i sigurisë lokale, globale dhe elektronike) janë gati për verifikim, në mënyrë që AKAS-i të skedulojë planin e akreditimit të sigurisë;

ii) AOS-i duhet të raportojë tek AKAS çdo lloj kushti shtesë (operacional, komercial ose strategjik), nëse ka, për t'u marrë në konsideratë nga AKAS-i për t'i dhënë prioritet akreditimit të këtij sistemi në fazat pasardhëse të procesit;

c) implementimi dhe dokumentimi i masave të sigurisë:

i. AOS-i, pas aprovimit të konceptimit të operimit, marrin masat për përgatitjen e dokumentacionit të sigurisë së sistemit, si dhe identifikimin dhe përmbushjen e aktiviteteve për akreditimin e sistemit;

ii. dokumentacioni i sigurisë së sistemit, së bashku me dokumente të tjera shtesë për aspekte të sigurisë së personelit, sigurimit industrial etj., dërgohet tek AKAS-i për aprovim;

iii. AOS-i, është përgjegjës për implementimin e sistemit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar në DSIK dhe masat e sigurisë të përshkruara në të.

Neni 28

Verifikimi i sistemit

1. Verifikimi ka si objektive rishikimin e dokumentacionit të sigurisë së sistemit dhe verifikimin e masave të sigurisë së sistemit me qëllim konfirmimin e sigurisë së sistemit dhe identifikimin e kërkesave të sigurisë që nuk janë përmbushur dhe dobësitë e sistemit.

2. Kjo fazë përfshin këto aktivitete :

- a) testim dhe vlerësim i sigurisë;
- b) testim i penetrimit në sistem;
- c) analizë e menaxhimit të sistemit;
- d) matjet TEMPEST të zonave të sigurisë;
- e) rishikim i menaxhimit të riskut.

3. Autoritetet e sigurisë kryejnë verifikimin e masave të sigurisë në përputhje me PASS dhe dokumentojnë rezultatet dhe riskun e mbetur në raportet përkatëse të testimit dhe vlerësimit.

4. AOS, përditësojnë sistemin dhe dokumentacionin me rekomandimet e rezultateve të verifikimit për ta bërë sistemin gati për akreditim.

5. Verifikimi i masave të sigurisë së sistemit kryhet me një nga këto metoda:

- a) testim;
- b) ekzaminim;
- c) intervistim.

Neni 29

Miratimi

1. Miratimi ka si objektiv autorizimin e sistemit për të operuar brenda kushteve të sigurisë.

2. Kjo fazë përfshin këto aktivitete:



a) certifikim: Autoritetet e sigurisë që kanë kryer verifikimin e masave të sigurisë lëshojnë certifikatën e sigurisë përkatëse për komponentët e sistemit që kanë verifikuar.

b) akreditim: AKAS-i verifikon dokumentacionin e sigurisë së sistemit, përfshirë raportet e vlerësimit dhe certifikatat e sigurisë, inspekton zbatimin e masave të sigurisë, vlerëson riskun e mbetur.

Neni 30

Akreditimi i Sigurisë

1. AKAS-i vendos, për:

a) Lëshimin e Deklaratës së Akreditimit të Sigurisë për një periudhë të caktuar kohore për mjedisin e planifikuar operacional, në të cilin përmbushen të gjithë kërkesat e sigurisë; Deklarata e Akreditimit të Sigurisë përcakton kushtet nën të cilat është i vlefshëm akreditimi i sigurisë. Periudha e vlefshmërisë së akreditimit ndryshon në varësi të nivelit të klasifikimit si më poshtë:

b) Tepër Sekret ose ekuivalent – 3 vjet;

c) Sekret ose ekuivalent – 3–4 vjet;

d) Konfidencial ose ekuivalent – 4–5 vjet;

e) I kufizuar ose ekuivalent – 5–7 vjet;

f) Lëshimin e Deklaratës së Përkohshme të Akreditimit të Sigurisë për një periudhë të caktuar kohore për mjedisin e planifikuar operacional, në të cilin nuk janë përmbushur të gjithë kërkesat e sigurisë. Deklarata e Përkohshme e Akreditimit të Sigurisë përcakton periudhën e vlefshmërisë si dhe kushtet dhe aktivitetet që duhen kryer për të kaluar në Deklaratë të Akreditimit të Sigurisë.

g) Lëshimin Autorizimit për Operim të Kufizuar autorizim i këshillueshëm nëse procesi i akreditimit nuk ka mbaruar. Ky lloj autorizimi lëshohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, kur kërkesat operationale tejkalojnë kërkesat e sigurisë (deri në 6 muaj, pa të drejtë shtyrje). Për këtë lloj autorizimi duhet më parë të miratohet koncepti i operimit.

h) Refuzimin e akreditimit të sigurisë; këtu përfshihet identifikimi i mangësive specifike dhe masave korrigjuese. AKAS-i i kërkon AOS-së hartimin e planit të veprimit për marrjen e masave korrigjuese.

i) Anulimin e akreditimit ekzistues të sigurisë; këtu përfshihet identifikimi i mangësive specifike dhe masave korrigjuese. AKAS-i i kërkon AOS-së

hartimin e planit të veprimit për marrjen e masave korrigjuese.

2. Akreditimi i sistemeve që trajtojnë informacion të klasifikuar të NATO-s, BE-së apo shteteve e organizatave të tjera ndërkombëtare bëhet në përputhje me marrëveshjet e sigurisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar si dhe duke aplikuar këtë rregullore në të gjithë aspektet e mundshme.

Neni 31

Aktivitetet pas akreditimit

1. Aktivitetet pas akreditimit fillojnë pasi sistemi është akredituar për operim dhe ka si objektiv garantimin e menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtës të sigurt të sistemi, si dhe mbajtjen në nivel të pranueshëm të riskut të mbetur.

2. Kjo fazë përfshin këto aktivitete:

a) Përdorimi i sistemit:

i. Pas lëshimit të Deklaratës së Akreditimit të Sigurisë (DAS), AOS është përgjegjës për menaxhimin e sigurisë së sistemit dhe ruajtjen e kushteve të sigurisë nën të cilat u bë i mundur lëshimi i DAS.

ii. AKAS mbikëqyr sigurinë e SKI-ve nën përgjegjësinë e saj nëpërmjet verifikimeve periodike të sigurisë për të garantuar që sistemet e akredituara trajtojnë informacion të klasifikuar në të njëjtat kushte sigurie në të cilat u dha akreditimi.

b) Riakreditim, i cili kryhet në këto raste:

i. Pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së Deklaratës së Akreditimit të Sigurisë, sistemi nuk është i autorizuar të trajtojë informacion të klasifikuar.

ii. Nëse ndodhin ndryshime në sistem që ndikojnë në kushtet e sigurisë të tilla si:

- Ndryshimet në nivelin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në SKI.

- Ndryshimet në kërkesat e sigurisë që vijnë si pasojë e ndryshimeve të legjislacionit për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

- Ndryshimet në arkitekturën e sistemit.

- Ndryshimet në konfigurimet e sigurisë së SKI-së.

- Ndryshimet në kërkesat operationale.

- Identifikimin e kërcënimeve ose dobësive të reja në sisteme.

- Identifikimin e mosfunksionimit të masave të sigurisë.



- Përhapjen e një incidenti të rëndë të sigurisë kompjuterike ose të sigurisë në përgjithësi dhe që ndikon në akreditimin e sigurisë së sistemit.

- Ndryshime të rëndësishme në strukturën fizike të ndërtesës ose të POS-eve.

iii. AOS-i është përgjegjës për njoftimin e AKAS-së për ndryshimet në sistem që në fazën e planifikimit të tyre.

iv. AOS-i është përgjegjëse për iniciimin e procedurës së riakreditimit të sistemit 4 muaj para afatit të përfundimit të vlefshmërisë së akreditimit.

c) Nxjerrja jashtë përdorimit e sistemit:

i. AOS-i është përgjegjës për marrjen e masave të përshtatshme për arkivimin ose deklasifikimin dhe/ose shkatërrimin e SKI dhe informacionit që ruhet në të si dhe raportimin tek AKAS-i që në fazën e planifikimit të nxjerrjes jashtë përdorimit.

ii. Procedurat që do të ndiqen përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet e sigurisë së sistemit.

PJESA II

KËRKESAT E SIGURISË SË SISTEMEVE

KREU I

SIGURIA FIZIKE E SISTEMEVE

Neni 32

Mjediset dhe infrastruktura e rrjetit

1. AOS-i të aplikojnë masat e sigurisë fizike të mjediseve dhe infrastrukturës së rrjetit për mbrojtjen e sistemeve.

2. Sistemet të instalohen dhe operojnë në zona sigurie të klasit I ose II.

3. Në rastet e shkëmbimit të informacionit të klasifikuar në formë elektronike jashtë zonave të sigurisë të aplikohet mbrojtja kriptografike e informacionit.

Neni 33

Sigurimi fizik i serverëve dhe pajisjeve të komunikimit

1. Serverët dhe pajisjet e komunikimit të vendosen në ambiente të veçanta të ndara nga zyrat e përdoruesve.

2. Sallat e serverëve dhe/ose pajisjeve të komunikimit të vendosen në zona sigurie të klasit I.

3. Sallat e serverëve dhe/ose pajisjeve të komunikimit si dhe *rack*-et të sigurohen nga aksesit i paautorizuar ose dëmtimet fizike.

4. Çelësat ose mekanizmat ekuivalentë të aksesit të dhomave të serverëve dhe/ose pajisjeve të komunikimit si dhe *rack*-eve të kontrollohen përshtatshëm.

5. Në ambientet ku administrohen materiale ose sisteme të një rëndësie të veçantë (p.sh. materiale kriptografike) të vendosen masa shtesë sigurie si, përforcimi i integritetit të sigurisë nëpërmjet dy personave, ku të gjitha veprimet dëshmojnë nga minimalisht një person tjetër i kualifikuar. Në këto zona duhet të sigurohen të gjitha pikat e hyrjeve dhe daljeve.

Neni 34

Sigurimi fizik i pajisjeve dhe mediave kompjuterike

1. Pajisjet dhe mediat elektronike që ruajnë informacion të klasifikuar të regjistrohen në regjistra të veçantë me numër unik identifikimi dhe të ruhen në përputhje me kërkesat e sigurisë, si gjatë orarit zyrtar të punës ashtu edhe jashtë tij. Të kryhen inventarë vjetorë për gjendjen e tyre.

2. Pajisjet dhe mediat elektronike që ruajnë informacion të klasifikuar të administrohen brenda zonave të sigurisë.

3. Në rastet kur nuk është e mundur të aplikohen masat e përshtatshme të sigurimit fizik të pajisjeve dhe mediave kompjuterike, të bëhet fshirja e memories RAM si dhe të përdoret një nga metodat e mëposhtme:

a) përdorimi i hard diskut të jashtëm, i cili të ruhet në kasafortë jashtë orarit zyrtar të punës;

b) konfigurimi i sistemit për të penguar ruajtjen e të dhënave lokalisht;

c) përdorimi i programeve kriptografike për kriptimin e pajisjeve dhe mediave kompjuterike.

KREU II

SIGURIA E PERSONELIT TË SISTEMEVE

Neni 35

Edukimi për sigurinë e informacionit

1. AOS-i ngarkohen me hartimin dhe aplikimin e programeve të edukimit të personelit për sigurinë e informacionit.



2. Qëllimi i këtyre programeve është njohja e personelit me rolet dhe përgjegjësitë, pasojat në rast moszbatimi të rregullave të sigurisë, si dhe risqet e mundshme të sigurisë e masat përkatëse.

Neni 36

Autorizimi, certifikimi dhe brifimi i personelit

1. Aksesit në sistem lejohet vetëm për personat e autorizuar, të certifikuar dhe të brifuar përshtatshmërisht për aksesin në sistem.

2. AOS-i kanë detyrë:

a) të kufizojnë aksesin në sistem sipas nevojës për njohje;

b) të lejojnë aksesin në sistem vetëm pas autorizimit të kërkesës për akses dhe njohjen me procedurat e operimit të sigurt të sistemit;

c) t'u japin përdoruesve të drejtat minimale që u nevojiten për kryerjen e detyrave të tyre;

d) të rishikojnë autorizimet dhe të drejtat e aksesit të paktën një herë në vit si dhe kur personeli ndryshon detyrën;

e) gjatë rishikimit të autorizimeve për akses, të konfirmojnë vlefshmërinë e nevojës për aksesimin e sistemit, në të kundërt të heqin të drejtën e aksesit.

3. AOS-i mbajnë rekordet e sakta, për:

a) të gjithë personelin e autorizuar për të aksesuar sistemin;

b) personin/personat që dhanë autorizimin për të aksesuar sistemin;

c) datën e dhënies së autorizimit;

d) datat e rishikimit të autorizimit;

e) datën e heqjes së autorizimit.

4. AOS-i të mbajnë rekordet gjatë gjithë jetëgjatësisë së sistemit në të cilin është lejuar aksesit.

KREU III

SIGURIMI INDUSTRIAL

Neni 37

Siguria industriale

Në rastet e prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve për sisteme ku trajtohet informacion i klasifikuar “Sekret shtetëror”, operatorët ekonomikë që do të ofrojnë produkte ose shërbime të jenë të certifikuar përshtatshmërisht.

Neni 38

Kontratat e klasifikuara

Mallrat, punët dhe shërbimet të cilat do të prokurohen, të jenë si rezultat i kontratave të klasifikuar.

KREU III

SIGURIA E KOMUNIKIMEVE

Neni 39

Infrastruktura e komunikimeve

(Menaxhimi i kablllove)

1. AOS-i të grupojnë kabllot në kanalina si më poshtë:

a) grupi 1 – Kabllot e sistemeve të paklasifikuar;

b) grupi 2 – Kabllot e sistemeve “i Kufizuar”, “Konfidencial” dhe “Sekret”;

c) grupi 3 – Kabllot e sistemeve “Tepër Sekret”.

2. Fibrat optike, pavarësisht grupit ku bëjnë pjesë, mund të grupohen në të njëjtën kanalinë.

3. Kabllot e informacionit të klasifikuar të përfundojnë në kabinete të veçanta.

4. Në rast të niveleve të ndryshme të klasifikimit, kabinetet të ndahen me pllaka ndarëse për secilin nivel klasifikimi.

5. Kabinetet e sistemeve të klasifikuara të jenë në largësi nga kabinetet e sistemeve të paklasifikuar minimalisht 50 cm.

6. Rrjetet e kabllimit të përfundojnë sa më afër kabineteve.

7. Kabllot të etiketohen me numrin unik të identifikimit dhe të shenjëzohen, në pikat e inspektimit, me shenja dalluese sipas skemës së mëposhtme:

a) shirit portokalli – “Tepër Sekret”;

b) shirit i kuq – “Sekret”;

c) shirit blu – “Konfidencial”;

d) shirit i bardhë – “i Kufizuar”.

8. Prizat e rrjetit të etiketohen me nivelin e klasifikimit, numrin e kabllot dhe numrin e prizës së rrjetit.

9. Kabllot dhe prizat e rrjetit të dokumentohen në regjistrin e kablllove dhe prizave të rrjetit me numrin përkatës dhe nivelin e klasifikimit. Për secilin kabull të dokumentohet burimi dhe destinacioni.



10. Procedura e etiketimit dhe regjistrimit të kabllave dhe prizave të rrjetit të dokumentohet në POS.

11. Të ndahen fizikisht *patch* panelet e sistemeve të klasifikuar nga ato të paklasifikuara, duke i instaluar ato në kabinete të veçantë.

Neni 40

Siguria e emetimeve

Sistemet që përdoren për trajtimin e informacionit të klasifikuar “Konfidencial” e lart, të mbrohen nga emetimet elektromagnetike kompromentuese, studimi dhe kontrolli i të cilave referohet si “TEMPEST”, sipas rregullave dhe procedurave të specifikuara me rregullore të veçantë.

Neni 41

Sistemet dhe pajisjet e komunikimit

(Pajisjet RF, *infrared* dhe *bluetooth*)

1. Në zonat e sigurisë ndalohet përdorimi i pajisjeve të tilla si:

- a) akses point;
- b) tastiera *infrared*, *bluetooth* ose *wireless*;
- c) pajisje RF.

2. Përjashtim bëhet vetëm në rastet kur merret autorizimi nga AKAS-i.

3. AOS implementojnë masa sigurie për identifikimin e pajisjeve të paautorizuara RF, aktive në zonat e sigurisë.

Neni 42

Sistemet dhe pajisjet e komunikimit (Pajisjet faks dhe pajisjet faks multifunkionale)

1. AOS-i që përdorin pajisje faks dhe pajisje faks multifunkionale të hartojnë procedurat për përdorimin e sigurt të tyre.

2. AOS-i të përdorin pajisje faks për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar të ndryshme nga pajisjet faks të paklasifikuara.

3. AOS-i të sigurojnë që mesazhet faks të jenë të kriptuara në përputhje me nivelin e informacionit që transmetohet.

4. Pajisjet faks multifunkionale, të lidhura me rrjete kompjuterike të klasifikuara, ndalohet të lidhen

drejtpërdrejt me rrjete të telefonisë digjitale të paakredituar përshtatshmërisht.

5. Pajisjet faks multifunkionale, të lidhura me rrjete kompjuterike të klasifikuara, ndalohet të përdoren për skanimin ose fotokopjimin e dokumenteve në nivel më të lartë klasifikimi.

Neni 43

Telefonat dhe sistemet telefonike

1. AOS-i të hartojnë procedurat për përdorimin e sigurt të telefonave dhe sistemeve telefonike.

2. AOS-i të sigurojnë, që:

- a) sistemet telefonike të klasifikuara të akreditohen përshtatshmërisht;
- b) trafiku i të dhënave të klasifikuara të kriptohej përshtatshmërisht.

3. Nuk lejohet përdorimi i telefonave (receptorëve telefonik) pa kordë për informacionin e klasifikuar, pavarësisht nëse lidhet me pajisje të sigurta telefonike.

KREU IV

SIGURIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Neni 44

Siguria e pajisjeve TIK

1. AOS-i të për zgjedhin produkte të vlerësuar sipas një standardi të mirënjohur ndërkombëtar për funksionin e sigurisë që duan të implementojnë.

2. AOS-i të përdorin produkte të vlerësuar sipas një listë të njohur sipas standardeve kombëtare, të NATO-s, BE-së, përveç nëse është vlerësuar, pranuar dhe dokumentuar risku i sigurisë që lidhet me përdorimin e tyre.

3. AOS-i të kontrollojnë dokumentacionin e vlerësimit të produktit, nëse disponohet, të përcaktojnë kërkesat specifike të produktit dhe të përmbushin këto kërkesa për përdorimin e sigurt të produktit.

4. AOS-i të sigurojnë transportin e sigurt të produkteve në përputhje me legjislacionin për sigurinë e informacionit.



Neni 45
Kufizime

AOS-i ndalohet të përdorin në SKI produkte që nuk janë pronë e institucionit, pronë e AKSHI-t, ose për rastet e akreditimit të SKI-ve për operatorët ekonomik pronë e vetë operatorit, me përjashtim të rasteve kur ka marrëveshje sigurie me shtete dhe/ose organizata ndërkombëtare.

Neni 46
Siguria e produkteve
(Instalimi dhe konfigurimi i produkteve)

1. AOS-i të instalojnë, konfigurojnë, operojnë dhe administrojnë produktet në përputhje me kërkesat e sigurisë së produktit.

2. Institucionet shtetërore të etiketojnë produktet dhe pajisjet e TIK-ut sipas nivelit më të lartë të informacionit që trajtojnë.

3. Produktet dhe pajisjet e TIK-ut të etiketohen me numrin unik të identifikimit dhe nivelin e klasifikimit përkatës dhe të shenjëzohen me shenja dalluese sipas skemës së mëposhtme:

- a) shirit portokalli – “Tepër Sekret”;
- b) shirit i kuq – “Sekret”;
- c) shirit blu – “Konfidencial”;
- d) shirit i bardhë – “i Kufizuar”.

Neni 47
Siguria e produkteve
(Mirëmbajtja dhe riparimi i produkteve)

Mirëmbajtja dhe riparimi i produkteve dhe pajisjeve të TIK-ut të bëhet brenda zonave të sigurisë dhe nga personel i certifikuar përshtatshmërisht.

Neni 48
Rastet e mirëmbajtjes në kushtet e emergjencës

Në raste emergjente, kur mirëmbajtja dhe riparimi i produkteve dhe pajisjeve të TIK është e pamundur të bëhet nga personel i certifikuar ose brenda zonave të sigurisë, institucionet shtetërore duhet të përmbushin këto detyrime:

1. Të dokumentojnë rastin dhe nevojën për një ndërhyrje të tillë.

2. Nëse është e mundur, të heqin pjesët e memories dhe të deklasifikojnë produktin ose pajisjen e TIK që do të mirëmbahet apo riparohet përpara ndërhyrjes nga persona të pacertifikuar ose jashtë zonës së sigurisë.

3. Nëse vlerësohet, të pastrohet dhe deklasifikohet produkti ose pajisja e TIK që do të mirëmbahet apo riparohet përpara ndërhyrjes për mirëmbajtje ose riparim jashtë zonës së sigurisë.

4. Personeli teknik që do të kryejë mirëmbajtjen të mbikëqyret gjatë gjithë kohës nga personel i institucionit i certifikuar dhe brifuar përshtatshmërisht.

Neni 49
Pastrimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit e pajisjeve TIK

1. Me pastrim dhe nxjerrje jashtë përdorimit të pajisjeve të TIK nënkuptohet pastrimi i komponentëve memorizues të tyre në mënyrë të pakthyeshme.

2. Komponentët memorizues brenda pajisjeve të TIK janë:

- a) komponentë me memorie elektrostatische;
- b) memorjet magnetike të qëndrueshme;
- c) memorjet me gjysëmperçjells;
- d) memorjet e paqëndrueshme.

3. AOS-i të hartojnë procedura të mirëpërcaktuara për pastrimin e komponentëve memorizues të pajisjeve TIK përpara se t'i nxjerrin jashtë përdorimit sipas modelit të ofruar nga DSIK.

4. AOS-i të pastrojnë komponentët memorizues të pajisjeve TIK duke mbishkruar tërësisht memorien të paktën dy herë me një model të rastësishëm, ndjekur nga një rilexim për verifikim dhe nga shkëputja e energjisë për të paktën dhjetë minuta.

5. Nëse rileximi është i pamundur ose nëse në komponentët memorizues ekziston informacion i klasifikuar, ndiqen procedurat e shkatërrimit shpjeguar më poshtë.

6. Pas procedurave të pastrimit pajisjet TIK dhe komponentët e tyre memorizues trajtohen si më poshtë:



Niveli i klasifikimit para pastrimit	Niveli i klasifikimit pas pastrimit
Tepër Sekret	Tepër Sekret
Sekret	Konfidencial
Konfidencial	I paklasifikuar
I Kufizuar	I paklasifikuar

7. Procedurat e pastrimit inician nga pajisje të tjera TIK, të ndryshme nga pajisjet që i nënshtrohen procesit të pastrimit.

8. Rast përjashtimi nga ripërdorimi në rrjet të klasifikuar është kur në komponentët memorizues të pajisjeve TIK është ruajtur çelës kriptografik statik.

Neni 50

Shkatërrimi dhe asgjësimi i pajisjeve TIK

1. AOS-i të hartojnë procedura të mirëpërcaktuara për shkatërrimin e komponentëve memorizues të pajisjeve TIK.

2. Procedura të mbikëqyret nga të paktën tre punonjës të certifikuar në nivelin e klasifikimit të pajisjeve që po i nënshtrohen kësaj procedure.

3. Të përdoret një nga metodat si në tabelë:

Produkti hardware	Metodat e shkatërrimit					
	Furrë djegie	Mulli me goditje	Disintegrator / Shpërbërës	Grirës/ Grimcues	Prerës	Degausser/ Demagnetizues
Pajisje me memorie elektrostatische	PO	PO	PO	PO	JO	JO
Floppy disk magnetik	PO	PO	PO	JO	PO	PO
Hard disk magnetik	PO	PO	PO	PO	JO	PO
Shirit magnetik	PO	PO	PO	JO	PO	PO
Disk optik	PO	PO	PO	PO	PO	JO
Memorie me gjysëmpërcjellës	PO	PO	PO	JO	JO	JO

4. Në rastet e përdorimit të pajisjes Degausser / Demagnetizues për shkatërrim, pajisja duhet të jetë e certifikuar dhe akredituar nga DSIK-u.

5. Gjatë përdorimit të pajisjes Degausser / Demagnetizues, testohet rregullisht fuqia e fushës për të konfirmuar se procedura po kryhet konform kërkesave.

6. Të hartohen procedura të mirëpërcaktuara për trajtimin e mbetjeve të komponentëve memorizues të pajisjeve TIK pas deklasifikimit dhe shkatërrimit.

Neni 51

Siguria e aplikacioneve (Të përgjithshme)

1. AOS-i duhet që:

a) të përdorin aplikacione të licensuara, të miratuara nga AKAS.

b) janë përgjegjës për regjistrimin, kontrollin dhe ruajtjen për arsye *backup*-i të aplikacioneve që kanë në përdorim, dhe nëse aplikohet për shenjëzimin e tyre përshtatshmërisht me nivelin e klasifikimit.

c) Të dokumentojnë në dokumentet e sigurisë së sistemit (DSS dhe/ose POS) funksionet e sigurisë së aplikacioneve, nëse aplikohet.



d) Të lejojnë transferimin manual të të dhënave ndërmjet SKI-ve nëpërmjet mediave të lëvizshme nën kontroll të rreptë dhe vetëm në rrethana kur nevojat operationale e kërkojnë këtë transferim. Institucionet shtetërore të përcaktojnë dhe dokumentojnë procedurat e transferimit manual të të dhënave në POS të sistemit.

2. AOS-i të ndalojnë:

a) ndryshimet në konfigurimet e aplikacioneve ose në vetë aplikacionin pa aprovimin paraprak të titullarit të institucionit. Nëse këto ndryshime ndikojnë në profilin e sigurisë së sistemit, të merret paraprakisht miratimi i AKAS-ut;

b) përdorimin e autorizuar dhe të paautorizuar të SKI-ve të aksesojnë sistemin duke përdorur kredenciale dhe/ose identitete të tjera;

c) përdorimin e llogarive në grup në sisteme të klasifikuar në nivel Konfidencial e lart që operojnë në mënyrën e lartë të sigurisë ose në mënyrën me shumë nivele. Në SKI-të që operojnë në mënyrën e dedikuar, mund të përdoren llogaritë në grup me kusht që të aprovohen nga AKAS-i rast pas rasti. Megjithatë, në çdo rast të merren masat përkatëse për identifikimin, autentifikimin dhe mbajtjen në llogari të individëve që aksesojnë llogaritë në grup.

Neni 52

Mjediset e operimit standard

Në mjediset e operimit standard merren masat që:

1. Të sigurojnë çaktivizimin, riemërimin ose ndryshimin e fjalëkalimeve të llogarive default të sistemeve operative.

2. Të fshijnë ose çaktivizojnë llogaritë e përdoruesve, aplikacionet, komponentët, shërbimet dhe funksionalitetet e panevojshme në sistem.

3. Të çaktivizojnë llogaritë e administratorëve lokalë dhe të përdorin llogari domaini me të drejta administrative lokale.

4. Të aktivizojnë dhe konfigurojnë funksionet e sigurisë që ofrojnë aplikacionet dhe të çaktivizojnë funksionet e panevojshme për përdoruesit.

5. Të ndjekin udhëzimet e prodhuesve, nëse ka, për konfigurimin e sigurt të produkteve të tyre.

6. Të përdorin metoda të kontrollit të aplikacioneve për kufizimin e ekzekutimit të programeve, dll-ve dhe skripteve sipas një liste të miratuar.

7. Të konfigurojnë mekanizmat e kontrollit të aplikacioneve për gjenerimin e logeve gjatë ndërhyrjeve të dështuara dhe të regjistrojnë informacion në lidhje me *file*-t e bllokuara, kohën dhe përdoruesin që tentoi të ekzekutojë *file*-n.

8. Të përdorin sisteme të parandalimit të ndërhyrjeve *host-based* në serverë që administrojnë informacion të klasifikuar në nivel “Sekret” dhe “Tepër sekret”.

9. Të përdorin aplikacione *firewall software-based* për të kufizuar lidhjet hyrëse dhe dalëse të rrjetit.

10. Të përdorin aplikacione të kontrollit të pajisjeve periferike për të parandaluar përdorimin e paautorizuar të mediave kompjuterike dhe pajisjeve në kompjuterë dhe serverë.

11. Të mos lejojnë përdoruesit të çaktivizojnë ose tejkalojnë mekanizmat e kontrollit të aplikacioneve.

12. Të mos lejojnë përdoruesit të instalojnë, çinstalojnë ose çaktivizojnë aplikacione.

13. Të mos lejojnë pajisje të lidhen njëkohësisht në dy rrjete të ndryshme.

Neni 53

Mbrojtja nga aplikacionet keqdashëse dhe viruset kompjuterike

1. AOS-i duhet të përdorin programe kundër aplikacioneve keqdashëse dhe viruseve kompjuterike në sistemet e tyre dhe të dokumentojnë detajet që lidhen me to, përfshirë kërkesat dhe procedurat për përditësim dhe skanim si dhe personat përgjegjës për përditësimin e tyre dhe ndjekjen e procedurave të sigurisë.

2. AOS-i të sigurojnë që këto programe:

a) përditësohen rregullisht.

b) janë konfiguruar për skanim automatik dhe periodik të disqeve dhe mediave të lëvizshme.

3. AOS-i të dokumentojnë në POS instruksionet për veprimet që duhen ndërmarrë dhe raportimin e incidenteve që lidhen me infektimet e aplikacioneve keqdashëse dhe viruseve kompjuterike.

Neni 54

Përditësimi (*patching*) i software-ve

1. AOS-i duhet që:

a) të përfshijnë në POS procedurat e menaxhimit të përditësimeve të sistemeve



operative, aplikacioneve, driverave dhe firmware-ve të pajisjeve.

b) të monitorojnë burimet e informacionit për dobësitë e reja dhe përditësimet përkatëse për sistemet operative, aplikacionet, driverat dhe firmware-t e pajisjeve.

2. Sistemet operative, aplikacionet dhe pajisjet hardware që nuk suportohen më nga prodhuesi të zëvendësohen me një version që suportohet nga prodhuesi ose me një version të suportueshëm nga një prodhues tjetër.

Neni 55

Zhvillimi i aplikacioneve

1. Gjatë zhvillimit të aplikacioneve për trajtimin e informacionit të klasifikuar, të merret në konsideratë përmbushja e objektivave të sigurisë gjatë gjithë fazave të zhvillimit të aplikacioneve (dizenjimi, zhvillimi, shpërndarja dhe mirëmbajtja).

2. Aplikacionet t'u nënshtrohen procesit të testimit të sigurisë, menaxhimit të konfigurimeve dhe kontrollit të ndryshimeve.

3. AOS-i të mos lejojë aksesin e paautorizuar në kodin burim të aplikacioneve.

Neni 56

Implementimi i teknologjisë web në sistemet e klasifikuar

1. AOS-i të hartojnë dhe dokumentojnë procedurat për implementimin dhe përdorimin e shërbimeve intranet në sistemet e tyre.

2. AOS-i të sigurojnë që të gjithë faqet web të shenjëzohen përshtatshëmrisht me nivelin më të lartë të klasifikimit të informacionit që përmbahet në atë faqe.

3. AOS-i të sigurojnë vlefshmërinë dhe/ose pastrimin e të gjithë inputit në një aplikacion web.

4. AOS-i të implementojnë kontrollet e sigurisë së browser-ave për mbrojtjen e aplikacioneve web dhe përdoruesve të tyre.

Neni 57

Sistemet e databazave

AOS-i duhet që:

1. të mirëmbajnë dhe monitorojnë rregullisht inventarin e saktë të databazave që kanë në zotërim dhe përmbajtjeve të tyre.

2. Të fshijnë të gjithë skedarët dhe loget e përkohshme të instalimit pas instalimit të sistemeve për menaxhimin e databazave.

3. Të konfigurojnë në mënyrë të sigurt sistemet e menaxhimit të databazave në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

4. Të fshijnë të gjithë databazat model që instalohen me sistemin e menaxhimit të databazave.

5. Të konfigurojnë sistemin e menaxhimit të databazave të funksionojë nën një llogari të veçantë përdoruesi me minimumin e privilegjeve që nevojiten për kryerjen e funksioneve. Kjo llogari të ketë akses të kufizuar në zona joesenciale të sistemit të skedarëve të serverit të databazës.

6. Të sigurojnë ruajtjen e fjalëkalimeve të kriptuara me algoritma të fortë kriptimi në databaza.

7. Të aplikojnë kontrolle aksesi në skedarët e databazave.

8. Të kriptojnë harddisqet e serverave të databazave plotësisht (*full disk encryption*).

9. Të shenjëzojnë përshtatshëmrisht databazat ose përmbajtjet e tyre.

10. Të ndajnë privilegjet e përdoruesve të databazës sipas nevojës për njohje duke u dhënë atyre privilegjet e nevojshme për akses, futje të dhënash, modifikim ose fshirje të dhënash në databazë sipas detyrave përkatëse.

11. Të çaktivizojnë, rëmërojnë ose ndryshojnë fjalëkalimet e llogarive default të administratorëve të databazave.

12. Të sigurojnë që administratorët e databazave të kenë llogari unike dhe të identifikueshme për secilin administrator.

13. Të sigurojnë që llogaritë e administratorëve të databazave të përdoren ekskluzivisht për detyra administrative.

14. Të sigurojnë që administratorëve të databazave t'u jepet akses sipas roleve që kanë dhe jo të gjitha të drejtat ose të drejtat default të administratorëve.

15. Të fshijnë llogaritë anonime të databazave.

16. Serverët e databazave dhe serverët web të ndahen funksionalisht, nëpërmjet një ndarje fizike ose virtuale.

17. Të vendosin serverët e databazave në një segment rrjeti të ndryshëm nga kompjuterët e përdoruesve.



18. Të implementohen kontrollet e aksesit të rrjetit për të kufizuar komunikimet e serverëve të databazave me pjesët e tjera të rrjetit sipas një skeme të mirëpërcaktuar.

19. Të filtrojnë të gjithë pyetësorët (*queries*) nga aplikacionet web në sistemet e databazave për përmbajtje të ligjshme dhe sintaksë korrekte.

20. Të përdorin pyetësorë me parametra të caktuar ose procedura të ruajtura në vend të pyetësorëve të gjeneruar automatikisht.

21. Të kriptohet informacioni që komunikohet ndërmjet sistemeve të databazave dhe aplikacioneve web.

22. Të dizenojnë aplikacione web që të ofrojnë sa më pak informacion të sistemit të menaxhimit të databazave dhe skemave të databazave për përdoruesit gjatë gabimeve që mund të ndodhin në sistem.

23. Të mos lejojnë ose fshijnë të gjithë funksionet dhe procedurat e ruajtura të panevojshme të sistemeve për menaxhimin e databazave.

24. Të mos lejojnë opsionet e sistemit të menaxhimit të databazave për leximin e filave lokale nga serveri.

25. Të mos kryejnë aktivitete testimi dhe zhvillimi të databazave në serverët e databazave në përdorim.

26. Të mos përdorin informacion të klasifikuar në mjediset e testimit dhe zhvillimit të databazave, përveç nëse janë akredituar përshtatshmërisht me nivelin më të lartë të informacionit që trajtojnë.

Neni 58

Siguria e e-mail-eve (Posta elektronike)

AOS-i që kërkojnë të implementojnë shërbimet e postës elektronike në sistemet e klasifikuara duhet:

1. Të sigurojnë që infrastruktura e postës elektronike të jetë pjesë e sistemit të klasifikuar dhe të mos ketë lidhje me sisteme të tjera të paakredituara përshtatshmërisht.

2. Të hartojnë procedura për përdorimin e sigurt të postës elektronike të klasifikuar.

3. Të implementojnë masat e nevojshme që sigurojnë ndjekjen e këtyre procedurave.

4. Të shenjëzojnë mesazhet e postës elektronike në përputhje me nivelin e informacionit që mezazhi

përmban dhe nivelin e informacionit të dokumenteve bashkëlidhur, nëse ka.

Neni 59

Kontrolli i aksesit

1. AOS-i të implementojnë dhe dokumentojnë procedurat për identifikimin, autentifikimin dhe autorizimin e çdo entiteti (person, pajisje apo shërbim) që ka qasje në sistem apo informacionin e klasifikuar që trajtohet në të.

2. AOS-i të sigurojnë që çdo përdorues:

a) Të identifikohet në mënyrë unike.

b) Të autentifikohet në çdo rast që i miratohet qasja në sistem.

c) Të autorizohet sipas parimit “nevojë për njohje”.

3. AOS-i, të cilat përdorin fjalëkalimin si të vetmen metodë autentifikimi, të implementojnë një nga politikat e mëposhtme:

a) fjalëkalimi të jetë i përbërë nga minimalisht 13 karaktere jo kompleks

b) fjalëkalimi të jetë i përbërë nga minimalisht 10 karaktere dhe në përbërje të ketë shkronja të vogla, shkronja të mëdha, numra dhe karaktere specifike (të paktën një prej secilit tip në çfarëdolloj renditje).

4. Për sistemet ku trajtohet informacion i klasifikuar në nivel “Tëpër Sekret” AOS të implementojnë një nga politikat e mëposhtme:

a) Fjalëkalimi të jetë i përbërë nga minimalisht 15 karaktere jo kompleks

b) Fjalëkalimi të jetë i përbërë nga minimalisht 11 karaktere dhe në përbërje të ketë shkronja të vogla, shkronja të mëdha, numra, karaktere specifike.

5) AOS-i, në varësi të rezultateve të raportit të vlerësimit të riskut, të implementojnë një metodë të kombinuar autentifikimi për përdoruesit e privilegjuar si:

a) administrator sistemi;

b) administrator database-i;

c) përdorues me të drejta jo të kufizuara;

d) përdorues me të drejta të Aksesit në largësi;

e) përdorues.

6. AOS të ndjekin praktikën e mëposhtme për menaxhimin e fjalëkalimeve:

a) të sigurojnë që fjalëkalimet të ndryshohen çdo 90 ditë.



b) të parandalojnë ndryshimin e fjalëkalimeve nga përdoruesit më shumë se një herë në ditë.

c) të parandalojnë përdorimin e të njëjtit fjalëkalim në vazhdimësi. I njëjti fjalëkalim mund të përdoret vetëm pas 8 fjalëkalimesh të ndryshme.

d) të parandalojnë ruajtjen e fjalëkalimeve në tekst të hapur.

e) të bllokojnë llogarinë e përdoruesit pas maksimumi 5 përpjekjesh të dështuara për akses/qasje në llogari.

f) të dokumentojnë dhe implementojnë mënyrat e rivendosjes (riset) së fjalëkalimeve pas bllokimit të aksesit/qasjes në llogari.

g) gjatë aktivizimit të llogarisë për herë të parë, përdoruesit t'i vihet në përdorim një fjalëkalim "i përdorshëm vetëm një herë" dhe të detyrohet të ndryshojë fjalëkalimin gjatë logimit në sistem.

7. AOS-i të dokumentojnë dhe implementojnë procedurat për mbylljen e sesionit apo ekranit.

8. AOS-i të fshijnë ose pezullojnë llogaritë e përdoruesve në të njëjtën ditë që përdoruesit nuk kanë ligjërisht të drejta aksesit/ qasje në sistem.

9. AOS-i të implementojnë banera logimi ku të informojnë përdoruesit mbi të drejtat që kanë në sistem, përgjegjësit dhe detyrimet ligjore.

Neni 60

Auditimi dhe ruajtja e logeve të sigurisë

1. AOS të hartojnë dhe implementojnë procedurat për ruajtjen dhe auditimin e log-eve.

2. Institucionet shtetërore të ruajnë minimalisht ngjarjet që lidhen me:

a) veprimet e privileguara;

b) shtimin, fshirjen dhe modifikimin e të drejtave të aksesit të përdoruesve dhe grupeve;

c) përpjekjet e dështuara për akses/qasje në sisteme dhe file kritike;

d) paralajmerime (alert) dhe dështime që lidhen me sigurinë e sistemit;

e) hyrjet/daljet në sistem;

f) përpjekjet e dështuara për hyrje në sistem.

3. Për çdo ngjarje të ruhet:

a) data dhe ora e ngjarjes.

b) përdoruesi apo procesi që lidhet me ngjarjen.

c) përshkrim i ngjarjes.

d) dështim apo suksesi i ngjarjes.

e) burimi i ngjarjes (p.sh. emri i aplikacionit).

f) vendndodhja/ identifikimi i pajisjes ku ka ndodhur.

4. Këto rekorde të ruhen sipas një periudhe të rënë dakord ndërmjet AKAS dhe AOS të specifikuar në DSS dhe POS përkatëse. Për informacionin e klasifikuar në nivel "Tepër sekret" kjo periudhë të jetë minimalisht 5 vjet.

5. Informacioni i auditimit të mbrohet nga aksesit, ndryshimi ose fshirja e paautorizuar.

6. Anomalitë dhe incidentet e sigurisë të raportohen tek AKAS-i.

Neni 61

Menaxhimi i rrjetit

1. AOS-i duhet që:

a) të menaxhojnë rrjetet në mënyrë të përqendruar.

b) të dokumentojnë dhe aprovojnë të gjitha ndryshimet në konfigurimet e rrjetit.

c) Të kontrollojnë vazhdimisht përputhjen e konfigurimeve të rrjetit me konfigurimet e dokumentuara.

2. Dokumentacioni i konfigurimeve/rrjetit të përfshijë:

a) diagramin e rrjetit ku tregohen të gjitha lidhjet e rrjetit;

b) diagram logjike të rrjetit ku tregohen të gjitha pajisjet e rrjetit, shërbimet dhe serverët;

c) konfigurimet e pajisjeve të rrjetit.

3. Dokumentacioni i konfigurimeve/rrjeti të përditësohet me ndryshimet e fundit dhe të klasifikohet në tërësi me nivelin më të lart të informacionit që trajtohet në rrjet.

4. Dokumentacioni i rrjetit që u vihet në dispozicion palëve të treta të përmbajë vetëm detajet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve, shërbimeve sipas kontratës.

5. AOS-i të inventarizojnë pajisjet e rrjetit, të përditësojnë dhe auditojnë inventarin rregullisht.

Neni 62

Dizenjimi dhe konfigurimi i rrjetit

1. AOS-i të implementojnë kontrollet mbi aksesimin e rrjetit për të kufizuar trafikun sipas nevojës për njohje brenda dhe ndërmjet segmenteve të rrjetit.

2. Në rastet kur informacioni i klasifikuar procesohet, ruhet apo komunikohet nga sisteme të cilat nuk janë në kontroll të institucionit, ai duhet të



sigurojë që pala tjetër ka aplikuar masat e duhura të sigurisë në përputhje me këtë rregullore.

3. AOS-i:

a) të çaktivizojnë portat fizike të pa përdorura në pajisjet e rrjetit.

b) të çaktivizohen, riemërtohen ose të ndryshohen fjalëkalimet të tyre llogarive *default* në pajisjet e rrjetit.

c) të sinkronizohet koha në të gjitha pajisjet e rrjetit.

4. AOS-i të zhvillojnë, implementojnë, mirmbajnë procedurat e sistemit të dedektimit dhe parandalimit të ndërhyrjeve ku të përfshijnë:

a) sistemet NISP, NISD;

b) procedura dhe burime për mirëmbajtjen dhe kontrollin e nënshkrimeve elektronike;

c) procedura dhe burime për analizimin e logeve dhe alerteve në kohë reale;

d) procedura dhe burime për përgjigje ndaj incidenteve të dedektuara (zbuluara);

e) frenkuencat e rishikimit të procedurave dhe burimeve të dedektimit (zbulimit) dhe parandalimit.

5. AOS-i në rastet e ndërlidhjes së sistemeve të aplikojnë sistemet e detektimit dhe parandalimit të ndërhyrjeve në të gjitha nyjat e ndërlidhjes.

6. Lejohet përdorimi i VLAN-eve për ndarjen e trafikut të rrjetit vetëm ndërmjet rrjeteve në të njëjtin nivel klasifikimi.

7. Të përdoren funksionet IPv6 kur është e mundur, në të kundërt t'i çaktivizojnë funksionet IPv6 në të gjitha pajisjet e sistemit.

8. Në sistemet e klasifikuara ndalohet rreptësisht përdorimi i pajisjeve *wireless*.

Neni 63

Videokonferencat, rrjeti telefonik dhe telefonia IP

1. Institucionet shtetërore në rastet e përdorimit të video konferencave dhe telefonisë IP të klasifikuar:

a) të marrin masa për kriptimin e të dhënave.

b) të kryejnë autentifikimin dhe autorizimin për të gjitha veprimet në rrjetin e video konferencave dhe telefonisë IP.

2. Telefonia IP të konfigurohet në mënyrë të tillë që:

a) telefonat IP të autentifikojnë vetveten te menaxhuesi i thirrjeve gjatë regjistrimit;

b) të çaktivizohet funksioni i vetëregjistrimit të pajisjeve dhe të lejohet akses në rrjet vetëm për një listë të mirëpërcaktuar të pajisjeve të autorizuar;

c) të bllokohen pajisjet e paautorizuara;

d) të çaktivizohen funksionet e papërdorura dhe të ndaluara.

3. Trafiku i videokonferencave dhe telefonisë IP të ndahet fizikisht ose logjikisht nga trafiku i të dhënave të tjera të rrjetit.

4. Në zonat e sigurisë ndalohet përdorimi i mikrofonave, kufjeve, receptorëve USB dhe kamerave web.

KREU V

SIGURIMI KRIPTOGRAFIK

Neni 64

Të përgjithshme

1. Institucionet shtetërore të përdorin produkte, algoritma dhe/ose protokolle kriptografike të vlerësuara nga Autoriteti Kombëtar i Sigurimit të Komunikimeve dhe të miratuara nga DSIK për kriptimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” të palëvizshëm ose në transit.

2. DSIK-u mban listën e produkteve, algoritmeve dhe protokolleve kriptografike të miratuar për përdorim.

3. institucionet shtetërore për kriptimin e të dhënave të palëvizshme të përdorin;

a) kriptimin e plotë të diskut.

b) Kriptimin e pjesshëm të diskut me kusht që të lejohet shkrimi vetëm në particione të kriptuara.

4. Produktet kriptografike të ofrojnë një mënyrë për rikuperimin e të dhënave në rast të humbjes ose dëmtimit të çelësit kriptografik, kur është e mundur.

5. Institucionet shtetërore të përdorin kriptimin e të dhënave në transit në rastet kur informacioni i klasifikuar shkëmbehet nëpërmjet infrastrukturës së rrjeteve publike ose rrjeteve me nivel më të ulët të klasifikimit.

Neni 65

Menaxhimi i materialit kriptografik

Institucionet shtetërore duhet që:

1. Të shpërndajnë, menaxhojnë dhe ruajnë pajisjet dhe materialet kriptografike sipas rregullave



dhe procedurave të specifikuara me rregullore të veçantë.

2. Të hartojnë Planin e Menaxhimit të Materialit Kriptografik kur implementojnë sisteme kriptografike që përdorin pajisje kriptografike.

3. Të ruajnë pajisjet dhe materialet kriptografike në zona të sigurisë së klasit I.

4. Të mbajnë dhe përditësojnë regjistrin e aksesit në të cilin të ruhet informacion në lidhje me sistemin kriptografik, si:

a) detaje të personelit që ka akses në sistem në nivel administratori;

b) detaje të personelit që i është hequr aksesit në sistem në nivel administratori;

c) detaje të dokumentave të sistemit;

d) aktivitetet e mbajtjes në llogari të transaksioneve me pajisjet dhe materialet kriptografike;

e) aktivitetet e kontrollit të sigurisë së sistemit.

5. Përpara dhënies së aksesit personelit për sigurinë e komunikimeve të sigurojnë që personat:

a) të kenë nevojën për akses;

b) të lexojnë dhe pranojnë Planin e Menaxhimit të Materialit Kriptografik për sistemin kriptografik që përdorin;

c) të jenë të pajisur me certifikatë të përshtatshme të sigurisë së personelit;

d) të mbrojnë dhe të mos nxjerrin informacionin e autentifikimit të sistemit kriptografik;

e) të pranojnë të mbajnë përgjegjësi për të gjitha veprimet nën llogarinë e tyre;

f) të raportojnë problemet që lidhen me sigurinë në instancat e duhura.

6. Të mbajnë në llogari të gjitha transaksionet që lidhen me materialet e sistemit kriptografik, përfshirë pjesët *hardware* dhe *software* të lëshuara me pajisjet dhe materialet kriptografike, kur janë lëshuar dhe ku.

7. Të inventarizojnë materialin e sistemit kriptografik:

a) gjatë kalimit të përgjegjësive administrative (dorëzimit/marrjes të detyrës) për sistemin kriptografik;

b) gjatë ndryshimit të personelit që ka akses në sistemin kriptografik;

c) të paktën 2 herë në vit;

8. Të kryejnë kontroll të inventarit për të verifikuar nëse materialet e sistemit kriptografik janë në përputhje me dokumentacionin.

9. Të sigurojnë që kontrolli i inventarit të kryhet nga persona të trajnuar për aspektet e sigurisë së komunikimeve.

10. Të anulojnë materialet çelës ose certifikatat nëse dyshohet se janë kompromentuar.

11. Të raportojnë te DSIK për çdo material çelës ose certifikatë që dyshohet se është kompromentuar.

KREU VI

SIGURIA E NDËRLIDHJES SË SISTEMEVE TË KLASIFIKUAR

Neni 66

Të përgjithshme

Për çdo ndërlidhje të SKI-ve, zbatohen kërkesat sa më poshtë:

1. Kërkesat operacionale dhe funksionale të ndërlidhjes të jenë miratuar nga zotëruesit e SKI-ve.

2. Ndërlidhja e SKI-ve kalon në procesin e akreditimit të sigurisë.

3. Të kalojë procesin e vlerësimit, certifikimit dhe/ose të aprovimit të mekanizmave me funksione sigurie nga AKAS.

4. Ndalohet ndërlidhja e SKI-ve që trajtojnë informacion të klasifikuar në nivel “Tepër sekret”.

5. SKI-të që trajtojnë informacion të klasifikuar mund të përdorin internetin ose rrjetet e ngjashme të domain-it publik vetëm si bartëse, me kusht që në to të implementohet mbrojtja e duhur kriptografike.

6. Ndalohet ndërlidhja e SKI-ve në kaskadë.

7. Ndalohet ndërlidhja e SKI-ve me rrjete të paklasifikuara, me përjashtim të rastit të SKI-ve në nivel “i Kufizuar”.

Neni 67

Pajisjet gateway

1. AOS të sigurojnë që:

a) Sistemet të mbrohen nga sistemet e *domain*-eve të tjera me një ose më shumë pajisje *gateway*.

b) Pajisjet *gateway* të përmbajnë mekanizma për filtrimin e rrjedhës së të dhënave në shtresën e rrjetit (nivel rrjeti).

c) Të gjitha lidhjet ndërmjet *domain*-eve të sigurisë të përmbajnë mekanizma për inspektimin



dhe filtrimin e rrjedhës së të dhënave për shtresën e transportit dhe më lart sipas modelit OSI.

2. AOS të sigurojnë që pajisjet *gateway*:

a) janë të vetmet rrugë komunikimi ndërmjet rrjeteve;

b) në gjendje *default*, të pengojnë të gjithë lidhjet brenda dhe jashtë rrjetit;

c) lejojnë vetëm lidhjet e autorizuar në mënyrë eksplicite;

d) janë konfiguruar me masat e përshkruara në këtë rregullore;

e) menaxhohen nëpërmjet një pathi të sigurt të izoluar nga rrjetet e lidhura (fizikisht me *gateway* ose në një rrjet administrues të dedikuar);

f) ofrojnë regjistrim logesh dhe kapacitete të mjaftueshme për Identifikimin e incidenteve të sigurisë kompjuterike, përpjekjet për ndërhyrje dhe *pattern*-e të përdorimit të pazakontë

g) ofrojnë alerte në kohë reale.

3. AOS-i duhet që:

a) të përdorin zonat e demilitarizuara (DMZ) për ofrimin e shërbimeve që aksesohen nga autoritetet e tjera të ndërlidhur;

b) të kryejnë vlerësimin e riskut të sigurisë në pajisjet *gateway* dhe konfigurimet përkatëse përpara implementimit të tyre dhe të kuptojnë e pranojnë riskun e mbetur;

c) të dokumentojnë dhe vlerësojnë të gjitha ndryshimet në arkitekturën e pajisjeve *gateway*;

d) të kufizojnë aksesin në funksionet administrative të pajisjeve *gateway*;

e) të sigurojnë që administratorët janë trajnuar për menaxhimin e pajisjeve *gateway*;

f) të autentifikojnë përdoruesit dhe pajisjet e SKI në rrjetet e klasifikuara që aksesohen nëpërmjet pajisjeve *gateway*;

g) të sigurojnë që vetëm përdoruesit e autentifikuar dhe të autorizuar në një pajisje *gateway* mund ta përdorin atë;

h) të sigurojnë që të gjitha ruhen loget e të gjitha veprimeve (*events*).

Neni 68

Pajisjet *firewall*

AOS-i të përdorin pajisje *firewall* si pjesë e infrastrukturës së ndërlidhjes së sistemeve në të gjitha pikat e ndërlidhura, në mënyrë të pavarur.

Neni 69

Diodat e të dhënave

1. Në ndërlidhje sistemesh njëdrejtimësh ndërmjet rrjeteve të klasifikuara të përdoren dioda të dhënash sipas një liste të njohur sipas standardeve kombëtare, të NATO-s, BE-së dhe të certifikuar me nivelin me të lartë të informacionit i cili trajtohet në këto SKI.

2. AOS-i të monitorojnë volumin e të dhënave që transferohet në diodat e të dhënave.

Neni 70

Përmbajtjet dhe lidhjet web

AOS-i, në rastin e implementimit të faqeve web në rrjetet e klasifikuara duhet:

1. Të hartojnë politikën e përdorimit të sigurt të web-it.

2. Të sigurojnë që aksesin e web-it të kryhet nëpërmjet një web proxy.

3. Të sigurojnë që web proxy të autentifikojë përdoruesit dhe të ruajë loget me detajet e website-ve që aksesohen:

a) adresa URL.

b) koha/data.

c) përdoruesi.

d) sasia e të dhënave të upload-uara dhe download-uara.

e) adresa IP.

Neni 71

Pajisjet KVM switch

1. AOS-i të përdorin pajisje KVM switch sipas një liste të njohur sipas standardeve kombëtare, të NATO-s, BE-së për aksesimin e sistemeve sipas rasteve:

a) sistem i klasifikuar dhe sistem i paklasifikuar;

b) sisteme me nivele të ndryshme klasifikimi;

c) sisteme në të njëjtin nivel klasifikimi por në *domaine* të ndryshme.

2. Pajisjet KVM switch duhet:

a) të operohen manualisht;

b) të kenë të ndarë përshtatshmëri dhe në mënyrë të dukshme kabllot nga sisteme të ndryshme;

c) të përmbajë tregues për të njoftuar përdoruesin në rastet kur kalohet në sisteme të paklasifikuar;



d) të inspektohen rregullisht lidhur me mirëfunksionimin e tyre.

3. Pajisjet KVM switch nuk duhet të kenë procesor ose memorje të brendshme.

4. Pajisjet KVM switch nuk lejohet të lidhen me sisteme të paklasifikuara të cilat kanë konvertues Analog-Digital.

Neni 72

Politika dhe procedurat e transferimit të të dhënave

AOS-i të sigurojnë që:

1. Veprimet e përdoruesve që shkëmbejnë të dhëna ndërmjet sistemeve të ruhen në log-e.

2. Përdoruesit të parandalojnë incidentet kompjuterike nëpërmjet:

a) kontrollit të shenjëzimeve për të siguruar që sistemi destinacion është i përshtatshëm për administrimin e të dhënave që transferohen;

b) kryerjen e kontrollit kundër viruseve në të dhënat që transferohen;

c) ndjekjen e proceseve dhe procedurave për transferimin e të dhënave.

3. Të dhënat e importuara në sistem duhet:

a) të skanohen për përmbajtje keqdashëse dhe aktive;

b) të kontrollohet formati i të dhënave;

c) të ruhen loget për çdo ngjarje;

d) të monitorohen për identifikimin e modeleve të pazakonta të përdorimit.

4. Të dhënat e eksportuara në sistem:

a) të kontrollohen për shenjëzimet përkatëse;

b) të ruhen loget për çdo ngjarje;

c) të monitorohen për identifikimin e modele të pazakonta të përdorimit;

d) të kontrollohet formati i të dhënave;

e) të bëhen kontrole të fjalëve;

f) të ketë procedura për kontrollin e madhësisë së skedarëve.

5. Transferimi i të dhënave të kryhet në përputhje me procedurat e miratuara të institucionit.

KREU VII

PUNA JASHTË ZONAVE TË SIGURISË

Neni 73

Pajisjet e lëvizshme

AOS-i të kryejnë veprimet e mëposhtme:

1. Të dokumentojnë procedurat e përdorimit të sigurt të pajisjeve të lëvizshme.

2. Të vlerësojnë dhe dokumentojnë riskun që lidhet me përdorimin e pajisjeve të lëvizshme.

3. Të krijojnë informacionin që administrohet në pajisjet e lëvizshme me një produkt kriptografik të akredituar.

4. Në rast të përdorimit të pajisjeve të lëvizshme për komunikimin e informacionit të klasifikuar mbi infrastrukturën e rrjeteve publike, të përdorin produkte kriptografike të akredituar për kriptimin e këtij informacioni.

5. Në rast të lejit të pajisjeve të lëvizshme për aksesimin e informacionit të klasifikuar të ndalojnë instalimin dhe çinstalimin e aplikacioneve nga përdoruesit.

6. Në rast të lejit të pajisjeve të lëvizshme për aksesimin e informacionit të klasifikuar mos lejohet çaktivizimin e funksioneve të sigurisë nga përdoruesit.

7. Në rast të përdorimit të sistemeve nëpërmjet lidhjeve VPN të çaktivizohet *split tunneling* në pajisjet që e suportojnë këtë funksionalitet.

8. Në rast se ofrohet funksion i zerimit ose sanitizimit të çelësve kriptografikë në pajisjet e lëvizshme, ky funksion të përdoret si pjesë e procedurave të asgjësimit në raste emergjence.

9. Të mos lejojnë përdorimin e pajisjeve të lëvizshme për përpunimin ose ruajtjen e informacionit të klasifikuar në nivel “Tepër sekret” përveçse me miratim të DSIK-së.

10. Të mos lejojnë pajisjet e lëvizshme që nuk janë në zotërim të institucionit për aksesimin dhe/ose administrimin e informacionit të klasifikuar.

11. Të mos lejojnë futjen e pajisjeve të lëvizshme që nuk janë në zotërim të institucionit pa autorizimin me shkrim të titullarit të institucionit.

12. Të mos lejojnë funksionet *bluetooth*, *wireless* apo *infrared* në pajisjet e lëvizshme.



Neni 74

Pajisjet e lëvizshme jashtë zonave të sigurisë

Për pajisjet e lëvizshme jashtë zonave të sigurisë, AOS-i të kryejë veprimet e mëposhtme:

1. Të sigurojnë që pajisjet e lëvizshme transportohen në mënyrë të sigurt jashtë zonave të sigurisë pas autorizimit të AOS-it.
2. Pajisjet e lëvizshme jashtë zonave të sigurisë të mbahen nën mbikëqyrje të vazhdueshme.
3. Personeli që udhëton jashtë shtetit me pajisje të lëvizshme:
 - a) të aplikojë patch-et e aplikacioneve dhe sistemeve operative;
 - b) të implementojë autentifikim multifaktorial;
 - c) të kryejë back-up-in e të dhënave;
 - d) të heqë informacionet e panevojshme nga pajisja;
 - e) të çaktivizojë aplikacionet që nuk janë të rëndësishme për periudhën e udhëtimit;
 - f) të çaktivizojë lidhjet bluetooth, wireless dhe infrared;
 - g) t'i mbajë ato nën kontroll gjatë gjithë kohës.

KREU VIII

**INCIDENTET E SIGURISË
KOMPJUTERIKE DHE PROCEDURAT E
RAPORTIMIT**

Neni 75

**Përgjigja ndaj incidenteve të sigurisë
kompjuterike**

1. Institucionet shtetërore të zhvillojnë, implementojnë dhe mirëmbajnë mjete dhe procedura për Identifikimin dhe raportimin e incidenteve të sigurisë së sistemeve.
2. Për trajtimin e incidenteve të sigurisë të caktohet personel me kualifikimin e duhur profesional.
3. Incidentet që lidhen me sigurinë e sistemeve të regjistrohen në regjister të veçantë. Në këto regjistra të regjistrohen minimalisht të dhënat e mëposhtme:
 - a) data e verifikimit të incidentit të sigurisë;
 - b) data kur ka ndodhur incidenti i sigurisë;
 - c) një përshkrim i incidentit të sigurisë, përfshirë personelin dhe mjediset e përfshira;
 - d) veprimet e marra;

- e) kujt i është raportuar incidenti;
- f) dokumenti referencë i përfshirë në incident (nëse ka të tillë).

4. Incidentet që lidhen me sigurinë e sistemeve të raportohen në strukturat e duhura me qëllimin përgjigjen, hetimin dhe inspektimin në përputhje me legjislacionin për sigurinë e SKI-ve.

Neni 76

Njoftimi i DSIK për incidentet

Kushtet në të cilat DSIK duhet njoftuar menjëherë pas ndodhjes së incidentit janë:

1. Thyerjet e sigurisë që prekin informacionin e klasifikuar.
2. Përhapje e paautorizuar e informacionit në mediat publike ose entitete të tjera.
3. Akses i paautorizuar i të dhënave.
4. Dyshime për spiunazh, sabotazh ose terrorizëm.
5. Aktivitete të brendshme keqdashëse (p.sh., kërcënim i brendshëm).
6. Incidente që përfshijnë akses të privilegjuar në SKI.
7. Incidente që përfshijnë elemente kriptografikë.
8. Incidente që cenojnë sigurinë kombëtare.

Neni 77

Operatorët ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë/kontraktorët gjatë realizimit të kontratave të klasifikuara të përdorin SKI të akredituara përshtatshëmrisht.
2. Periudha e vlefshmërisë së akreditimit është në përputhje me afatet e zbatimit të kontratës së klasifikuar, por jo më tepër se 3 vjet.
3. Për operatorët ekonomikë ndalohet akreditimi i SKI-ve në nivel “Tepër sekret” ose ekuivalent.
4. Ndalohet ndërlidhja e SKI-ve për operatorët ekonomik/kontraktorët me SKI të institucioneve shtetërore.

Neni 78

Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Ministritë, institucionet shtetërore dhe Operatorët Ekonomik/Kontraktorët të marrin masa për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.



2. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar për kontrollin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje.

3. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Drejtoria e Shifrës për ngritjen e autoriteteve përkatëse brenda vitit 2020.

4. Institucionet shtetërore të cilat nuk përmbushin standardet e sigurisë për ngritjen e strukturave të parashikuara në këtë vendim, të marrin masat për arritjen e standardeve brenda 2021.

5. Ministritë, institucionet shtetërore dhe operatorët ekonomikë, duhet që brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin udhëzimet përkatëse për zbatimin e tij.

6. Vendimi nr. 922, datë 19.12.2007 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)”, shfuqizohet.

Neni 79

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM QARKULLUES

Nr. 23, datë 12.7.2019

PËR PËRJASHTIMIN NGA SKEMA DHE REVOKIMIN E CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË BANKËS NDËRKOMBËTARE TREGTARE SHA, TË PËRTHITHUR NGA BANKA UNION SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 28, pika 1, të nenit 30, pika 1, shkronja “a”, të nenit 31, pika 6, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 7, pika 6, të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 8, pika 3 dhe nenit 9, pika 4 të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar, të nenit 10, pika 6, të nenit 18, pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së

Sigurimit të Depozitave”, të nenit 24, pika 1, shkronja “k”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 220, pika 3, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 53, datë 3.7.2019 “Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Union sh.a. me Bankën Ndërkombëtare Tregtare sh.a.”, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën Ndërkombëtare Tregtare sh.a. të përthithur nga bashkimi me Bankën Union sh.a.

2. Të revokojë certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. Ngarkohet Banka Union sh.a., që të dorëzojë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Banka Union sh.a. që të mbajë të veçuara depozitat e siguruar të subjekteve pjesëmarrëse në këtë proces, për një periudhë tre-mujore nga hyrja në fuqi e revokimit të licencës të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a., që përkon me çregjistrimin e kësaj të fundit si shoqëri e përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.

5. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me çregjistrimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a. si shoqëri e përthithur.

KRYETAR I AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE
Donald Duraj



KËRKESE

Shtetasi Florjan Çera, i datëlindjes 18.6.1995, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Edison Çera, më datë 15.2.1992, për shkaqe natyrore.

KËRKUES
Florjan Çera

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 1036 lekë